

BIBLIOTEKA

80  
8.95

# GJUHA LETRARE SHQIPE

për  
të gjithë

SHTËPIA BOTUESE E LIBRIT SHKOLLOR  
TIRANË, 1976

30  
895

# GJUHA LETRARE SHQIPE

## PËR TË GJITHË

Elemente të normës së sotme letrare  
kombëtare



SHTËPIA BOTUESE E LIBRIT SHKOLLOR  
TIRANË, 1976

**Komisioni hartues**

**Prof. Androkli KOSTALLARI (kryetar),  
Emil LAFE, Menella TOTONI, Nikoleta CIKULI**

## PARATHËNIE

*Kujdesi i vazhdueshëm i shoqërisë sonë për zhvillimin e gjuhës letrare kombëtare dhe për zbatimin e normave të saj ka marrë një hov të ri sidomos pas Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe (nëntor 1972). Ky «kuvend historik», siç e theksoi shoku Enver Hoxha, ishte «një fitore e pallogaritshme në mes aq fitoreve të tjera madhështore që ka korrur populli ynë me luftë, me përpjekje e me zotësi» dhe i dha «një shkëlqim akoma më të madh gjuhës, thesarit më të madh të një populli». Gjatë këtyre viteve të fundit në të gjithë vendin tonë është duke u zhvilluar një veprimtari e shumanshme për të vënë në jetë porositë e këtij Kongresi, të cilat kanë gjetur shprehjen e tyre edhe në vendimin e Këshillit të Ministrave «Mbi masat për zbatimin e drejtshkrimit të njësuar të gjuhës shqipe» (mars 1974). Shtresa gjithnjë e më të gjera punonjësish po interesohen gjallërisht që ta përdorin mirë, drejt e pa gabime gjuhën e sotme letrare. Zotërimi dhe zbatimi i rregullave të drejtshkrimit është, natyrisht, detyra e parë në këtë fushë. Por norma letrare kombëtare, siç dihet, është më e gjerë se drejtshkrimi. Gjuha letrare është një tërësi e përbërë: ajo ka sistemin e saj fonetik e gramatikor, strukturën leksikore e fjalëformuese dhe stilet e saj funksionale. Te të gjitha këto veprojnë ligje e rregulla të caktuara, prandaj për ta shkruar e për ta folur drejt gjuhën letrare duhet të njihen e të zbatohen drejt edhe këto ligje e rregulla.*

*Libri «Gjuha letrare shqipe për të gjithë», i cili plotëson një nga detyrat që shtrohen në vendimin e lartpërmendur të Këshillit të Ministrave, synon pikërisht që të japë disa rregulla kryesore të sistemit gramatikor e fjalëformues të gjuhës sonë të sotme letrare, si edhe disa norma udhërrëfyese të drejtshqiptimit, të cilat pasqyrojnë një varg tiparësh të rëndësishme të sistemit fonetik. Bashkë me «Drejtshkrimin*

e gjuhës shqipe», *ky libër do t'i shërbejë masës së gjerë të punonjësve si mbështetje për të zotëruar në mënyrë të vetëdijshme normën e sotme letrare. Në mënyrë të veçantë ai do t'i ndihmojë punonjësit të zbatojnë drejt normën në rastet kur vihen re luhatje të saj ose kur ndeshen trajtat normative me trajta jonormative.*

*Ky libër u drejtohet, në radhë të parë, atyre që e kanë kryer shkollën tetëvjeçare, tekstet e së cilës mbeten kurdoherë baza e formimit gjuhësor të brezave të rinj e të gjithë punonjësve. Komisioni hartues është përpjekur që lënda të paraqitet në mënyrë sa më të kuptueshme, duke bashkuar argumentimin shkencor të pohimeve e të rregullave me shpjegimin e tyre në mënyrë sa më të qartë e të thjeshtë. Konkluzionet dhe udhëzimet normative të këtij teksti mbështeten në studimet monografike e në punimet sintetizuese për gjuhën letrare shqipe dhe në mënyrë të veçantë në studimet më të reja për formimin e gjuhës letrare kombëtare shqipe, për tiparet themelore të normës së sotme letrare e për prirjet e zhvillimit të saj<sup>1</sup>). Me qëllim që rregullat e pohimet të jenë sa më objektive, për hartimin e këtij teksti janë shfrytëzuar edhe kartotekat gjuhësore të Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë të Akademisë së Shkencave.*

*Libri që po u jepet lexuesve përbëhet prej katër pjesësh: I. Çështje të morfologjisë, II. Çështje të sintaksës, III. Çështje të formimit të fjalëve dhe IV. Disa nga rregullat kryesore të drejtshqiptimit të gjuhës letrare shqipe<sup>2</sup>). Përcaktimi i problemeve e i zgjidhjeve normative që jepen në këtë tekst është bërë në mënyrë kolegjiale nga komisioni hartues, nën drejtimin shkencor të prof. A. Kostallarit. Pjesët I dhe III janë shkruar nga E. Lafe, pjesa II nga M. Totoni dhe pjesa IV nga N. Cikuli. Përpunimi e njësimi shkencor i gjithë tekstit, si edhe redaktimi i tij përfundimtar janë bërë nga prof. A. Kostallari, i cili ka bashkëpunuar edhe për hartimin e pjesëve I, III, IV.*

- 1) Në fund të tekstit jepet një listë e studimeve më të rëndësishme për gjuhën e sotme letrare, të cilat mund të shërbejnë si literaturë plotësuese për ata që dëshirojnë të thellojnë e të zgjerojnë njohuritë e tyre në këtë fushë.
- 2) Në bazë të vendimeve të Kongresit të Drejtshkrimin në Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë të Akademisë së Shkencave po hartohet një trajtesë më e plotë dhe më e hollësishme e drejtshqiptimit të gjuhës shqipe.

Veçoria dalluese e këtij teksti është se në të, në truallin e trajtave e të përdorimeve normative, i tërhiqet vëmendja lexuesit te rastet më të shpeshta të shmangieve nga norma e sotme letrare, te vështirësitë e te ndikimet e dëmshme që pengojnë sot zbatimin e normës. Për këtë arsye, në pjesët e në kapitujt e këtij teksti nuk është bërë kudo një paraqitje e plotë e sistematike e normës së gjuhës së sotme letrare, por janë dhënë vetëm një varg elementesh themelore të kësaj norme. Kështu, ky libër jo vetëm nuk e përjashton nevojën e teksteve shkollore të gjuhës shqipe, por e parakupton këtë, sepse në tekstet shkollore sistemi gramatikor i gjuhës sonë letrare shijellohet në mënyrë të plotë e tërësore.

Gjuha është një fenomen shoqëror që zhvillohet vazhdimisht. Edhe në gjuhë lindin elemente të reja, dalin nga përdorimi elemente të vjetra ose bashkëjetojnë elemente të reja me elemente të vjetra. Kjo do të thotë se edhe në normën letrare, krahas shtresave të qëndrueshme, ka edhe elemente që ndodhen në lëvizje. Në disa raste norma e sotme letrare nuk është e njësuar, por paraqitet me dy variante. Këto variante normative mund të jenë plotësisht të barasvlershme ose njëri prej tyre mund të jetë varianti kryesor që mbizotëron në përdorimin e sotëm a që është më i drejtë nga pikëpamja e sistemit të gjuhës letrare kombëtare. Nga këto variante me kohë mund të kalohet në një normë të njësuar, por ato mund të fitojnë edhe ngjyrimë kuptimore a stilistike të veçanta dhe të përdoren në gjuhë si mjete stilistike-shprehëse. Bashkëpërdorimi i disa varianteve normative është një dukuri e natyrshme, e ligjshme për gjuhët letrare. Ai është një shfaqje e vetë ngulitjes së normës dhe e zhvillimit të gjuhës, sepse nga shumësia e varianteve të gjuhës së folur popullore ose të gjuhës së shkruar mbi baza dialektore gjuha letrare ka zgjedhur dy prej tyre.

Nga variantet normative duhen dalluar në mënyrë të prerë trajtat jonormative dhe trajtat e gabuara, të cilat janë në kundërshtim të plotë me strukturën e gjuhës dhe duhen përjashtuar fare nga gjuha letrare. Këto trajta, që lindin në gjuhën e folur për arsye të ndryshme, përdoren herë-herë edhe në gjuhën letrare për shkak të njohjes së pamjaftueshme të normave të saj.

Lufta për zotërimin e gjuhës letrare kombëtare dhe për zbatimin e plotë të normave të saj është bërë sot një pjesë e rëndësishme e jetës kulturore të popullit tonë. Gjuha, siç dihet, është mjete më i rëndësi-

shëm i marrëdhënieve midis njerëzve. Ajo luan një rol të madh për njohjen e botës, për kalimin e dijeve e të përvojës nga brezi në brez dhe për edukimin e njerëzve. Zbatimi i plotë i normës letrare ia zgjeron gjuhës mundësitë për ta kryer sa më mirë funksionin e saj komunikues në shoqëri. Gjuha letrare e njësuar dhe e normuar bëhet kështu një mjet i rëndësishëm për zhvillimin e arsimit e të kulturës, për forcimin e bashkimit shpirtëror të popullit, për përparimin e gjithë shoqërisë sonë socialiste që udhëhiqet nga Partia e Punës.

Sot Shqipëria është e mbushur me një rrjet të dendur shkollash të arsimit të përgjithshëm e profesional. Shtypi dhe botimet e tjera përhapen kudo, deri në fshatrat më të largëta. Fjala e folur letrare kumbon anembanë vendit nëpërmjet radios e televizionit, teatrit e kinematografisë, në klasa e në auditore, në mbledhje, konferenca, kongrese e mitingje popullore. Vetë masat punonjëse, ndërtueset aktive të shoqërisë socialiste, në veprimtarinë e tyre të përditshme synojnë të përdorin gjithnjë e më shumë gjuhën e njësuar letrare, rrezja e veprimit të së cilës është shtrirë në çdo skaj të atdheut. Të gjitha këto kërkojnë që organet dhe institucionet e ndryshme shtetërore ta përmirësojnë rrënjësisht punën e tyre për gjuhën, në mënyrë që gjuha letrare kombëtare të zotërohet plotësisht në të gjithë sistemin e saj nga shtresa sa më të gjera punonjësish dhe që shkalla e kulturës gjuhësore të masave të ngrihet më lart si në qytet, ashtu edhe në fshat. Në këtë punë me përpjesëtime kaq të gjera detyra të mëdha i dalin në radhë të parë shkollës sonë, që është vatra themelore e brumosjes dhe e edukimit gjuhësor të brezave të rinj. Sot, më tepër se kurrë, në gjithë veprimtarinë e shkollës bëhet e domosdoshme që të përdoret një gjuhë letrare e përpiktë, e pastër dhe e kulturuar, duke synuar që jo vetëm gjuha e teksteve të jetë plotësisht e normuar, e njësuar, por edhe që të folurit e mësuesit e të nxënësit të çlirohet nga të gjitha luhatjet e ndikimet dialektore, të vihet në përputhje të plotë me gjuhën e tekstit. Një kujdes më i madh për gjuhën kërkohet sot gjithashtu nga punonjësit e shtypit e të botimeve, të radios e të televizionit, të teatrove etj., sepse me punën e tyre ata ndikojnë përditë dhe në mënyrë të fuqishme për përhapjen e normës letrare kombëtare.

Ne shpresojmë se te libri «Gjuha letrare shqipe për të gjithë» punonjësit e arsimit e të kulturës, të shtypit e të botimeve, të fushave të ndryshme ku vepron sidomos trajta gojore, e folur, e gjuhës letrare,

*punonjësit e organeve shtetërore e të organizatave të masave, gjithë punonjësit e qytetit e të fshatit do të gjejnë një ndihmë të mirë për punën e tyre të përditshme gjuhësore dhe do ta shfrytëzojnë atë me kujdes në përpjekjet e pandërprera për një gjuhë shqipe sa më të përpiktë, të qartë e të njësuar dhe sa më të pasur e të zhdërvjellët.*

*Komisioni hartues është i vetëdijshëm se në këtë botim të parë të librit «Gjuha letrare shqipe për të gjithë» nuk përfshihen as të gjitha fushat, as të gjitha çështjet që kanë nevojë të ndriçohen nga këndi i vështrimit të normës gjuhësore kombëtare. Një trajtim të veçantë do të kërkonin sidomos çështjet e normës leksikore — përdorimi i drejtë i fjalëve e i kuptimeve të tyre, lufta kundër fjalëve të huaja të panevojshme që prishin pastërtinë e qartësinë e gjuhës sonë letrare, disa çështje të stilistikës leksikore etj. Kërkesa të ndryshme, të përgjithshme e të veçanta, mund të paraqiten nga lexuesit. Të gjitha këto kërkesa e vërejtjet e lexuesve do të mirëpritën nga komisioni hartues, si një ndihmë e rëndësishme për ta plotësuar e për ta përmirësuar më tej këtë libër në botimet e mëvonshme.*

**Komisioni hartues**



PJESA E PARË

ÇËSHITJE TË MORFOLOGJISË

# I EMRI

## GJINIA

§ 1. Gjinia e emrave në shumicën dërrmuese të rasteve mund të dallohet morfologjikisht nga mbaresat që marrin ata në trajtën e shquar të rasës emërore të njëjësit:

emrat mashkullorë marrin mbaresën **-i** ose **-u**: *plep-i, mendim-i, vëlla-i, burr-i* (burrë), *gjum-i* (gjumë), *zog-u, dhe-u* etj.;

emrat femërorë marrin mbaresën **-a** ose **-ja**:<sup>1)</sup> *këng-a, pushk-a, shtëpi-a, lule — lul-ja, ujitje — ujit-ja, radio — radio-ja* etj.;

emrat asnjane marrin mbaresën **-t(ë)** ose **-it**: *të ftohtë-t, të verdhë-t, të zi-të, të ecur-it* etj.

**Shënim.** Këtu është fjala në radhë të parë për emrat e përgjithshëm. Gjinia gramatikore e emrave të përveçëm të njerëzve përcaktohet nga seksi i personit përkatës, p.sh. *Lekë — Leka, Dedë — Deda, Kolë — Kola, Koço — Koçoja* janë emra mashkullorë, megjithëse shkojnë pas lakimit të emrave femërorë, nga ana tjetër, emra si *Nermin-i, Antigoni* etj., janë emra femërorë, megjithëse shkojnë pas lakimit të emrave mashkullorë. Po kështu disa emra si *axhë — axha, dajë — daja, gegë — gega, toskë — toska*, që shënojnë frymorë të seksit mashkullor, megjithëse shkojnë pas lakimit të emrave femërorë, i përkasin gjinisë mashkullore<sup>2)</sup> (Janë emra mashkullorë të lakimit të tretë, —shih më poshtë §38).

Gjinia gramatikore e emrave të mësipërm, të përveçëm e të përgjithshëm, shprehet sintaktikisht: fjalët përcaktuese dhe fjalët e tjera që përshtaten me këta emra, vihen në trajtën e gjinisë mashkullore, p.sh.: *Leka i Madh; Kola është punëtor i dalluar; Nermini është punëto-re e dalluar; axha im; daja i vogël* etj.

1) Marrin **-ja** në trajtën e shquar vetëm emrat që dalin më **-e** ose **-o** të patheksuar  
2) Shih edhe «Drejtshkrimi i gjuhës shqipe» § 8a.

§ 2. Ka një numër emrash, të cilët dikur përdoren në mbarë gjuhën si asnjat dhe e formonin trajtën e shquar të emërores e të kallëzores me mbaresën **-t**, p.sh.: *drithë-t*, *gjalpë-t* etj. Kjo formë dëgjohet ende sot nëpër dialektet e në të folurit e brezit të vjetër. Në gjuhën letrare të sotme këta emra përdoren si mashkullorë, d.m.th. e formojnë trajtën e shquar të emërores së njëjësit me mbaresën **-i** dhe trajtën e shquar të kallëzores me mbaresën **-in**. Emrat në fjalë janë:

<b>ballë</b> - balli - ballin	<b>gjalpë</b> - gjalpi - gjalpin
<b>brumë</b> - brumi - brumin	<b>lesh</b> - leshi - leshin
<b>djathë</b> - djathi - djathin	<b>miell</b> - mielli - miellin
<b>drithë</b> - drithi - drithin	<b>mish</b> - mishi - mishin
<b>dyllë</b> - dylli - dyllin	<b>mjaltë</b> - mjalti - mjaltin
<b>dhallë</b> - dhalli - dhallin	<b>ujë</b> - uji - ujin
<b>dhjamë</b> - dhjami - dhjamin	<b>vaj</b> - vaji - vajin
<b>grurë</b> - gruri - grurin	

**Shënim 1.** Trajtat asnjatose të këtyre emrave mund të përdoren në vepra letrare për të individualizuar ndonjë personazh me anë të gjuhës ose për të karakterizuar gjuhën e një epoke të kaluar. Ato mund të përdoren gjithashtu edhe në shprehje frazeologjike, p.sh.: *m'u ngjeth mishtë*, ose kur kanë marrë një kuptim të veçantë, p.sh.: *ujët* (në kuptimin «ujët e hollë»), *dhjamët* (në mjekësi, p.sh.: *operoi dhjamët*).

**Shënim 2.** Emri *krye*, kur përdoret me kuptimin «kokë», në rasën emërore ose kallëzore, është kurdoherë asnjatose dhe e formon trajtën e shquar me mbaresën **-t**, p.sh.: *më dhemb kryet*, ndërsa, kur përdoret me kuptimin «kryetar, i parë» ose «kapitull» (libri) është kurdoherë mashkullor dhe e formon trajtën e shquar me mbaresën **-u**, p.sh.: *kreu i vendit*, *kreu i tretë* etj.

§ 3. Një numër emrash, të cilët janë përdorur më parë edhe si mashkullorë, edhe si femërorë ose përdoren ende kështu nëpër të folme të ndryshme, kanë kaluar sot përfundimisht në gjininë mashkullore, p.sh.: *borxh-i*, *djep-i*, *kryq-i*, *ligj-i*, *lot-i*, *nder-i*<sup>1)</sup>, *pyll-i*, *qiell-i*, *shëndet-i*, *turp-i* etj.; po kështu edhe: *problem-i*, *program-i*, *komunizm-i*, *marksizm-i*, *organizm-i*, *reumatizm-i*, *sarkazm-i*, *socializm-i* etj.

1) Për këtë arsye duhet thënë *falemnderit*, *falemnderit* dhe jo *falemnderës*, *falemnderës*.

Trajtat femërore të tyre, si *borxha, djepja, ligja, lodja, ndera, problema, komunizma, reumatizma, sarkazma* etj., kanë dalë jashtë normës së sotme letrare dhe nuk duhen përdorur. Emri *furrë* është i gjinisë femërore: *furra* (dhe jo *furri*).

## SHUMËSI I EMRAVE

§ 4. Mjetet e formimit të trajtës së shumësit të emrave në gjuhën e sotme letrare janë të larmishme.

Në përgjithësi, trajta e shumësit formohet me anë mbaresash. Nga këto më të përdorshmet janë: -ë, -a, -e, p.sh.: *anëtarë, gurë, lekë, shoferë* etj.; *dema, fusha, kodra, pëllumba, vegla* etj.; *aksione, fise, kombe, shtete* etj.

Një vend të rëndësishëm ndër mjetet e formimit të shumësit zënë edhe mbaresat -nj e -ra, p.sh.: *arinj, mullinj, penj, heronj, ftonj* etj.; *dhjamëra, fshatra, mallra, ujëra* etj.

Një numër emrash e kanë trajtën e shumësit të njëllotjës me trajtën e njëjësit, p.sh.: *një nxënës — shumë nxënës, një mësues — shumë mësues, një ditë — shumë ditë, një kala — shumë kala, një ide — shumë ide, një shtëpi — shumë shtëpi, një lagje — shumë lagje, një depo — shumë depo* etj.

Disa emra e formojnë trajtën e shumësit duke pësuar ndërrime tingujsh në temën e tyre. Ndërrimet kryesore janë: **a>e, e>i, k>q, g>gj, ll>j, r>j**. Një pjesë nga këta emra marrin edhe një mbaresë, p.sh.: *breg — brigje, rrezik — rreziqe, kunat — kunetër* etj., kurse të tjerët nuk marrin mbaresë: *dash — desh, mik — miq, plak — pleq, kungull — kunguj, bir — bij* etj.

Për shkak të ndikimit të dialekteve ose të varianteve letrare të mëparshme, për disa tipa emrash në gjuhën e folur e në gjuhën e shkruar nganjëherë ndeshen ende dy ose më shumë trajta shumësi, p.sh.: *oficera e oficerë, xhepa e xhepe, nxënës* (trajtë pa mbaresë) e *nxënësa, dardhë, gjurmë* (trajta pa mbaresë) e *dardha, gjurma* etj. Në këto raste, zakonisht, vetëm njëra nga trajtat është në pajtim me normën e sotme letrare, ndërsa trajta tjetër nuk është normative dhe

duhet mënjanuar nga përdorimi letrar. Në paragrafët më poshtë do të tregojmë se cilat janë trajtat normative në këto raste. Por më parë le të shikojmë disa rregulla të formimit të trajtës së shumësit në gjuhën letrare.

## SHUMËSI I EMRAVE MASHKULLORË

§ 5. E formojnë shumësin rregullisht me mbaresën -ë emrat mashkullorë që dalin më:

- ac: *kupacë, përtacë, tullacë* etj.;
- aç: *gungaçë, gjembaçë, kulaçë, trazovaçë* etj. (por: *ilaç — ilaçe*);
- af: *çarçafë, fotografë, paragrafë* etj.;
- ak: *binjakë, fshatarakë, fusharakë, kapakë, rosakë, ushtarakë* etj.;
- aq: *hutaqë, shkataraqë* etj.;
- ash: *balashë, gjumashë, larashë* etj.;
- eç: *gjyveçë, kryeneçë* etj.;
- ek: *byrekë, direkë, dyfekë, dyshekë, fishekë, hendekë, lejlekë, mjekë* etj.;
- en: *hostenë, kapitenë, legenë, sejmenë, sergjenë* etj. (bëjnë përjashtim: *beden — bedena, liqen — liqene*);
- ik: *akademikë, calikë, diabetikë, historikë, ibrikë, klerikë, romantikë, zhapikë* etj. (por: *armik — armiq, fik — fiq, mik — miq*);
- in: *beduinë, kofinë, latinë, pinguinë, qefinë* etj.;
- ist: *aksionistë, aktivistë, artistë, ballistë, çiklistë, egoistë, futbollistë, kapitalistë, komunistë, kooperativistë, koristë, leninistë, marksistë, specialistë, sportistë, traktoristë, turistë* etj.;
- ok: *maçokë, malokë, misërokë, mjeshtërokë, patokë, shokë* etj.;
- or: *agresorë, ambasadorë, banorë, dëshmorë, fjalorë, frymorë, kryqëzorë, malësorë, profesorë, punëtorë, traktorë, vaporë*

etj. (por: *auditor* — *auditore*, *kor* — *kore*, *korridor* — *korridore*);

**-osh:** *baloshë*, *barkoshë*, *kataroshë*, *mjekroshë*, *trimoshë* etj. (bëjnë përjashtim: *kosh* — *kosha*, *djalosh* — *djelmosha*);

**-ot:** *despotë*, *dhespotë*, *himarjotë*, *patriotë*, *suljotë* etj. (bën përjashtim *lot*, që e ka shumësin njësoj si njëjës, por në trajtën e shquar *lot-ët*);

**-tar:** *çlirimtarë*, *këngëtarë*, *lojtarë*, *luftëtarë*, *shkrimtarë* etj.;

**-tor:** *fajtorë*, *konsumatorë*, *kultivatorë*, *muratorë*, *punëtorë* etj.;

**-uk:** *bishtukë*, *kopukë* etj.

Fjalët e mësipërme e formojnë shumësin me mbaresën -ë, edhe në rast se përdoren si mbiemra në gjininë mashkullore, p.sh.: *djem binjakë*, *shkrimtarë romantikë*, *nxënës punëtorë* etj. E formojnë trajtën e shumësit me mbaresën -ë edhe të gjithë mbiemrat e tjerë të panyjshëm mashkullorë, që dalin me fundoret<sup>1)</sup> e mësipërme, p.sh.: *dredharakë*, *artistikë*, *çamarokë* etj.

§ 6. E formojnë shumësin përgjithësisht me mbaresën -ë emrat mashkullorë që dalin më:

**-(i)an:** *aeroplanë*, *evropianë*, *fazanë*, *fidanë*, *filxhanë*, *fizikanë*, *gjerdanë*, *jargavanë*, *jorganë*, *havanë*, *hidroplanë*, *historianë*, *kazanë*, *luanë*, *matematikianë*, *partizanë*, *politikanë*, *republikanë*, *sahanë*, *shandanë*, *shejtanë*, *timpanë*, *tiganë*, *tiranë* etj.;

**-ar:** *barbarë*, *detarë*, *fshatarë*, *hambarë*, *kalendarë*, *këpuçarë*, *korçarë*, *skenarë*, *ushtarë* etj.;

**-ec:** *dordolecë*, *guralecë*, *memeçë*, *mistrecë*, *pijanecë* etj.;

**-er:** *berberë*, *fenerë*, *frigoriferë*, *kaloriferë*, *oficerë*, *shoferë* etj.;

**-ir:** *ilirë*, *vampirë*, *zinxhirë* etj.;

**-ol:** *gogolë*, *kaqolë* etj.;

**-on:** *bidonë*, *timonë*, *vagonë* etj.;

**-un:** *bastunë*, *majmunë*, *pirunë*, *sapunë*, *spiunë* etj.

Me mbaresën -ë e formojnë trajtën e shumësit edhe mbiemrat mashkullorë që dalin me fundoret e mësipërme, p.sh.: *djalosharë*, *barkalecë*, *grindavecë* etj.

1) Fundore quhet tingulli ose tingujt e fundit të fjalës që shërbejnë si tipar klasifikues a karakterizues i saj.

Një numër emrash që dalin me të njëjtat fundore si emrat e mësipërm, nuk e formojnë shumësin me mbaresën -ë, po me -a ose me -e. Më poshtë po shënojmë më të përdorshmit prej tyre.

Me mbaresën -a:

- an: *mana, patëllxhana;*
- ec: *bishtaleca, karkaleca, kastraveca, keca, spec;*
- on: *gramafona, magnetofona, mikrofonta, telefona* (dhe të gjitha fjalët e huaja të përbëra, që kanë si gjymtyrë të dytë -fon), *kupçna, napolona;*
- ol: *gola, qafola, shkolla, stola;*
- un: *çuna, zhguna.*

Me mbaresën -e:

- an: *divane, duhane, dyqane, hane, karvane, mejdane, oqëane, organe, plane, stane, tavane, vullkane<sup>1)</sup>;*
- ar: *honorare, orare, pazare, qilare, seminare, tipare, thesare, visare, zare etj.*
- ec: *kotece;*
- er: *dikastere, karaktere, mermere, mindere, mistere etj.;*
- ir: *hire, manastire, panairë;*
- on: *ballkone, ciklone, elektrone, frone, hone, hormone, kone, protone, sallone, shabllone, zakone;*
- un: *kanune.*

§ 7. Emrat që dalin më -al, -ant, -at, -az, -el, -ent, -ez, -id, -it, -ont, si rregull, e formojnë shumësin me mbaresën -ë, kur shënojnë frymorë, dhe me -e (ndonjëherë me -a), kur nuk shënojnë frymorë:

- al:
  - ë *admiralë, gjeneralë, intelektualë, vandatë, vasatë etj.;*
  - e: *centrale, festivale, ideale, kanale, karnavale, korale, kristale, lokale, male, materiale, minerale etj. (por: kuïntalë);*

1) Të gjithë emrat më -an që e formojnë shumësin me mbaresat -a ose -e, nuk shënojnë frymorë.

**-ant:** -ë: *aspirantë, elefantë, diversantë, gjigantë, lobarantë, kursantë, maturantë* etj.;

-e: *diamante, restorante, variante* etj.;

**-at:** -ë: *argatë, delegatë, diplomatë, kroatë, labeatë, vlonjatë* etj. (por: *kunat — kunetër*);

-e: *agregate, aparate, atentate, fosfate, kampionate, kate, kombinatë, pallate, silikate, shpate* etj. (por: *shtrat — shtretër*);

**-az:** -ë: *matrapazë, xhambazë* etj.;

-e: *kafaze, pullaze* etj.;

**-ei:** -ë: *dembelë, kriminelë, teveqelë* etj. (por: *harabela*);

-e: *akuarele, duele, hotele, kapitete, paste, tunele, zabele* etj.;

-a: *bela, çengela, gjela, tegela, tela* etj.;

**-ent:** -ë: *agjentë, asistentë, docentë, elementë, klientë, studentë* etj.;


-e: *aksidente, argumente, bazamente, dokumente, eksperimente, elemente (kimike), fermente, fragmente, instrumente, komente, kontinente* etj.;

**-et:** -ë: *atletë, dasaretë-t, deputetë* etj. (por: *personalitete*);

-e: *dete, fakultete, marifete, qytete, shtete, tërmete* etj. (por: *magnetë, planetë*);

**-ez:** -ë: *berlinezë, borgjezë, kinezë, vietnamezë* etj.;

-e: *qymeze, sofabeze, trapeze* etj. (por: *breza*);





- id:
  - ë; *abasidë-t, heraklidë-t, invalidë* etj.;
  - e: *hibride, metaloide, okside, romboide* etj.;
- ier-jer
  - ë: *artiljerë, aventurierë, brigadierë, infermierë, inxhinierë, karrocierë, magazinierë, mitraljerë, pionierë, portierë* etj.;
  - e: *kantiere, kuartiere* etj.;
- it
  - ë: *gjirokastritë, komitë, parazitë, petritë* etj.;
  - e: *boksitë, deficite, fosforite, grafitë, pirite, suficite* etj. (por: *satelitë, shirita*);
- ont:
  - ë: *kontë, rinoqerontë* etj.;
  - e: *fronte, horizonte* etj.

Emrat që mbarojnë me **-il**, **-oz**, e formojnë shumësin me mbaresën **-ë**, kur shënojnë frymorë, dhe me **-a**, kur nuk shënojnë frymorë:

- il:
  - ë: *civilë, katilë, kopilë*;
  - a: *fitila, kandila, karafila; trëndafila* etj.<sup>1)</sup> (por: *idile*);
- oz:
  - ë: *bajlozë, karagjozë, marangozë, tifoze* etj.;
  - a: *kavanoza, mitraloza, rrogoza* etj. (por: *lloze*).

Mbiemrat mashkullorë të panyjshëm që dalin me fundoret e përmendura në këtë paragraf, e formojnë shumësin me mbaresën **-ë**: *idealë, normalë; italianë, injorantë; dembelë, kriminelë; tekanozë, vitaminozë* etj.

1) Emri *bilbil* e formon shumësin me **-a** në të dyja kuptimet e tij: 1. një zog që këndon bukur; 2. vegël për të fërshëlyer.

§ 8. Emrat mashkullorë që dalin më *-azh, -ezh, -ël, -im, -ion, -(i)um, -ozh, -us*, e formojnë shumësin me mbaresën *-e*:

*-azh*: *aliazhe, ambalazhe, grupazhe, plazhe, silazhe, shantazhe* etj.;

*-ezh*: *kortezhe*;

*-ël*: *ansamble (ansambël), cikle (cikël)*;

*-im*: *botime, kërkime, punime, vendime* etj.;

*-ion*: *batalione, divizione, dominione, embrione, kampione (mos-tër), komisione, legjione, leksione, pozicione, profesione* etj. (por: *kamionë, kampionë*);

*-(i)um*: *albume, forume, kostume, presidume, simpoziume, stadiume* etj.;

*-ozh*: *elozhe*.

Emrat që dalin më *-am* e formojnë shumësin në këtë mënyrë:

a) me mbaresën *-e*: *diagrame, fonograme, pentagrame, radiogramme, telegrame* etj.;

b) me mbaresën *-ë*: emri *gram* — *gramë* dhe emrat e përbërë të njësive të tjera të peshës, me gjymtyrë të dytë këtë fjalë: *centigramë, dekagramë, hektogramë, kilogramë, miligramë* etj.

§ 9. Siç është përmendur në § 4, emrat mashkullorë më *-ës, -ues* a *-yes* e kanë trajtën e shumësit njësoj si të njëjësit:

*blerës, grykës, hamës, mbledhës, mundës, nxënës, qitës, vendës, zgjedhës* etj. (por: *çelësa-t*);

*dëgjues, mësues, sulmues, vrapues* etj.; *hekurkthyes, përkthyes, udhërrëfyes* etj.

Nuk marrin mbaresë në shumës as mbiemrat mashkullorë që dalin me fundoret e mësipërme, p.sh.: *trekëndësha barabrinjës, specadjegës, gjarpërinj helmues* etj<sup>1)</sup>.

§ 10. Siç vumë në dukje më lart (§ 4), për një numër emrash nga tipat e përmendur në § 5-8, në gjuhën e folur, po aty-këtu edhe në gjuhën e shkruar, përdoren dy e nganjëherë tri trajta shumësi. Në këto raste, zakonisht, njëra prej tyre është trajtë e drejtë, normative, kurse të tjerat nuk janë normative, prandaj duhen mënjanuar nga gjuha letrare.

1) Për sa u shjtjellua në §§ 5-9 shih edhe «Drejtshkrimi i gjuhës shqipe» §§ 38-41.

Më poshtë janë paraqitur rastet kryesore të luhatjeve në përdorimin e trajtave të shumësit të emrave mashkullorë.

§ 11. Trajta jonormative me mbaresën -a, të përdorura:

a) në vend të trajtave normative me mbaresën -e:

trajta normative

trajta jonormative

emra më -ent, -ant

*argumente*

*argumenta*

*dokumente*

*dokumenta*

*elemente*<sup>1)</sup>

*elementa*

*instrumente*

*instrumenta*

*koeficiente*

*koeficienta*

*monumente*

*monumenta etj.*

*altoparlante*

*altoparlanta*

*diamante*

*diamanta*

*karburante*

*karburanta etj.*

emra të tjerë:

*djepe*

*djepa*

*gërxe*

*gërxa*

*grushte*

*grushta*

*kallëpe*

*kallëpa*

*kryqe*

*kryqa*

*lloze*

*lloza*

*mëngjese*

*mëngjesa*

*probleme*

*problema*

*profile*

*profila*

*rafte*

*rafta*

*romuze*

*romuza etj.*

b) në vend të trajtave normative me mbaresën -ë (në shumicën e rasteve janë emra që mbarojnë me -an, -el, -(i)er, -en, -ent, -il, -ir, -ist, -on, -or, -un, të cilët, siç u shpjegua në §§ 4-6, e formojnë shumësin me -ë);

1) Kur nuk shënon frymorë.

trajta normative

trajta jonormative

-an

aeroplanē  
asllanē  
fidanē  
filxhanē  
kazanē

aeroplana  
asllana  
fidana  
filxhana  
kazana etj.

-el

dembelē  
kriminelē

dembela  
kriminela etj.

-(i)er

bunkerē  
fenerē  
inxhinierē  
oficerē  
portierē  
revolverē  
rreshterē  
shoferē  
togerē  
transportierē

bunkera  
fenera  
inxhiniera  
oficera  
portiera  
revolvera  
rreshtera  
shofera  
togera  
transportiera etj.

-en

hostenē  
legenē

hostena  
legena etj.

-ent

elementē<sup>1)</sup>  
studentē

elementa  
studenta etj.

1) Kur shënon frymorë

civililē

*civilē*

katilē

-il

*civila*

katila etj.

pešqirē

vampirē

zinxhirē

-ir

*pešqira*

vampira

zinxhira etj.

akademistē

artistē

ballistē

fashistē

instrumentistē

komunistē

kooperativistē

makinistē

solistē

shahistē

tankistē

telefonistē

turistē

-ist

*akademista*

artista

ballista

fashista

instrumentista

**komunista**

kooperativista

makinista

solista

shahista

tankista

telefonista

turista etj.

bidonē

kamionē

timonē

vagonē

-(i)on

*bidona*

kamiona

timona

vagona etj.

doktorē

elevatorē

motorē

profesorē

-or

*doktora*

elevatora

motora

profesora

televizorē  
traktorē  
transformatorē

televizora  
traktora  
transformatora etj.

-un

majmunē  
pirunē

majmuna  
piruna

Disa raste tē tjera:

bandillē  
çekiçē  
dollapē  
sakatē  
tifoze

bandilla  
çekiça  
dollapa  
sakata  
tifoza etj.

c) në vend të trajtave normative pa mbaresë (në shumicën e rasteve janë emra më -ës, -ues, -yes, të cilët, siç u shpjegua në § 8, e kanë shumësin njësoj si njëjës):

trajta normative

-ës

trajta jonormative

blerës  
brejtës  
gazsjellës  
grykës  
korrës  
lypës  
mbjellës  
mbrojtës  
mikpritës  
naftësjellës  
nxitës  
përcjellës  
përgjegjës  
rritës  
shitës  
tretës

blerësa  
brejtësa  
gazsjellësa  
grykësa  
korrësa  
lypësa  
mbjellësa  
mbrojtësa  
mikpritësa  
naftësjellësa  
nxitësa  
përcjellësa  
përgjegjësa  
rritësa  
shitësa  
tretësa

*ujësjellës*  
*zbutës*  
*zgjedhës*

*ujësjellësa*  
*zbutësa*  
*zgjedhësa* etj.

**-ues, -yes**

*dëgjues*  
*drejtues*  
*mësues*  
*transmetues*  
*transportues*  
*hekurkthyes*  
*përçues*  
*përkthyes*  
*sulmues*

*dëgjuesa*  
*drejtuesa*  
*mësuesa*  
*transmetuesa*  
*transportuesa*  
*hekurkthyesa*  
*përçuesa*  
*përkthyesa*  
*sulmuesa* etj.

Emri *mjeshtër* e ka shumësin *njësoj* si *njëjësin*: *një mjeshtër* — *shumë mjeshtër*, pra, *trajta mjeshtër* nuk është në pajtim me normën e sotme letrare.

§ 12. *Trajta jonormative* me mbaresën *-e* të përdorura:  
a) në vend të *trajtave normative* me mbaresën *-a*:

*trajta normative*

*bërryla*  
*cepa*  
*çelësa*  
*çengela*  
*filma*  
*gjyma*  
*lapsa*  
*mana*  
*stola*  
*tipa*  
*xhepa*

*trajta jonormative*

*bërryle*  
*cepe*  
*çelëse*  
*çengele*  
*filme*  
*gjyme*  
*lapse*  
*mane*  
*stole*  
*tipe*  
*xhepe* etj.

b) në vend të *trajtave normative* me mbaresën *-ë*: (në shumicën e rasteve janë emra më *-af, -an, -ar, -er, -on, -or, -un*, të cilët, siç u shpjegua në §§ 4-6, e formojnë shumësin me *-ë*):

trajta normative

trajta jonormative

**-af**

*çarçafë*  
*paragrafë*

*çarçafe*  
*paragrafe*

**-an**

*aeroplanë*  
*fidanë*  
*filxhanë*  
*jorganë*  
*tiganë*

*aeroplane*  
*fidane*  
*filxhane*  
*jorgane*  
*tigane etj.*

**-ar**

*damarë*  
*ditarë*  
*formularë*  
*hambarë*  
*hangarë*  
*margaritarë*  
*pishtarë*  
*rezervuarë*

*damare*  
*ditare*  
*formulare*  
*hambare*  
*hangare*  
*margaritare*  
*pishtare*  
*rezervuare etj.*

**-er**

*fenerë*  
*frigoriferë*

*fenere*  
*frigorifere etj.*

po kështu edhe:

*dollapë*  
*sapunë*

*dollape*  
*sapune*

§ 13. Trajta jonormative me mbaresën -ë, të përdorura:

a) në vend të trajtave normative me mbaresën -a:



trajta normative

automobila  
mitraloza  
qilima  
rrogoza  
shirita  
trëndafila  
vinça

trajta jonormative

automobilē  
mitralozē  
qilimē  
rrogozē  
shiritē  
trëndafilē  
vinçē etj.

b) në vend të trajtave normative me mbaresën -e (përveç emrave më -ant, -at, -ent, -id, të cilët, siç u shpjegua në § 6, kur nuk shënojnë frymorë, e formojnë shumësin me mbaresën -e, këto trajta jonormative vihen re edhe te një numër emrash më -ar, -azh, -(i)er, -ir etj.):

trajta normative

diamante  
variante  
aparate  
koncentrate  
krevate  
ambiente  
elemente<sup>1)</sup>  
instrumente  
hibride  
seminare  
thesare  
personazhe  
kantiere  
mindere  
manastire  
mikrobe  
sallame

trajta jonormative

diamantē  
variantē  
aparatē  
koncentratē  
krevatē  
ambientē  
elementē  
instrumentē  
hibridē  
seminarē  
thesarē  
personazhē  
kantierē  
minderē  
manastirē  
mikrobē  
sallamē etj.

1) Kur nuk shënon frymorë.

§ 14. Një numër emrash të gjinisë mashkullore, që shënojnë kryesisht frymorë, e formojnë trajtën e shumësit me mbaresën -ër, p.sh.: *dreqër* (dreq), *mbretër* (mbret), *robër* (rob) etj. Disa prej tyre pësojnë edhe ndonjë ndërrim tingujsh në temë, p.sh.: *etër* '(atë), *kunetër* (kumat), *lugetër* (lugat), *skllevër* (skllav), *shtretër* (shtrat) etj.

Shumësi i emrit *vëlla* është *vëllezër*.

Emri *zot* ka dy trajta shumësi sipas kuptimit me të cilin përdoret: *zotër*, kur përdoret me kuptimin «i zoti, pronari», dhe *zotërinj*, kur përdoret si titull nderimi.

§ 15. Disa emra që shënojnë frymorë, kanë dy trajta shumësi: një me mbaresën -ër e një tjetër me mbaresën -ë ose -a:

*çamë* e *çamër*, *gjyshë* e *gjyshër*, *labë* e *lebër*, *nipa* e *nipër*, *prindë* e *prindër*.

Të dyja këto trajta janë normative, por në gjuhën e sotme vihet re një prirje për të parapëlqyer trajtat me mbaresën -ë ose -a.

§ 16. Për disa emra të tipave të mësipërm krahas trajtës normative të shumësit përdoret herë-herë edhe një trajtë jonormative me mbaresën -ër:

trajta normative

*argatë*

*avokatë*

*bujq*

*cjep*

*desh*

*evlatë*

*hajdutë*

*grekë*

*keca*

trajta jonormative

*argatër*

*avokatër*, *avoketër*

*bujqër*

*cjepër*

*deshër*

*evlatër*

*hajdutër*

*grekër*

*kecër* etj.

Trajtat me mbaresën -ër janë dialektore ose të vjetruara dhe kanë mbetur jashtë normës së sotme letrare.

§ 17. Disa emra frymorësh, kur përdoren me kuptim të figurshëm, për qëllime stilistike-shprehëse, mund ta formojnë trajtën e shumësit me mbaresën -ër, p.sh.:

*bufër*, *hajvanër*, *këlyshër*, *qenër*, *ujqër* etj.

Ja një shembull nga letërsia artistike:

«Vraje, më të lumtë dora, se këta qenër i kanë vënë shkëlmin atdheut!»

Por, kur nuk përdoren me kuptim të figurshëm, emrat e mësipërm nuk e formojnë shumësin me **-ër**, p.sh.:

«dëgjoheshin të lehurat e qenve të fshatit» ose «një gjuetar kishte vrrarë dy ujq» dhe jo: të lehurat e qenërve të fshatit; kishte vrrarë dy ujqër.

§ 18. Emrat mashkullorë që dalin më **-i**, **-e**, **-o** ose **-u** të theksuar, e formojnë trajtën e shumësit përgjithësisht me mbaresën **-nj**:

*flori — florinj, kalli — kallinj, kërci — kërcinj, kërcu — kërcunj, kërti — kërtinj, kushëri — kushërinj, mi — minj, mulli — mullinj, myshteri — myshterinj, turi — turinj, shalqi — shalqinj, sharrëxhi — sharrëxhinj, zanatçi — zanatçinj etj.* (por: *kufi — kufij*); po kësh-tu edhe mbiemrat mashkullorë më **-i**: *i ri — të rinj, i zi — të zinj* (ose të zes);

*gdhe — gdhenj, korife — korifenj, pe — penj, plebe — plebenj etj., hero — heronj, dru — drunj, hu — hunj, kërcu — kërcunj*<sup>1)</sup>.

**Shënim.** Bëjnë përjashtim nga kjo rregull emrat *bri, dre e fre*, që e kanë shumësin përkatësisht *brirë*,<sup>2)</sup> *drerë, frerë*, si edhe emri *tru*, që e ka shumësin një-soj si njëjës: *tru-të*.

Emri *dru-ri* ka dy trajta shumësi: *drurë-t* dhe *drunj-të*, nga të cilat e para ka marrë një përhapje më të madhe.

Emri *dru — druja* i gjinisë femërore, që përdoret zakonisht me kuptimin «dru zjarri», e ka shumësin njësoj si njëjës, p.sh.; *dy metra kub dru; drutë i kemi të thata etj.*

§ 19. Emrat mashkullorë që dalin më togun zanor **-ua**, e formojnë trajtën e shumësit gjithashtu me mbaresën **-nj**:

*dragua — dragonj, ftua — ftonj, pallua — pallonj, patkua — patkonj, thua — thonj* (por: *krua — kroje, zgjua — zgjoj ose zgjoje*) etj.

1) Për emrat dhe mbiemrat më **-i** duhet pasur kujdes që në trajtën e shumësit të mos shkruhen me **-j** e as pa mbaresë, pra trajta si *kallijtë, mijtë, të rijtë ose myshteritë, turitë etj.* nuk janë normative.

2) Shumësi i emrit *bri* përdoret gabimisht herë-herë edhe në trajtën *brinj* ose *brinjë*, duke u ngatërruar kështu me shumësin e emrit femëror *brinjë — brinja*, shumësi *brinjë-t*.

§ 20. E formojnë shumësin me mbaresën **-enj** emrat:

*lëmë — lëmenj, lumë — lumenj, përrua — përrenj*, si edhe mbiemri *i madh — të mëdhenj*.

Po kështu e formojnë shumësin edhe një numër emrash që dalin më **-a** të theksuar dhe që mund të përdoren edhe si mbiemra, p.sh.:

*budalla — budallenj, fukara — fukarenj, maskara — maskarenj, qerata — qeratenj* etj.

Edhe për këta emra duhet pasur kujdes që në shumës të mos shkruhen më **-ej**, pra, trajta si *lëmej, lumej, fukarej* nuk janë normative.

§ 21. E formojnë shumësin me mbaresën **-inj** emrat:

*prift — priftërinj* (te ky emër kemi një mbaresë të përbërë **-ërinj**), *shkop — shkopinj, thelb — thelpinj* (te ky emër ndodh edhe ndërrimi fonetik *b > p*);

emrat *drapër, gjarpër* dhe *gisht* kanë nga dy trajta shumësi:

*drapër — drapinj, drapërinj; gjarpër — gjarpinj, gjarpërinj; gisht — gishta, gishtërinj*; nga këto dy trajta, të parat kanë marrë një përhapje më të madhe.

§ 22. Emrat mashkullorë që dalin më fundoret **-áll, -éll, -íell, -ýell, -ill, -ull**, zakonisht e formojnë trajtën e shumësit duke ndërruar bashkëtingëlloren **-ll** në **-j**:

*papagall — papagaj, portokall — portokáj<sup>1)</sup>* (por: *hall — halle, mall — mallra, sandall — sandalla* «barkë e vogël», *shall — shalle, tellall — tellallë*);

*dell — dej, kërcell — kërcëj*;

*diell — diej, qiell — qiej* (por: *miell — miellra — shumës i llojit*);

*fëndyell — fëndyej, fyell — fyej*);

*kërmill — kërmij, thëngjill — thëngjij* (por: *bandill — bandillë, mill — mille*);

*akull — akuj, artikull — artikuj, avull — avuj, brumbull — brumbuj, fashikull — fashikuj, gargull — garguj, grumbull — grumbuj*,

1) Varianti femëror i këtij emri: *portokalle — portokallja*, që përdoret gjerësisht krahas variantit mashkullor, e ka shumësin pa mbaresë: *portokalle-t*.

*i dhull — idhuj, ishull — ishuj, kungull — kunguj, matrikull — matrikuj, orakull — orakuj, popull — popuj, qefull — qefuj, shekull — shekuj, shembull — shembuj, shpargull — shparguj, tingull — tinguj* etj.

Emri *mashkull* në shumës bën *meshkuj* (dhe jo *mashkuj*).

Për këta emra, në gjuhën e folur e në gjuhën e shkruar ndeshen herë-herë edhe disa trajta shumësi që nuk janë në pajtim me rregullën e mësipërme dhe nuk duhen përdorur, p.sh.: *mangalle, manglej, portokalla, shalla* ose *shaje, deje, kërcelle, kërminj, thëngjinj* etj.

§ 23. Disa emra mashkullorë që dalin më **-ll**, ashtu si emrat e trajtuar në paragrafin më sipër, e formojnë trajtën e shumësit duke kthyer **-ll**-në fundore në **-j** e duke marrë njëkohësisht edhe mbaresën -e ose duke pësuar edhe ndonjë ndërrim tingullor në zanoret e temës:

*bakall — bakej* (por edhe *bakaj*), *çakall — çakej* (por edhe *çakaj*), *hamall — hamej* (por edhe *hamaj*);

*zall — zaje, fill — fije, pyll — pyje, yll — yje* (por dhe *yj*);

*huall — hoje, shuall — shoje, truall — troje*.

Trajtat *bakenj, çakenj, hamenj* nuk janë në pajtim me normën e sotme letrare dhe nuk duhen përdorur.

§ 24. Emrat që dalin më bashkëtingëlloret **-k** ose **-g**, e formojnë trajtën e shumësit në mënyra të ndryshme. Disa ndërrojnë bashkëtingëlloren fundore **-k** në **-q** ose **-g** në **-gj**, p.sh.:

*armik — armiq, bujk — bujq, fik — fiq, krushk — krushq, ujk — ujq, murg — murgj, zog — zogj* etj.

Një numër emrash të tjerë, përveç ndërrimit të **-k-së** ose **-g-së** fundore përkatësisht në **-q** e **-gj**, marrin edhe mbaresën **-e**:

*bark — barqe, bisk — bisqe, bllok — blloqe, brisk — brisqe, çark — çarqe, çek — çeqe, disk — disqe, dushk — dushqe, hark — harqe, park — parqe, qark — qarqe, rrezik — rreziqe, shkak — shkaqe* etj.;

**Shënim. 1.** Emrat *breg, shteg, lak* e formojnë shumësin në mënyrën e mësipërme, duke ndërruar njëkohësisht edhe zanoren e rrënjës: *brigje, shtigje, leqe*.

**Shënim. 2.** Emrat më **-ak, -ek, -ik, -ok, -uk**, siç është shpjeguar në § 5, e formojnë shumësin me mbaresën **-ë** dhe nuk duhen ngatërruar me emrat më **-k**, të përmendur në paragrafin e mësipërm, të cilët me përjashtim të *armik, çiflig* e *rrezik*, janë njërrrokësh.

*burg — burgje, çiflig — çifligje, deng — dengje, lëng — lëngje, pîrg — pîrgje, plug — plugje, prag — pragje, shëlg — shëlgje, treg — tregje, trung — trungje* etj.

§ 25. Të gjithë emrat që kanë prapashtesën **-llëk**, e formojnë trajtën e shumësit duke ndërruar **-k-në në -q** e duke marrë edhe mbaresën **-e**:

*budallallëqe, çilimillëqe, matrapazllëqe, pazarllëqe* etj.

Trajtat *budallallëke, pazarllëke* etj. të këtyre emrave nuk janë në pajtim me normën e sotme dhe nuk duhen përdorur.

§ 26. Një numër emrash dyrokësh, kryesisht me burim nga turqishtja dhe që mbarojnë me **-ak, -ek, -ik, -uk**, e formojnë shumësin me mbaresën **-ë**:

*oxhakë; byrekë, dyfekë, fishekë, hendekë; jastëkë; furikë, ibrikë; kolltukë, ullukë* etj.

Për disa prej tyre ndeshet në gjuhën e folur e në gjuhën e shkruar edhe një trajtë tjetër shumësi:

*oxhaqe, byreqe, hendeqe, jastëqe* etj.,

por trajta e parë me mbaresën **-ë** po përgjithësohet gjithnjë e më shumë dhe duhet parapëlqyer<sup>1)</sup>.

§ 27. Emrat *metër, kilometër, centimetër, milimetër* etj. (d.m.th. të gjitha emërtimet e përbëra që kanë fjalën *metër* si gjymtyrë të dytë), si edhe emrat *filtër, litër* e *tub* e formojnë shumësin me mbaresën **-a**:

*metra, kilometra, centimetra, milimetra, filtra, litra, tuba* etj.

Trajtat me mbresën **-o**: *metro, kilometro, centimetro, milimetro, filtro, tubo* etj., nuk janë normative.

§ 28. Emri *vit* ka dy trajta shumësi: *vjet* dhe *vite*.

Në gjuhën e sotme letrare trajta *vjet* përdoret zakonisht kur

1) Për analogji me tipin e mësipërm, edhe disa emra të tjerë, që nuk janë me burim nga turqishtja, si *dialog, monolog, grafik, historik, stomak*, ndeshen ndonjëherë në shumës në trajtat *dialogje, monologje, grafike, historike, stomake*. Këto trajta nuk janë të rregullta dhe nuk duhen përdorur. Trajta normative e shumësit të këtyre emrave formohet me mbaresën **-ë**: *dialogë, monologë, grafikë, historikë, stomakë* etj.

është e shoqëruar me ndonjë numëror ose me ndonjë fjalë që tregon sasi, p.sh.:

*pesë vjet, tridhjetë vjet, shumë vjet, pak vjet, sa vjet?* etj.

Trajta vite përdoret në të gjitha rastet e tjera, p.sh.: *këto vite, vitet e para, vite të paharruara, vitet e shkollës* etj.

§ 29. Emri *flamur* ka dy trajta shumësi sipas vendit të theksit: kur theksohet në rrokjen e parë:

*flámur*, shumësi është *flámuj*;

kur theksohet në rrokjen e dytë:

*flamùr*, shumësi është *flamùrë*

Emri *rreth-i* ka dy trajta shumësi sipas kuptimit me të cilin përdoret: *rreth* — *rrathë* (si figurë gjeometrike ose si një send konkret) dhe *rreth* — *rrethe* (njësi e ndarjes administrative).

## SHUMËSI I EMRAVE FEMËRORË

§ 30. Shumësi i emrave femërorë paraqitet më i thjeshtë se shumësi i emrave mashkullorë. Emrat femërorë marrin në shumës mbaresën *-a* (*tuf-a, kumbull-a*) ose e kanë shumësin njësoj si njëjës (lule, lopë etj.). Disa emra në trajtën e shumësit pësojnë ndërrime të tingujve të temës: *dorë* — *duar, grua* — *gra, natë* — *net* etj. Këta emra janë të paktë.

§ 31. E formojnë shumësin me mbaresën *-a*:

a) Shumica e emrave femërorë që dalin më *-ë*, p.sh.:

*arkë* — *arka, barkë* — *barka, bazë* — *baza, bishë* — *bisha, blegëri-më* — *blegërima, dërrasë* — *dërrasa, dhuratë* — *dhurata, egërsirë* — *egërsira, errësirë* — *errësira, fushë* — *fusha, hekurudhë* — *hekurudha*,<sup>1)</sup> *kazmë* — *kazma, lopatë* — *lopata, mbeturinë* — *mbeturina, mburojë* — *mburoja, mushkë* — *mushka, ndalesë* — *ndalesa, nënë* — *nëna, tepricë* — *teprica, tufë* — *tufa, vetëtimë* — *vetëtima, zhurmë* — *zhurma* etj.<sup>2)</sup>

1) Por *udhë* — *udhë-t*.

2) Me fare pak përjashtime (*bletë, lopë, kafshë, shtazë*), emrat femërorë që shënojnë genie të gjalla, e formojnë shumësin me mbaresën *-a*.

Siç shihet edhe nga shembujt e mësipërm, emrat e prejardhur, të formuar me anë prapashtesash me ë fundore, marrin në shumës mbaresën -a.

b) Gjithë emrat që dalin më -ël, -ër, -ëz, -ull, -ur, me një fjalë, gjithë emrat femërorë që dalin me temë më bashkëtingëllore:

*gogël — gogla, pupël — pupla, vegël — vegla, etj.;*

*femër — femra, kodër — kodra, letër — letra, lundër — lundra, kthetër — kthetra, thupër — thupra etj.;*

*fshikëz — fshikëza, lidhëz — lidhëza, mollëz — mollëza etj.;*

*kumbull — kumbulla, nofull — nofulla, petull — petulla, shpatull — shpatulla, tjegull — tjegulla etj.;*

*flutur — flutura, gjepura-t.*

§ 32. E kanë shumësin njësoj si njëjës:

a) një pjesë e emrave femërorë që dalin më -ë të patheksuar (veç atyre që marrin mbaresën -a):

*brinjë, ditë, enë, kafshë, kofshë, lopë, lugë, mollë, plagë, rrugë, udhë etj.;*

b) të gjithë emrat që dalin më -a, -e, -i, -o, -u të theksuar ose më -e, -a -o të patheksuar:

*kala-të, shaka-të, para-të etj.;* *dysheme-të, epope-të, re-të, rrufe-të, etj.;* *dhi-të, lajthi-të, liri-të, shtëpi-të, ushtri-të etj.;* *bordero-të, byro-të etj.;* *dru-të; anije-t, dele-t, faqe-t, nuse-t etj.;* *depo-t, pako-t, pallto-t, torno-t, triko-t etj.<sup>1)</sup>*

**Shënim.** Për disa nga emrat e tipave të mësipërm, për qëllime të caktuar stilistike-shprehëse ose për të shprehur ngjyrimet e veçanta kuptimore, përdoren në gjuhën letrare edhe shumësi më -ra: *çudira, gostira, hordhira, kusira, rëzira, mrekuilira, tepsira, idera; belara, shakara, kohëra etj<sup>2)</sup>*. Në raste të tilla shumësi më -ra nuk duhet përdorur.

Nuk duhet përdorur gjithashtu as shumësi më -a i emrave që dalin më -i të theksuar, si: *qershia, shtëpia, tepsia etj.*

1) Mbiemri e madhe e ka shumësin të mëdha (siç shihet edhe nga shembujt e jo të mëdhaja).

2) Shih edhe «Drejtshkrimi i gjuhës shqipe» § 39.



§ 33. Edhe për një numër emrash të gjinisë femërore, për shkak të ndikimit të dialekteve ose të varianteve letrare të mëparshme, vihen re luhatje në përdorimin e trajtës së shumësit. Për të njëjtin emër në gjuhën e folur e në gjuhën e shkruar përdoren herë-herë dy shumësa, nga të cilët vetëm njëri pajtohet me normën e sotme letrare.

Më poshtë janë paraqitur rastet kryesore të luhatjeve në përdorimin e trajtave të shumësit të emrave femërorë.

§ 34. Trajta jonormative me mbaresën -a të përdorura në vend të trajtave normative pa mbaresë:

trajta normative	trajta jonormative
<i>degë-t</i>	<i>dega-t</i>
<i>fletë-t</i>	<i>fleta-t</i>
<i>gozhdë-t</i>	<i>gozhda-t</i>
<i>gjurmë-t</i>	<i>gjurma-t</i>
<i>gjymtyrë-t</i>	<i>gjymtyra-t</i>
<i>jetë-t</i>	<i>jeta-t</i>
<i>këmishë-t</i>	<i>këmisha-t</i>
<i>kofshë-t</i>	<i>kofsha-t</i>
<i>llërë-t</i>	<i>llëra-t</i>
<i>mollë-t</i>	<i>molla-t</i>
<i>pjeshkë-t</i>	<i>pjeshka-t</i>
<i>rrugë-t</i>	<i>rruga-t</i>
<i>stinë-t</i>	<i>stina-t</i>
<i>strehë-t</i>	<i>streha-t</i>
<i>shegë-t</i>	<i>shega-t</i>
<i>udhë-t</i>	<i>udha-t</i> etj.

§ 35. Trajta jonormative pa mbaresë të përdorura në vend të trajtave normative me mbaresën -a:

trajta normative	trajta jonormative
<i>ara-t</i>	<i>arë-t</i>
<i>arra-t</i>	<i>arrë-t</i>
<i>bisha-t</i>	<i>bishë-t</i>

detyra-t  
fara-t  
forma-t  
fusha-t  
fytyra-t  
kërpudha-t  
kisha-t  
klasa-t  
maja-t  
mënyra-t  
mynxyra-t  
nevoja-t  
pëlhura-t  
pisha-t  
pulpa-t  
qepalla-t  
supa-t  
shembëlltyra-t  
shtëllunga-t  
toka-t  
thika-t  
veta-t

detyrë-t  
farë-t  
formë-t  
fushë-t  
fytyrë-t  
kërpudhë-t  
kishë-t  
klasë-t  
majë-t  
mënyrë-t  
mynxyrë-t  
nevojë-t  
pëlhurë-t  
pishë-t  
pulpë-t  
qepallë-t  
supë-t  
shembëlltyrë-t  
shtëllungë-t  
tokë-t  
thikë-t  
vetë-t etj.

Shënim. Emrat *bankë* (në të dyja kuptimet), *banjë*, *kontratë* e formojnë shumësin me mbaresën -a:

*banka-t, banja-t, kontrata-t.*

Trajtat me mbaresën -o: *banko-t* (ose *bango-t*), *banjo-t, kontrato-t*, nuk janë normative dhe nuk duhen përdorur.

E kanë shumësin me -a gjithashtu edhe emrat:

*nyjë — nyja-t* dhe jo *nyje-t*  
*rrobë — rroba-t* » » *rrobe-t.*

§ 36. Disa emra femërorë që mbarojnë me -ë në trajtën e pashquar të njëjësit, kanë nga dy trajta shumësi, sipas kuptimeve me të cilat përdoren:

*brinjë: brinjë-t* (p.sh., *brinjët e trupit*)  
*brinja-t* (p.sh., *nëpër ato brinja*);

- copë*: *copë-t* (p.sh., një mijë copë tulla)  
*copa-t* (p.sh., dy copa bukë);
- grykë*: *grykë-t* (si pjesë e trupit të frymorëve dhe si emër sëmundjeje)  
*gryka-t* (p.sh., grykat e maleve, të puseve, të topave etj.);
- kokë*: *kokë-t* (si njësi e numërimit të bagëtisë, sinonim me krerë-t, p.sh. sa kokë dhen?)  
*koka-t* (në të gjitha kuptimet e tjera, p.sh., *kaloï mbi kokat tona*);
- lëkurë*: *lëkurë-t* (p.sh. përpunimi i lëkurëve)  
*lëkura-t* (p.sh. lëkurat e pemëve);
- petë*: *petë-t* (p.sh. petët e byrekut)  
*peta-t* (gur i hollë e petashuq me të cilin lozin fëmijët, dhe loja vetë);
- pikë*: *pikë-t* (p.sh. fitoi 10 pikë)  
*pika-t* (p.sh. pikat e shiut).

## EMRA QË PËRDOREN VETËM NË SHUMËS

§ 37. Ka një numër emrash që përdoren vetëm në trajtën e shumësit ose kryesisht në këtë trajtë. Këta emra mund të dalin në shumës:

më -a, p.sh.: të ardhura-t, dokrra-t, gjepura-t, të holla-t, të korra-t, lajka-t, të lashta-t, makarona-t, të mbjella-t, pantallona-t, qelqurina-t, qurra-t, shqerra-t, shyta-t etj.;

më -e të theksuar, p.sh.: krunde-t, ledhe-t, naze-t, perime-t, syze-t, shallvare-t, vithe-t etj.;

më -e të theksuar, p.sh.: hejbe-të;

më -ë, p.sh.: brekë-t, gërshërë-t, grykë-t;

më -i të theksuar p.sh.: ski-të;

më bashkëtingëllore, p.sh.: dhen-të, gjind-të, mend-të.

## LAKIMI I EMRAVE

§ 38. Lakim quhet ndryshimi i emrave sipas rasave. Në gjuhën shqipe ka pesë rasa: *emërore, gjinore, dhanore, kallëzore e rrjedhore*, dhe katër tipa lakimi. Lakimet dallohen sipas mbaresës që marrin emrat në trajtën e shquar të rasës emërore të njëjësit.

*Lakimi i parë* përfshin emrat që marrin në këtë rasë mbaresën -i, p.sh.: *mal-i, lum-i, vëlla-i* etj.;

*lakimi i dytë* përfshin emrat që marrin mbaresën -u, p.sh.: *breg-u, shok-u, krah-u, dhe-u, mi-u* etj.;

*lakimi i tretë* përfshin emrat që marrin mbaresën -a ose -ja, p.sh.: *fish-a, kumbull-a, lul-ja, nus-ja* etj.;

*lakimi i katërt* përfshin emrat që marrin mbaresën -t(ë) ose -it, p.sh.: *të ftohtë-t, të verdhë-t, të zi-të, të ecur-it* etj.

Shënim. Ndarja e emrave në lakime përkon në vija të përgjithshme me ndarjen e tyre në gjini: emrat e lakimit të parë janë kryesisht të gjinisë mashkullore (me përjashtim të disa emrave të përveçëm si *Nermin-i, Persefonti* etj.), emrat e lakimit të dytë janë të gjithë të gjinisë mashkullore, emrat e lakimit të tretë janë kryesisht të gjinisë femërore (me përjashtim të disa emrave si *dajë, gegë* etj. dhe të disa emrave të përveçëm si *Lekë, Koço* etj.), ndërsa emrat e lakimit të katërt janë të gjithë të gjinisë asnjësore (shih edhe § 2).

Po japim disa pasqyra të këtyre lakimeve, nga të cilat shihet se ç'mbaresa marrin emrat në rasat e ndryshme, duke vënë në dukje për çdo tip lakimi luhatjet e gabimet që vihen re më shpesh.

## § 39. LAKIMI I PARË

### Numri njëjës

Rasa	Trajta e pashquar	Trajta e shquar
E.	(një) mal	mal-i
Gj.	(i, e) (një) mal-i	(i, e) mali-t
Dh.	(një) mal-i	mali-t
K.	(një) mal	mal-in
Rr.	(një) mal-i	mali-t
E.	(një) lumë	lum-i
Gj.	(i, e) (një) lum-i	(i, e) lumi-t
Dh.	(një) lum-i	lumi-t
K.	(një) lumë	lum-in
Rr.	(një) lum-i	lumi-t
E.	(një) vëlla <sup>1)</sup>	vëlla-i
Gj.	(i, e) (një) vëlla-i	(i, e) vëllai-t
Dh.	(një) vëlla-i	vëllai-t
K.	(një) vëlla	vëlla-në
Rr.	(një) vëlla-i	vëllai-t

**Shënim.** Në rasën emërore, në kallëzore e në rrjedhore të trajtës së pashquar emrat mund të përdoren edhe të pashoqëruar nga nyja *një* ose nga ndonjë fjalë tjetër përcaktuese., p.sh.: *Vjosa është lumë i madh; s'ka lumë më të kulluar se Valbona; u lamë me ujë lumi* etj.

Në rasën gjinore e dhanore ata përdoren kurdoherë të shoqëruar nga nyja *një* ose nga ndonjë fjalë tjetër përcaktuese, p.sh: *(i) një mali, (e) këtij mali, (të) çdo mali* etj. Këtë kuptim ka nyja *një* e vënë në kllapa gjatë lakimit të pashquar.

1) Nga emrat mashkullorë që dalin më -a të theksuar, lakohen sipas lakimit të parë emrat dy- e mëshumërrrokësh. Emrat njërrrokësh si *ka, va* lakohen sipas lakimit të dytë: *kau, vau*.

E.	(një) <i>ftua</i>	<i>fto-i</i>
Gj.	(i, e) (një) <i>fto-i</i>	(i, e) <i>ftoi-t</i>
Dh.	(një) <i>fto-i</i>	<i>ftoi-t</i>
K.	(një) <i>ftua</i>	<i>ftuan ose fto-in</i>
Rr.	(një) <i>fto-i</i>	<i>ftoi-t</i>
<hr/>		
E.	(një) <i>zë</i>	<i>zër-i</i>
Gj.	(i, e) (një) <i>zër-i</i>	(i, e) <i>zëri-t</i>
Dh.	(një) <i>zër-i</i>	<i>zëri-t</i>
K.	(një) <i>zë</i>	<i>zër-in</i>
Rr.	(një) <i>zër-i</i>	<i>zëri-t</i>

§ 40. Emrat e tipit *zë* — *zëri* në gjinore, dhanore e rrjedhore të pashquar dhe në të gjitha rasat në trajtën e shquar para mbaresave rasore kanë bashkëtingëlloren r. Kështu lakohen: *flori* — *floriri*, *gji* — *gjiri*, *gju* — *gjuri*, *hu* — *huri*, *kalli* — *kalliri*, *kufi* — *kufiri*, *kushëri* — *kushëri*, *mulli* — *mulliri*, *pe* — *peri*, *sy* — *syri*, *ulli* — *ulliri* etj. Por disa nga këta emra lakohen herë-herë sipas tipit *ari* — *ariu*, për shkak të ngjashmërisë fonetike që kanë me këtë tip. Trajta të tilla nuk janë normative dhe duhen mënjanuar nga gjuha letrare. Ja disa shembuj:

trajta normative

*gjiri, gjirit, gjirin*  
*kalliri, kallirit, kallirin*  
*kushëri, kushërit, kushërin*  
*peri, perit, perin*  
*syri, syrit, syrin*

trajta jonormative

*gjiu, gjiut, gjiun*  
*kalliu, kallit, kallion*  
*kushëriu, kushëriut, kushëriun*  
*peu, peut, peun*  
*syu, syut, syun*

§ 41. Trajta e shquar e rasës kallëzore të emrave të lakimit të parë që mbarojnë me -a të theksuar (tipi *vëlla-i*), formohet me mbaresën -në dhe jo me -in, pra duhet:

<i>babanë</i>	dhe jo	<i>babain</i>
<i>budallanë</i>	» »	<i>budallain</i>
<i>vëllanë</i>	» »	<i>vëllain</i>
<i>xhaxhanë</i>	» »	<i>xhaxhain</i> etj.

Po kështu e bëjnë kallëzoren e shquar edhe emrat e përveçëm të lakimit të parë që mbarojnë me -a të theksuar:

<i>Hamzanë</i>	dhe jo	<i>Hamzain</i>
<i>Isanë</i>	» »	<i>Isain</i>
<i>Rizanë</i>	» »	<i>Rizain</i>
<i>Thomanë</i>	» »	<i>Thomain</i> etj.

§ 42. Emrat që mbarojnë me grupin zanor -ua (tipi *ftua* — *ftoi*), në rasën kallëzore të shquar mund të përdoren në dy forma:

<i>ftuan</i>	ose	<i>ftoin</i>
<i>kruan</i>	»	<i>kroin</i>
<i>përruan</i>	»	<i>përroin</i>
<i>thuan</i>	»	<i>thoin</i> etj.

Nga këto trajta duhen parapëlqyer të parat, si më të përhapura në gjuhën letrare.

### § 43. LAKIMI I DYTË

#### Numri njëjës

Rasa	Trajta e pashquar	Trajta e shquar
E.	(një) <i>shok</i>	<i>shok-u</i>
Gj.	(i, e) (një) <i>shok-u</i>	(i, e) <i>shoku-t</i>
Dh.	(një) <i>shok-u</i>	<i>shoku-t</i>
K.	(një) <i>shok</i>	<i>shok-un</i>
Rr.	(një) <i>shok-u</i>	<i>shoku-t</i>
E.	(një) <i>dhe</i>	<i>dhe-u</i>
Gj.	(i, e) (një) <sup>tr</sup> <i>dhe-u</i>	(i, e) <i>dheu-t</i>
Dh.	(një) <sup>tr</sup> <i>dhe-u</i>	<i>dheu-t</i>
K.	(një) <i>dhe</i>	<i>dhe-un</i>
Rr.	(një) <i>dhe-u</i>	<i>dheu-t</i>

§ 44. Kallëzorja e shquar e emrave të lakimit të dytë që mbarojnë me -a, -e, ose -i të theksuar, formohet me mbaresën -un e jo me -në, pra duhet:

<i>kaun</i>	dhe jo	<i>kanë</i>
<i>vaun</i>	» »	<i>vanë</i>
<i>atdheun</i>	» »	<i>atdhenë</i>
<i>dheun</i>	» »	<i>dhenë</i>
<i>ariun</i>	» »	<i>arinë</i>
<i>bariun</i>	» »	<i>barinë</i>
<i>hanxhiun</i>	» »	<i>hanxhinë</i>
<i>njeriun</i>	» »	<i>njerinë etj.</i>

Po kështu edhe emrat e përveçëm që mbarojnë njësoj si të mësipërmit:

<i>Skënderbeun</i>	dhe jo	<i>Skënderbenë</i>
<i>Aliun</i>	» »	<i>Alinë</i>
<i>Bedriun</i>	» »	<i>Bedrinë</i>
<i>Dhërmiun</i>	» »	<i>Dhërminë</i>
<i>Ganiun</i>	» »	<i>Ganinë etj.</i>

Trajtat me mbaresën -në përdoren në frazeologjizma si: *nori fjala dhenë* (jo *dheun*); *i bën hesapet pa hanxhinë* (jo *hanxhiun*) etj.



## § 45. LAKIMI I TRETË<sup>1)</sup>

### Numri njëjës

Rasa	Trajta e pashquar	Trajta e shquar
E. Gj. Dh. K. Rr.	(një) <i>fushë</i> (i, e) (një) <i>fush-e</i> (një) <i>fush-e</i> (një) <i>fushë</i> (një) <i>fush-e</i>	<i>fush-a</i> (i, e) <i>fushë-s</i> <i>fushë-s</i> <i>fushë-n</i> <i>fushë-s</i>
E. Gj. Dh. K. Rr.	(një) <i>dele</i> (i, e) (një) <i>dele-je</i> (një) <i>dele-je</i> (një) <i>dele</i> (një) <i>dele-je</i>	<i>del-ja</i> (i, e) <i>dele-s</i> <i>dele-s</i> <i>dele-n</i> <i>dele-s</i>
E. Gj. Dh. K. Rr.	(një) <i>anije</i> (i, e) (një) <i>anije-je</i> (një) <i>anije-je</i> (një) <i>anije</i> (një) <i>anije-je</i>	<i>anij-a</i> (i, e) <i>anije-s</i> <i>anije-s</i> <i>anije-n</i> <i>anije-s</i>
E. Gj. Dh. K. Rr.	(një) <i>liri</i> (i, e) (një) <i>liri-e</i> (një) <i>liri-e</i> (një) <i>liri</i> (një) <i>liri-e</i>	<i>liri-a</i> (i, e) <i>liri-së</i> <i>liri-së</i> <i>liri-në</i> <i>liri-së</i>

1) Në këtë lakim përfshihen edhe disa emra mashkullorë si *axhë*, *dajë* etj. (shih § 2).

§ 46. Emrat që dalin më -e të patheksuara, si: *dele, fitore, lule* etj, e ruajnë atë në gjinore, dhanore e rrjedhore të pashquar njëjës, pra duhet:

(i, e) (një)	<i>deleje</i>	dhe jo	<i>delje</i>
» » »	<i>fitoreje</i>	» »	<i>fitorje</i>
» » »	<i>lulishteje</i>	» »	<i>lulishtje</i>
» » »	<i>mësuesjeje</i>	» »	<i>mësuesje</i>
» » »	<i>qytetareje</i>	» »	<i>qytetarje</i>
» » »	<i>studenteje</i>	» »	<i>studentje</i> etj.

§ 47. Emrat që dalin më -je, si: *anije, ardhje, familje, lëvizje* etj., në gjinore, dhanore e rrjedhore të pashquar marrin mbaresën -je: *anije-je, çështje-je, familje-je, lëvizje-je*, prandaj ata shkruhen me dy -je njëra pas tjetrës.

Në vend të këtyre formave të drejta vihet re se herë-herë përdoren gabimisht forma pa mbaresë, p.sh.:

*kapiteni i një anije; rëndësia e kësaj çështje; prej një familje fshatare* etj.,

kurse duhet:

*kapiteni i një anijeje; rëndësia e kësaj çështjeje; prej një familjeje fshatare.*

## § 48. LAKIMI I KATËRT

Numri njëjës

Rasa	Trajta e pashquar	Trajta e shquar
E.	(një) të ftohtë	të ftohtë-t
Gj.	(i, e) (një) të ftoht-i	(i, e) të ftohti-t
Dh.	(një) të ftoht-i	të ftohti-t
K.	(një) të ftohtë	të ftohtë-t
Rr.	(një) të ftoht-i	të ftohti-t
E.	(një) të ecur	të ecur-it
Gj.	(i, e) (një) të ecur-i	(i, e) të ecuri-t
Dh.	(një) të ecur-i	të ecuri-t
K.	(një) të ecur	të ecur-it
Rr.	(një) të ecur-i	të ecuri-t

Siç shihet nga pasqyra e mësipërme, lakimi i katërt dallohet nga i pari vetëm në emëroren e në kallëzoren e shquar, në të cilat lakimi i katërt ka mbaresat -t ose -it. Në rasat e tjera mbaresat e këtyre lakimeve janë të njëjta.

## LAKIMI I EMRAVE NË NUMRIN SHUMËS

§ 49. Të gjithë emrat në numrin shumës lakohen njëjloj, pavarësisht nga gjinia ose nga tipi i lakimit të cilit i përkasin në numrin njëjës. Trajtat rasore të numrit shumës formohen në bazë të temës së emërores së pashquar shumës, së cilës i shtohen mbaresat përkatëse, p.sh.: *lis* — *lisa*, *lisave*, *lisash* etj., pra, trajtat e shumësit mund të kenë dy mbaresa: mbaresën që tregon numrin, p.sh.: -a (*lis-a*), dhe mbaresën që tregon rasën, p.sh.: -ve, -sh (*lisa-ve*, *lisa-sh*).

Ashtu si në njëjës, edhe në shumës emrat lakohen në trajtë të pashquar e në trajtë të shquar.

Më poshtë po japim disa pasqyra lakimi të emrave në numrin shumës.

### EMRA MASHKULLORË

Rasa	Trajta e pashquar	Mbaresa	Trajta e shquar	Mbaresa
E.	(ca) <i>lisa</i>	—	<i>lisa-t</i>	-t
Gj.	(i, e) (ca) <i>lisa-ve</i>	-ve	(i, e) <i>lisa-ve</i>	-ve
Dh.	(ca) <i>lisa-ve</i>	-ve	<i>lisa-ve</i>	-ve
K.	(ca) <i>lisa</i>	—	<i>lisa-t</i>	-t
Rr.	(ca) <i>lisa-sh</i>	-sh	<i>lisa-ve</i>	-ve

Si emri *lisa* lakohen edhe të gjithë emrat mashkullorë që e bëjnë shumësin me -a, p.sh.: *dema, gjemba, plepa, plumba, qilima, tela* etj.

E.	(ca)	<i>male</i>		<i>male-t</i>
Gj.	(i, e)	(ca) <i>male-ve</i>	(i, e)	<i>male-ve</i>
Dh.		(ca) <i>male-ve</i>		<i>male-ve</i>
K.		(ca) <i>male</i>		<i>male-t</i>
Rr.		(ca) <i>male-sh</i>		<i>male-ve</i>

Si emri *male* lakohen edhe të gjithë emrat mashkullorë që e bëjnë shumësin me -e, p.sh.: *fise, brigje, shtigje, ledhe, hotele, zabele, kanale, mendime, përparime, punime, vendime, kombe, kënde, vende, gjokse, boshte, kopshte, trustee, poste, fronte, vargje, harqe, parqe* etj.

E.		(ca) <i>fshatarë</i>		<i>fshatarë-t</i>
Gj.	(i, e)	(ca) <i>fshatarë-ve</i>	(i, e)	<i>fshatarë-ve</i>
Dh.		(ca) <i>fshatarë-ve</i>		<i>fshatarë-ve</i>
K.		(ca) <i>fshatarë</i>		<i>fshatarë-t</i>
Rr.		(ca) <i>fshatarë-sh</i>		<i>fshatarë-ve</i>

Si emri *fshatarë* lakohen edhe të gjithë emrat mashkullorë që e formojnë shumësin me -ë, p.sh.: *anëtarë, hambarë, aeroplanë, partizanë, intelektualë, kuintalë, doktorë, motorë, berberë, oficerë, luftëtarë, shqiptarë, peshqirë, zinxhirë, shokë, gurë* etj.

E.		(ca) <i>arinj</i>		<i>arinj-të</i>
Gj.	(i, e)	(ca) <i>arinj-ve</i>	(i, e)	<i>arinj-ve</i>
Dh.		(ca) <i>arinj-ve</i>		<i>arinj-ve</i>
K.		(ca) <i>arinj</i>		<i>arinj-të</i>
Rr.		(ca) <i>arinj-sh</i>		<i>arinj-ve</i>

Si emri *arinj* lakohen edhe të gjithë emrat mashkullorë që e bëjnë shumësin me -nj, p.sh.: *florinj, kërcinj, minj, mullinj, sharrëxhinj, heronj, hunj, ftonj, thonj* etj., etj., si edhe emrat e tjerë njërrrokësh

ose me theks mbi rrokjen e fundit, që në shumësin e pashquar dalin më një nga bashkëtingëlloret **-gj, -q, -j**, p.sh.: *zogj, fiq, miq, pleq, bij, çakej, papagaj* etj.

E.		(ca) <i>peshq</i>		<i>peshq-it</i>
Gj.	(i, e)	(ca) <i>peshq-ve</i>	(i, e)	<i>peshq-ve</i>
Dh.		(ca) <i>peshq-ve</i>		<i>peshq-ve</i>
K.		(ca) <i>peshq</i>		<i>peshq-it</i>
Rr.		(ca) <i>peshq-ish</i>		<i>peshq-ve</i>

Si emri *peshq* lakohen edhe të gjithë emrat mashkullorë që në shumës dalin me dy bashkëtingëllore, p.sh.: *bujq, krushq, ujq, murgj* etj.

E.		(ca) <i>nxënës</i>		<i>nxënës-it</i>
Gj.	(i, e)	(ca) <i>nxënës-ve</i>	(i, e)	<i>nxënës-ve</i>
Dh.		(ca) <i>nxënës-ve</i>		<i>nxënës-ve</i>
K.		(ca) <i>nxënës</i>		<i>nxënës-it</i>
Rr.		(ca) <i>nxënës-ish</i>		<i>nxënës-ve</i>

Si emri *nxënës* lakohen edhe të gjithë emrat mashkullorë që në emëroren e pashquar shumës dalin më **-s, -z** ose **-r**, p.sh.: *mësues, punonjës, shitës, njerëz, mbretër* etj.

## EMRA FEMËRORË

E.		(ca) <i>vajza</i>		<i>vajza-t</i>
Gj.	(i, e)	(ca) <i>vajza-ve</i>	(i, e)	<i>vajza-ve</i>
Dh.		(ca) <i>vajza-ve</i>		<i>vajza-ve</i>
K.		(ca) <i>vajza</i>		<i>vajza-t</i>
Rr.		(ca) <i>vajza-sh</i>		<i>vajza-ve</i>

Si emri *vajza* lakohen edhe të gjithë emrat femërorë që e bëjnë shumësin me -a, p.sh.: *baza, bisha, fusha, lopata, toka, kumbulla, vetulla, dhelpra, kodra, motra, pupla, vegla* etj.

E.	(ca)	<i>lule</i>		<i>lule-t</i>
Gj.	(i, e)	(ca) <i>lule-ve</i>	(i, e)	<i>lule-ve</i>
Dh.		(ca) <i>lule-ve</i>		<i>lule-ve</i>
K.		(ca) <i>lule</i>		<i>lule-t</i>
Rr.		(ca) <i>lule-sh</i>		<i>lule-ve</i>

Si emri *lule* lakohen të gjithë emrat femërorë që dalin më -e ose -o të patheksuar, p.sh.: *dele, faqe, mace, lagje, anije, lutje*, etj.: *depo, pako, radio, torno* etj.

E.		(ca) <i>shtëpi</i>		<i>shtëpi-të</i>
Gj.	(i, e)	(ca) <i>shtëpi-ve</i>		<i>shtëpi-ve</i>
Dh.		(ca) <i>shtëpive</i>		<i>shtëpi-ve</i>
K.		(ca) <i>shtëpi</i>		<i>shtëpi-të</i>
Rr.		(ca) <i>shtëpi-sh</i>		<i>shtëpi-ve</i>

Si emri *shtëpi* lakohen edhe të gjithë emrat femërorë që dalin më zanore të theksuar (-a, -e, -ë, -i, -o, -a), p.sh.: *kala, para, shaka* etj.; *be, ide, re, rrufe* etj.; *bukuri, cilësi, dituri, liri* etj.; *gjë; byro, tablo* etj.; *dru*.

**Shënim.** Në rasën emërore, në kallëzore e në rrjedhore të trajtës së pashquar emrat në shumës mund të përdoren edhe të pashoqëruar nga fjala *ca* (që ka kuptimin e shumësit të nyjës *një*) ose nga ndonjë fjalë tjetër përcaktuese, p.sh.: *Korabi dhe Tomori janë male të larta; Shqipëria ka shumë male; shumica e lumenjve të Shqipërisë burojnë prej malesh.* Në rasën gjinore e dhanore ata përdoren kurdoherë të shoqëruar nga fjalët *ca, disa* ose nga ndonjë fjalë tjetër përcaktuese, p.sh.: *(e) disa shokëve, (i) këtyre fshatarëve, (të) shumë nxënësve, (e) dhjetë shtëpive* etj. Këtë kuptim ka fjala *ca* e vënë në kllapa gjatë lakimit të pashquar.

Nga pasqyrat e lakimeve që u parashtruan më sipër, mund të vihet re lehtë se:

a) Mbaresat rasore të shumësit janë:

<i>për trajtën e pashquar</i>		<i>për trajtën e shquar</i>
E.	—	-t(ë), -it
Gj.	-ve	-ve
Dh.	-ve	-ve
K.	—	-t(ë), -it
Rr.	-sh, -ish	-ve

b) Emërorja dhe kallëzorja e pashquar nuk kanë ndonjë mbaresë rasore; gjinorja e dhanorja për të dyja trajtat dhe rrjedhorja e shquar kanë mbaresën -ve<sup>1</sup>, ndërsa rrjedhorja e pashquar ka mbaresën -sh ose -ish.

c) Emrat që në shumës dalin më zanore të theksuar (*kala, ide, shtëpi*), si edhe emrat njërrrokësh ose me theks në rrokjen e fundit që dalin më një bashkëtingëllore (*bij, desh, djem, ftonj, armiq, heronj* etj.), në emëroren e në kallëzoren e shquar shkruhen me -ë fundore<sup>2</sup>: *kalatë, idetë, shtëpitë* etj.; *bijtë, deshtë, djemtë, fiqtë, ftonjtë* etj.; *armiqtë, heronjtë* etj.

ç) Emrat që në shumës dalin më dy bashkëtingëllore ose më -r, -s, -z, në rrjedhoren e pashquar marrin mbaresën -ish, ndërsa në emëroren dhe në kallëzoren e shquar marrin mbaresën -it<sup>3</sup>: *bujq-ish, etër-ish, nxënës-ish, njerëz-ish; bujq-it, etër-it, nxënës-it, njerëz-it* etj.

---

1) Trajtat me -vet të gjinores, dhanores e rrjedhores së shquar, si *djemvet, malevet nënavet* etj., kanë dalë nga norma e sotme gramatikore, ato nuk kryejnë ndonjë funksion të veçantë dhe s'ka përse të përdoren.

2) Shih për këtë «Drejtshkrimi i gjuhës shqipe» § 8 dh, e.

3) Shih për këtë «Drejtshkrimi i gjuhës shqipe» § 9 c.

## DISA VËREJTJE PËR PËRDORIMIN E TRAJTËS

§ 50. Siç u pa edhe nga pasqyrat e lakimeve, emrat në gjuhën shqipe përdoren në dy trajta: në trajtën e pashquar e në trajtën e shquar.

Emri në trajtën e pashquar tregon sende, frymorë etj. në përgjithësi në mënyrë të pacaktuar, p.sh.: *Në brigadë erdhi një punëtor i ri; Ne hekurudhë ka vullnetarë nga gjithë vendi; Liria fitohet në luftë* etj.

Emri në trajtën e shquar tregon sende, frymorë etj. të caktuar, të njohur, p.sh.:

**Punëtori** i ri i brigadës ndjek shkollën e mesme; **Populli** e do ushtrinë e tij; «**O malet** e Shqipërisë dhe ju o lisat e gjatë!»

§ 51. Emrat e lakimit të tretë, të përgjithshëm ose të përveçëm, që dalin më -o të patheksuar, e formojnë trajtën e shquar me mbare-sën -ja<sup>1</sup>, p.sh.: *çimentoja, depoja, pianoja, radioja, tifoja, xhiroja* etj.; *Gaqoja, Koçoja, Kongoja, Osloja, Vitoja* etj. (trajtat më -ua, si: *çimentua, depua, tifua, Gaqua, Koçua* etj., nuk janë më normative dhe s'duhën përdorur në gjuhën letrare). Kështu duhet thënë: **çimentoja** dëmtohet nga lagështia; u ndërtua **depoja** e drithit; **radioja** dhe televizori buçasin në çdo fshat; **tifoja** e shpendëve shkaktohet nga ...; **xhiroja** e këtij viti do të rritet... etj.; erdhi **Gaqoja**; **Koçoja** shkoi vullnetar; **Kongoja** është një nga lumenjtë më të mëdhenj të botës; nga **Osloja** njoftohet se... etj.

Në të folur dhe nëpër shkrime të ndryshme vihet re herë-herë se për emrat e tipit të mësipërm në vend të trajtës së shquar përdoret e pashquara, p.sh.: *çimento dëmtohet nga lagështia; u ndërtua depo e drithit; tifo e shpendëve shkaktohet nga ...; nga Oslo njoftohet se ...* etj. Këto përdorime janë në kundërshtim me normat gramatikore dhe nuk duhen lejuar në gjuhën letrare.

1) Shih «Drejtskrimi i gjuhës shqipe» § 25 c.



## NDËRRIMI I GJINISË SË DISA EMRAVE MASHKULLORË NË NUMRIN SHUMËS

§ 52. Disa emra që në njëjës janë mashkullorë, në numrin shumës kërkojnë që mbiemrat përcaktues të tyre të vihen në trajtën e gjinisë femërore. Këta janë:

a) emrat që e formojnë shumësin me mbaresën *-e*, p.sh.:

*aparate elektronike, artet e bukura, këto aspekte, dete të thella, drejtimet kryesore, gaze të djegshme, grupe të veçanta, indet lidhëse, kanale ujitëse, katunde malore, kurse dymujore, kujtimet e mia, këto lajme s'më duken të besueshme, lloje të reja, male të larta, materiale të tjera, minerale të dobishme, mendime të vlefshme, të gjitha organet shtetërore, pallate shumëkatëshe, personazhe pozitive, plane pesëvjeçare, probleme ekonomike, të gjitha prodhimet bujqësore, këto procese janë të mekanizuara, qytetet e mëdha, ritme të shpejta, sende të gjetura, sulme të befasishme, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, tanke të rënda, tipare themelore, tregime humoristike, ushtrime gjimnastikore, vende liridashëse, këto vendime janë të drejta, veprime luftarake, vite të zjarra, zakonet i kanë të afërta etj. etj. (dhe jo: aparate elektronikë, këta aspekte, male të lartë, dete të thellë, qytete të mëdhenj etj.);*

b) emrat që e formojnë shumësin me mbaresën *-ra*, p.sh.:

*barëra të këqija, djathëra të mira, drithëra të sivjetme, fshatra të elektrifikuara, leshra të dredhura, mallra të jashtme, mishra të pjekura, plehra organike, shira të rrëmbyera, ujëra nëntokësore etj. (dhe jo: barëra të këqij, djathëra të mirë, drithërat e sivjetmë etj.).*

**Shënim.** Të mos ngatërrohet kjo kategori me emrat që në emëroren e pashquar të njëjësit dalin më *-r* dhe e formojnë shumësin me mbaresën *-a*; mbiemrat që i përcaktojnë këta emra, përdoren në trajtën e gjinisë mashkullore: *emra ilirë, hekura të ndryshkur, libra të vjetër, mbiemra të nyjshëm; metra katrorë, pjepra të ëmbël, regjistra themelitarë, urdhra të prerë etj. (dhe jo: emra ilire, hekura të ndryhkura, libra të vjetra etj.).*

§ 53. Të gjithë tipat e tjerë të emrave mashkullorë që nuk përfshihen në pikat *a* e *b* të paragrafit të mësipërm, kërkojnë që mbiemrat e përemrat që i përcaktojnë, të vihen në trajtën e gjinisë mashkullore. Pra, është i gabuar përdorimi në gjininë femërore i mbiemrave e i përemrave që përcaktojnë emrat mashkullorë, të cilët e formojnë

shumësin me mbaresat **-a** ose **-ë**. Ky përdorim i gabuar e ka burimin tek analogjia me emrat femërorë që dalin në shumës gjithashtu **më -a** ose **më -ë**. Kështu, nuk është e drejtë të shkruhet e të thuhet:

*bedenat e gurta, filma të xhiruara, gishta të forta dhe të shkathëta, me shënimin e dy golave të tjera, këto janë krimba të holla, specat e mbushura, stolat e gjata, shirita të zeza, tela të holla, tuba të gjera, midis vagonave të bukura etj. (duhej: bedenat e gurtë, filmat e xhiruar, tela të hollë etj.);*

ose: *faktorët kryesore, flokë të qethura, këto dy përvjetorë, rrathë të mëdha, këto rezervuarë, rezervuarë artificiale, thasët e tyre të rënda etj. (duhej: faktorët kryesorë, flokë të qethur, këta dy përvjetorë, rrathë të mëdhenj etj.).*

## II. NUMËRORI

§ 54. Nga numërorët, vetëm *tre/tri* dallohen sipas gjinisë së emrit me të cilin përdoren. Numërori *tre* përdoret me emra të gjinisë mashkullore, p.sh.:

*tre djem, tre kalema, tre lekë* etj.;

po kështu përdoren edhe numërorët e përbërë që kanë si gjymtyrë të fundit numërorin *tre*:

*njëzet e tre vullnetarë, pesëdhjetë e tre nxënës, nëntëdhjetë e tre vjet* etj.

Numërori *tri* përdoret me emra të gjinisë femërore, p.sh.:

*tri vajza, tri pena, tri fletore, tri pjesë, tri copë* etj.; po kështu përdoren edhe numërorët e përbërë që kanë si gjymtyrë të fundit numërorin *tri*:

*njëzet e tri pjesë, dyzet e tri vullnetarë, pesëdhjetë e tri nxënëse, nëntëdhjetë e tri ditë* etj.

Ky dallim gjinie ruhet edhe kur numërori *tre/tri* përdoret pa emrin përkatës, në raste të tilla si:

— *Sa shokë ishin?*

— **Tre.**

— *Sa fletore bleve?*

**Tri.**

— *Në sa pjesë e ndave?*

— **Në tri.**

### III. P Ë R E M R I

#### 1. PËREMRI VETOR

§ 55. Përemrat vetorë janë:

	<i>njëjës</i>	<i>shumës</i>
veta I	<b>unë</b>	<b>ne</b>
» II	<b>ti</b>	<b>ju</b>
» III	<b>ai, ajo</b>	<b>ata, ato</b>

Në të tria vetat përemrat kanë numër njëjës dhe shumës, por vetëm në vetën e tretë ata dallohen edhe sipas gjinisë:

mashk. **ai, ata,** fem. **ajo, ato.**

Përemrat vetorë lakohen sipas pasqyrës së mëposhtme:

#### LAKIMI I PËREMRAVE VETORË

Veta e parë dhe e dytë

Rasa	Veta e parë		Veta e dytë	
	Njëjës	Shumës	Njëjës	Shumës
E.	<i>unë</i>	<i>ne</i>	<i>ti</i>	<i>ju</i>
Gj.	—	—	—	—
Dh.	<i>mua, më</i>	<i>neve, na</i>	<i>ty, të</i>	<i>juve, ju</i>
K.	<i>mua, më</i>	<i>ne, na</i>	<i>ty, të</i>	<i>ju, ju</i>
Rr.	<i>meje</i>	<i>nesh</i>	<i>teje</i>	<i>jush</i>

Veta e tretë

Rasa	Numri njëjës		Numri shumës	
	m	f	m	f
E.	<i>ai</i>	<i>ajo</i>	<i>ata</i>	<i>ato</i>
Gj.	<i>i (e) atij</i>	<i>i (e) asaj</i>	<i>i (e) atyre</i>	<i>i (e) atyre</i>
Dh.	<i>atij, i</i>	<i>asaj, i</i>	<i>atyre, u</i>	<i>atyre, u</i>
K.	<i>atë, e</i>	<i>atë, e</i>	<i>ata, i</i>	<i>ato, i</i>
Rr.	<i>atij</i>	<i>asaj</i>	<i>atyre</i>	<i>atyre</i>

1) Përemrat vetorë në rasat dhanore dhe kallëzore kanë një trajtë të plotë dhe një trajtë të shkurtër: **mua, më; juve, ju; atij, i** etj. Trajtat e shkurtra janë kurdoherë të patheksuara dhe shërbejnë si kundrina të drejta ose të zhdrejta, d.m.th. u përgjigjen pyetjeve *kë?, cilin?, kujt?, cilit?*

**më pa (kë?); e gjeta (kë? çfarë?); i lutem (kujt?), u tregova (kujt?)** etj.

2) Përemrat vetorë të vetës së parë e të dytë nuk përdoren në rasën gjinore.

3) Për vetën e parë e të dytë trajtat e shkurtra të rasave dhanore e kallëzore janë të njëllorja: *më, na, të, ju*. Rasa e tyre mund të përcaktohet vetëm me anë të pyetjeve:

**Më kujtohet (Kujt? — Mua — rasa dhanore);**

**Më pa (Kë? — Mua — rasa kallëzore);**

**Na kënaqi me ato fjalë (Kë? — Ne — rasa kallëzore);**

**Na kënaqi shpirtin me ato fjalë (Kujt? — Neve — rasa dhanore).**

## VËREJTJE RRETH DISA PËRDORIMEVE TË GABUARA TË PËREMRAVE VETORË

§ 56. Në gjuhën e folur e në gjuhën e shkruar vihen re disa gabime lidhur me përdorimin e trajtave rasore të përemrave vetorë që u paraqitën në pasqyrën e lakimit në paragrafin e mësipërm. Më të shpeshta janë rastet e përdorimit të trajtave *neve*, *juve* në vend të *ne*, *ju*, d.m.th. *përdoret gabimisht trajta e rasës dhanore në vend të trajtës së rasës emërore ose të rasës kallëzore*.

Ja disa shembuj me përdorime të gabuara të trajtave *neve* e *juve*:

*Po ta ndërpresim neve punën. . . ; Ti e mban mend me se loznim neve kur ishim të vegjël; Neve i kemi të gjitha kushtet për. . . ; Me mjetet që kemi neve . . . ; Kush e ka pastruar oborrin? — Neve; etj. ; Juve na keni bërë një shërbim të madh; Po juve, a keni qenë në hekurudhë?; Si shkolla, si juve jeni të rinj etj.; Neve na ka gëzuar pa masë lajmi që . . . ; Organizata na ngarkoi neve me një detyrë të rëndësishme; Juve, sigurisht, ju ka marrë uria; Po kush do t'ju shpëtojë juve në mes të oqeanit? etj.*

Te të gjithë shembujt e mësipërm trajtat *neve* e *juve* janë përdorur gabimisht në vend të trajtave *ne* e *ju*.

Për të shmangur këtë gabim duhen pasur parasysh rregullat e mëposhtme:

Trajtat *ne*, *ju*, kur përdoren pa parafjalë, mund të shërbejnë si kryefjalë (dhe atëherë i përgjigjen pyetjes *kush?*), ose si kundrinë e drejtë (dhe atëherë i përgjigjen pyetjes *kë?*). P.sh.: *Ne do të nisemi sot* (*Kush? — Ne*); *Të na kujtosh edhe ne* (*Kë? — Ne*); *Ju keni bërë një punë shumë të dobishme* (*Kush? — Ju*); *Po ju pres ju, shoku Agim* (*Kë? — Ju*) etj.

Trajtat *ne* e *ju* mund të përdoren edhe me parafjalë:

a) me parafjalët *te(k)* e *nga*, që kërkojnë rasën emërore, p.sh.: *te ne*, *nga ju* etj.;

b) me parafjalët *me*, *për*, *pa*, *mbi*, *nën*, *ndër* etj.; që kërkojnë rasën kallëzore, p.sh.: *me ne*, *ndër ne*, *për ne*, *pa ju*, *për ju*, *me ju* etj.

Trajtat e rasës dhanore *neve*, *juve* shërbejnë kurdoherë si kundrina të zhdrejta dhe i përgjigjen pyetjes *kujt?*, p.sh.: *na e trego edhe neve* (*Kujt? — Neve*); *po ju flas juve* (*Kujt? — Juve*) etj.

Trajtat *neve* e *juve* nuk përdoren asnjëherë me parafjalë, sepse

ato janë trajta të rasës dhanore dhe *rasa dhanore përdoret pa parafjalë*.

Përdorimi i gabuar i trajtave **neve, juve** në vend të **ne, ju** vihet re edhe pas parafjalëve të rasës emërore e kallëzore, p.sh.: *nga neve, nga juve, te neve, te juve, me neve, mbi juve, pa neve, për juve* etj.

Tetë gjithë shembujt e mësipërm në vend të trajtave *neve, juve*, që janë trajta të rasës dhanore (shih pasqyrën e lakimit), duhej të ishin trajtat *ne, ju* të rasës emërore e kallëzore, sepse pas parafjalëve *nga* e *te* përdoret kurdoherë *rasa emërore*, ndërsa pas parafjalëve *me, mbi, pa, për* përdoret kurdoherë *rasa kallëzore*.

§ 57. Përveç përdorimit të gabuar të trajtave *neve, juve* në vend të *ne, ju* vihet re, ndonëse më rrallë, edhe gabimi i përkundërt, d.m.th. përdorimi i trajtave *ne, ju* të rasës emërore e kallëzore në vend të trajtave *neve, juve* të rasës dhanore. Ja disa shembujt e këtyre përdorimeve të gabuara:

*Ky lajm na u komunikua edhe ne; Ne na vjen keq që...; Ne na duhet të mendohejmë thellë për këto probleme; Kur na u dha flamuri, ne na dukej sikur...; Kjo përshtypje na krijohet edhe ne të moshuarve; Ju ju pëlqen të këndonin këngë partizane; Po jua tregoj edhe ju atë që më ngjau* etj.

Te të gjithë shembujt e mësipërm foljet kërkojnë kundrina të zhdrejta, prandaj përemrat vetorë duhej të ishin përdorur në trajtën e rasës dhanore **neve, juve** dhe jo në trajtën e emërores a të kallëzores (**ne, ju**).

§ 58. Pas parafjalëve **nga** e **te(k)**<sup>1)</sup> përemri, ashtu si emri, vihet kurdoherë në rasën emërore, p.sh.: *e mori vesh nga unë (nga kush?); erdhi tek unë (te kush?); sille tek unë (te kush?)* etj. Vihet re herë-herë se pas këtyre parafjalëve në vend të trajtës **unë** përdoret gabimisht **mua**, p.sh.:

*Eja te mua!; Nesër, mbliidhemi te mua; Mos u largo nga mua!* etj.

Te të gjithë shembujt e mësipërm duhej përdorur: **tek unë, nga unë**. Pra:

	<i>te mua</i>		<b>te unë</b>
asnjëherë		gjithnjë	
	<i>nga mua</i>		<b>nga unë</b>

1) Trajta *tek* përdoret zakonisht përpara emrave e përemrave që fillojnë me zanore.

## TRAJTAT E SHKURTRA TË PËREMRAVE VETORË

§ 59. Gjatë lakimit, në rasën dhanore e në kallëzore përemrat vetorë kanë veç trajtave të plota edhe trajta të shkurtra. Këto trajta të shkurtra mund të paraqiten në mënyrë të përmblodhur në pasqyrat e mëposhtme:

### Veta e parë dhe e dytë

Rasat	Veta e parë		Veta e dytë	
	Njëjës	Shumës	Njëjës	Shumës
Dh.	<i>mua, më</i>	<i>neve, na</i>	<i>ty, të</i>	<i>juve, ju</i>
K.	<i>mua, më</i>	<i>ne, na</i>	<i>ty, të</i>	<i>ju, ju</i>

### Veta e tretë

Rasa	Numri njëjës		Numri shumës	
	m	f	m	f
Dh.	<i>atij, i</i>	<i>asaj, i</i>	<i>atyre, u</i>	<i>atyre, u</i>
K.	<i>atë, e</i>	<i>atë, e</i>	<i>ata, i</i>	<i>ato, i</i>

Nga pasqyrat e mësipërme shihet se në vetën e parë dhe të dytë trajtat e shkurtra janë të njëjta për të dyja rasat: **më, na, të, ju** për dhanoren e për kallëzoren; në vetën e tretë trajtat e shkurtra janë të njëjta për të dyja gjinitë, por trajta e shkurtër e rasës dhanore është e ndryshme nga trajta e shkurtër e rasës kallëzore.

Trajtat e shkurtra janë kurdoherë të patheksuara. Ato shër-



bejnë për të shprehur kundrinën e drejtë ose të zhdrejtë dhe përdoren vetëm ose krahas trajtave të plota, P.sh.:

— *A më mban mend mua?*

— *Nuk të mbaj mend.*

Mund të përdoren edhe dy trajta të shkurtra pranë njëra-tjetrës. Në këto raste e para është trajtë e shkurtër e rasës dhanore (e vetës së parë, të dytë ose të tretë, të njëjësit ose të shumësit), ndërsa e dyta është trajtë e shkurtër e rasës kallëzore (veta e tretë e njëjësit ose e shumësit), d.m.th. trajtat e shkurtra të rasës dhanore mund të bashkohen me trajtat e shkurtra e ose i të kallëzores.

### Pasqyra e trajtave të shkurtra të bashkuara

Trajta e dhanores		Trajta e kallëzores	Trajta e bashkuar	Shembuj
<b>më</b> ( <i>mua</i> )	+	<b>e</b> (atë)	= <b>ma</b>	<b>Ma dha librin</b>
<b>të</b> ( <i>ty</i> )	+	<b>e</b> »	= <b>ta</b>	<b>Ta dha librin</b>
<b>i</b> ( <i>atij, asaj</i> )	+	<b>e</b> »	= <b>ia</b>	<b>Ia dha librin</b>
<b>na</b> ( <i>neve</i> )	+	<b>e</b> »	= <b>na e</b>	<b>Na e dha librin</b>
<b>ju</b> ( <i>juve</i> )	+	<b>e</b> »	= <b>jua</b>	<b>Jua dha librin</b>
<b>u</b> ( <i>atyre</i> )	+	<b>e</b> »	= <b>ua</b>	<b>Ua dha librin</b>
<b>më</b> ( <i>mua</i> )	+	<b>i</b> (ata, ato)	= <b>m'i</b>	<b>M'i dha librat</b>
<b>të</b> ( <i>ty</i> )	+	<b>i</b> » »	= <b>t'i</b>	<b>T'i dha librat</b>
<b>i</b> ( <i>atij, asaj</i> )	+	<b>i</b> » »	= <b>ia</b>	<b>Ia dha librat</b>
<b>na</b> ( <i>neve</i> )	+	<b>i</b> » »	= <b>na i</b>	<b>Na i dha librat</b>
<b>ju</b> ( <i>juve</i> )	+	<b>i</b> » »	= <b>jua</b>	<b>Jua dha librat</b>
<b>u</b> ( <i>atyre</i> )	+	<b>i</b> » »	= <b>ua</b>	<b>Ua dha librat</b>

Nga kjo pasqyrë shihet se:

- vetëm trajtat **m'i**, **t'i** shkruhen me apostrof;
- vetëm trajtat **na e**, **na i** shkruhen ndaras;

c) trajtat e bashkuara **ia**, **ua** mund të dalin në dy mënyra:

**ia** < **i** (*atij*) + **e** (*atë*)      **ia** < **i** (*atij*) + **i** (*ata, ato*)

**Ja** *dhashë librin shokut.*      **Ia** *dhashë librat shokut.*

**ua** < **u** (*atyre*) + **e** (*atë*)      **ua** < **u** (*atyre*) + **i** (*ata, ato*)

**Ua** *dhashë librin shokëve.*      **Ua** *dhashë librat shokëve.*

## VËREJTJE RRETH DISA PËRDORIMEVE TË GABUARA TË TRAJTAVE TË SHKURTRA TË PËREMRAVE VETORË

§ 60. Mjaft herë vihen re përdorime të gabuara të trajtave të shkurtra të përemrave. Këto gabime janë dy farësh: gabime në numër dhe gabime në vetë.

### GABIME NË NUMËR

a) **u** *tha atyre* dhe **jo** *i tha atyre*

**U** dhe **i** janë trajta të shkurtra të rasës dhanore të përemrave vetorë të vetës së tretë, por **u** është trajtë e shumësit (*atyre u*), ndërsa **i** trajtë e njëjësit (*atij, asaj i*). Kur kundrina e zhdrejtë është një emër a një përemër në numrin shumës, edhe trajta e shkurtër e përemrit që përsërit kundrinën, duhet të jetë në numrin shumës, d.m.th. **u** dhe **jo i**.

Kështu, te të gjithë shembujt e mëposhtëm:

*Një kujdes i madh i kushtohet këtu metodave të reja; Një pjesë e instalimeve nuk i përgjigjet kushteve teknike; Rruga dhe drita i ngjiten maleve; Ushtarët e vdekjes po i afroreshin mureve; Mallra që i përgjigjen kërkesave të blerësve; Nuk i vuri veshin këshillave të mia; Rinia i ndryshoi pamjen këtyre kodrave; Për sa i përket masave që janë marrë kundër thatësirës etj., trajta i është përdorur gabim. Në vend të saj duhej përdorur trajta **u** e shumësit, sepse të gjitha kundrinat e zhdrejta janë në numrin shumës: *metodave, kushteve, maleve, mureve, kërkesave, këshillave, këtyre kodrave, masave.**

Edhe kur kundrina shprehet me dy a më shumë emra të bashkërenditur në numrin njëjës, trajta e shkurtër duhet të vihet në shumës, sepse **u** përgjigjet disa kundrinave, pra, **u** dhe **jo i**, p.sh.:

*Kujdes i veçantë duhet t'u kushtohet ruajtjes, transportimit dhe përdorimit të lëndëve helmuese (dhe jo t'i kushtohet); Pushteti popullor u ka kushtuar rëndësi të madhe arsimit dhe kulturës (dhe jo i ka kushtuar) etj.*

b) **ua** dha atyre dhe jo **ia** dha atyre

Edhe në këtë rast kemi të bëjmë me të njëjtin gabim: kur kundrina e zhdrejtë është në numrin shumës, duhet të përdoret kurdoherë trajta **ua** e formuar nga **u + e** ose **u + i** dhe jo trajta **ia**, që formohet nga **i + e** ose **i + i**.

Kështu, te të gjithë shembujt e mëposhtëm:

*Do t'ia them shoqeve; për t'ia arritur këtyre qëllimeve; Disa prej tyre zhdrukeshin duke ia lënë vendin të tjerëve; Borgjezia barrën e gjithë shpenzimeve të luftës ia ngarkon punëtorëve; Ai nuk ia përton punëve të tilla; Shtypi ilegal ia hoqi maskën pseudopatriotëve ballistë; Organizata e rinisë, ia preu rrugën këtyre sjelljeve etj., trajta **ia** është përdorur gabim. Në vend të saj duhej përdorur trajta **ua**, sepse kundrina e zhdrejtë është në numrin shumës, pra:*

**ua** < **u** (atyre) +  $\begin{cases} e \text{ (atë)} \\ i \text{ (ata, ato)} \end{cases}$

**ua** dha librin shokëve

**ua** dha librat shokëve

c) **na** e dha fjalën dhe jo **na i** dha fjalën

Te bashkimet **na e** dhe **na i** (shih pasqyrën në § 59 faqe 58), pjesa e parë **na** është trajta e shkurtër e dhanores **neve**, pjesa e dytë është trajta e kallëzores: **e** (atë), **i** (ata, ato). Kur kundrina e drejtë është në numrin njëjës, duhet përdorur trajta **na e**, ndërsa kur është në numrin shumës **na i**. Te shembulli **Na e dha fjalën**, kundrina e drejtë **fjalën** është në numrin njëjës, prandaj duhet përdorur trajta e shkurtër e (atë) dhe jo **i** (ato). Herë-herë, nën ndikimin e ndonjë të folmeje, përdoret gabimisht **na i** në vend të **na e**. Ja disa shembuj të tillë:

**K**ëtë e dimë edhe pa na i thënë ti; Na i keni prishur mendjen fare me këtë që na treguat; Atë nuk na i zuri syri gjëkund; Nuk na i kanë fajin të tjerët etj.

Te të gjithë shembujt e mësipërm kundrinat e drejta këtë, mendjen, atë, fajin janë në numrin njëjës, prandaj duhej përdorur trajta e shkurtër e, pra na e dhe jo na i.

### Përmbledhje e gabimeve në numër

a) u	dhe jo	i	(u tha atyre)
b) ua	» »	ia	(ua dha atyre librin (librat))
c) na e	» »	na i	(na e dha librin)

### GABIME NË VETË

a) **ju** dhashë juve dhe jo u dhashë juve

**Ju** është trajtë e shkurtër e vetës së dytë të shumësit për rasën dhanore (juve **ju**) ose kallëzore (ju **ju**), ndërsa u është trajtë e shkurtër e vetës së tretë të shumësit, për rasën dhanore (atyre **u**). Herë-herë trajta u e vetës së tretë përdoret gabimisht në vend të trajtës **ju** të vetës së dytë, p.sh.:

*Juve u kujtohet mirë koha e aksioneve të para; U lutem të më regjistroni edhe mua vullnetar . . . ; Do t'u luteshim, shoku kryetar, që me rastin e mbarimit të vitit . . . ; Unë u kam pritur . . . ; Nuk do t'u harroj kurrë etj.*

Te të gjithë shembujt e mësipërm duhej përdorur trajta e shkurtër **ju** qoftë si kundrinë e zhdrejtë (rasa dhanore), qoftë si kundrinë e drejtë (rasa kallëzore), sepse këto kundrina në të gjitha rastet i përkasin vetës së dytë: *Juve ju kujtohet . . . (Kujt? — Juve, ju); Ju lutem të më regjistroni . . . (Kujt? — Juve, ju); Unë ju kam pritur . . . (Kë? — Ju, ju) etj.*

b) **ju**a dhashë juve dhe jo **ua** dhashë juve

Edhe në këtë rast kemi të bëjmë me gabimin që u përkrua më sipër: kur kundrina e zhdrejtë është në veten e dytë (juve), atëherë

duhet përdorur trajta e bashkuar **jua** (e formuar nga *ju + e* ose *ju + i*) dhe jo trajta **ua** (e formuar nga *u + e* ose *u + i*).

Ja disa shembuj ku trajta **ua** është përdorur gabim:

*Juve ua kanë thënë të gjitha; Materialet që na kërkoni, do t'ua dërgojmë brenda muajit; Shkaqet e kësaj gjendjeje po ua radhitim më poshtë etj.*

Te këta shembuj kundrina e zhdrejtë është në vetën e dytë, prandaj pranë foljes duhej përdorur trajta e bashkuar *jua*: *Jua kanë thënë* (Kujt? — *Juve*); *Do t'jua dërgojmë* (Kujt? — *Juve*) etj.

c) **u dhashë atyre** dhe jo **ju dhashë atyre**

Më lart, në pikën **a** të këtij paragrafi, thamë se trajta e vetës së tretë **u** përdoret herë-herë gabimisht në vend të trajtës së vetës së dytë **ju**, p.sh. **u dhashë juve** për **ju dhashë juve**. Por vihet re edhe gabimi i përkundërt: trajta e vetës së dytë **ju** përdoret nganjëherë gabimisht në vend të trajtës së vetës së tretë **u**. Ja disa shembuj:

*Më këshilloi t'ju thosha edhe shokëve se . . . ; Ata filluan vetë nga puna dhe ne nuk ju thamë gjë; Ata i mposhtën me guxim vështirësitë që ju dolën gjatë ndërtimit të urës; Ju lumtë trimave të mi! — thirri me gëzim brigadieri; Disa prindër ju thonë fëmijëve se . . . etj.*

Te të gjithë shembujt e mësipërm duhej përdorur trajta e shkur-tër **u**, sepse kundrinat e zhdrejta te këta shembuj i përkasin vetës së tretë. *T'u thosha shokëve* (Kujt? — *Atyre, u*); *U lumtë trimave të mi* (Kujt? — *Atyre, u*) etj.

ç) **ua dhashë atyre** dhe jo **jua dhashë atyre**

Edhe në këtë rast kemi të bëjmë me gabimin që u përshkrua më sipër: kur kundrina e zhdrejtë e fjalisë i përket vetës së tretë, atëherë duhet përdorur trajta e bashkuar **ua**, e formuar nga **u** (*atyre*) + **e** (*atë*) ose **i** (*ata, ato*), dhe jo trajta *jua*.

Ja disa shembuj përdorimesh të gabuara:

*Për t'jua arritur qëllimeve të tyre ata përdorin të gjitha mjetet; Duhet t'jua bëjmë të qartë nxënësve rëndësinë e punës prodhuese etj.* Te shembujt e mësipërm duhej përdorur trajta **ua**, sepse kundrina e zhdrejtë i përket vetës së tretë: *për t'ua arritur qëllimeve* (*atyre, u*); *t'ua bëjmë të qartë nxënësve* (*atyre, u*).

## Përmbledhje e gabimeve në vetë

a) ju	dhe jo	u	(ju dhashë juve)
b) jua	» »	ua	(jua dhashë juve)
c) u	» »	ju	(u dhashë atyre)
ç) ua	» »	jua	(ua dhashë atyre)

## 2. PËREMRI PRONOR

§ 61. Përemrat pronorë mund të paraqiten në këtë pasqyrë përmbledhëse:

Veta e parë		Veta e dytë				Veta e tretë	
Njëjës		Shumës		Njëjës		Shumës	
m.	f.	m.	f.	m.	f.	m.	f.
<i>im</i>	<i>ime</i>	<i>e mi</i>	<i>e mia</i>	<i>yt jote</i>	<i>e tu</i>	<i>e tij</i>	<i>e saj</i>
						<i>e tij</i>	<i>e saj</i>
						<i>i saj</i>	<i>e saj</i>
<i>ynë</i>	<i>jonë</i>	<i>tanë</i>	<i>tona</i>	<i>juaj juaj</i>	<i>tuaj tuaja</i>	<i>i tyre</i>	<i>e tyre</i>
						<i>e tyre</i>	

Nga pasqyra e mësipërme shihet se përemrat pronorë, ashtu si vetorët, kanë tri veta dhe përdoren në njëjës e në shumës. Përemrat vetorë kanë edhe gjini. Trajta e gjinisë mashkullore përdoret kur emri që përcaktohet, është mashkullor, ndërsa trajta e gjinisë femërore përdoret kur emri që përcaktohet është femëror, p.sh.:

*djali im, shoku ynë, qëndrimi yt, mendimi i tij, qëndrimi i saj etj.;*

*vajza ime, shoqja jonë, sjellja jote, skuadra e tij, vjersha e saj etj.*

Në vetën e tretë njëjës përemrat pronorë kanë trajta të veçanta që varen jo vetëm nga gjinia e emrit që përcaktojnë<sup>1)</sup>, por edhe nga gjinia e «pronarit», d.m.th. e emrit a e përemrit që shënon frymorin ose sendin të cilit i përket diçka, p.sh.:

**Petriri** më dha kalemin e tij.

**Vjollca** më dha kalemin e saj.

**Populli** ynë është zot i vendit dhe i fateve të tij.

**Bajamja** lulëzon e para nga pemët. Lulet e saj janë të bukura.

**Secili** përgjigjet për punën e tij. **Secila** të ulet në vendin e saj.

Në vetën e tretë përveç përemrave të shënuar në pasqyrën e mësipërme, përdoret edhe përemri *i (e, të) vet*, p.sh.: *shoku i vet, shoqja e vet, shokët e vet, shoqet e veta*. Për përdorimin e këtij përemri shih më poshtë § 65.

Përemrat pronorë përdoren jo vetëm si përcaktorë të një emri (*libri im, fushat tona* etj.), por edhe më vete. p.sh.:

— *I kujt është ky libër?*

— *Imi.*

Ose: *Ndërmarrja jonë ka më shumë punëtorë se juaja.*

*Shkolla juaj është më e re se jona.*

Ja pasqyra e trajtave të përemrave pronorë kur përdoren më vete:

Veta e parë				Veta e dytë			
Njëjës		Shumës		Njëjës		Shumës	
m	f.	m.	f.	m.	f.	m.	f.
<i>imi</i>	<i>imja</i>	<i>yni</i>	<i>jona</i>	<i>yti</i>	<i>jotja</i>	<i>juaji</i>	<i>juaja</i>
<i>të mitë</i>	<i>të miat</i>	<i>tanët</i>	<i>tonat</i>	<i>të tutë</i>	<i>të tuat</i>	<i>tuajt</i>	<i>tuajat</i>

1) Siç shihet edhe nga këta shembuj, përemrat pronorë të vetës së tretë, kur përcaktojnë një emër të gjinisë mashkullore, kanë nyjën *i: libri i tij, i saj*; kur përcaktojnë një emër të gjinisë femërore, kanë nyjën *e: fletorja e tij, e saj* etj. Trajta (*fletorja*) e *tija, e saja*, që përdoren nganjëherë për këta pronorë, kur ata përcaktojnë një emër femëror, nuk janë në pajtim me normën e sotme gramatikore dhe duhen mënjeluar nga gjuha letrare.

Veta e tretë			
Njëjës		Shumës	
m.	f.	m.	f.
<i>i tiji</i>	<i>i saji</i>	<i>i tyri</i>	<i>e tyrja</i>
<i>e tija<sup>1)</sup></i>	<i>e saja<sup>1)</sup></i>		
<i>të tijtë</i>	<i>të sajtë</i>	<i>të tyret</i>	
<i>të tijat</i>	<i>të sajat</i>		

Siç shihet nga pasqyra e mësipërme, përemrat e gjinisë mashkullore, kur përdoren më vete, në numrin njëjës kanë mbaresën **-i**:

**imi, yni, yti, juaji, i tiji, i saji, i tyri;**

përemrat e gjinisë femërore kanë mbaresën **-a**:

**imja, jona, jotja, juaja, e tija, e saja, e tyrja;**

në numrin shumës të gjithë përemrat kanë mbaresën **-t(ë)** dhe disa prej tyre nyjën e përparme **të**;

*të mitë, të miat, tanët, tonat, të tutë, të tuat, tuajt, tuajat, të tijtë, të sajtë, të tijat, të sajat, të tyret.*

Sipas rregullave të drejtshkrimit, te përemrat e mësipërm përdoret mbaresa **-të** (me **-ë**), kur ndodhet fill pas rrokjes së theksuar, p.sh.: *të mitë, të sajtë* (rrokja e theksuar: *mi, saj*), dhe mbaresa **-t** (pa **-ë**), kur ndodhet një rrokje më tej rrokjes së theksuar, p.sh.: *tonat, të tuat, tuajt* etj.

Përemri pronor *i vet*, kur përdoret më vete, del në këto trajta:

<i>njëjës</i>	<i>shumës</i>
m: <b>i veti</b>	<b>të vetët</b>
f: <b>e veta,</b>	<b>të vetat</b>

1) Të mos ngatërrohen këto trajta me trajtat jonormative *fletoret e tija/e saja*, për të cilat u tërhoq vërejtja në shënimin në fund të faqes 64.



## § 62. LAKIMI I PËREMRAVE PRONORË

Nga sa u parashtrua në paragrafin më sipër, del se përemrat pronorë kanë dy lakime të veçanta: a) kur përdoren pas emrave, b) kur përdoren më vete:

### A. LAKIMI I PËREMRAVE PRONORË KUR PËRDOREN SI PËRCAKTUES TË EMRAVE

#### I. Përemri ndodhet pas emrit

##### Veta e parë njëjës

Gjinia mashkullore

Gjinia femërore

##### *Prona njëjës*

E.	<i>libri im</i>	<i>detyra ime</i>
Gj.	<i>i(e) librit tim</i>	<i>i (e) detyrës sime</i>
Dh.	<i>librit tim</i>	<i>detyrës sime</i>
K.	<i>librin tim</i>	<i>detyrën time</i>
Rr.	<i>librit tim</i>	<i>detyrës sime</i>

##### *Prona shumë*

E.	<i>librat e mi</i>	<i>detyrat e mia</i>
Gj.	<i>i(e) librave të mi</i>	<i>i (e) detyrave të mia</i>
Dh.	<i>librave të mi</i>	<i>detyrave të mia</i>
K.	<i>librat e mi</i>	<i>detyrat e mia</i>
Rr.	<i>librave të mi</i>	<i>detyrave të mia</i>

## Veta e parë shumës

### *Prona njëjës*

E.	<i>libri ynë</i>	<i>detyra jonë</i>
Gj.	<i>i (e) librit tonë</i>	<i>i (e) detyrës sonë</i>
Dh.	<i>librit tonë</i>	<i>detyrës sonë</i>
K.	<i>librin tonë</i>	<i>detyrën tonë</i>
Rr.	<i>librit tonë</i>	<i>detyrës sonë</i>

### *Prona shumës*

E.	<i>librat tanë</i>	<i>detyrat tona</i>
Gj.	<i>i (e) librave tanë</i>	<i>i (e) detyrave tona</i>
Dh.	<i>librave tanë</i>	<i>detyrave tona</i>
K.	<i>librat tanë</i>	<i>detyrat tona</i>
Rr.	<i>librave tanë</i>	<i>detyrave tona</i>

## Veta e dytë njëjës

### *Prona njëjës*

E.	<i>libri yt</i>	<i>detyra jote</i>
Gj.	<i>i (e) librit tënd</i>	<i>i (e) detyrës sate</i>
Dh.	<i>librit tënd</i>	<i>detyrës sate</i>
K.	<i>librin tënd</i>	<i>detyrën tënde</i>
Rr.	<i>librit tënd</i>	<i>detyrës sate</i>

### *Prona shumës*

E.	<i>librat e tu</i>	<i>detyrat e tua</i>
Gj.	<i>i (e) librave të tu</i>	<i>i (e) detyrave të tua</i>
Dh.	<i>librave të tu</i>	<i>detyrave të tua</i>
K.	<i>librat e tu</i>	<i>detyrat e tua</i>
Rr.	<i>librave të tu</i>	<i>detyrave të tua</i>

## Veta e dytë shumës

### Prona njëjës

E.	<i>libri juaj</i>	<i>detyra juaj</i>
Gj.	<i>i (e) librit tuaj</i>	<i>i (e) detyrës suaj</i>
Dh.	<i>librit tuaj</i>	<i>detyrës suaj</i>
K.	<i>librin tuaj</i>	<i>detyrën tuaj</i>
Rr.	<i>librit tuaj</i>	<i>detyrës suaj</i>

### Prona shumës

E.	<i>librat tuaj</i>	<i>detyrat tuaja</i>
Gj.	<i>i (e) librave tuaj</i>	<i>i (e) detyrave tuaja</i>
Dh.	<i>librave tuaj</i>	<i>detyrave tuaja</i>
K.	<i>librat tuaj</i>	<i>detyrat tuaja</i>
Rr.	<i>librave tuaj</i>	<i>detyrave tuaja</i>

## Veta e tretë njëjës, gjinia mashkullore

### Prona njëjës

E.	<i>libri i tij</i>	<i>detyra e tij</i>
Gj.	<i>i (e) librit të tij</i>	<i>i (e) detyrës së tij</i>
Dh.	<i>librit të tij</i>	<i>detyrës së tij</i>
K.	<i>librin e tij</i>	<i>detyrën e tij</i>
Rr.	<i>librit të tij</i>	<i>detyrës së tij</i>

### Prona shumës, mashk. + fem.

E.	<i>librat, detyrat e tij</i>
Gj.	<i>i (e) librave, i (e) detyrave të tij</i>
Dh.	<i>librave, detyrave të tij</i>
K.	<i>librat, detyrat e tij</i>
Rr.	<i>librave, detyrave të tij</i>

## Veta e tretë njëjës, gjinia femërore

### *Prona njëjës*

E.	<i>libri i saj</i>	<i>detyra e saj</i>
Gj.	<i>i (e) librit të saj</i>	<i>i (e) detyrës së saj</i>
Dh.	<i>librit të saj</i>	<i>detyrës së saj</i>
K.	<i>librin e saj</i>	<i>detyrën e saj</i>
Rr.	<i>librit të saj</i>	<i>detyrës së saj</i>

### *Prona shumës, mashk. + fem.*

E.	<i>librat, detyrat e saj</i>
Gj.	<i>i (e) librave, i (e) detyrave të saj</i>
Dh.	<i>librave, detyrave të saj</i>
K.	<i>librat, detyrat e saj</i>
Rr.	<i>librave, detyrave të saj</i>

### *Prona shumës, mashk. + fem.*

E.	<i>librat, detyrat e tyre</i>
Gj.	<i>i (e) librave, i (e) detyrave të tyre</i>
Dh.	<i>librave, detyrave të tyre</i>
K.	<i>librat, detyrat e tyre</i>
Rr.	<i>librave, detyrave të tyre</i>

## PËREMRI i vet

### **Gjinia mashkullore**

### **Gjinia femërore**

### *Prona njëjës*

E.	<i>libri i vet</i>	<i>detyra e vet</i>
Gj.	<i>i (e) librit të vet</i>	<i>i (e) detyrës së vet</i>
Dh.	<i>librit të vet</i>	<i>detyrës së vet</i>
K.	<i>librin e vet</i>	<i>detyrën e vet</i>
Rr.	<i>librit të vet</i>	<i>detyrës së vet</i>

## Prona shumë

E.	<i>librat e vet</i>	<i>detyrat e veta</i>
Gj.	<i>i (e) librave të vet</i>	<i>i (e) detyrave të veta</i>
Dh.	<i>librave të vet</i>	<i>detyrave të veta</i>
K.	<i>librat e vet</i>	<i>detyrat e veta</i>
Rr.	<i>librave të vet</i>	<i>detyrave të veta</i>

## II. Përemri ndodhet para emrit

Përemrat e vetës së parë e të vetës së dytë njëjës *im, ime, yt, jote*, kur përcaktojnë emra që tregojnë lidhje gjinie ose marrëdhënie familjare, si *atë, bijë, bir, dhëndër, ëmë, kunat, kunatë, mbesë, motër, nip, shoq, shoqe* (vetëm në kuptimin «bashkëshort, -e»), *vëlla* etj., mund të përdoren edhe përpara këtyre emrave, p.sh. *im atë, ime motër, yt vëlla, jot ëmë, jot motër*<sup>1)</sup>, *im kunat, jot kunatë, im nip, jot mbesë, im shoq, ime shoqe, yt ungj* etj.

Kur përdoren në këtë pozicion, përemrat pronorë lakohen kështu:

### Veta e parë

#### Gjinia mashkullore

E.	<b>im atë</b>
Gj.	<b>(i,e) tim eti</b>
Dh.	<b>tim eti</b>
K.	<b>tim atë</b>
Rr.	<b>tim eti</b>

#### Gjinia femërore

	<b>ime motër</b>
(i, e)	<b>sime motre</b>
	<b>sime motre</b>
	<b>time motër</b>
	<b>sime motre</b>

<sup>1)</sup> Para emrave femërorë të mësipërm përemri pronor i vetës së dytë të njëjësit del në trajtën *jot: motra jote*, por: *jot motër*.

## Veta e dytë

E.	yt vëlla	jot motër
Gj. (i, e)	tët vëllai	(i, e) sat motre
Dh.	tët vëllai	sat motre
K.	tët vëlla	tët motër
Rr.	tët vëllai	sat motre

**Shënim.** Para disa emrave nga të më sipërmit përdoren në raste të rralla edhe trajtat e shumësit të këtyre përemrave, p.sh. *të mi vëllezër, të mi motra* ose *time motra, të tu vëllezër* ose *tët vëllezër, të tu motra* ose *tët motra, tët bij, tët bija* et j.

## B. LAKIMI I PËREMRAVE PRONORË KUR PËRDOREN MË VETE

### Veta e parë njëjës

#### *Prona njëjës*

#### *Prona shumës*

	mashk.	fem.		mashk.	fem.
E.	imi	imja	E.	të mitë	të miat
Gj. <i>i (e)</i>	timit	<i>i (e)</i> simes	Gj. <i>i (e)</i>	të mive	<i>i (e)</i> të miave
Dh.	timit	simes	Dh.	të mive	të miave
K.	timin	timen	K.	të mitë	të miat
Rr.	timit	simes	Rr.	të mive	të miave

### Veta e parë shumës

E.	yni	jona	E.	tanët	tonat
Gj. <i>i (e)</i>	tonit	<i>i (e)</i> sonës	Gj. <i>i (e)</i>	tanëve	<i>i (e)</i> tonave
Dh.	tonit	sonës	Dh.	tanëve	tonave
K.	tonin	tonën	K.	tanët	tonat
Rr.	tonit	sonës	Rr.	tanëve	tonave

### Veta e dytë njëjës

	maskh.	fem.		maskh.	fem.
E.	yt <b>i</b>	got <b>ja</b>	E.	të tu <b>të</b>	të tu <b>at</b>
Gj.	<i>i (e)</i> t <b>ëndit</b>	<i>i (e)</i> s <b>ates</b>	Gj.	<i>i (e)</i> t <b>ë tuve</b>	<i>i (e)</i> t <b>ë tuave</b>
Dh.	t <b>ëndit</b>	s <b>ates</b>	Dh.	t <b>ë tuve</b>	t <b>ë tuave</b>
K.	t <b>ëndin</b>	t <b>ënden</b>	K.	t <b>ë tu<b>të</b></b>	t <b>ë tu<b>at</b></b>
Rr.	t <b>ëndit</b>	s <b>ates</b>	Rr.	t <b>ë tuve</b>	t <b>ë tuave</b>

### Veta e dytë shumës

E.	ju <b>aji</b>	ju <b>aja</b>	E.	tu <b>ajt</b>	tu <b>ajat</b>
Gj.	<i>i (e)</i> tu <b>ajit</b>	<i>i (e)</i> su <b>ajës</b>	Gj.	<i>i (e)</i> tu <b>ajve</b>	<i>i (e)</i> tu <b>ajave</b>
Dh.	tu <b>ajit</b>	su <b>ajës</b>	Dh.	tu <b>ajve</b>	tu <b>ajave</b>
K.	tu <b>ajin</b>	tu <b>ajën</b>	K.	tu <b>ajt</b>	tu <b>ajat</b>
Rr.	tu <b>ajit</b>	su <b>ajës</b>	Rr.	tu <b>ajve</b>	tu <b>ajave</b>

### Veta e tretë njëjës, gjinia mashkullore

E.	<i>i</i> t <b>iji</b>	<i>e</i> t <b>ija</b>	E.	të t <b>ijtë</b>	të t <b>ijat</b>
Gj.	<i>i (e)</i> t <b>ë tijit</b>	<i>i (e)</i> s <b>ë tijës</b>	Gj.	<i>i (e)</i> t <b>ë tijve</b>	<i>i (e)</i> t <b>ë tijave</b>
Dh.	t <b>ë tijit</b>	s <b>ë tijës</b>	Dh.	t <b>ë tijve</b>	t <b>ë tijave</b>
K.	t <b>ë tijin</b>	t <b>ë tijën</b>	K.	t <b>ë t<b>ijtë</b></b>	t <b>ë t<b>ijat</b></b>
Rr.	t <b>ë tijit</b>	s <b>ë tijës</b>	Rr.	t <b>ë tijve</b>	t <b>ë tijave</b>

### Veta e tretë njëjës, gjinia femërore

E.	<i>i</i> s <b>aji</b>	<i>e</i> s <b>aja</b>	E.	të s <b>ajtë</b>	të s <b>ajat</b>
Gj.	<i>i (e)</i> t <b>ë sajit</b>	<i>i (e)</i> s <b>ë sajës</b>	Gj.	<i>i (e)</i> t <b>ë sajve</b>	<i>i (e)</i> t <b>ë sajave</b>
Dh.	t <b>ë sajit</b>	s <b>ë sajës</b>	Dh.	t <b>ë sajve</b>	t <b>ë sajave</b>
K.	t <b>ë sajin</b>	t <b>ë sajën</b>	K.	t <b>ë s<b>ajtë</b></b>	t <b>ë s<b>ajat</b></b>
Rr.	t <b>ë sajit</b>	s <b>ë sajës</b>	Rr.	t <b>ë sajve</b>	t <b>ë sajave</b>

## Veta e tretë shumës

mashk. + fem.

E.	<b>i tyri</b> <sup>1)</sup>	<b>e tyrja</b> <sup>1</sup>	E.	<b>të tyret</b>
Gj.	<i>i (e) të tyrit</i>	<i>i (e) së tyres</i>	Gj.	<i>i (e) të tyreve</i>
Dh.	<b>të tyrit</b>	<b>së tyres</b>	Dh.	<b>të tyreve</b>
K.	<b>të tyrin</b>	<b>të tyren</b>	K.	<b>të tyret</b>
Rr.	<b>të tyrit</b>	<b>së tyres</b>	Rr.	<b>të tyreve</b>

## PËREMRI i veti

*Prona njëjës*

*Prona shumës*

	mashk.	fem.		mashk.	fem.
E.	<b>i veti</b>	<b>e veta</b>		<b>të vetët</b>	<b>të vetat</b>
Gj.	<i>i (e) të vetit</i>	<i>i (e) së vetës</i>	<i>i (e)</i>	<i>të vetëve</i>	<i>i (e) të vetave</i>
Dh.	<b>të vetit</b>	<b>së vetës</b>		<b>të vetëve</b>	<b>të vetave</b>
K.	<b>të vetin</b>	<b>të vetën</b>		<b>të vetët</b>	<b>të vetat</b>
Rr.	<b>të vetit</b>	<b>së vetës</b>		<b>të vetëve</b>	<b>të vetave</b>

## PËRDORIME TË GABUARA TË DISA TRAJTAVE TË PËREMRAVE PRONORË

§ 63. Herë-herë vihet re përdorimi i disa trajtave të gabuara të përemrave pronorë qoftë kur këta përdoren si përcaktorë të një emri, qoftë kur qëndrojnë më vete. Këto gabime janë dy farësh. *mospërshtatje në rasë* (nuk përdoret trajta e duhur rasore) dhe *mospërshtatje në gjini* (përdoret trajta e gjinisë mashkullore në vend të femërores e anasjelltas).

1) Këta përemra në emërore, gjinore, dhanore e rrjedhore, në përgjithësi përdoren shumë rrallë.



## A. MOSPËRSHTATJE NË RASË

Përemri pronor, kur shërben si përcaktor i një emri, vihet në rasën e emrit të përcaktuar (*libri im, librit tim* etj.), ndërsa kur përdoret më vete, vihet në atë rasë që kërkon funksioni sintaksor i tij, p.sh.: *Skuadra jonë fitoi, juaja nuk e di si ka dalë; Propozimi yt ishte më i drejtë se imi; Bashkë me çantën time kam marrë edhe tënden* etj. Te shembujt e mësipërm përemrat *juaja* dhe *imi* janë në rasën emërore, sepse i pari shërben si kryefjalë, i dyti tregon një krahasim me kryefjalën dhe vihet në rasën e saj; te shembulli i tretë përemri *tënden* është në rasën kallëzore, sepse shërben si kundrinor i drejtë.

Mirëpo herë-herë vihet re se trajtat rasore të përemrave pronorë përdoren në mënyrë të gabuar. Gabimet më të shpeshta në përdorimin e trajtave rasore të përemrave pronorë janë këto:

### 1. Trajta e kallëzores përdoret gabimisht në vend të trajtës së gjinores, dhanores ose të rrjedhores.

a) **time** e përdorur gabimisht në vend të **sime**:

*Kanë kaluar 64 vjet të jetës time dhe asnjëherë nuk kisha ndier një gëzim të tillë; Ai iu përgjigj pyetjes time pa e kthyer kokën nga unë; Sa hap e mbyll sytë, ai u gjend mu përpara makinës time; Prej dritares time shihej ura etj.*

Te të gjithë shembujt e mësipërm në vend të trajtës **time**, që është trajtë e rasës kallëzore, duhej përdorur trajta **sime**, sepse emrat *të jetës, pyetjes, makinës, dritares*, janë në rasat gjinore, dhanore e rrjedhore (shih lakimin e përemrit pronor, vetën e parë të njëjësit, § 62 f. 66). Pra, përemri duhet të vihet në po atë rasë, në të cilën është emri përpara tij.

Kur ky përemër përdoret si fjalë më vete, në funksion të emrit, trajta e tij e gjinores, dhanores e rrjedhores është:

**simes** dhe jo **times**

(shih pasqyrën e lakimit § 62, f. 71), p.sh.:

— *Motrës sime i pëlqen shumë noti.*

— *Edhe simes (jo times).*

b) **tonë** e përdorur gabimisht në vend të **sonë**:

Edhe në këtë rast kemi të bëjmë me përdorimin e gabuar të trajtës së kallëzores në vend të trajtës së gjinore, të dhanores ose të rrjedhores. Ja disa shembuj:

*Këtë e kanë ndërtuar novatorët e ndërmarrjes tonë; Shkrimtari është frymëzuar nga jeta e klasës tonë punëtore; Bujqësisë tonë në pesëvjeçarët e ardhshëm i hapen perspektiva të shkëlqyera; Ata s'i shpëtuan dot vigjilencës tonë; Kështu u themi ne atyre që kanë qëllime të këqija ndaj Republikës tonë etj.*

Te shembujt e mësipërm duhej të ishte përdorur trajta **sonë**, e cila i përshtatet rasës së emrit që ndodhet para saj (shih lakimin e përemrave pronorë, vetën e parë të shumësit, § 62, f. 67)<sup>1)</sup>

Kur ky përemër përdoret si fjalë më vete, në funksion të emrit, trajta e tij e gjinore, dhanores dhe rrjedhores është

**sonës** dhe jo *tonës*

(shih pasqyrën e lakimit § 62, f. 71), p.sh.;

*Ndërmarrja juaj do të parakalojë pas sonës (jo tonës).*

c) **tënde** e përdorur gabimisht në vend të **sate**:

Në këtë rast kemi të bëjmë gjithashtu me përdorimin e gabuar të trajtës së kallëzores në vend të trajtës së gjinore, dhanores ose rrjedhores. Ja disa shembuj:

*Unë dija vetëm se ky është kopshti i gjyshes tënde; Jepja këtë letër mësueses tënde; Ç'duhej të bëja unë atëherë, sipas mendjes tënde?* etj.

Te shembujt e mësipërm duhej të ishte përdorur trajta **sate**, e cila i përshtatet rasës së emrit që ndodhet para saj (shih lakimin e përemrave pronorë, vetën e dytë të njëjësit, § 62, f. 67).

Kur ky përemër përdoret më vete, në funksion të emrit, trajta e tij e gjinore dhe e rrjedhores është

**sates** dhe jo *tëndes*

(shih pasqyrën e lakimit, § 62, f. 72)

1) Në rastin e përdorimit të gabuar të trajtës *tonë* në vend të *sonë*, kemi njëkohësisht edhe mospërshtatje në gjini, d.m.th. trajta *tonë* e gjinisë mashkullore (p.sh. *shokut tonë*) përdoret gabimisht në vend të trajtës *sonë* të gjinisë femërore (p.sh. *shoqes sonë*).

ç) **tuaj** e përdorur gabimisht në vend të **suaj**:

Edhe në këtë rast kemi të bëjmë me përdorimin e gabuar të trajtës të kallëzores në vend të trajtës së gjinores, dhanores ose rrjedhore. Ja disa shembuj:

*Si i kanë arritur këto suksese nxënësit e shkollës tuaj?; Kur po i afrohesha portës tuaj, dëgjova disa zëra nga prapa; Përpara se të niseni për fluturim, na thoni disa gjëra rreth pregatitjes tuaj luftarake etj.*

Te shembujt e mësipërm duhej të ishte përdorur trajta **suaj**, sepse emrat para saj janë në gjinore, dhanore ose rrjedhore (shih lakimin e përemrave pronorë, vetën e dytë të shumësit § 62, f 68)<sup>1)</sup>.

Kur ky përemër përdoret më vete, në funksion të emrit, trajta e tij e gjinores dhe e rrjedhores është

**suajës** dhe jo **tuajës**

(shih pasqyrën e lakimit § 62, f. 72).

## 2. Trajta e kallëzores përdoret gabimisht në vend të trajtës së emërores

tim	në vend të	im
time	» » »	ime
tonë	» » »	ynë
tonë	» » »	jonë
tënd	» » »	yt
tënde	» » »	jote
tuaj	» » »	juaj

Këto gabime ndeshen më rrallë se ato që u përmendën në pikën 1, por, sidoqoftë, duhet të kihet parasysh në mënyrë që të shmangen plotësisht. Ja disa shembuj me përdorime të gabuara:

*Sot nga qyteti tonë u nisën 150 vullnetarë për në hekurudhë; Kooperativa tonë po forcohet gjithnjë e më shumë; Ka ardhur vëllai tënd; Dhe festa tënde, ndërtues, erdhi përsëri; Sukseset që ka arritur*

1) Në rastin e përdorimit të gabuar të trajtës *tuaj* në vend të *suaj* kemi njëkohësisht edhe mospërshtatje në rasë, d.m.th. trajta *tuaj* e gjinisë mashkullore (p.sh. *shokut tuaj*) përdoret gabimisht në vend të trajtës *suaj* të gjinisë femërore (p.sh. *shoqes suaj*).

atdheu tuaj na gëzojnë pa masë; Edhe nga hamulloret mund të merren kokrra, por kjo varet plotësisht nga puna tuaj etj.

Te shembujt e mësipërm trajtat e drejta janë: *qyteti ynë, kooperative jonë, festa jote, atdheu juaj, puna juaj*, ku përemri është në rasën emërore, ashtu si emri i përcaktuar prej tij.

Kur këta përemra përdoren më vete, në funksion të emrit, trajta e emërores është:

imi	dhe jo	timi
imja	» »	timja
yni	» »	toni
jona	» »	tona
yti	» »	tëndi
jotja	» »	tëndja
juaji	» »	tuaji
juaja	» »	tuaja

(shih pasqyrat e lakimit § 62 f.71-72); p.sh.:

*Ky çelës nuk është imi (jo timi); Këtë guxim revolucionar mund ta ketë vetëm një parti si jona (jo tona); Babai im është më plak se yti (jo tëndi); Kjo punë nuk është juaja (jo tuaja) etj.*

## PASQYRA PËRMBLEDHËSE E PËRDORIMEVE TË GABUARA DHE E PËRDORIMEVE TË DREJTA TË PËREMRAVE PRONORË

### 1. Përdorimi i gabuar i trajtës së kallëzores në vend të trajtës së gjinores, të dhanores ose të rrjedhores

Rasat	Veta I njëjës		Veta I shumës	
	Trajta e gabuar	Trajta e drejtë	Trajta e gabuar	Trajta e drejtë
Emërore		<i>Jeta ime</i>		<i>klasa jonë</i>
Gjinore	<b>time</b>	<i>i (e) jetës sime</i>	<b>tonë</b>	<i>i (e) klasës sonë</i>
Dhanore	<b>time</b>	<i>jetës sime</i>	<b>tonë</b>	<i>klasës sonë</i>
Kallëzore		<i>jetën time</i>		<i>klasën tonë</i>
Rrjedhore	<b>time</b>	<i>jetës sime</i>	<b>tonë</b>	<i>klasës sonë</i>

Rasat	Veta II njëjës		Veta II shumës	
	Trajta e gabuar	Trajta e drejtë	Trajta e gabuar	Trajta e drejtë
Emërore		<i>jeta jote</i>		<i>klasa juaj</i>
Gjinore	<b>tënde</b>	<i>i (e) jetës sate</i>	<b>tuaj</b>	<i>i (e) klasës suaj</i>
Dhanore	<b>tënde</b>	<i>jetës sate</i>	<b>tuaj</b>	<i>klasës suaj</i>
Kallëzore		<i>jetën tënde</i>		<i>klasën tuaj</i>
Rrjedhore	<b>tënde</b>	<i>jetës sate</i>	<b>tuaj</b>	<i>klasës suaj</i>

2. Përdorimi i gabuar i trajtës së kallëzores në vend të trajtës së emërores

Rasa	Veta I njëjës		Veta I shumës	
	Trajta e gabuar	Trajta e drejtë	Trajta e gabuar	Trajta e drejtë
Emërore	<b>tim</b>	<i>shoku im</i>	<b>tonë</b>	<i>shoku ynë</i>
Kallëzore	<b>time</b>	<i>shoqja ime</i>		<i>shoqja jonë</i>
		<i>shokun tim</i>		<i>shokun tonë</i>
		<i>shoqen time</i>		<i>shoqen tonë</i>

Rasa	Veta II njëjës		Veta II shumës	
	Trajta e gabuar	Trajta e drejtë	Trajta e gabuar	Trajta e drejtë
Emërore	<b>tënd</b>	<i>shoku yt</i>		<i>shoku juaj</i>
	<b>tënde</b>	<i>shoqja jote</i>	<b>tuaj</b>	<i>shoqja tuaj</i>
Kallëzore		<i>shokun tënd</i>		<i>shokun tuaj</i>
		<i>shoqen tënde</i>		<i>shoqen tuaj</i>

## B. MOSPËRSHTATJE NË GJINI

Përemri pronor përshtatet në gjini me emrin që përcakton, p.sh.: *djali im* (m), *vajza ime* (f). Kur përdoret në vend të emrit, ai merr gjininë e emrit që zëvendëson: *Repartit ynë është më i madh se juaji* (= se repartit juaj); *Shkolla jonë është më e madhe se juaja* (= se shkolla juaj) etj. Mirëpo nganjëherë përemri pronor nuk përdoret në gjininë e duhur. Gabimet e mospërshtatjes në gjini vihen re vetëm te disa nga përemrat e vetës së parë e të dytë: trajta e gjinisë femërore përdoret gabimisht në vend të trajtës së gjinisë mashkullore:

a) **jonë** e përdorur gabimisht në vend të **ynë**:

*Kooperativisti jonë ka filluar ta ndryshojë edhe mënyrën e jetesës; Diskutimi jonë vazhdoi për një kohë të gjatë; Rrethi jonë mund ta zgjerojë pjesëmarrjen e kuadrove në prodhim; Fatmiri është njeriu jonë* etj.

**Jonë** dhe **ynë** janë përemra pronorë të vetës së parë të njëjësit (prona njëjës), por i pari është i gjinisë femërore, i dyti i gjinisë mashkullore. Te shembujt e mësipërm të gjithë emrat që përcaktohen nga përemri pronor, janë të gjinisë mashkullore, prandaj pas tyre duhej përdorur trajta **ynë** e gjinisë mashkullore dhe jo trajta **jonë** e gjinisë femërore.

Për të njëjtën arsye duhet përdorur trajta **yni** dhe jo **joni**:

— *Nga cili fshat është kryetari?*

— *Nga yni* (dhe jo nga *joni*).

b) **tonë**, **tona** të përdorura gabimisht në vend të **tanë**:

*Emrat tonë u thirrën njëri pas tjetrit; Shumë nga fshatarët tonë kanë ndërtuar edhe shtëpi me dy kate; Punonjësit tonë gjatë këtij viti kanë bërë shumë propozime. . . ; Të gjitha këto janë fryt i punës së përbashkët të kooperativistëve tonë* etj.

*Këto gjëra po i shohim me sytë tona; Ne e hodhëm poshtë mendimin e gabuar se në shkrepat tona nuk sigurohet buka në vend; Sa zbavitëse ishte kur topat tona qëllonin në shenjë!* etj.

Te shembujt e mësipërm emrat e përcaktuar nga përemri pronor janë të gjithë mashkulorë, prandaj në vend të trajtave femërore **tonë**, **tona** duhej përdorur trajta mashkullore **tanë**, pra: *emrat tanë*

*fshatarët tanë, punonjësit tanë; me sytë tanë, në shkrepat tanë, topat tanë* etj.

Për të njëjtën arsye, kur ky përemër përdoret në vend të një emri mashkullor, trajta e drejtë është

**tanët** dhe jo *tonët* ose *tonat*:

— *Të kujt janë këta libra?*

— **Tanët** (dhe jo *tonët*).

**Shënim.** Të kihet parasysh se përemrat, ashtu si edhe mbiemrat që përcaktojnë në emrat mashkullorë, të cilët e formojnë shumësin me mbaresën -e ose -ra, përdoren në trajtën e gjinisë femërore pra:

<i>malet tona</i>	dhe jo	<i>malet tanë</i>
<i>kujtimet tona</i>	» »	<i>kujtimet tanë</i>
<i>fshatrat tona</i>	» »	<i>fshatrat tanë</i> etj. 1)

c) **jot** e përdorur gabimisht në vend të **yt**:

*Emri jot i kuq në pllakën e mermertë. . . ; Mendimi jot më pëlqen; Ai nuk është shoku jot* etj.

Te shembujt e mësipërm emrat e përcaktuar nga përemri pronor janë të gjithë mashkullorë, prandaj në vend të trajtës femërore **jot** duhet përdorur trajta mashkullore **yt**, pra:

*emri yt, mendimi yt, shoku yt.*

Për të njëjtën arsye, kur ky përemër përdoret në vend të një emri mashkullor, trajta e drejtë është

**yti** dhe jo **joti**

p.sh.: *yti është ky djalë?; yti është ky libër?* etj.

§ 64. Siç u tregua në pasqyrën e lakimit të pronorëve (§ 62 f. 68-69) përemrat *i tij, i saj* në numrin shumësh kanë të njëjtën trajtë për të dyja gjinitë:

<i>shokët e tij</i>	<i>shokët e saj</i>
<i>shoqet e tij</i>	<i>shoqet e saj</i>
dhe jo	
<i>shoqet e tij,</i>	<i>shoqet e saja</i>

1) Shih për këtë më lart § 52, si dhe «Drejtskrimi i gjuhës shqipe» § 42, 43.

p.sh.: *Këngët e tij s'do të vdesin kurrë; Marsi ka tekat e tij; Fjalët e saj shprehin një shqetësim të thellë etj.*

Kur këta përemra përdoren më vete, në vend të emrave, ata kanë trajta të veçanta për gjininë mashkullore dhe për gjininë femërore:

gj. mashkullore

**i tiji** (libri)  
**të tijtë** (librat)  
**i saji** (libri)  
**të sajtë** (librat)

*Ky libër është i tiji.*  
*Kjo fletore është e tija.*  
*Këta libra janë të tijtë.*  
*Këto fletore janë të tijat.*

*Ky libër është i saji.*  
*Kjo fletore është e saja.*  
*Këta libra janë të sajtë.*  
*Këto fletore janë të sajat.*

gj. femërore

**e tija** (fletorja)  
**të tijat** (fletoret)  
**e saja** (fletorja)  
**të sajat** (fletoret), p.sh.:

«Pronari» i gjinisë  
mashkullore

«Pronari» i gjinisë  
femërore

## PËREMRI PRONOR *i (e, të) vet*

§ 65. Përemri pronor *i (e, të) vet*, në gjuhën tonë letrare kombëtare përdoret vetëm si përemër i vetës së tretë, njëjës ose shumës:

*shoku i vet*<sup>1)</sup> (= *i tij, i saj, i tyre*)  
*shoqja e vet* (= *e tij, e saj, e tyre*)  
*shokët e vet*  
*shoqet e veta* (= *e tij, e saj, e tyre*)

1) Përemri *i (e, të) vet* përdoret rrallë në rasën emërore, megjithatë në këtë pasqyrë është dhënë trajta e emërores, si trajtë përfaqësuese.



Në shumë raste *i (e) vet* dhe *i (e) tij, i (e) saj* etj. mund të përdoret lirisht në vend të njëri-tjetrit.

*Ai u ul në vendin e vet [e tij], pranë dritares; Bardhyli thirri edhe një herë me zërin e vet [e tij] të trashë; Edhe vendi më i egër ka bukurinë e vet [e tij]; Edhe Blerta kishte shkruar diçka për familjen e vet [e saj]; Çdo bazë ka superstrukturën e vet [e saj]; Kjo sjellje kishte arsyen e vet [e saj]; Ajo do të kthehej përsëri atje, në fshatin e vet [e saj] etj.*

Te të gjithë shembujt e mësipërm në vend të përemrit *i vet* mund të përdoren përemrat *i tij, i saj*, që janë vënë në kllapa. Por, megjithatë, ka një dallim në kushtet sintaksore të përdorimit të këtyre përemrave: përemri *i (e, të) vet* mund të përdoret vetëm kur emri ose përemri që tregon «pronarin» është kryefjalë e fjalisë, ndërsa përemrat *i (e) tij, i (e) saj, i (e) tyre* mund të përdoren jo vetëm kur «pronari» është kryefjalë, por edhe kur është ndonjë gjymtyrë jetër e fjalisë. Te këto vargje:

*Ashtu si shoku në llogore i lidh shokut*

*krahun e plagosur me këmishën e vet*

kuptohet jashtë çdo dyshimi se këmisha është e atij që i lidh plagën shokut, e jo e shokut të plagosur, sepse përemri *e vet* i referohet kurdoherë kryefjalës (kryefjalë në këtë rast është *shoku*). Po të ishte thënë: *me këmishën e tij*, nuk do të ishte e qartë nëse këmisha është e atij që i lidh plagën shokut, apo e shokut të plagosur. Pikërisht në raste të tilla, kur përemrat *i (e) tij, i (e) saj* mund të kuptohen në dy mënyra, është e domosdoshme të përdoret përemri *i (e) vet*. Po të themi:

*Anila i dha Entelës kukullën e saj,*

nuk është e qartë nëse kukulla është e Anilës apo e Entelës. Gramatikisht «pronari» nuk është i përcaktuar. Por po të themi:

*Anila i dha Entelës kukullën e vet,*

atëherë është e qartë se kukulla është, po kurrfarë dyshimi, e Anilës.

§ 66. Në shtyp, në radio, në televizion etj. kanë marrë një përdorim të gjerë shprehjet «*me (ose në) forcat e vetës*». Lidhur me përdorimin e këtyre shprehjeve duhen pasur parasysh ato që u thanë më sipër për përemrin *i (e, të) vet*.

Së pari, kryefjala e fjalisë duhet të jetë emër ose përemër i vetës së tretë, p.sh.:

**Traktoristët u zotuan që riparimet e vogla t'i bëjnë me forcat e veta; Vendi ynë e ndërton socializmin sipas parimit të madh të mbështetjes në forca e veta; Ata, duke u mbështetur në forcat e veta, po i pajisin vendet e punës me mjetet e nevojshme;**

por nuk mund të thuhet:

**Ne e ndërtojmë socializmin duke u mbështetur në forcat e veta; ose Ne, duke u mbështetur në forcat e veta, po i pajisim. . .**, sepse kryefjala në këto fjali është përemër i vetës së parë (ne). Në këto raste duhej thënë: **duke u mbështetur në forcat tona**. Pra, nuk duhet përdorur:

*me forcat e veta (kryefj. ata, ato)*

në vend të

*me forcat tona (kryefj. ne).*

Kryefjala së cilës i referohet shprehja «*me (ose në) forcat e veta*», duhet të tregojë vepruesin (atë që kryen veprimin) dhe jo sendin mbi të cilin bie veprimi. Kur shkelet kjo rregull, mendimi nuk shprehet drejt.

Ja disa shembuj ku shprehja «*me (ose në) forcat e veta*» është përdorur në mënyrë të gabuar:

*Në ndërmarrjet e ndryshme të ndërtimit, duke u mbështetur në forcat e veta, u prodhuan mbi 450 copë makineri e pajisje për mekanizimin e ndërtimeve;* — del sikur makineritë e pajisjet u prodhuan duke u mbështetur në forcat e vetë makinerive e pajisjeve!

*Edhe në kooperativat malore buka ka kohë që po sigurohet me forcat e veta;* — del sikur buka po sigurohet me forcat e vetë bukës!

*Me forcat e veta u siguroa një bazë materiale me vleftë prej 30.760 lekësh;* — del sikur kjo bazë materiale është siguruar me forcat e vetë bazës materiale.

Te shembujt e mësipërm, që mendimi të shprehet drejt, duhet që kryefjala të tregojë vepruesin. Pra përdorimi i drejtë është:

*Ndërmarrjet e ndryshme të ndërtimit prodhuan me forcat e veta...* (kryefjala: *Ndërmarrjet*); *Edhe në kooperativat malore ka kohë që bukën po e sigurojnë me forcat e veta* (kryefjala e nënkuptuar: *kooperativat*).

rativistët); *Me forcat e veta siguruan një bazë materiale me vleftë ...* (kryefjala e nënkuptuar: *ata*).

§ 67. Përemrat pronorë **im, ime, yt, jote, ynë, jonë, juaj** nuk marrin asnjëherë nyjë të përparme. Trajtat me nyjë të përparme që dëgjohen herë-herë, janë trajta dialektore dhe nuk duhet të përdoren në gjuhën letrare. Pra duhet thënë e shkruar:

<i>libri im</i>	dhe jo	<b>i im</b>
<i>ky libër është imi</i>	» »	<b>i imi</b>
<i>çadra ime</i>	» »	<b>e ime</b>
<i>kjo çadër është imja</i>	» »	<b>e imja</b>
<i>djali yt</i>	» »	<b>i yt</b>
<i>ytë është ky djalë?</i>	» »	<b>i yti</b>
<i>tryeza jote</i>	» »	<b>e jote</b>
<i>kjo tryezë është jotja</i>	» »	<b>e jotja</b>
<i>vapori ynë</i>	» »	<b>i ynë</b>
<i>ky vapor është yni</i>	» »	<b>i yni</b>
<i>shkolla jonë</i>	» »	<b>e jonë</b>
<i>kjo shkollë është jona</i>	» »	<b>e jona</b>
<i>çelësi juaj</i>	» »	<b>i juaj</b>
<i>juaji është ky çelës?</i>	» »	<b>i juaji</b>
<i>shtëpia juaj</i>	» »	<b>e juaj</b>
<i>juaja është kjo shtëpi?</i>	» »	<b>e juaja</b>

Përemrat pronorë *e (të) mi, e (të) mia, e (të) tu, e (të) tua, i (e, të) tij, i (e, të) saj, i (e, të) tyre, i (e, të) vet* shkruhen me nyjë të përparme në të gjitha trajtat dhe përdorimet e tyre:

*shokët e mi, dëshirat e mia, djemtë e tu, duart e tua, shkolla e tij, motra e saj, fshati i tyre, kënga e tyre, vëllai i vet, shoqja e vet etj.*

dhe jo *shkolla tij, motra saj, fshati tyre, vëllai vet etj.*<sup>1)</sup>

1) Shih për këtë edhe «Drejtskrimi i gjuhës shqipe» §61.

### 3. PËREMRI PYETËS

§ 68. Përemra pyetës janë fjalët *kush?*, *cili?*, *cilat?*, *ç'?*, *çfarë?*, *sa?*, *i sati?*, *me se?*, *për se?*<sup>1)</sup> etj. Ata përdoren për të pyetur për frymorë e sende ose për tipare të tyre.

Përemri *kush?* lakohet në këtë mënyrë:

E.	<b>kush</b>
Gj.	<b>i (e) kujt</b>
Dh. Rr.	<b>kujt</b>
K.	<b>kë</b>

Ky përemër përdoret vetëm në numrin njëjës, p.sh.:

*Kush është atje? Kush erdhi?* etj.

Përdorimi i përemrit *kush* me kuptimin e shumësit, që vihet re ndonjëherë (p.sh.: *Kush erdhën?*), është i gabuar dhe nuk duhet lejuar në gjuhën letrare.

Përemri *cili* ka trajta të veçanta për gjininë mashkullore e femërore, për numrin njëjës e shumës. Ai lakohet në këtë mënyrë:

		Njëjës		Shumës	
	M.	F.		M.	F.
E.	<b>cili</b>	<b>cila</b>	E.K.	<b>cilët</b>	<b>cilat</b>
Gj.	<b>i (e) cilit</b>	<b>i (e) cilës</b>	Gj.	<b>i (e) cilëve</b>	<b>i (e) cilave</b>
Dh.,Rr.	<b>çilit</b>	<b>çilës</b>	Dh.,Rr.	<b>çilëve</b>	<b>çilave</b>
K.	<b>cilin</b>	<b>cilën</b>			

Përemri *kush* dhe përemri *cili* kanë këto dallime në përdorimin e tyre:

1. Përemri *kush* zakonisht përdoret për të pyetur për njerëz ose për qenie të personifikuara (në përrallat), p.sh.:

— **Kush është te porta?**

— **Agimi**

1) Përemri pyetës *se* përdoret vetëm i shoqëruar me parafjalë.

— Për kë e ke blerë këtë libër?

— Për vëllanë e vogël.

**Kush** këndon më bukur se unë? — *tha Këndesi.*

Përemri *kush* nuk duhet të përdoret për të pyetur për kafshë ose për sende të ndryshme.

Përdorime të tilla si këto më poshtë janë të gabuara dhe nuk duhen lejuar në gjuhën letrare:

**Kush jep më shumë qumësht, dhia apo delja? Kush është më i rëndë, hekuri apo bakri?**

Te shembujt e mësipërm në vend të *kush* duhej përdorur *cili, cila*, pra: **Cila jep më shumë qumësht...? Cili është më i rëndë...?**

Përemri *cili* mund të përdoret për të pyetur për njerëz, për kafshë dhe për sende.

2. Përemri *kush* nuk duhet të përdoret asnjëherë përpara emrave si përcaktor i tyre, d.m.th. është gabim të thuhet:

**Te kush mjek u vizitove?: Kush traktorist e ka këtë traktor?; Kush klasë ka gjimnastikë këtë orë?; Me kë shoqe shkove në Durrës?**

Te shembujt e mësipërm dhe në të gjitha rastet e tjera të ngjashme duhej përdorur përemri *cili*, d.m.th.:

**Te cili mjek...?; Cili traktorist...?; Cila klasë...?; Me cilën shoqe...? etj.**

Përemri *cili* përdoret edhe pa emër pranë, si përemri *kush*, edhe si përcaktor i një emri, p.sh.:

**Cili je ti? ose Kush je ti?**

**Cili shok ka ardhur?, por jo Kush shok ka ardhur?**

Duhet pasur parasysh se përemri *cili* përdoret për të pyetur për natyrën ose për identitetin e një njeriu të një kafshe a të një sendi, d.m.th. për të diferencuar, për të veçuar një a më shumë frymorë ose sende brenda një klase, një kategorie ose një grupi, p.sh.:

**Cili repart e fitoi flamurin e garave?; Cila këngë fitoi çmimin e parë?; Cili është mali më i lartë i Shqipërisë?; Cili është kapiteni i skuadrës?; Cila është drejtoresha?; Cilat janë qytetet më të mëdha të Azisë?; Cili është qëllimi i jetës?; I cilës lopë është ky viç? etj.**

Përemri **kush** shërben për t'ë pyetur për një person të panjohur ose të papërmendur më parë në bisedë, p.sh.:

**Kush erdhi?; Kush është atje?**

Në qoftë se pyesim **Cili erdhi?** ose **Cili është atje?** kërkojmë të dimë cili pikërisht nga ata që mendojmë ne se mund të vijnë ose mund të jenë atje.

Ky dallim në kuptimin e këtyre përemrave shpjegon se pse **kush** nuk mund të përdoret përpara emrit.

## IV. NYJAT TEK EMRI, MBIEMRI, NUMËRORI DHE PEREMRI

### FUNKSIONET DHE KARAKTERISTIKAT GRAMATIKORE TË NYJAVE

§ 69. Nyjat *i, e, të, së* kryejnë shërbime të ndryshme në gjuhë. Ato përdoren kryesisht:

1. Si pjesë përbërëse e mbiemrave të quajtur të nyjshëm: (*i, e*) *mirë, (i, e) gjatë, (i, e) artë, (i, e) ditur, (i, e) punuar* etj.

2. Si pjesë përbërëse e numërorëve rreshtorë: (*i, e*) *parë, (i, e) dytë, (i, e) tretë, (i, e) katërt* etj.

3. Si pjesë përbërëse e disa emrave (me prejardhje foljore ose të formuar prej pjesësh të tjera të ligjëratis):

a) emra prejpjesorë (asnjanës ose femërorë) p.sh.: *të ecur-it, të menduar-it, të ngrënë-t, të qarë-t* etj.; *të ardhura-t, të korra-t, e qeshura, të vjela-t* etj.;

b) emra të formuar me prapashtesë prej një teme foljore, p.sh.: *e ardhme — e ardhmja* ose *e ardhshme — e ardhshmja, e folme — e folmja* etj.;

c) emra të formuar nga substantivimi i mbiemrave, p.sh.: *i ardhur, i plagosur, i vdekur* etj.; *e bukura, e drejta, e keqja, e mira* etj.; *të ftohtët, të ngrohtët, të verdhët* etj.; *të holla-t, të lashtat* etj.;

4. Si pjesë përbërëse e disa përemrave:

a) e përemrave pronorë (*i, e*) *tij, (i, e) saj, (i, e) tyre, të tij, të saj, të tyre, e mi, e mia, e tu, e tua;*

b) e përemrit dëftor *i tillë, e tillë, të tillë, të tilla;*

c) e përemrit lidhor *i cili, e cila, të cilët, të cilat;*

5. Si element përbërës i trajtës së rasës gjinore (nyja dallon, gjinoren nga dhanorja), p.sh.: *realizimi i planit, mbrojtja e atdheut, liqenet e Lurës, shokë të armëve* etj.

6. Me funksionin e një përemri pronor para disa emrash që tregojnë lidhje gjinie ose marrëdhënie familjare, p.sh.: *i ati, e ëma, i vëllai, e motra, i shoqi, e shoqja, i ungji* etj. (p.sh.: *i vëllai* = «vëllai i tij ose i saj», *e motra* = «motra e tij ose e saj» etj.).

Disa nga këta emra përdoren gati kurdoherë të shoqëruar me një ose me një përemër pronor të paravendosur, p.sh.: *i ati, e ëma, i shoqi, e shoqja* ose *im atë, jot ëmë, yt shoq, ime shoqe*<sup>1)</sup>, ndërsa të tjerët mund të përdoren me ose pa një, p.sh.: *erdhi me (të) motrën, vajti te (i) vëllai* etj.

§ 70. Nyjat kanë gjini, numër e rasë. Gjinia, numri dhe rasa e nyjës te mbiemrat, te numërorët rreshtorë, te përemrat pronorë (*i, e*) *tij, (i, e) saj* etj., te përemri dëftor *i tillë* dhe te emrat në rasën gjinore përcaktohet nga gjinia, numri dhe rasa e emrit që ndodhet para tyre. Kështu, kur themi *punëtor i dalluar, djali i tij, rreshti i dytë, drejtori i shkollës*, në të katër rastet kemi nyjën *i*, sepse emrat *punëtor, djalë, rreshti, drejtori*, që ndodhen para saj, janë emra mashkullorë në numrin njëjës, në rasën emërore. Te shembujt *punëtore e dalluar, tokë e punuar, klasa e pestë, festa e Çlirimit* kemi nyjën *e*, sepse emrat *punëtore, tokë, klasa, festa*, që ndodhen para saj, janë emra femërorë, në numrin njëjës, në rasën emërore.

Nyja te shembuj si të mësipërmit quhet në gramatikë edhe **nyjë** e **lidhur**, sepse gjinia, numri dhe rasa e saj varen nga emri që ka përpara (*punëtor i dalluar, punëtore e dalluar; drejtori i shkollës, festa e Çlirimit*).

Gjinia, numri dhe rasa e nyjës te emra si të *verdhët, e ardhmja, e diel* etj, dhe te emrat që tregojnë lidhje gjinie e marrëdhënie fa-

1) Emrat *shoq, shoqe*, të pashoqëruar me një nyjë të ose me një përemër pronor të paravendosur, nuk përdoren me kuptimin «bashkëshort».



miljare si *të birit, së mbesës* etj. varen nga vetë fjala ku ato bëjnë pjesë ose me të cilën përdoren, e jo nga ndonjë fjalë tjetër, p.sh.: *të verdhët, të ecurit*, janë emra të gjinisë asnjënjëse, prandaj kanë njëjën të, e *ardhmja* është emër femëror, prandaj ka njëjën e, *birit* është emër mashkullor në rasën dhanore, prandaj merr njëjën të, ndërsa *mbesës* është emër femëror në rasën dhanore e për këtë arsye merr njëjën së.

Nyja te shembuj si të mësipërmit quhet në gramatikë edhe **nyjë** e **këputur**, sepse gjinia, numri dhe rasa e saj, nuk lidhen me ndonjë fjalë tjetër.

Në shembuj si *detyrat* e së *ardhmes, vëllai* i së *shoqes*, nyja e parë i ose e është e lidhur, ndërsa nyja e dytë së është e këputur.

## LAKIMI I NYJAVE

§ 71. Nyjat lakohen në këtë mënyrë:

### I. NYJA E LIDHUR

#### Numri njëjës

#### Gjinia mashkullore

E.	(një) ushtar i popullit	ushtari i popullit	i
Gj.	(i, e) (një) ushtari të popullit	(i, e) ushtarit të popullit	të
Dh.	(një) ushtari të popullit	ushtarit të popullit	të
K.	(një) ushtar të popullit	ushtarin e popullit	të, e
Rr.	(një) ushtari të popullit	ushtarit të popullit	të
E.	(një) ushtar i shkathët	ushtari i shkathët	i
Gj.	(i, e) (një) ushtari të shkathët	(i, e) ushtarit të shkathët	të
Dh.	(një) ushtari të shkathët	ushtarit të shkathët	të
K.	(një) ushtar të shkathët	ushtarin e shkathët	të, e
Rr.	(një) ushtari të shkathët	ushtarit të shkathët	të

## Gjinia femërore

E. (një) <i>bijë e popullit</i>	<i>bija e popullit</i>	e
Gj. (i, e) (një) <i>bije të popullit</i>	(i, e) <i>bijës së popullit</i>	të, së
Dh. (një) <i>bije të popullit</i>	<i>bijës së popullit</i>	të, së
K. (një) <i>bijë të popullit</i>	<i>bijën e popullit</i>	të, e
Rr. (një) <i>bije të popullit</i>	<i>bijës së popullit</i>	të, së

E. (një) <i>bijë e dashur</i>	<i>bija e dashur</i>	e
Gj. (i, e) <i>një bje të dashur</i>	(i, e) <i>bijës së dashur</i>	të, së
Dh. (një) <i>bije të dashur</i>	<i>bijës së dashur</i>	të, së
K. (një) <i>bijë të dashur</i>	<i>bijën e dashur</i>	të, e
Rr. (një) <i>bije të dashur</i>	<i>bijës së dashur</i>	të, së

## Numri shumës

(Për të dyja gjinitë)

E. (ca) <i>ushtarë (bija) të popullit</i>	të
Gj. (i, e) (ca) <i>ushtarëve (bijave) të popullit</i>	të
Dh. (ca) <i>ushtarëve (bijave) të popullit</i>	të
K. (ca) <i>ushtarë (bija) të popullit</i>	të
Rr. (ca) <i>ushtarësh (bijash) të popullit</i>	të

E. <i>ushtarët (bijat) e popullit</i>	e
Gj. (i, e) <i>ushtarëve (bijave) të popullit</i>	të
Dh. <i>ushtarëve (bijave) të popullit</i>	të
K. <i>ushtarët (bijat) e popullit</i>	e
Rr. <i>ushtarëve (bijave) të popullit</i>	të

E. (ca) <i>ushtarë të shkathët</i>	<i>ushtarët e shkathët</i>	të, e
Gj. (i, e) (ca) <i>ushtarëve të shkathët</i>	(i, e) <i>ushtarëve të shkathët</i>	të
Dh. (ca) <i>ushtarëve të shkathët</i>	<i>ushtarëve të shkathët</i>	të
K. (ca) <i>ushtarë të shkathët</i>	<i>ushtarët e shkathët</i>	të, e
Rr. (ca) <i>ushtarësh të shkathët</i>	<i>ushtarëve të shkathët</i>	të

po kështu: *bija të dashura; bijat e dashura* etj.

Siç shihet nga pasqyra e msipërme, forma e nyjës në disa raste varet nga trajta e emrit që ndodhet para saj:

në rasën kallëzore njëjës të gjinisë mashkullore e femërore nyja është **të**, kur emri para saj është i pashquar (*një ushtar të popullit, një bijë të popullit*) dhe **e**, kur emri është i shquar (*ushtarin e popullit*);

në rasat gjinore, dhanore e rrjedhore njëjës të gjinisë femërore nyja është **të**, kur emri para saj është i pashquar (*një bije të popullit*), dhe **së**, kur emri është i shquar (*bijës së popullit*);

në rasat emërore e kallëzore të shumësit për të dyja gjinitë nyja është **të**, kur emri është i pashquar (*ushtarë ose bija të popullit*), dhe **e**, kur emri është i shquar (*ushtarët ose bijat e popullit*).

## II. NYJA E KËPUTUR

### Numri njëjës

#### Gjinia mashkullore

E.	(një) <b>i ri</b>	<b>i riu</b>	<b>i biri</b>	<b>i</b>
Gj. (i, e)	(një) <b>të riu</b>	(i, e) <b>të riut</b>	(i, e) <b>të birit</b>	<b>të</b>
Dh.	(një) <b>të riu</b>	<b>të riut</b>	<b>të birit</b>	<b>të</b>
K.	(një) <b>të ri</b>	<b>të riun</b>	<b>të birin</b>	<b>të</b>
Rr.	(një) <b>të riu</b>	<b>të riut</b>	<b>të birit</b>	<b>të</b>

Siç shihet nga pasqyra e mësipërme, në rasat gjinore, dhanore, kallëzore e rrjedhore përdoret nyja **të**, si atëherë kur emri të cilit i përket ajo, është në trajtë të pashquar (*një të ri, një të riu*), ashtu edhe kur ai është në trajtë të shquar (*të riut, të riun*).

#### Gjinia femërore

E.	(një) <b>e re</b>	<b>e reja</b>	<b>e bija</b>	<b>e</b>
Gj. (i, e)	(një) <b>të reje</b>	<b>të (i, e) së resë</b>	(i, e) <b>së bijës</b>	<b>së</b>
Dh.	(një) <b>të reje</b>	<b>të së resë</b>	<b>së bijës</b>	<b>së</b>
K.	(një) <b>të re</b>	<b>të renë</b>	<b>të bijën</b>	<b>të</b>
Rr.	(një) <b>të reje</b>	<b>të së resë</b>	<b>së bijës</b>	<b>së</b>

Siç shihet nga pasqyra e mësipërme, në rasat gjinore, dhanore e rrjedhore përdoret nyja *të*, kur emri të cilit i përket ajo është në trajtë të pashquar, dhe nyja *së*, kur ky emër është në trajtë të shquar.

Ato që u parashtruan në këtë paragraf, ndihmojnë për të kuptuar më mirë përdorimin e drejtë të nyjave, për të cilin bëhet fjalë në paragrafët e mëposhtëm.

§ 72. Nyja është pjesë përbërëse e domosdoshme e trajtës së gjinore. Ajo e dallon këtë rasë nga dhanorja e rrjedhorja:

gjinore: *i, (e, të, së) popullit* — dhanore, rrjedhore: *popullit*.

Prandaj është i gabuar mospërdorimi i nyjës në raste si: *niveli [i] jetesës, liqeni [i] Shkodrës, stacioni [i] trenit* etj.; *i repartit [të] ngjyrosjes, drejtorit [të] ndërmarrjes, rrethit [të] Dibrës* etj.; *organizata [e] pionierit, dega [e] planit* etj.; *kryesisë [së] kooperativës, vatrës [së] kulturës* etj. Në të gjitha rastet e mësipërme nyja duhet shkruar dhe duhet shqiptuar rregullisht.

Siç shihet, gabimi i mospërdorimit të nyjës vihet re zakonisht kur emri që ndodhet para saj është në trajtën e shquar dhe mbaresa e këtij emri tingëllon njësoj me nyjën ose me tingullin e parë të saj, p.sh.: *niveli i jetesës, shtimit të prodhimit, vatrës së kulturës* etj. (me përjashtim të rasteve si *dega e planit*).

Nyja e mbiemrave të nyjshëm dhe e numërorëve rreshtorë është gjithashtu një element i domosdoshëm i tyre. Prandaj mospërdorimi i saj, që vihet re herë-herë në po ato rrethana që u përkthuan për nyjën e gjinore, është gjithashtu i gabuar. Duhet shkruar e shqiptuar gjithnjë:

*libri i ri, flamuri i kuq, misri i bardhë, librit të ri, flamurit të kuq, misrit të bardhë* etj.;

*klasa e parë, gazeta e sotme, lule e bukur, klasës së parë, gazetës së sotme, lules së bukur* etj.

Përdorimet e gabuara pa nyjë që u përkthuan më sipër, nuk duhen lejuar as në gjuhën e shkruar e as në gjuhën e folur.

## DISA RASTE KUR DUHET PËRDORUR NYJA TË DHE JO SË

§ 73. Kur një emër femëror në rasën gjinore, dhanore a rrjedhore njëjës përcaktohet nga një emër në rasën gjinore ose nga një mbiemër i nyjshëm, nyja e këtyre është së (shih pasqyrën e lakimit në § 71, f.91.) p.sh.:

*historia e luftës së popullit shqiptar (dhe jo të popullit); fryti i punës së punëtorëve (dhe jo të punëtorëve); ashpërsimi i luftës së klasave; flamuri iu dha fabrikës së qelqit; pas korrjes së gryrit etj.*

Por në rast se midis këtyre dy emrave ose midis emrit dhe mbiemrit ndodhet një fjalë tjetër (ose disa fjalë të tjera), që përcakton gjithashtu emrin e parë, atëherë nyja e emrit të fundit përcaktues është të e jo së, p.sh.:

(i, e) *fabrikës së tullave*, por:

(i, e) *fabrikës [së re] të tullave*;

*minierës së Bulqizës*, por:

*minierës [së kromit] të Bulqizës*;

(i, e) *fabrikës së re*, por:

(i, e) *fabrikës [sonë] të re*.

Për këtë arsye duhet shkruar:

(i, e) *klasës punëtore të Shqipërisë* (dhe jo *së Shqipërisë*);

(i, e) *Partisë së Punës të Shqipërisë* (dhe jo *së Shqipërisë*);

(i, e) *përhapjes së shpejtë të sëmundjes* (dhe jo *së sëmundjes*);

(i, e) *organizatës së rinisë të fshatit* (dhe jo *së fshatit*);

(i, e) *shkollës 12-vjeçare të qytetit* (dhe jo *së qytetit*);

*veshjet e krahinës së Mirditës dhe të Matit* (dhe jo *së Matit*);

*prodhimet e fushës së Korçës, të Myzeqesë, të Vurgut e të Zadrimës* (dhe jo *së Myzeqesë, së Vurgut*);

(i, e) *shoqes sonë të paharruar* (dhe jo *së paharruar*);

(i, e) *fshatarësisë së varfër e të mesme* (dhe jo *së mesme*);

*motrës së saj të dashur* (dhe jo *së dashur*);

(i, e) *nxënëses më të mirë* (dhe jo *së mirë*) etj.

§ 79. Kur pas një emri femëror të shquar të rasës gjinore, dhanore a rrjedhore njëjës, vijnë dy a më shumë emra femërorë në gjinore njëjës, të gjithë ata marrin përpara nyjën së (e jo të), në rast

se secili përcakton emrin në gjinore që ndodhet menjëherë para tij, p.sh.:

*punimet e tharjes së kënetës së fushës së Thumanës, d.m.th.:*

*(punimet) + (e tharjes) + (së kënetës) + (së fushës) + (së Thumanës),*

pra, secili prej këtyre emrave në rasën gjinore përcakton atë emër që ka menjëherë përpara.

Po kështu ndodh edhe te shembujt e mëposhtëm:

*i shërben ngritjes së mirëqenies së fshatarësisë së zonave malore; projekti i ndërtesës së shkollës së kulturës; vendimet e mbledhjes së asamblesë së kooperativës etj.*

Por kur një emër në rasën gjinore, që vjen pas një emri femëror në gjinore të shquar njëjës, përcakton tërë togfjalëshin<sup>1)</sup> të cilit i përket ky i fundit, atëherë ai merr përpara nyjën të e jo së, p.sh.:

*zhvillimi i industrisë së naftës të Shqipërisë, sepse:*

*(zhvillimi) + (i industrisë së naftës) + (të Shqipërisë),*

domethënë emri në gjinore të Shqipërisë nuk përcakton vetëm emrin në gjinore së naftës, por gjithë togfjalëshin i industrisë së naftës, pra, është fjala për industrinë e naftës të Shqipërisë dhe jo për naftën e Shqipërisë.

Po kështu edhe në shembujt më poshtë:

*themelimi i Partisë së Punës të Shqipërisë (është fjala për Partinë e Punës të Shqipërisë);*

*Komiteti Qendror i Bashkimit të Rinisë së Punës të Shqipërisë (është fjala për Bashkimin e Rinisë së Punës të Shqipërisë);*

*punonjësit e bujqësisë të zonave malore (është fjala për punonjësit e bujqësisë të zonave malore);*

*në zonën e portës të skuadrës mike (është fjala për zonën e portës të skuadrës mike);*

*në rafinerinë e naftës të Cërrikut (është fjala për rafinerinë e naftës të Cërrikut);*

---

1) Një bashkim fjalësh, nga të cilat njëra plotëson tjetrën dhe varet gramatikisht prej saj, në sintaksë quhet togfjalësh, p.sh.: *oborri i shkollës, qumësht lope, ditë e bukur etj.*

*këngët e dasmës të Myzeqesë* (është fjala për këngët e dasmës të Myzeqesë);

*Gjatë stinës së verës të këtij viti* (është fjala për stinën e verës të këtij viti) etj.

Siç shihet, në raste si të mësipërmet, për të përcaktuar se cila nyjë duhet përdorur, **të apo së**, duhet zbuluar lidhja kuptimore e fjalëve, ndryshe mund të lindin keqkuptime. P.sh. po të thuhet:

*punonjësit e bujqësisë së zonave malore,*

duket sikur bëhet fjalë për *bujqësinë e zonave malore* e jo për *punonjësit e bujqësisë të këtyre zonave*.

Rregulla e përgjithshme për të gjitha rastet e trajtuara në §§ 73, 74 është kjo:

*Një emër në rasën gjinore, që vjen pas një emri femëror në rasën gjinore të shquar njëjës, merr nyjën së kur përcakton drejtpërdrejt këtë emër, dhe nyjën të kur nuk përcakton drejtpërdrejt këtë emër.*

## DISA RASTE KUR DUHET PËRDORUR NYJA SË DHE JO TË

§ 75. Kur mbiemri i nyjshëm qëndron para emrit që përcakton, atëherë nyja e tij lakohet si nyjë e këputur (shih § 71, f. 92):

E. e *lumtura nënë*

K. të *lumturën nënë*

Gj. (i, e) së *lumturës nënë*

Rj. së *lumturës nënë*

Dh. së *lumturës nënë*

Nyja mbetet po ajo, dhe kur mbiemri është në shkallën sipërore të formuar me pjesëzën më:

*më e bukura ditë, (i, e) më së bukurës ditë, më të bukurën ditë* etj.

Pra, është i gabuar përdorimi i nyjës të në vend të nyjës së në rasat gjinore, dhanore e rrjedhore te mbiemrat e nyjshëm femërorë,

edhe kur këta qëndrojnë para emrave. Duhet shkruar e shqiptuar:

së dashurës motër	dhe jo	të dashurës motër
së bardhës ditë	» »	të bardhës ditë
së shkretës nënë	» »	të shkretës nënë
më së bukurës ditë	» »	më të bukurës ditë etj.

§ 76. Edhe tek emrat femërorë të nyjshëm nyja lakohet gjithashtu si nyjë e këputur:

E. e hëna	K. të hënë
Gj. (i, e) së hënës	Rr. së hënës
Dh. së hënës	

Përdorimi i nyjës të në vend të nyjës së në gjinore, dhanore e në rrjedhore edhe në këto raste është i gabuar:

programi i së dielës	dhe jo	i të dielës
shfaqjet e së dielës	» »	e të dielës
orari i së mërkurës	» »	i të mërkurës
ndeshja e së mërkurës	» »	e të mërkurës
parashikimi i së ardhmës	» »	i të ardhmës
mbeturinat e së kaluarës	» »	e të kaluarës
përhapja e së resë	» »	e të resë
nxënësit e së pestës A	» »	e të pestës etj.

Po kështu vepohet edhe për emrat femërorë të farefisnisë, kur përdoren me nyjë:

kujdesi i së bijës	dhe jo	i të bijës
i tha së motrës	» »	të motrës
i shkroi së shoqes	» »	të shoqes etj.

## DISA ÇËSHTJE TË TJERA TË PËRDORIMIT TË NYJAVE

§ 77. Kur në rasën gjinore të një emri femëror të nyjshëm ndeshen dy nyja të përparme së, atëherë e para nga këto (dhe jo e dyta) zëvendësohet me të:

përpara forcës së së vërtetës → përpara forcës të së vërtetës.



po kështu:

<i>frytet e fitores të së resë</i>	dhe jo	së të resë
<i>pas dasmës të së mbesës</i>	» »	së të mbesës
<i>ditëlindja e vajzës të së motrës</i>	» »	së të motrës
<i>recitimi i nxënëses të së tetës B</i>	» »	së të tetës B etj.

§ 78. Kur dy emra në rasën gjinore vijnë pas një emri në emërore njëjës dhe i dyti prej tyre përcakton jo emrin që ndodhet para tij, po tërë togfjalëshin, atëherë ai merr, sipas gjinisë së emrit në emërore, nyjën i ose e:

<i>libri i gjuhës i klasës VII</i>	dhe jo	së klasës VII
<i>rendi i ditës i kongresit</i>	» »	së kongresit
<i>ministri i Tregtisë i RPSH</i>	» »	së RPSH
<i>kampionati i futbollit i këtij viti</i>	» »	të këtij viti
<i>Partia e Punës e Shqipërisë</i>	» »	së Shqipërisë
<i>fjala e nderit e shqiptarit</i>	» »	të shqiptarit
<i>Ministria e Industrisë e RPSH</i>	» »	së RPSH etj.

Për të përcaktuar drejt nyjën që duhet përdorur, edhe këtu, ashtu si në rastin e trajtuar në § 74, duhet zbuluar lidhja kuptimore e fjalëve, ndryshe mund të lindin keqkuptime, p.sh., po të thuhet:

*Partia e Punës së Shqipërisë, kampionati i futbollit të këtij viti* duket sikur është fjala për **punën e Shqipërisë**, e jo për *Partinë e Punës* ose sikur është fjala për *futbollin e këtij viti* e jo për *kampionatin e këtij viti*.

§ 79. Mbiemri i nyjshëm që vjen pas një kundrinori të drejtë, të shprehur me një emër në kallëzore të shquar, merr nyjën e, kur është përcaktor, dhe nyjën të, kur ka funksion kallëzuesor<sup>1)</sup>.

1) *Përcaktor* quhet gjymtyra e fjalisë që plotëson një gjymtyrë tjetër të shprehur me emër dhe tregon një tipar të saj, p.sh.: *ditë e bukur, populli ynë, lufta e klavave, pyll me pisha* etj. *Kallëzuesor* quhet gjymtyra e fjalisë që varet si nga kallëzuesi, ashtu edhe nga kryefjala ose kundrinori i drejtë p.sh.: *Qielli u bë i kaltër; Drita doli agronome* (te këta dy shembuj kallëzuesori varet nga kallëzuesi dhe nga kryefjala); *Shkollën e kemi të re; Ai i ka fjalët të pakta* (te këta dy shembuj kallëzuesori varet si nga kallëzuesi, ashtu dhe nga kundrinori).

Si përcaktor, mbiemri që vjen pas një kundrine, lidhet me të drejtëpërdrejt dhe tregon një tipar të saj, p.sh.:

*E gjeta këmishën e larë* (ç'këmishë?, cilën këmishë?),

ndërsa si *kallëzuesor* mbiemri tregon përsëri një tipar të kundrinorit, por lidhet njëkohësisht me kundrinorin dhe kallëzuesin, p.sh.:

*E gjeta këmishën të larë* (si e gjeta?).

(kallëzuesi) <i>gjeta</i>	→	<i>të larë</i> (kallëzuesori)
(kundrinori) <i>këmishën</i>		

Siç shihet nga kjo skemë, mbiemri *të larë*, i përdorur si kallëzuesor, lidhet njëkohësisht me kallëzuesin *gjeta* dhe me kundrinën *këmishën*. Mbiemri i përdorur si kallëzuesor dallohet nga mbiemri i përdorur si përcaktor edhe sepse në rastin e parë mbi të bie, si rregull, theksi logjik i fjalisë.

Po kështu edhe:

*i dua mollët të ëmbla; i kemi shokët të mirë; e lashë punën të mbaruar; e ka dorën të mbarë; i gjeta dritaret të hapura; gënjeshtra i ka këmbët të shkurtra; do ta bëjmë fshatin të bukur* etj.

Prandaj përdorimi i nyjës e në vend të nyjës të, që vihesh herë-herë në këto raste, është i gabuar. Duhet: *i kemi shokët të mirë* dhe *jo e mirë; e ka dorën të mbarë* dhe *jo e mbarë; gënjeshtra i ka këmbët të shkurtra* dhe *jo e shkurtra* etj., pasi mbiemri është në funksion kallëzuesori.

## V. FOLJA

Folja ka një sistem të pasur trajtash gramatikore, me anën e të cilave shprehen kuptime të tilla si kuptimi i diatezës, i mënyrës, i kohës dhe i vetës.

### 1. FOLJE KALIMTARE E JOKALIMTARE

§ 80. Të gjitha foljet sipas mundësisë që kanë për të marrë ose jo një kundrinë të drejtë ndahen në kalimtare e jokalimtare.

*Folje kalimtare* janë ato që mund të marrin një kundrinë të drejtë, e cila shprehet zakonisht me një emër a përemër në rasën kallëzore pa parafjalë, p.sh.: *tejkaloj planin, hap dritaren, shkruaj një letër, e pashë, nuk të njoh* etj.

*Folje jokalimtare* janë ato që nuk mund të marrin ndonjë kundrinë të drejtë, p.sh.: *dal, eci, fle, rri, rroj, shkoj, vrapoj* etj.

Cilësimi i një foljeje si kalimtare ose jokalimtare varet në shumë raste nga kuptimi leksikor që ka ajo në fjalinë ku është përdorur, p.sh.:

kalimtare

*e fjeta mendjen*

*humba çelësin*

*kaloj klasën*

*shkoj perin në gjilpërë*

*thërres shokët*

jokalimtare

*fjeta shumë*

*humba në gjumë*

*kaloj rrugës*

*shkoj në stadium*

*thërres fort* etj.

Foljet kalimtare kur nuk kanë pranë në fjalinë përkatëse një kundrinë të drejtë, përdoren si jokalimtare. Kjo shoqërohet edhe me një farë ndryshimi në kuptimin e tyre: folja jokalimtare e tregon veprimin si një aftësi, si mundësi, si një veprim të zakonshëm, p.sh.:

*Sot dielli s'ngroh; Kush këndon nga ju?* (d.m.th. kush di, kush është i aftë të këndojë); *Këta nxënës shkruajnë bukur; Rinia jonë mëson dhe punon; Nuk lexoj dot pa syze; Punëtorët hanë në mensë* etj. Në disa raste të veçanta folja jokalimtare mund ta tregojë veprimin edhe si të shkëputur nga objekti, p.sh.: *Fitova!* (lojën); *Kalova!* (klasën); (A hëngre drekë?) — *Hëngra* etj.

## 2. DIATEZAT E FOLJES

§ 81. Diateza shpreh marrëdhënien midis veprimit të emërtuar nga folja dhe kryefjalës. Folja ka tri diateza: veprore, pësore dhe vet-vetore. Këto diateza shprehen vetëm me dy palë forma: forma e diatezës veprore ose *forma veprore*, p.sh.: *laj, dëmtoj, mendova, kam veshur* etj. dhe forma e diatezave joveprore (e pësore dhe e vetvetores) ose *forma joveprore*, p.sh.: *lahem, dëmtohem, u mendova, jam veshur*. Kështu, ndërsa diatezën veprore mund ta dallojmë drejtpërdrejt edhe vetëm nga forma e foljes, për të përcaktuar diatezat e tjera duhet marrë parasysh edhe kuptimi.

Mund të ndryshojnë sipas diatezave vetëm foljet kalimtare, të cilat përdoren si në formën veprore, ashtu edhe në formën pësore. Foljet jokalimtare nuk kanë diatezë. Ato përdoren kryesisht në formën veprore<sup>1)</sup>.

Folja në *diatezën veprore* ka formë veprore dhe shënon një veprim që e kryen kryefjala, p.sh.: *bëj, blej, kërkoj, laj, lyej, them, ujit* etj.

Folja në *diatezën pësore* ka formë joveprore dhe shënon një veprim që drejtohet mbi kryefjalën, por kryhet nga dikush tjetër, p.sh.: *Shqipëria u çlirua më 29 Nëntor 1944; Vreshtat janë dëmtuar nga breshri; Revista «Shkenca dhe jeta» lexohet shumë; U ndezën dritat* etj.

Te fjalitë e mësipërme veprimi i foljeve *u çlirua, lexohet, janë dëmtuar, u ndezën* drejtohet mbi kryefjalët *Shqipëria, revista, vreshtat, dritat*.

Foljet e diatezës pësore, kur kthehen në formë veprore, ruajnë po atë kuptim leksikor: *Vreshtat janë dëmtuar nga breshri — vreshtat i ka dëmtuar breshri* etj.

1) Në raste të veçanta përdoret si pavetore trajta joveprore e vetës së tretë njëjës, p.sh.: *S'ecet kështu; Si dilet që këtej?; Më flihet; S'më iket* etj.

Folja në *diatezën vetvetore* ka formë joveprore dhe shënon në përgjithësi një veprim që e kryen dhe e pëson kryefjala. Diateza vetvetore ka tri nëndarje: vetvetore e mirëfilltë, vetvetore reciproke dhe vetvetore mesore.

Foljet *vetvetore të mirëfillta* shënojnë një veprim që bie mbi personin që e kryen, p.sh.: *krihem, lahem, mburrem, vishem, zhvishemetj.*

Foljet *vetvetore reciproke* shënojnë një veprim që kryhet reciprokisht ose së bashku nga dy a më shumë persona, p.sh.: *fejohem, grindem, martohem, përqafohem, përshëndetem, takohem* etj.

Foljet *vetvetore mesore* shënojnë një veprim që mbetet te personi që e kryen. Këto folje mund të shprehin veprime fizike, si *hidhem, kthehem, ngjitem, nisem* etj., ose veprime psikike e fiziologjike, si *dëshpërohem, dobësohem, gëzohem, hidhërohem, kollem, mallëngjehem, pendohem, shëndoshem* etj.

Foljet e diatezës mesore kanë kuptim jokalimtar, prandaj kur kthehen në diatezën veprore dhe përdoren si kalimtare, ato marrin një kuptim pak a shumë të ndryshëm, kahaso, p.sh.: *hidhem* dhe *hedh kthehem* dhe *kthej, nisem* dhe *nis, dëshpërohem* dhe *dëshpëroj, mendohem* dhe *mendoj* etj.

**Shënim.** E njëjta folje, në varësi nga konteksti, mund të përdoret si vetvete ose si pësore, p.sh.: *Atë ditë pionierët ishin larë më shumë se herët e tjera* (vetvete) — *Rrugët ishin larë nga shiu që kish rënë gjatë natës* (pësore).

### 3. MËNYRAT E FOLJES

§82. Me anë të mënyrës shprehet lidhja në mes veprimit që shënon folja, dhe realitetit objektiv. Këtë lidhje e vendos folësi. Ai mund ta paraqesë një veprim si real, p.sh.: *punoj, shkruaj*, ose, përkundrazi, si të mundshëm, të dëshirueshëm, të detyrueshëm etj., p.sh.: *të punoj, të shkruaj, punofsha, shkruaj!* etj.

Sipas kuptimeve që shprehin, dhe formave gramatikore përkatëse, dallohen gjashtë mënyra të foljes:

mënyra dëftore, p.sh.: *kam, mësoj, marr* etj.;

» lidhore, p.sh.: *të kem, të mësoj, të marr* etj.,

» kushtore, p.sh.: *do të kisha, do të mësoja, do të merrja* etj.,

» habitore, p.sh.: *paskam, mësuakam, marrkam* etj.

» dëshirore, p. sh.: *paça, mësofsha, marrsha* etj.,

» urdhërore, p.sh.: *ki, mëso, merr* etj.

Veç këtyre mënyrave ka edhe tri trajta foljore të pashtjelluara<sup>1)</sup>:  
 pjesorja: *pasur, mësuar, marrë* etj.,  
 paskajorja: *për të pasur, për të mësuar, për të marrë* etj.,  
 përcjellorja: *duke pasur, duke mësuar, duke marrë* etj.  
 Në këto trajta nuk shprehet qëndrimi i folësit ndaj veprimit të foljes, prandaj ato nuk merren si mënyra.

#### 4. KOHA, VETA DHE NUMRI I FOLJES

§83. Folja ka tri kohë: të tashmen, të shkuarën dhe të ardhshmen.

**Koha e tashme** tregon se veprimi kryhet në çastin kur flasim.  
 p.sh.: *shkruaj, dëgjoj* etj.

**Koha e shkuar** tregon se veprimi është kryer para çastit kur flasim, dhe ka pesë forma, që janë:

1) **E pakryera**, p.sh.: *shkruaja, dëgjoja*; 2) **E kryera e thjeshtë**, p.sh.: *shkrova, dëgjova*; 3) **E kryera**, p.sh.: *kam shkruar, kam dëgjuar*; 4) **E kryera e plotë**, p.sh.: *kisha shkruar, kisha dëgjuar*; 5) **E kryera e tejkshkuar**, p.sh.: *pata shkruar, pata dëgjuar*.

Këto forma kanë secila kuptimin e saj të veçantë:

**Koha e ardhshme** tregon se veprimi do të kryhet *pas* çastit kur flasim, dhe ka dy forma, që janë: 1) **E ardhshmja**, p.sh.: *do të shkruaj do të dëgjoj* dhe 2) **E ardhshmja e përparme**, p.sh.: *do të kem shkruar, do të kem dëgjuar*. Këto dy forma kanë secila kuptimin e saj të veçantë.

Kohët që u përshkruan më sipër, i ka të gjitha vetëm mënyra **dëftore**. Mënyrat e tjera nuk i kanë të gjitha këto kohë, po një pjesë prej tyre. Këto do të paraqiten në pasqyrat e zgjedhimeve në paragrafët pasues.

Gjatë zgjedhimit folja ndryshon edhe në vetë e në numër: **vetat** janë tri e numrat dy.

njëjës

shumës

veta I (*unë*) *punoj*

(*ne*) *punojmë*

veta II (*ti*) *punon*

(*ju*) *punoni*

veta III (*ai, ajo*) *punon*

(*ata, ato*) *punojnë*

1) Këto trajta quhen të pashtjelluara, sepse ato nuk ndryshojnë sipas vetës dhe numrit.

## FOLJET kam e jam

§ 84. Foljet *kam* e *jam* përdoren edhe si folje me kuptim të pavarur, p.sh.: *Sot kam shumë punë; Kjo çështje ka shumë rëndësi; Ai ka një vajzë të zgjuar; Vjet në verë qeshë në Pogradec; Mbasdite do të jem në shtëpi* etj., edhe si folje ndihmëse, për të formuar kohët e përbëra të foljeve të tjera, p.sh.: *kam punuar, kisha punuar, jam menduar, isha menduar* etj.

Foljet *kam* e *jam* zgjedhohen në këtë mënyrë<sup>1)</sup>:

### Folja *kam*

### Folja *jam*

#### 1. Mënyra dëftore

E tashmja	E pakryera	E tashmja	E pakryera
unë <i>kam</i>	<i>kisha</i>	<i>jam</i>	<i>isha</i>
ti <i>ke</i>	<i>kishe</i>	<i>je</i>	<i>ishe</i>
ai <i>ka</i>	<i>kishte</i> <sup>2)</sup>	<i>është</i>	<i>ishte</i> <sup>2)</sup>
ne <i>kemi</i>	<i>kishim</i>	<i>jemi</i>	<i>ishim</i>
ju <i>keni</i> <sup>3)</sup>	<i>kishit</i>	<i>jeni</i> <sup>3)</sup>	<i>ishit</i>
ata <i>kanë</i>	<i>kishin</i>	<i>janë</i>	<i>ishin</i>
E kryera	E kryera	E kryera	E kryera
e thjeshtë		e thjeshtë	
unë <i>pata</i>	<i>kam pasur</i>	<i>qeshë</i>	<i>kam qenë</i>
ti <i>pate</i>	<i>ke »</i>	<i>qe</i>	<i>ke »</i>
ai <i>pati</i> <sup>4)</sup>	<i>ka »</i>	<i>qe</i>	<i>ka »</i>
ne <i>patëm</i>	<i>kemi »</i>	<i>qemë</i>	<i>kemi »</i>
ju <i>patët</i>	<i>keni »</i>	<i>qetë</i>	<i>keni »</i>
ata <i>patën</i>	<i>kanë »</i>	<i>qenë</i>	<i>kanë »</i>

- 1) Pasqyrat e zgjedhimit të këtyre foljeve dhe të foljeve të tjera jepen për të ndihmuar lexuesin që të kuptojë më mirë vërejtjet që bëhen më poshtë, për përdorimin e trajtave të ndryshme foljore. Pasqyra më të plota të zgjedhimit të foljeve lexuesi mund të gjejë në tekstet shkollore të gjuhës shqipe.
- 2) Në disa raste, për arsye kryesisht të ritmit të ligjërit, në vend të trajtave të plota letrare *kishte, ishte*, mund të përdoren trajtat e shkurtuara *kish, ish*.
- 3) Trajtat *kini* e *jini*, që përdoren herë-herë në vend të trajtave *keni* e *jeni*, sot nuk janë normative.
- 4) Si folje ndihmëse, për të formuar vetën e tretë njëjës të së kryerës së tejkshuar, mund të përdoret edhe trajta e shkurtuar *pat*, p.sh.: *pat ardhur, pat thënë* etj.

E kryera e plotë	E kryera e tejtj- shkuar	E kryera e plotë	E kryera e tejtj- shkuar
unë <i>kisha pasur</i>	<i>pata pasur</i>	<i>kisha qenë</i>	<i>pata qenë</i>
ti <i>kishe »</i>	<i>pate »</i>	<i>kishe »</i>	<i>pate »</i>
ai <i>kishte »</i>	<i>pati »</i>	<i>kishte »</i>	<i>pati »</i>
ne <i>kishim »</i>	<i>patëm »</i>	<i>kishim »</i>	<i>patëm »</i>
ju <i>kishit »</i>	<i>patët »</i>	<i>kishit »</i>	<i>patët »</i>
ata <i>kishin »</i>	<i>patën »</i>	<i>kishin »</i>	<i>patën »</i>
E ardhshmja	E ardhshmja e përparme	E ardhshmja	E ardhshmja e përparme
unë <i>do të kem</i>	<i>do të kem pasur</i>	<i>do të jem</i>	<i>do të kem qenë</i>
ti » » <i>kesh</i>	» » <i>kesh</i>	» » <i>jesh</i>	» » <i>kesh</i> »
ai » » <i>ketë</i>	» » <i>ketë</i>	» » <i>jetë</i>	» » <i>ketë</i> »
ne » » <i>kemi</i>	» » <i>kemi</i>	» » <i>jemi</i>	» » <i>kemi</i> »
ju » » <i>keni</i>	» » <i>keni</i>	» » <i>jeni</i>	» » <i>keni</i> »
ata » » <i>kenë</i>	» » <i>kenë</i>	» » <i>jenë</i>	» » <i>kenë</i> »

## 2. Mënyra lidhore

E tashmja	E pakryera	E tashmja	E pakryera
unë <i>të kem</i>	<i>të kisha</i>	<i>të jem</i>	<i>të isha</i> <sup>1)</sup>
ti <i>të kesh</i>	<i>të kishe</i>	<i>të jesh</i>	<i>të ishe</i>
ai <i>të ketë</i>	<i>të kishte</i>	<i>të jetë</i>	<i>të ishte</i> <sup>1)</sup>
ne <i>të kemi</i>	<i>të kishim</i>	<i>të jemi</i>	<i>të ishim</i>
ju <i>të keni</i>	<i>të kishit</i>	<i>të jeni</i>	<i>të ishit</i>
ata <i>të kenë</i>	<i>të kishin</i>	<i>të jenë</i>	<i>të ishin</i>

1) Trajtat (*unë*) *të qeshë*, (*ai*) *të qe*, që përdoren mjaft herë në vend të (*unë*) *të isha*, (*ai*) *të ishte*, janë gramatikisht të gabuara dhe përbëjnë shkelje të normës së gjuhës letrare.



E kryera		E kryera e plotë		E kryera		E kryera e plotë
unë të kem pasur		të kisha pasur		të kem qenë		të kisha qenë
ti të kesh »		të kishe »		të kesh »		të kishe »
ai të ketë »		të kishte »		të ketë »		të kishte »
ne të kemi »		të kishim »		të kemi »		të kishim »
ju të keni »		të kishit »		të keni »		të kishit »
ata të kenë »		të kishin »		të kenë »		të kishin »

### 3. Mënyra kushtore

<i>E tashmja</i>		<i>E kryera</i>		<i>E tashmja</i>		<i>E kryera</i>
unë do të kisha		do të kisha pasur		do të isha		do të kisha qenë
ti » » kisha		» » kishe »		» » ishe		» » kishe »
ai » » kishte		» » kishte »		» » ishte		» » kishte »
ne » » kishim		» » kishim »		» » ishim		» » kishim »
ju » » kishit		» » kishit »		» » ishit		» » kishit »
ata » » kishin		» » kishin »		» » ishin		» » kishin »

### 4. Mënyra habitore

<i>E tashmja</i>		<i>E pakryera</i>		<i>E tashmja</i>		<i>E pakryera</i>
unë paskam <sup>1)</sup>		paskështa		qenkam <sup>1)</sup>		qenkështa
ti paskë		paskështë		qenke		qenkështë
ai paska		paskësh		qenka		qenkësh
ne paskemi		paskëshim		qenkemi		qenkëshim
ju paskeni		paskëshit		qenkeni		qenkëshit
ata paskan		paskëshin		qenkan		qenkëshin

1) Trajtat *paskërkam, paskërke, paskërka...*; *qenkërkam, qenkërke, qenkërka...* janë dialektore dhe nuk duhen përdorur në gjuhën letrare.

E kryera	E kryera e plotë	E kryera	E kryera e plotë
unë <i>paskam pasur</i>	<i>paskështa pasur</i>	<i>paskam qenë</i>	<i>paskështa qenë</i>
ti <i>paske</i>	» <i>paskëshe</i>	» <i>paske</i>	» <i>pashkëshe</i>
ai <i>paska</i>	» <i>paskësh</i>	» <i>paska</i>	» <i>paskësh</i>
ne <i>paskemi</i>	» <i>paskëshim</i>	» <i>paskemi</i>	» <i>paskëshim</i>
ju <i>paskeni</i>	» <i>paskëshit</i>	» <i>paskeni</i>	» <i>paskëshit</i>
ata <i>paskan</i>	» <i>paskëshin</i>	» <i>paskan</i>	» <i>paskëshin</i>

### 5. Mënyra dëshirore

E tashmja	E kryera <sup>1)</sup>	E tashmja	E kryera <sup>1)</sup>
unë <i>paça</i>	<i>paça pasur</i>	<i>qofsha</i>	<i>paça qenë</i>
ti <i>paç</i>	<i>paç</i> »	<i>qofsh</i>	<i>paç</i> »
ai <i>pastë</i>	<i>pastë</i> »	<i>qoftë</i>	<i>pastë</i> »
ne <i>paçim</i>	<i>paçim</i> »	<i>qofshim</i>	<i>paçim</i> »
ju <i>paçi</i>	<i>paçi</i> »	<i>qofshi</i>	<i>paçi</i> »
ata <i>paçin</i>	<i>paçin</i> »	<i>qofshin</i>	<i>paçin</i> »

### 6. Mënyra urdhërore

E tashmja	E tashmja
<i>ki</i>	<i>ji</i>
<i>kini</i>	<i>jini</i>

### Pjesorja

<i>pasur</i> <sup>2)</sup>	<i>qenë</i>
----------------------------	-------------

1) E kryera e mënyrës dëshirore e foljeve *kam* e *jam* (ashtu si edhe disa trajta të tjera kohore të këtyre foljeve) përdoret shumë rrallë, por këtu është dhënë për ta paraqitur të plotë sistemin e zgjedhimit.

2) Trajta *patur*, që përdoret mjaft herë në vend të trajtës *pasur*, është dialektore dhe duhet mënjanuar nga gjuha letrare. Nga pjesorja *pasur* janë formuar dhe përdoren në gjuhën letrare fjalët: *i pasur*, *pasuri*, *pasanik*, *pasje*, ndërsa trajta *patur* ka mbetur e izoluar si trajtë dialektore dhe nuk shërben si mbështetje për të formuar fjalë të reja.

## Paskajorja

*për të pasur*

*për të genë*

## Përcjellorja

*duke pasur*

*duke genë*

## NDARJA E FOLJEVE NË ZGJEDHIME

§ 85. Foljet ndahen në tri zgjedhime:

*Zgjedhimi i parë* përfshin foljet e tipit *laj, gjej, pëlqej, punoj, shkruaj, ziej, lyej* etj., d.m.th. folje me temë<sup>1)</sup> më zanore, të cilat në vetën e parë njëjës të kohës së tashme marrin mbaresën -j.

*Zgjedhimi i dytë* përfshin foljet e tipit *hap, mbyll, kap, lidh, rrit, vras, shes* etj., d.m.th. folje me temë më bashkëtingëllore, të cilat në numrin njëjës, në të tria vetat nuk marrin asnjë mbaresë (unë, ti, ai) *hap*.

*Zgjedhimi i parë dhe i dytë*, sipas ndryshimeve që mund të pësojë tema, ndahen në klasa e nënklasa:

*Zgjedhimi i parë* ndahet në tri klasa:

Kl. I përfshin folje si *punoj — punova — punuar; laj — lava — larë; kthej — ktheva — kthyer, rrëfej — rrëfeva — rrëfyer* etj., të cilat në vetën e parë e të dytë të së kryerës së thjeshtë marrin mbaresat -va, -ve.

Kl. II përfshin folje si *gjej — gjeta — gjetur; mbaj — mbajta — mbajtur* etj., të cilat në të kryerën e thjeshtë e në pjesore e zgjerojnë temën me -t-, -jt-.

Kl. III përfshin folje si *bëj — bëra — bërë; hyj — hyra — hyrë*, të cilat në të kryerën e thjeshtë, në numrin njëjës e zgjerojnë temën me -r-.

1) Temë nga pikëpamja morfologjike quhet ajo pjesë e fjalës që mbetet po të heqim mbaresën, p.sh. tema e foljeve *laj, punoj, shkruaj, ziej, lyej* është *la-, puno-, shkrua-, zie-, lye-*. Një folje mund të ketë tema të ndryshme në trajta kohore të ndryshme (p.sh. *heq*, por *hoq-a*). Këtu është fjala për temën e foljes në kohën e tashme.

Zgjedhimi i dytë ndahet në dy klasa:

Kl. I përfshin folje si *hap* — *hapa* — *hapur*; *mat* — *mata* — *matur* etj., të cilat gjatë zgjedhimit nuk e ndryshojnë zanoren e temës;

Kl. II përfshin folje si *heq* — *hoqa* — *hequr*; *marr* — *mora* — *marrë*; *vjel* — *vola* — *vjelë*; *bërtas* — *bërtita* — *bërtitur*; *flas* — *fola* — *folur* etj., të cilat gjatë zgjedhimit e ndryshojnë zanoren e temës.

Zgjedhimi i tretë përfshin një numër të kufizuar foljesh, tema e të cilave del më zanore, por ndryshe nga foljet e zgjedhimit të parë, ato në të tria vetat e numrit njënjës nuk kanë asnjë mbaresë, p.sh.: (unë, ti, ai) *pi*, *fle*, *di*, *lë*, *nxë*, *vë*, *zë*, *përzë*, *shpie*, *shtie* etj. Po japim disa pasqyra të këtyre zgjedhimeve.

## § 86. ZGJEDHIMI I PARË

Trajta veprore

Trajta pësore

### 1. Mënyra dëftore

E tashmja

unë <i>laj</i>	-j	<i>lahem</i>	-hem
ti <i>lan</i>	-n	<i>lahesh</i>	-hesh
ai <i>lan</i>	-n	<i>lahet</i>	-het
ne <i>lajmë</i>	-jmë	<i>lahemi</i>	-hemi
ju <i>lani</i>	-ni	<i>laheni</i>	-heni
ata <i>lajnë</i>	-jnë	<i>lahen</i>	-hen

E pakryera

unë <i>laja</i>	-ja	<i>lahesha</i>	-heshha
ti <i>laje</i>	-je	<i>laheshe</i>	-heshhe
ai <i>lante</i>	-nte	<i>lahej</i>	-hej
ne <i>lanim</i>	-nim	<i>laheshim</i>	-heshim
ju <i>lanit</i>	-nit	<i>laheshit</i>	-heshit
ata <i>lanin</i>	-nin	<i>laheshin</i>	-heshin

## E kryera e thjeshtë

<i>unë lava</i>	<b>-va</b>	<i>u lava</i>	<b>-va</b>
<i>ti lave</i>	<b>-ve</b>	<i>u lave</i>	<b>-ve</b>
<i>ai lau</i>	<b>-u</b>	<i>u la</i>	—
<i>ne lamë</i>	<b>-më</b>	<i>u lamë</i>	<b>-më</b>
<i>ju latë</i>	<b>-të</b>	<i>u latë</i>	<b>-të</b>
<i>ata lanë</i>	<b>-në</b>	<i>u lanë</i>	<b>-në</b>

## E kryera

<i>unë kam larë</i>		<i>jam larë</i>
<i>ti ke</i> »		<i>je</i> »
<i>ai ka</i> »		<i>është</i> »
<i>ne kemi</i> »		<i>jemi</i> »
<i>ju keni</i> »		<i>jeni</i> »
<i>ata kanë</i> »		<i>janë</i> »

## E kryera e plotë

<i>unë kisha larë</i>		<i>isha larë</i>
<i>ti kishe</i> »		<i>ishe</i> »
<i>ai kishte</i> »		<i>ishte</i> »
<i>ne kishim</i> »		<i>ishim</i> »
<i>ju kishit</i> »		<i>ishit</i> »
<i>ata kishin</i> »		<i>ishin</i> »

## E kryera e tejshkuar

<i>unë pata larë</i>		<i>qeshë larë</i>
<i>ti pate</i> »		<i>qe</i> »
<i>ai pati</i> »		<i>qe</i> »
<i>ne patëm</i> »		<i>qemë</i> »
<i>ju patët</i> »		<i>qetë</i> »
<i>ata patën</i> »		<i>qenë</i> »

## E ardhshmja

unë do të laj  
ti do të lash  
ai do të lajë  
ne do të lajmë  
ju do të lani  
ata do të lajnë

unë do të lahem  
ti do të lahesh  
ai do të lahet  
ne do të lahemi  
ju do të laheni  
ata do të lahen

## E ardhshmja e përparme

unë do të kem larë  
ti do të kesh »  
ai do të ketë »  
ne do të kemi »  
ju do të keni »  
ata do të kenë »

do të jem larë  
do të jesh »  
do të jetë »  
do të jemi »  
do të jeni »  
do të jenë »

## 2. Mënyra lidhore

unë të laj -j  
ti të lash -sh  
ai të lajë -jë  
ne të lajmë -jmë  
ju të lani -ni  
ata të lajnë -jnë

të lahem -hem  
të lahesh -hesh  
të lahet -het  
të lahemi -hemi  
të laheni -heni  
të lahen -hen

## E pakryera

unë të laja  
ti të laje  
ai të lante  
ne të lanim  
ju të lanit  
ata të lanin

të lahesha  
të laheshe  
të lahej  
të laheshim  
të laheshit  
të laheshin

## E kryera

unë të kem larë  
ti të kesh »  
ai të ketë »  
ne të kemi »  
ju të kenë »  
ata të kenë »

të jem larë  
të jesh »  
të jetë »  
të jemi »  
të jeni »  
të jenë »

## E kryera e plotë

unë të kisha larë  
ti të kishe »  
ai të kishte »  
ne të kishim »  
ju të kishit »  
ata të kishin »

të isha larë  
të ishe »  
të ishte »  
të ishim »  
të ishit »  
të ishin »

## 3. Mënyra kushtore

### E tashmja

unë do të laja  
ti do të laje  
ai do të lante  
ne do të lanim  
ju do të lanit  
ata do të lanin

do të lahesha  
do të laheshe  
do të lahej  
do të laheshim  
do të laheshit  
do të laheshin

### E kryera

unë do të kisha larë  
ti do të kishe »  
ai do të kishte »  
ne do të kishim »  
ju do të kishit »  
ata do të kishin »

do të isha larë  
do të ishe »  
do të ishte »  
do të ishim »  
do të ishit »  
do të ishin »

#### 4. Mënyra habitore

##### E tashmja

unë lakam	u lakam
ti lake	u lake
ai laka	u laka
ne lakemi	u lakemi
ju lakeni	u lakeni
ata lakan	u lakan

##### E pakryera

unë lakësha	u lakësha
ti lakëshe	u lakëshe
ai lakësh	u lakësh
ne lakëshim	u lakëshim
ju lakëshit	u lakëshit
ata lakëshin	u lakëshin

##### E kryera

unë paskam larë	qenkam larë
ti paskë »	qenke »
ai paska »	qenka »
ne paskemi »	qenkemi »
ju paskeni »	qenkeni »
ata paskan »	qenkan »

##### E kryera e plotë

unë paskësha larë	qenkësha larë
ti paskëshe »	qenkëshe »
ai paskësh »	qenkësh »
ne paskëshim »	qenkëshim »
ju paskëshit »	qenkëshit »
ata paskëshin »	qenkëshin »



## 5. Mënyra dëshirore

### E tashmja

unë *lafsha*  
ti *lafsh*  
ai *lafhtë*  
ne *lafshim*  
ju *lafshi*  
ata *lafshin*

*u lafsha*  
*u lafsh*  
*u laftë*  
*u lafshim*  
*u lafshi*  
*u lafshin*

### E kryera

unë *paça larë*  
ti *paç* »  
ai *pahtë* »  
ne *paçim* »  
ju *paçi* »  
ata *paçin* »

*qofsha larë*  
*qofsh* »  
*qoftë* »  
*qofshim* »  
*qofshi* »  
*qofshin* »

## 6. Mënyra urdhërore

Pa trajtë  
të shkurtër

Me trajtë  
të shkurtër

ti *laj*  
ju *lani*

*laje*  
*lajeni*

*lahu*  
*lahuni*

### Pjesorja

*larë*

### Paskajorja

*për të larë*

*për t'u larë*

## Përcjellorja

duke larë

duke u larë

### § 87. ZGJEDHIMI I DYTË

Trajta veprore

Trajta pësore

#### 1. Mënyra dëftore

##### E tashmja

unë rrit	-	rritem	-em
ti rrit	-	rritesh	-esh
ai rrit	-	rritet	-et
ne rritim	-im	rritemi	-emi
ju rritni	-ni	rriteni	-eni
ata rritin	-in	rriten	-en

##### E pakryera

unë rritja	-ja	rritesha	-esha
ti rritje	-je	rriteshe	-eshe
ai rrite	-te	rritej	-ej
ne rritnim	-nim	rriteshim	-eshim
ju rritnit	-nit	rriteshit	-eshit
ata rritnin	-nin	rriteshin	-eshin

##### E kryera e thjeshtë

unë rrita	-a	u rrita	-a
ti rrite	-e	u rrite	-e
ai rriti	-i	u rrit	-
ne rritëm	-ëm	u rritëm	-ëm
ju rritët	-ët	u rritët	-ët
ata rritën	-ën	u rritën	-ën

## E kryera

<i>unë kam rritur</i>		<i>jam rritur</i>	
<i>ti ke</i>	»	<i>je</i>	»
<i>ai ka</i>	»	<i>është</i>	»
<i>ne kemi</i>	»	<i>jemi</i>	»
<i>ju keni</i>	»	<i>jeni</i>	»
<i>ata kanë</i>	»	<i>janë</i>	»

## E kryera e plotë

<i>unë kisha rritur</i>		<i>isha rritur</i>	
<i>ti kishe</i>	»	<i>ishe</i>	»
<i>ai kishte</i>	»	<i>ishte</i>	»
<i>ne kishim</i>	»	<i>ishim</i>	»
<i>ju kishit</i>	»	<i>ishit</i>	»
<i>ata kishin</i>	»	<i>ishin</i>	»

## E kryera e tejshkuar

<i>unë pata rritur</i>		<i>qeshë rritur</i>	
<i>ti pate</i>	»	<i>qe</i>	»
<i>ai pati</i>	»	<i>qe</i>	»
<i>ne patëm</i>	»	<i>qemë</i>	»
<i>ju patët</i>	»	<i>qetë</i>	»
<i>ata patën</i>	»	<i>qenë</i>	»

## E ardhshmja

<i>unë do të rrit</i>		<i>do të rritem</i>
<i>ti do të rritësh</i>		<i>do të rritesh</i>
<i>ai do të rritë</i>		<i>do të rritet</i>
<i>ne do të rritim</i>		<i>do të rritemi</i>
<i>ju do të rritni</i>		<i>do të rriteni</i>
<i>ata do të rritin</i>		<i>do të rriten</i>

## E ardhshmja e përparme

<i>unë do të kem rritur</i>		<i>do të jem rritur</i>
<i>ti do të kesh</i> »		<i>do të jesh</i> »
<i>ai do të ketë</i> »		<i>do të jetë</i> »
<i>ne do të kemi</i> »		<i>do të jemi</i> »
<i>ju do të keni</i> »		<i>do të jeni</i> »
<i>ata do të kenë</i> »		<i>do të jenë</i> »

## 2. Mënyra lidhore

### E tashmja

<i>unë të rrit</i>	-	<i>të rritem</i>	-em
<i>ti të rritësh</i>	-ësh	<i>të rritesh</i>	-esh
<i>ai të rritë</i>	-ë	<i>të rritet</i>	-et
<i>ne të rritim</i>	-im	<i>të rritemi</i>	-emi
<i>ju të rritni</i>	-ni	<i>të rriteni</i>	-eni
<i>ata të rritin</i>	-in	<i>të rriten</i>	-en

### E pakryera

<i>unë të rritja</i>	<i>të rritesha</i>
<i>ti të rritje</i>	<i>të rriteshe</i>
<i>ai të rriste</i>	<i>të rritej</i>
<i>ne të rritnim</i>	<i>të rriteshim</i>
<i>ju të rritnit</i>	<i>të rriteshit</i>
<i>ata të rritnin</i>	<i>të rriteshin</i>

### E kryera

<i>unë të kem rritur</i>	<i>të jem rritur</i>
<i>ti të kesh</i> »	<i>të jesh</i> »
<i>ai të ketë</i> »	<i>të jetë</i> »
<i>ne të kemi</i> »	<i>të jemi</i> »
<i>ju të keni</i> »	<i>të jeni</i> »
<i>ata të kenë</i> »	<i>të jenë</i> »

## E kryera e plotë

unë të kisha rritur  
ti të kishe »  
ai të kishte »  
ne të kishim »  
ju të kishit »  
ata të kishin »

të isha rritur  
të ishe »  
të ishte »  
të ishim »  
të ishit »  
të ishin »

## 3. Mënyra kushtore

### E tashmja

unë do të rritja  
ti do të rritje  
ai do të rriste  
ne do të rritnim  
ju do të rritnit  
ata do të rritnin

do të rritesha  
do të rriteshe  
do të rritej  
do të rriteshim  
do të rriteshit  
do të rriteshin

### E kryera

unë do të kisha rritur  
ti do të kishe »  
ai do të kishte »  
ne do të kishim »  
ju do të kishit »  
ata do të kishin »

do të isha rritur  
do të ishe »  
do të ishte »  
do të ishim »  
do të ishit »  
do të ishin »

#### 4. Mënyra habitore

##### E tashmja

unë rritkam  
ti rritke  
ai rritka  
ne rritkemi  
ju rritkeni  
ata rritkan

u rritkam  
u rritke  
u rritka  
u rritkemi  
u rritkeni  
u rritkan

##### E pakryera

unë rritkësha  
ti rritkëshe  
ai rritkësh  
ne rritkëshim  
ju rritkëshit  
ata rritkëshin

u rritkësha  
u rritkëshe  
u rritkësh  
u rritkëshim  
u rritkëshit  
u rritkëshin

##### E kryera

unë paskam rritur  
ti paske »  
ai paska »  
ne paskemi »  
ju paskeni »  
ata paskan »

qenkam rritur  
qenke »  
qenka »  
qenkemi »  
qenkeni »  
qenkan »

##### E kryera e plotë

unë paskësha rritur  
ti paskëshe »  
ai paskësh »  
ne paskëshim »  
ju paskëshit »  
ata paskëshin »

qenkësha rritur  
qenkëshe »  
qenkësh »  
qenkëshim »  
qenkëshit »  
qenkëshin »

## 5. Mënyra dëshirore

### E tashmja

unë rritsha  
ti rritsh  
ai rrittë  
ne rritshim  
ju rritshi  
ata rritshin

u rritsha  
u rritsh  
u rrittë  
u rritshim  
u rritshi  
u rritshin

### E kryera

unë paça rritur  
ti paç »  
ai pastë »  
ne paçim »  
ju paçi »  
ata paçin »

qofsha rritur  
qofsh »  
qoftë »  
qofshim »  
qofshi »  
qofshin »

## 6. Mënyra urdhërore

Pa trajtë  
të shkurtër

Me trajtë  
të shkurtër

ti rrit  
ju rritni

rrite  
rriteni

rritu  
rrituni

### Pjesorja

rritur

### Paskajorja

për të rritur

për t'u rritur

### Përcjellorja

duke rritur

duke u rritur

## § 88. ZGJEDHIMI I TRETË

Trajta veprore

Trajta pësore

### 1. Mënyra dëftore

#### E tashmja

unë zë	-	<i>zihem</i>	-hem
ti zë	-	<i>zihesh</i>	-hesh
ai zë	-	<i>zihet</i>	-het
ne zëmë	-më	<i>zihemi</i>	-hemi
ju zini	-ni	<i>ziheni</i>	-heni
ata zënë	-në	<i>zihen</i>	-hen

#### E pakryera

unë zija	-ja	<i>zihesha</i>	-hesha
ti zije	-je	<i>ziheshe</i>	-heshe
ai zinte	-nte	<i>zihej</i>	-hej
ne zinim	-nim	<i>ziheshim</i>	-heshim
ju zinit	-nit	<i>ziheshit</i>	-heshit
ata zinin	-nin	<i>ziheshin</i>	-heshin

#### E kryera e thjeshtë

unë zura	-a	<i>u zura</i>	-a
ti zure	-e	<i>u zure</i>	-e
ai zuri	-i	<i>u zu</i>	-
ne zumë	-më	<i>u zumë</i>	-më
ju zutë	-të	<i>u zutë</i>	-të
ata zunë	-në	<i>u zunë</i>	-në



## E kryera

<i>unë kam zënë</i>		<i>jam zënë</i>
<i>ti ke »</i>		<i>je »</i>
<i>ai ka »</i>		<i>është »</i>
<i>ne kemi »</i>		<i>jemi »</i>
<i>ju jeni »</i>		<i>jeni »</i>
<i>ata kanë »</i>		<i>janë »</i>

## E kryera e plotë

<i>unë kisha zënë</i>		<i>isha zënë</i>
<i>ti kishe »</i>		<i>ishe »</i>
<i>ai kishte »</i>		<i>ishte »</i>
<i>ne kishim »</i>		<i>ishim »</i>
<i>ju kishit »</i>		<i>ishit »</i>
<i>ata kishin »</i>		<i>ishin »</i>

## E kryera e tejshkuar

<i>unë pata zënë</i>		<i>qeshë zënë</i>
<i>ti pate »</i>		<i>qe »</i>
<i>ai pati »</i>		<i>qe »</i>
<i>ne patëm »</i>		<i>qemë »</i>
<i>ju patët »</i>		<i>qetë »</i>
<i>ata patën »</i>		<i>qenë »</i>

## E ardhshmja

<i>unë do të zë</i>		<i>do të zihem</i>
<i>ti do të zësh</i>		<i>do të zihesh</i>
<i>ai do të zërë</i>		<i>do të zihet</i>
<i>ne do të zëmë</i>		<i>do të zihemi</i>
<i>ju do të zini</i>		<i>do të zihen</i>
<i>ata do të zënë</i>		<i>do të zihen</i>

## E ardhshmja e përparme

unë do të kem zënë		do të jem zënë
ti do të kesh »		do të jesh »
ai do të ketë »		do të jetë »
ne do të kemi »		do të jemi »
ju do të keni »		do të jeni »
ata do të kenë »		do të jenë »

## 2. Mënyra lidhore

### E tashmja

unë të zë	-	të zihem	-hem
ti të zësh	-sh	të zihesh	-hesh
ai të zërë	-ë	të zihet	-het
ne të zëmë	-më	të zihemi	-hemi
ju të zini	-ni	të ziheni	-heni
ata të zënë	-në	të zihen	-hen

### E pakryera

unë të zija	të zihesha
ti të zije	të ziheshe
ai të zinte	të zihej
ne të zinin	të ziheshim
ju të zinit	të ziheshit
ata të zinin	të ziheshin

### E kryera

unë të kem zënë	të jem zënë
ti të kesh »	të jesh »
ai të ketë »	të jetë »
ne të kemi »	të jemi »
ju të keni »	të jeni »
ata të kenë »	të jenë »

## E kryera e plotë

unë të kisha zënë  
ti të kishe »  
ai të kishte »  
ne të kishim »  
ju të kishit »  
ata të kishin »

të isha zënë  
të ishe »  
të ishte »  
të ishim »  
të ishit »  
të ishin »

## 3. Mënyra kushtore

### E tashmja

unë do të zija  
ti do të zije  
ai do të zinte  
ne do të zinim  
ju do të zinit  
ata do të zinin

do të zihesha  
do të ziheshe  
do të zihej  
do të ziheshim  
do të ziheshit  
do të ziheshin

### E kryera

unë do të kisha zënë  
**ti** do të kishe »  
ai do të kishte »  
ne do të kishim »  
ju do të kishit »  
ata do të kishin »

do të isha zënë  
do të ishe »  
do të ishte »  
do të ishim »  
do të ishit »  
do të ishin »

#### 4. Mënyra habitore

##### E tashmja

unë zënkam  
ti zënke  
ai zënka  
ne zënkemi  
ju zënkeni  
ata zënkam

u zënkam  
u zënke  
u zënka  
u zënkemi  
u zënkeni  
u zënkam

##### E pakryera

unë zënkështa  
ti zënkështe  
ai zënkësh  
ne zënkëshim  
ju zënkëshit  
ata zënkëshin

u zënkështa  
u zënkështe  
u zënkësh  
u zënkëshim  
u zënkëshit  
u zënkëshin

##### E kryera

unë paskam zënë  
ti paskë »  
ai paska »  
ne paskemi »  
ju paskeni »  
ata paskan »

qenkam zënë  
qenke »  
qenka »  
qenkemi »  
qenkeni »  
qenkan »

##### E kryera e plotë

unë paskështa zënë  
ti paskështe »  
ai paskësh »  
ne paskëshim »  
ju paskëshit »  
ata paskëshin »

qenkështa zënë  
qenkështe »  
qenkësh »  
qenkëshim »  
qenkëshit »  
qenkëshin »

## 5. Mënyra dëshirore

### E tashmja

unë zënça  
ti zënç  
ai zëntë  
ne zënçim  
ju zënçi  
ata zënçin

u zënça  
u zënç  
u zëntë  
u zënçim  
u zënçi  
u zënçin

### E kryera

unë paça zënë  
ti paç »  
ai pastë »  
ne paçim »  
ju paçi »  
ata paçin »

qofsha zënë  
qofsh »  
qoftë »  
qofshim »  
qofshi »  
qofshin »

## 6. Mënyra urdhërore

Pa trajtë  
të shkurtër

Me trajtë  
të shkurtër

ti zër  
ju zini

zëre  
zëreni

zihu  
zihuni

### Pjesorja

zënë

## Paskajorja

*për të zënë*

*për t'u zënë*

## Përcjellorja

*duke zënë*

*duke u zënë*

## FOLJET E PARREGULLTA

§ 89. Përveç foljeve që klasifikohen në zgjedhime, ka edhe një numër foljesh që në gramatikë quhen *të parregullta*. Një pjesë e tyre temën e së kryerës së thjeshtë e të pjesores e kanë krejt të ndryshme nga tema e së tashmes, kurse disa të tjera pësojnë ndryshime fonetike të veçanta dhe nuk mund të bashkohen me asnjë nga tri zgjedhimet. Foljet kryesore të parregullta janë këto:

E tashmja	E kryera e thjeshtë	Pjesorja
<i>jap</i>	<i>dhashë</i>	<i>dhënë</i>
<i>bie</i>	<i>rashë</i>	<i>rënë</i>
<i>bie</i>	<i>prura</i>	<i>prurë</i>
<i>ha</i>	<i>hëngra</i>	<i>ngrënë</i>
<i>jam</i>	<i>qeshë</i>	<i>qenë</i>
<i>kam</i>	<i>pata</i>	<i>pasur</i>
<i>rri</i>	<i>ndenja</i>	<i>ndenjor</i>
<i>shoh</i>	<i>pashë</i>	<i>parë</i>
<i>vij</i>	<i>erdha</i>	<i>ardhur</i>
<i>dua</i>	<i>desha</i>	<i>dashur</i>
<i>them</i>	<i>thashë</i>	<i>thënë</i>
<i>vdes</i>	<i>vdiqa</i>	<i>vdekur</i>
<i>vete</i>	<i>vajta</i>	<i>vajtur</i>

Për përdorimin e disa trajtave të gabuara të foljeve të parregullta shih § 114.

## VËREJTJE RRETH PËRDORIMIT TË DISA TRAJTAVE FOLJORE

§ 90. Krahas trajtave të rregullta, normative, për disa tipa foljesh si në gjuhën e folur, ashtu edhe në gjuhën e shkruar përdoren herë-herë edhe trajta të gabuara e dialektore, që nuk janë në pajtim me normën e sotme letrare. Këto trajta po i vëmë në dukje më poshtë, të grupuara sipas mënyrave e kohëve.

### MËNYRA DËFTORE

#### E TASHMJA DHE E PAKRYERA

Lidhur me zgjedhimin e foljeve në kohën e tashme duhen pasur parasysh vërejtjet e mëposhtme.

§ 91. Foljet e zgjedhimit të parë, në vetën e parë të numrit njëjës marrin kurdoherë mbaresën -j dhe jo -nj, pra:

<i>laj</i>	dhe jo	<i>lanj</i>
<i>běj</i>	» »	<i>bějnj</i>
<i>punoj</i>	» »	<i>punojnj</i>
<i>shkoj</i>	» »	<i>shkojnj</i>
<i>shkruaj</i>	» »	<i>shkruajnj</i>
<i>lyej</i>	» »	<i>lyejnj</i> etj.

§ 92. Të gjitha foljet në kohën e pakryer, në vetën e parë dhe të dytë njëjës, marrin mbaresat -ja, -je dhe jo -nja, -nje, pra:

<i>laja, laje</i>	dhe jo	<i>lanja, lanje</i>
<i>bėja, bëje</i>	» »	<i>bėja, bënje</i>
<i>shkoja, shkoje</i>	» »	<i>shkonja, shkonje</i>
<i>shkruaja, shkruaje</i>	» »	<i>shkruanja, shkruanje</i>
<i>punoja, punoje</i>	» »	<i>punoja, punoje</i>
<i>lyeja, lyeje</i>	» »	<i>lyenja, lyenje</i>
<i>hapja, hapje</i>	» »	<i>hapnja, hapnje</i>
<i>rritja, rritje</i>	» »	<i>rritnja, rritnje</i>
<i>vritja, vritje</i>	» »	<i>vritnja, vritnje</i>
<i>shitja, shitje</i>	» »	<i>shitnja, shitnje</i>
<i>pija, pije</i>	» »	<i>pinja, pinje</i>
<i>haja, haje</i>	» »	<i>hanja, hanje</i>
<i>bija, bije</i>	» »	<i>binja, binje</i> etj.

§ 93. Foljet e zgjedhimit të dytë me temë më -t, si *mat, zgjat, rrit, çudit* etj., në kohën e tashme dhe në të pakryerën përdoren edhe në trajtën me s: *mas, masja* etj., por trajta normative kryesore është ajo ku ruhet t-ja e temës, pra:

unë	<i>mat</i>	më	mirë	se	<i>mas</i>
ne	<i>matim</i>	»	»		<i>masim</i>
ju	<i>matni</i>	»	»		<i>masni</i>
ata	<i>matin</i>	»	»		<i>masin</i>
unë	<i>zgjat</i>	»	»		<i>zgjas</i>
ne	<i>zgjatim</i>	»	»		<i>zgjasim</i>
ju	<i>zgjatni</i>	»	»		<i>zgjasni</i>
ata	<i>zgjatin</i>	»	»		<i>zgjasin</i>
unë	<i>rrit</i>	»	»		<i>rris</i>
ne	<i>rritim</i>	»	»		<i>rrisim</i>
ju	<i>rritni</i>	»	»		<i>rrisni</i>
ata	<i>rritin</i>	»	»		<i>rrisin</i>
unë	<i>çudit</i>	»	»		<i>çudis</i>
ne	<i>çuditim</i>	»	»		<i>çudisim</i>
ju	<i>çuditni</i>	»	»		<i>çudisni</i>
ata	<i>çuditin</i>	»	»		<i>çudisin</i> etj.
unë	<i>matja</i>	»	»		<i>masja</i>
ti	<i>matje</i>	»	»		<i>masje</i>
ne	<i>matnim</i>	»	»		<i>masnim</i>
ju	<i>matnit</i>	»	»		<i>masnit</i>
ata	<i>matnin</i>	»	»		<i>masnin</i>
unë	<i>zgjatja</i>	»	»		<i>zgjasja</i>
ti	<i>zgjatje</i>	»	»		<i>zgjasje</i>
ne	<i>zgjatnim</i>	»	»		<i>zgjasnim</i>
ju	<i>zgjatnit</i>	»	»		<i>zgjasnit</i>
ata	<i>zgjatnin</i>	»	»		<i>zgjasnin</i>
unë	<i>rritja</i>	»	»		<i>rrisja</i>
ti	<i>rritje</i>	»	»		<i>rrisje</i>
ne	<i>rritnim</i>	»	»		<i>rrisnim</i>
ju	<i>rritnit</i>	»	»		<i>rrisnit</i>
ata	<i>rritnin</i>	»	»		<i>rrisnin</i>



unë	<i>çuditja</i>	më mirë se	<i>çudisja</i>
ti	<i>çuditje</i>	» »	<i>çudisje</i>
ne	<i>çuditnim</i>	» »	<i>çudisnim</i>
ata	<i>çuditnin</i>	» »	<i>çudisnin</i> etj.

Vetëm në vetën e tretë njëjës këto folje e ndërrojnë bashkëtingëlloren t të temës në s dhe marrin pas saj mbaresën -te:

ai	<i>maste</i>	dhe jo	<i>matte</i>
»	<i>zgjaste</i>	» »	<i>zgjatte</i>
»	<i>rriste</i>	» »	<i>rritte</i>
»	<i>çudiste</i>	» »	<i>çuditte</i> etj. <sup>1)</sup>

Foljet si *gërvisht*, *hesht*, *mposht*, *rresht*, *ysht* etj, në vetën e tretë njëjës të së pakryerës bëjnë:

*gërvishhte*, *heshtte*, *mposhtte*, *reshtte*, *yshtte*, d.m.th. nuk e ndërrojnë në s bashkëtingëlloren t të temës.

§ 94. Foljet e zgjedhimit të dytë që mbarojnë me -as ose -es, si *bërtas*, *flas*, *kërcas*; *pres*, *shes*, *zbres* etj., në vetën e dytë shumës të së tashmes përdoren në dy trajta:

*bërtitni*, *flitni* etj. dhe *bërtisni*, *flisni* etj.

Trajtat normative kryesore janë ato ku ruhet t-ja e temës, pra:

ju	<i>bërtitni</i>	më mirë se	<i>bërtisni</i>
»	<i>flitni</i>	» »	<i>flisni</i>
»	<i>kërcitni</i>	» »	<i>kërcisni</i>
»	<i>ngitni</i>	» »	<i>ngisni</i>
»	<i>shkitni</i>	» »	<i>shkisni</i>
»	<i>thërritni</i>	» »	<i>thërrisni</i>
»	<i>vritni</i>	» »	<i>vriski</i>
»	<i>pritni</i>	» »	<i>prisni</i>
»	<i>shitni</i>	» »	<i>shisni</i>
»	<i>zbritni</i>	» »	<i>zbrisni</i> etj.

1) Shih për këtë edhe «Drejtshkrimi i gjuhës shqipe» § 35 shënim 3.

Edhe në të pakryerën, me përjashtim të vetës së tretë njëjës, trajtat me t janë trajtat normative kryesore dhe duhen parapëlqyer ndaj trajtave me s:

*bërtitja, bërtitje, bërtitnim, bërtitnit, bërtitnin, më mirë se: bërtisja, bërtisje, bërtisnim, bërtisnit, bërtisnin, por: bërtiste.*

Po kështu edhe:

*flitja, flitje, flitnim, flitnit, flitnin,*

por: *fliste;*

*kërcitja, kërcitje, kërcitnim, kërcitnit, kërcitnin,*

por: *kërciste;*

*ngjitja, ngjitje, ngjitnim, ngjitnit, ngjitnin,*

por: *ngjiste;*

*shkitja, shkitje, shkitnim, shkitnit, shkitnin,*

por: *shkiste;*

*thërritja, thërritje, thërritnim, thërritnit, thërritnin,*

por: *thërriste;*

*vritja, vritje, vritnim, vritnit, vritnin,*

por: *vriste;*

*pritja, pritje, pritnim, pritnit, pritnin,*

por: *priste;*

*shitja, shitje, shitnim, shitnit, shitnin,*

por: *shiste;*

*zbritja, zbritje, zbritnim, zbritnit, zbritnin,*

por: *zbriste etj.*

§ 95. Te një numër foljesh, në vetën e dytë të shumësit të kohës së tashme zanorja e temës ndërrohet në i, p.sh.: *dredh — dridhni, dal — dilni, njoh — njihni, flas — flitni, vjel — vilni, nxjerr — nxirrni etj.*<sup>1)</sup> Në shumicën e trajtave të tyre foljet e tipit të mësipërm përdoren drejt, por për disa prej tyre si në gjuhën e folur, ashtu edhe në gjuhën e shkruar herë-herë vihen re luhatje. Për t'iu shmangur përdorimit të trajtave jonormative, duhet pasur parasysh se:

1) Këto ndërrime kanë të bëjnë me zhvillimin historik të fonetikës së shqipes, janë të përhapura e të ngulitura në mbarë gjuhën dhe nuk përbëjnë problem nga pikëpamja normative.

a) Foljet që kanë grupin **-je-** ose **-ie-** në temë, në vetën e dytë të shumësit zakonisht e kthejnë këtë grup në **-i-**<sup>1)</sup>:

(unë, ti, ai)	nxjerr	— (ju)	<i>nxirrni</i>	dhe jo	<i>nxjerrni</i>
»	<i>përcjell</i>	— »	<i>përcillni</i>	» »	<i>përcjellni</i>
»	<i>vjel</i>	— »	<i>vilni</i>	» »	<i>vjelni</i>
»	<i>djeg</i>	— »	<i>digjni</i>	» »	<i>djegni</i>
»	<i>bie</i>	— »	<i>bini</i>	» »	<i>bjeni</i>
»	<i>shtie</i>	— »	<i>shtini</i>	» »	<i>shtjeni</i> etj.

b) Foljet e mëposhtme në vetën e dytë të shumësit e ndërrojnë zanoren e temës në **i**:

(unë)	<i>blej</i>	— (ju)	<i>blini</i>	dhe jo	<i>bleni</i>
»	<i>dal</i>	— »	<i>dilni</i>	» »	<i>delni</i>
»	<i>fle</i>	— »	<i>flini</i>	» »	<i>fleni</i>
»	<i>ngre</i>	— »	<i>ngrini</i>	» »	<i>ngreni</i>
»	<i>lë</i>	— »	<i>lini</i>	» »	<i>leni</i>
»	<i>vë</i>	— »	<i>vini</i>	» »	<i>veni</i>
»	<i>zë</i>	— »	<i>zini</i>	» »	<i>zeni</i>
»	<i>përzë</i>	— »	<i>përzini</i>	» »	<i>përzeni</i>
»	<i>nxë</i>	— »	<i>nxini</i>	» »	<i>nxeni</i>

por:

(unë)	<i>marr</i>	— (ju)	<i>merrni</i>	dhe jo	<i>mirrni</i>
-------	-------------	--------	---------------	--------	---------------

Të gjitha foljet të cilat zanorja ose grupi zanor i temës ndërrohen në **i** në vetën e dytë të shumësit të së tashmes (d.m.th. foljet që u përmendën më lart në pikat *a* e *b*), dalin me **i** edhe në të pakryerën, si edhe në të tashmen e në të pakryerën e trajtës joveprore<sup>2)</sup>, në të tria vetat, në njëjës e në shumës:

1) Me përjashtim të foljeve *ziej*, *përziej*, *ndiej* dhe *ndej*: *zieni!*, *përzieni!*, *ndieni!*, *ndjeni*. Shih edhe «Drejtshtkrimi i gjuhës shqipe» § 13 b, e, ç.

2) E pakryera e trajtës veprare, si edhe e tashmja e e pakryera e trajtës joveprore formohen nga tema e vetës së dytë shumës të së tashmes dëftore, p.sh.: (unë) **ndjek** — (ju) **ndiqni**; e pakr.: *ndiqja*, *ndiqje*, *ndiqte*...; e tashme pësore: *ndiqem*, *ndiqesh*, *ndiqet*...; e pakryer pësore: *ndiqesha*, *ndiqeshe*, *ndiqej*... etj.

*nxirrja, nxirrje, nxirrte...* (dhe jo *nxjerrja, nxjerrje...*); *vilja, vilje, vilte...* (dhe jo *vjelja, vjelje...*) etj.; po kështu:

<i>blija, dilja</i>	dhe jo	<i>bleja, delja</i>
<i>blije, dilje</i>	» »	<i>bleje, delje</i>
<i>blinte, dilte</i>	» »	<i>blente, delte</i>
<i>blinim, dilnim</i>	» »	<i>blenim, delnim</i>
<i>blinit, dilnit</i>	» »	<i>blenit, delnit</i>
<i>blinin, dilnin</i>	» »	<i>blenin, delnin etj.;</i>

po kështu:

*blihet, dilet* dhe jo *blehet, delet etj.,*

por:

*merrja, merrjë, merrte, mernim, merrnit, merrnin,*

dhe jo: *mirrja, mirrje, mirrte, mirrnim, mirrnit, mirrnin;*

po kështu:

*merrem, merresh, merret, merremi, merreni, merren;*

*merresha, merreshe, merrej, merreshim, merreshit, merreshin*

dhe jo: *mirrem, mirresh, mirret...; mirresha, mirreshe, mirrej...*

§ 96. Foljet *fle, ngre, lë, vë, zë, nxë, di, pi, rri*, si folje të zgjedhimit të tretë, nuk marrin asnjë mbaresë në të tria vetat e njëjësit të kohës së tashme:

(unë, ti, ai) *fle, ngre, di, pi, rri etj.*

dhe jo: (unë) *flej, ngrej, dij, pij, rrij;*

(ti, ai) *flen, ngren, din, pin, rrin.*

Këto folje në vetën e parë e të tretë të shumësit të së tashmes së dëftores e të lidhores marrin mbaresat **-më, -në** (dhe jo **-jmë, -jnë**):

(ne) *flemë, ngremë, dimë, pimë, rrimë etj.*

(ju) *flini, ngrini, dini, pini, rriini etj.*

Trajta si *flejme, ngrejme, dijme, pijme, rrijme etj., flejnë, ngrejnë dijnë, pijnë, rrijnë etj.* janë dialektore dhe duhen mënjanuar nga gjuha

letrare<sup>1)</sup>. Kjo duhet pasur parasysh edhe për trajtat e lidhore: *të fle, të flemë, të flenë* etj. dhe jo *të flej, të flejmë, të flejnë*.

§ 97. Foljet *eci, iki, hipi*, në numrin njëjës zgjedhohen në këtë mënyrë:

(unë) *eci, iki, hipi*;  
(ti, ai) *ecën, ikën, hipën*

dhe jo: (unë, ti, ai) *ec, ik, hip*,  
as: (unë) *ecij, ikij, hipij*.

§ 98. Në vetën e dytë të njëjësit të së tashmes të trajtës joveprore të gjitha foljet marrin mbaresën *-esh/-hesh*. Trajtat që përdoren herë-herë pa këtë mbaresë, janë dialektore dhe përbëjnë shkelje të normës së sotme letrare. Pra:

(ti)	<i>dukesh</i>	dhe jo	<i>duke</i>
»	<i>lagesh</i>	» »	<i>lage</i>
»	<i>prekesh</i>	» »	<i>preke</i>
»	<i>tallesh</i>	» »	<i>talle</i>
»	<i>largoresh</i>	» »	<i>largohe</i>
»	<i>shqetësoresh</i>	» »	<i>shqetësohe</i>
»	<i>zemëroresh</i>	» »	<i>zemërohe</i> etj.

§ 99. Në vetën e tretë të njëjësit të së pakryerës të trajtës joveprore të gjitha foljet marrin mbaresën *-ej/-hej*. Në vend të kësaj mbarese herë-herë përdoret gabimisht mbaresa *-esh/-hesh* e vetës së dytë

1) Nën ndikimin e këtyre foljeve të zgjedhimit të tretë, edhe disa folje të zgjedhimit të parë, si *blej, fshij, ngrij, vij, fryj*, përdoren herë-herë gabimisht pa mbaresën *-j* në vetën e parë të njëjësit dhe me mbaresat *-më, -në* (në vend të *-jmë, -jnë*) në vetën e parë e të tretë të shumësit të së tashmes, p.sh.:

(unë) *ble, fshi, ngri, vi, fry*;

(ne) *blemë, fshimë, ngrimë, vimë, frymë*;

(ata) *blenë, fshinë, ngrinë, vinë, frynë*.

Këto trajta të gabuara duhen mënjeluar nga gjuha letrare. Për shkak të mungesës së *-j-së* trajtat e shumësit mund të ngatërrohen edhe me trajtat përkatëse të së kryerës së thjeshtë: *blemë, blenë* etj. Trajtat e drejta janë: *blejmë, blejnë; fshijmë, fshijnë; ngrijmë, ngrijnë; vijmë, vijnë; fryjmë, fryjnë*

të njëjësit të së tashmes. Këto trajta dialektore duhen mënjanuar nga gjuha letrare. Pra:

(ai)	<i>dukej</i>	dhe jo	<i>dukesh</i>
»	<i>merrej</i>	» »	<i>merresh</i>
»	<i>pyetej</i>	» »	<i>pyetesh</i>
»	<i>tallej</i>	» »	<i>tallesh</i>
»	<i>afrohej</i>	» »	<i>afrohesh</i>
»	<i>lahej</i>	» »	<i>lahesh</i>
»	<i>mendohej</i>	» »	<i>mendohesh</i> etj.

## E KRYERA E THJESHTË

Për përdorimin e trajtave foljore normative të kësaj kohe duhen pasur parasysh vërejtjet e mëposhtme.

§ 100. Një numër foljesh të zgjedhimit të parë në të kryerën e thjeshtë dhe në pjesore e zgjerojnë temën e tyre me bashkëtingëlloren **-t-** ose me grupin **-jt-**, p.sh.:

E tashme	E kryer e thjeshtë	Pjesore
<i>bre-j</i>	<i>brej-ta</i>	<i>brejt-ur</i>
<i>gje-j</i>	<i>gjet-a</i>	<i>gjet-ur</i>
<i>vle-j</i>	<i>vlejt-a<sup>1)</sup></i>	<i>vlejt-ur</i>
<i>hua-j</i>	<i>huajt-a</i>	<i>huajt-ur</i>
<i>lua-j</i>	<i>luajt-a</i>	<i>luajt-ur<sup>2)</sup></i>
<i>mba-j</i>	<i>mbajt-a</i>	<i>mbajt-ur</i>
<i>rua-j</i>	<i>ruajt-a</i>	<i>ruajt-ur</i>
<i>rre-j</i>	<i>rrejt-a</i>	<i>rrejt-ur</i>
<i>vëre-j</i>	<i>vërejt-a</i>	<i>vërejt-ur</i>
<i>di</i>	<i>dit-a</i>	<i>dit-ur</i>
<i>fle</i>	<i>fjet-a<sup>3)</sup></i>	<i>fjet-ur</i> etj.

1) Trajta *vleu* e vetës së tretë njëjës nuk është në pajtim me sistemin e zgjedhimit të kësaj foljeje dhe për këtë arsye nuk duhet mbajtur si normative.

2) Trajta *lojta*, *lojtur* janë dialektore dhe nuk duhen përdorur.

3) Trajta *fleta* është dialektore dhe nuk duhet përdorur.

Nën ndikimin e foljeve të mësipërme herë-herë përdoren gabimisht me temë të zgjeruar edhe një numër foljesh të tjera, kryesisht të zgjedhimit të parë, më **-aj, -ej, -yj, -uaj, -yej**, Foljet që përdoren më shpesh me këtë zgjerim të gabuar janë:

*shaj, blej, kthej, përkthej, mbërthej, shpërblej, shpërthej, zbërthej; fryj, hyj, ndryj, ndyj, pështyj; bluaj, kruaj, paguaj, përshekruaj, shkruaj, shuaj; gërryej, kryej, lyej, ngjyej, përkryej, përlyej, shqyej, thyej* dhe folja *shkas*.

Trajtat e drejta të së kryerës së thjeshtë dhe të pjesores për këto folje janë:

E kryera e thjeshtë			Pjesorja		
<b>shava</b>	dhe jo	<i>shajta</i>	<b>sharë</b>	dhe jo	<i>shajtur</i>
<b>bleva</b>	» »	<i>blejta</i>	<b>blerë</b>	» »	<i>blejtur</i>
<b>ktheva</b>	» »	<i>kthejta</i>	<b>kthyer</b>	» »	<i>kthejtur</i>
<b>përktheva</b>	» »	<i>përkthejta</i>	<b>përkthyer</b>	» »	<i>përkthejtur</i>
<b>mbërtheva</b>	» »	<i>mbërthejta</i>	<b>mbërthyer</b>	» »	<i>mbërthejtur</i>
<b>shpërbleva</b>	» »	<i>shpërblejta</i>	<b>shpërblyer</b>	» »	<i>shpërblejtur</i>
<b>shpërtheva</b>	» »	<i>shpërthejta</i>	<b>shpërthyer</b>	» »	<i>shpërthejtur</i>
<b>zbërtheva</b>	» »	<i>zbërthejta</i>	<b>zbërthyer</b>	» »	<i>zbërthejtur</i>
<b>fryva</b>	» »	<i>fryta,</i> <i>fryjta</i>	<b>fryrë</b>	» »	<i>frytur,</i> <i>fryjtur</i>
<b>hyra</b>	» »	<i>hyjta</i>	<b>hyrë</b>	» »	<i>hyjtur</i>
<b>ndryva</b>	» »	<i>ndryjta</i>	<b>ndryrë</b>	» »	<i>ndryjtur</i>
<b>ndyva</b>	» »	<i>ndyta</i>	<b>ndyrë</b>	» »	<i>ndytur</i>
<b>pështyva</b>	» »	<i>pështyta</i>	<b>pështyrë</b>	» »	<i>pështytur</i>
<b>blova</b>	» »	<i>blojta,</i> <i>bluajta</i>	<b>bluar</b>	» »	<i>blojtur,</i> <i>bluajtur</i>
<b>krova</b>	» »	<i>kruajta,</i> <i>krojta</i>	<b>kruar</b>	» »	<i>krojtur,</i> <i>kruajtur</i>
<b>pagova</b>	» »	<i>paguajta,</i> <i>pagojta</i>	<b>paguar</b>	» »	<i>pagojtur</i> <i>paguajtur</i>
<b>përshkova</b>	» »	<i>përshkruajta,</i> <i>përshkrojta</i>	<b>përshkruar</b>	» »	<i>përshkrojtur,</i> <i>përshkruajtur</i>
<b>shkrova</b>	» »	<i>shkruajta</i> <i>shkrojta,</i>	<b>shkruar</b>	» »	<i>shkrojtur,</i> <i>shkruajtur</i>
<b>shova</b>	» »	<i>shojta,</i> <i>shuajta</i>	<b>shuar</b>	» »	<i>shojtur,</i> <i>shuajtur</i>

rrova <sup>1)</sup>	» »	rrojta rruajta	rruar	dhe jo	rruajtur, rrojtur, por;
rrojta <sup>2)</sup>	dhe jo	rrova	rrojtur	» »	rruar
gërreva	» »	gërreyjta	gërryer	» »	gërreyjtur
kreva	» »	kryejta	kryer	» »	kryejtur
leva	» »	lyejta	lyer	» »	lyejtur
ngjeva	» »	ngjyeyta	ngjyer	» »	ngjyeytur
përkreva	» »	përkryejta	përkryer	» »	përkryejtur
përleva	» »	përlyejta	përlyer	» »	përlyejtur
shqeva	» »	shqyeyta	shqyer	» »	shqyeytur
theva	» »	thyejta	thyer	» »	thyejtur
shkava	» »	shkajta	shkarë	» »	shkajtur

§ 101. Në zgjedhimin e dytë ka një numër foljesh më -l. -ll a -rr të cilat kanë në temë zanoren a ose grupin je, p.sh.: *dal, marr, vjel, sjell, bjerr, nxjerr, tjerr* etj. Në të kryerën e thjeshtë këto folje e ndërrojnë zanoren a ose grupin je në o: *dola, mora, vola, solla*, dhe e ruajnë këtë o të pazbërthyer në ua edhe në numrin shumës, si në trajtën veprorë, ashtu edhe në trajtën joveprorë, p.sh.:

<b>dal</b>	<i>dola</i> <sup>3)</sup>		
	<i>dolëm</i>	dhe jo	<i>dualëm</i>
	<i>dolët</i>	» »	<i>dualët</i>
	<i>dolën</i>	» »	<i>dualën</i>
<b>marr</b>	— <i>mora</i>		
	(u) <i>morëm</i>	» »	(u) <i>muarëm</i>
	(u) <i>morët</i>	» »	(u) <i>muarët</i>
	(u) <i>morën</i>	» »	(u) <i>muarën</i>
<b>mjel</b>	— <i>mola</i>		
	<i>molëm</i>	» »	<i>mualëm</i>
	<i>molët</i>	» »	<i>mualët</i>
	<i>molën</i>	» »	<i>mualët</i>
	(u) <i>molën</i> —	» »	(u) <i>mualën</i>

1) Është fjala për foljen *rruaj*.

2) Është fjala për foljen *rroj*.

3) Trajtat me -ll-: *dolla, dollë, dolli, dollëm* etj. sot janë dialektore dhe nuk duhet të përdoren në gjuhën letrare.



<b>vjel</b>	— <i>vola</i>		
	<i>volëm</i>	dhe jo	<i>vualëm</i>
	<i>volët</i>	» »	<i>vualët</i>
	(u) <i>volën</i>	» »	(u) <i>vualën</i>
<b>përcjell</b>	— <i>përcolla</i>	» »	
	(u) <i>përcollëm</i>	» »	(u) <i>përcuallëm</i>
	(u) <i>përcollët</i>	» »	(u) <i>përcuallët</i>
	(u) <i>përcollën</i>	» »	(u) <i>përcua llën</i>
<b>sjell</b>	— <i>solla</i>		
	(u) <i>sollëm</i>	» »	(u) <i>suallëm</i>
	(u) <i>sollët</i>	» »	(u) <i>suallët</i>
	(u) <i>sollën</i>	» »	(u) <i>suallën</i>
<b>bjerr</b>	— <i>bora</i>		
	<i>borëm</i>	» »	<i>buarëm</i>
	<i>borët</i>	» »	<i>buarët</i>
	<i>borën</i>	» »	<i>buarën</i>

Po kështu edhe: *ndjell* — *ndollëm, ndollët, ndollën*; *pjell* — *pollën*; *vjell* — *vollëm, vollët, vollën*; *tjerr* — *torëm, torët, torën* etj.

Të gjitha foljet e përmendura më sipër e ruajnë zanoren **o** të pazbërthyer në **ua** edhe në vetën e tretë të njëjësit në trajtën joveprore të së kryerës së thjeshtë:

<i>u mor</i>	dhe jo	<i>u muar</i>	
<i>u mol</i>	» »	<i>u mual</i>	
<i>u vol</i>	» »	<i>u vual</i>	
<i>u mboll</i>	» »	<i>u mbuall</i>	
<i>u përcoll</i>	» »	<i>u përcuall</i>	
<i>u voll</i>	» »	<i>u vuall</i>	
<i>u çor</i>	» »	<i>u çuar</i>	
<i>u nxor</i>	» »	<i>u nxuar</i>	etj.

§ 102. Foljet e zgjedhimit të dytë me temë më **h** e ruajnë këtë bashkëtingëllore edhe në të kryerën e thjeshtë dhe në vetën e parë e të dytë të njëjësit marrin pas saj mbaresat vetore **-a, -e**. Trajtat pa **h** dhe me mbaresat **-va, -ve**, që përdoren nganjëherë nën ndikimin e foljeve me temë më zanore, janë të gabuara dhe nuk duhen lejuar në gjuhën letrare, pra:

<i>ftoh</i>	(u) <i>ftoha</i>	dhe jo	(u) <i>ftova</i>
	(u) <i>ftohe</i>	» »	(u) <i>ftove</i> <sup>1)</sup>
<i>kreh</i>	(u) <i>kreha</i>	» »	(u) <i>kreva</i>
	(u) <i>krehe</i>	» »	(u) <i>kreve</i>
<i>mpreh</i>	(u) <i>mpreha</i>	» »	(u) <i>mpreva</i>
	(u) <i>mprehe</i>	» »	(u) <i>mpreve</i>
<i>ngroh</i>	(u) <i>ngroha</i>	» »	(u) <i>ngrova</i>
	(u) <i>ngrohe</i>	» »	(u) <i>ngrove</i>
<i>nxeh</i>	(u) <i>nxeha</i>	» »	(u) <i>nxeva</i>
	(u) <i>nxehë</i>	» »	(u) <i>nxeve</i>
<i>rrah</i>	(u) <i>rraha</i>	» »	(u) <i>rrava</i>
	(u) <i>rrahe</i>	» »	(u) <i>rrave</i>
<i>shkreh</i>	(u) <i>shkreha</i>	» »	(u) <i>shkreva</i>
	(u) <i>shkrehe</i>	» »	(u) <i>shkreve</i> etj.
po kështu:			
<i>njoh</i>	(u) <i>njoha</i>	dhe jo	(u) <i>njojta</i>
	(u) <i>njohe</i>	» »	(u) <i>njojte</i>
	<i>u njoh</i>	» »	<i>u njojt</i> etj.

## MËNYRA LIDHORE

Për përdorimin e drejtë të trajtave të lidhore është e nevojshme të kihen parasysh disa formime jonormative që vihen re në raste të ndryshme.

1) Trajtat (u) *ftova*, (u) *ftove* janë e kryera e thjeshtë e foljes *ftoj*, prandaj veçanërisht për këtë rast duhet pasur kujdes që ato të mos përdoren në vend të trajtave të së kryerës së thjeshtë të foljes *ftoh*, pasi mund të lindin edhe keqkuptime.

§ 103. Veta e dytë njëjës e së tashmes së foljeve të zgjedhimit të parë formohet me anë të mbaresës *-sh* dhe jo *-jsh*. Pra:

(ti)	të lash	dhe jo	të lajsh
»	të blesh	» »	të blejsh
»	të vish	» »	të vijsh
»	të mësosh	» »	të mësojsh
»	të punosh	» »	të punojsh
»	të shkosh	» »	të shkojsh
»	të shkruash	» »	të shkruajsh
»	të thyesh	» »	të thyejsh etj.

§ 101. Trajta e vetës së tretë njëjës të së tashmes së lidhores te të gjitha foljet, pa përjashtim, del më *-ë* fundore<sup>1)</sup>:

*të lajë, të blejë, të dijë, të punojë, të hyjë, të shkruajë, të thyejë; të humbë, të kapë, të dalë, të vjelë, të sjellë, të shkasë, të heshtë, të nxjerrë* etj.

Veta e dytë njëjës e foljeve të zgjedhimit të dytë formohet me mbaresën *-ësh*:

*të hapësh, të lidhësh, të sjellësh, të korrësh* etj.

Prandaj trajtat më *-i* e *-ish*, që përdoren mjaft herë për vetën e tretë e të dytë të foljeve me temë më bashkëtingëllore, janë në kundërshtim me normën letrare të sotme. Pra duhet:

(ai)	të lidhë	dhe jo	të lidhi
»	të dalë	» »	të dali
»	të vjelë	» »	të vjeli
»	të hapë	» »	të hapi
»	të heqë	» »	të heqi
»	të marrë	» »	të marri
»	të nxjerrë	» »	të nxjerri
»	të flasë	» »	të flasi
»	të vendosë	» »	të vendosi
»	të vrasë	» »	të vراسi
»	të zbresë	» »	të zbresiti
»	të heshtë	» »	të heshtiti
»	të matë	» »	të mati etj.

1) Te foljet me temë në bashkëtingëllore (si të humbë) kjo ë është mbaresa vetore, ndërsa te foljet me temë më zanore (si të la-jë) mbaresa është -jë.

(ti)	të lidhësh	dhe jo	të lidhish
»	të dalësh	» »	të dalish
»	të ndalësh	» »	të ndalish
»	të mbjellësh	» »	të mbjellish
»	të kapësh	» »	të kapish
»	të heqësh	» »	të heqish
»	të marrësh	» »	të marrish
»	të nxjerrësh	» »	të nxjerrish

§ 105. Trajtat e vetës së tretë të njëjësit të së tashmes së foljeve *lë, vë, zë, përzë, nxë* janë:

(ai)	të lërë	dhe jo	të lëjë
»	të vërë	» »	të vëjë
»	të zërë	» »	të zëjë
»	të përzërë	» »	të përzëjë
»	të nxërë	» »	të nxëjë

por:

(ai)	të flejë	» »	të flerë
»	të ngrëjë	» »	të ngrerë

§ 106. Meqenëse trajta e së ardhshmes formohet nga e tashmja e lidhore duke marrë pjesëzën **do** (*do të punoj < do + të punoj*), ato që u thanë në §§ 103-105, vlejné edhe për trajtën e së ardhshmes, d.m.th. duhet:

(ti)	<i>do të lash</i>	» »	<i>do të lajsh</i>
»	<i>do të blesh</i>	» »	<i>do të blejsh</i>
»	<i>do të shkosh</i>	» »	<i>do të shkojsh</i> etj.
(ai)	<i>do të hapë</i>	» »	<i>do të hapi</i>
»	<i>do të dalë</i>	» »	<i>do të dali</i>
»	<i>do të flasë</i>	» »	<i>do të flasi</i> etj.
»	<i>do të lërë</i>	» »	<i>do të lëjë</i>
»	<i>do të vërë</i>	» »	<i>do të vëjë</i>
»	<i>do të përzërë</i>	» »	<i>do të përzëjë</i> etj.

## MËNYRA HABITORE

§ 107. Siç dihet, e tashmja e habitores formohet nga tema e pjesores (pjesorja pa prapashtesën), së cilës i ngjitet folja *kam* në vetën përkatëse, p.sh.: *ble(rë) + kam > blekam, hap(ur) + kam > hapkam, shkrua(r) + kam > shkruakam* etj.<sup>1)</sup>

Për këtë arsye foljet e zgjedhimit të parë që në të tashmen kanë në temë zanoren *o*, por që në pjesore e zbërthejmë atë në *ua*, trajtën e habitores duhet ta kenë me *ua*<sup>2)</sup>, pra:

<i>kënduar</i>	—	<i>kënduakam</i>	dhe jo	<i>këndokam</i>
<i>menduar</i>	—	<i>menduake</i>	» »	<i>mendoke</i>
<i>punuar</i>	—	<i>punuaka</i>	» »	<i>punoka</i>
<i>sulmuar</i>	—	<i>sulmuaka</i>	» »	<i>sulmoka</i>
<i>vrapuar</i>	—	<i>vrapuakan</i>	» »	<i>vrapokan</i> etj.

Për të njëjtën arsye grupi *ua* duhet të ruhet edhe te e pakryera e këtyre foljeve:

<i>menduakësha</i>	dhe jo	<i>mendokësha</i>
<i>vrapuakëshin</i>	» »	<i>vrapokëshin</i> etj.

## MËNYRA DËSHIRORE

§ 108. Trajtat e së tashmes së dëshirores formohen nga tema e së kryerës së thjeshtë ose tema e pjesores me anë të mbaresave *-(f)sha, -(f)sh, -(f)të, -(f)shim, -(f)shi, -(f)shin*. Varianti me *-f-i* këtyre mbaresave përdoret kur tema së cilës i ngjiten ato, del më zanore (p.sh.: *shko-fsha, shko-fsh, shko-ftë* etj. — shih më poshtë pikën *a*), ndërsa varianti pa *-f-* përdoret kur kjo temë del më bashkëtingëllore (p.sh.: *kap-sha, kap-sh, kap-të* etj. — shih më poshtë pikat *b,c*).

Rregullat kryesore për formimin e trajtave të dëshirores në gjuhën e sotme letrare janë këto:

- 1) Për fojet që e formojnë pjesoren me prapashtesën *-në*, si *genë, thënë, zënë* etj. (shih edhe më poshtë § 108 pika *ç*) në habitore bie vetëm *ë-ja* fundore e pjesores, ndërsa bashkëtingëllorja *n* ruhet: *genkam, thënkam, zënkam* etj.
- 2) Shih edhe «Drejtshkrimi i gjuhës shqipe» § 16 b.

a) Foljet e klasës së parë e të tretë të zgjedhimit të parë (shih § 85) e formojnë dëshiroren nga tema e së kryerës së thjeshtë<sup>1)</sup>, p.sh.

*laj* (kr. thj. *la-va*): *lafsha, lafsh, laftë, lafshim, lafshi, lafshin; blej* (kr. thj. *ble-va*): *blefsha, blefsh, bleftë, blefshim, blefshi, blefshin;*

*dëfrej* (kr. thj. *dëfre-va*): *dëfrefsha, dëfrefsh, dëfrefstë, dëfrefshim, dëfrefshi, dëfrefshim;*

*fshij* (kr. thj. *fshi-va*): *fshifsha, fshifsh, fshiftë, fshifshim, fshifshi, fshifshin;*

*punoj* (kr. thj. *puno-va*): *punofsha, punofsh, punoftë, punofshim, punofshi, punofshin;*

*fryj* (kr. thj. *fry-va*): *fryfsha, fryfsh, fryftë, fryfshim, fryfshi, fryfshin;*

*ndiej* (kr. thj. *ndje-va*): *ndjefsha, ndjefsh, ndjefstë, ndjefshim, ndjefshi, ndjefshin;*

*shkruaj* (kr. thj. *shkro-va*): *shkrofsha, shkrofsh, shkroftë, shkrofshim, shkrofshi, shkrofshin;*

*lyej* (kr. thj. *le-va*): *lefsha, lefsh, leftë, lefshim, lefshi, lefshin* etj.

b) Shumica e foljeve të tjera, d.m.th. foljet e zgjedhimit të dytë foljet e klasës së dytë të zgjedhimit të parë, foljet e zgjedhimit të tretë si edhe foljet e parregullta e supletive e formojnë dëshiroren nga një temë që zakonisht është e përbashkët për të kryerën e thjeshtë dhe për pjesoren, p.sh.:

*mund* (*mund-a, mund-ur*): *mundsha, mundsh, mundtë, mundshim, mundshi, mundshin;*

*lidh* (*lidh-a, lidh-ur*): *lidhsha, lidhsh, lidhtë, lidhshim, lidhshi, lidhshin;*

1) Për foljet më -oj, -iej, -uaj, -yej dhe për disa prej foljeve më -ej të kësaj klase, tema e së kryerës së thjeshtë ndryshon nga tema e pjesores (p.sh.: *puno-va* — *punua-r, ndje-va* — *ndie-r, shkro-va* — *shkrua-r, le-va* — *lye-r, dëfre-va* — *dëfrye-r* etj.), ndërsa foljet e tjera kanë një temë të vetme për të tashmen, të kryerën e thjeshtë dhe pjesoren (p.sh.: *la-j, la-va, la-rë; ble-j, ble-va, ble-rë, fshi-j, fshi-va, fshi-rë; fry-j, fry-va, fry-rë* etj.). Për këtë grup foljesh, që është shumë më i vogël se grupi i parë, mund të thuhet se dëshirorja formohet nga tema e përbashkët e së kryerës së thjeshtë dhe e pjesores.

*prek* (*prek-a, prek-ur*): *preksha, preکش, prektë, preکشim, preکشي, preکشin*;

*fal* (*fal-a, fal-ur*): *falsha, falش, faltë, falshim, falshi, falshin*;

*hap* (*hap-a, hap-ur*): *hapsha, hapش, haptë, hapshim, hapshi, hapshin*;

*flas* (*fol-a, fol-ur*): *folsha, folش, foltë, folshim, folshi, folshin*;

*shkas* (*shka-va, shka-rë*): *shkafsha, shkafش, shkafitë, shkafshim, shkafshi, shkafshin*;

*qëndis* (*qëndis-a, qëndis-ur*): *qëndissha, qëndisش, qëndistë, qëndisshim, qëndisshi, qëndisshin*;

*mat* (*mat-a, mat-ur*): *matsha, matش, mattë, matshim, matshi, matshin*;

*ujit* (*ujit-a, ujit-ur*): *ujitsha, ujitش, ujittë, ujitshim, ujitshi, ujitshin*;

*gjej* (*gjet-a, gjet-ur*): *gjetsha, gjetش, gjettë, gjetshim, gjetshi, gjetshin*;

*mbaj* (*mbajt-a, mbajt-ur*): *mbajtsha, mbajtش, mbajttë, mbajtshim, mbajtshi, mbajtshin*;

*di* (*dit-a, dit-ur*): *ditsha, ditش, dittë, ditshim, ditshi, ditshin*;

*fle* (*fjet-a, fjet-ur*): *fjetsha, fjetش, fjettë, fjetshim, fjetshi, fjetshin* etj.

**Shënim.** Siç shihet edhe nga shembujt e mësipërm, foljet me temë më bashkëtingëlloret **d, t** nuk marrin ë midis temës e mbaresës në trajtën e vetës së tretë të njëjësit të dëshirores:

(a)	<i>bindtë</i>	dhe jo	<i>bindët</i>
»	<i>mundtë</i>	» »	<i>mundët</i>
»	<i>rendtë</i>	» »	<i>rendët</i>
»	<i>shkundtë</i>	» »	<i>shkundët</i>
»	<i>tundtë</i>	» »	<i>tundët</i> etj.
»	<i>dittë</i>	» »	<i>ditët</i>
»	<i>gjettë</i>	» »	<i>gjetët</i>
»	<i>mbajttë</i>	» »	<i>mbajtët</i>
»	<i>pyettë</i>	» »	<i>pyetët</i>
»	<i>vajttë</i>	» »	<i>vajtët</i> etj. <sup>1)</sup>

Te këto folje, në trajtat ku **t**-ja ose **d**-ja e temës takohen me **sh-në** e mbaresave të dëshirores, këto bashkëtingëllore shkruhen që të dyja (pa u shkrirë në ç). p.sh.:

*arritsha, arritش, arritshim, arritshi, arritshin* (dhe jo *arriça, arriç, arriçim...*);

1) Shih për këtë edhe «Drejtshtkrimi i gjuhës shqipe» § 34, 35.

*mbajtsha, mbajtsh, mbajtshim, mbajtshi, mbajtshin* (dhe jo *mbajça, mbajç, mbajçim...*);

*gjetsha, gjetsh, gjetshim, gjetshi, gjetshin* (dhe jo *gjeça, gjeç, gjeçim...*);

*pritsha, pritsh, pritshim, pritshi, pritshin* (dhe jo *priça, priç, priçim...*);

*shëtisha, shëtitsh, shëtitshim, shëtitshi, shëtitshin* (dhe jo *shëtiça, shëtiç, shëtiçim...*) etj.;

*mundsha, mundsh, mundshim, mundshi, mundshin* (dhe jo *munça, munçim...*);

*tundsha, tundsh, tundshim, tundshi, tundshin* (dhe jo *tunça, tunç, tunçi...*) etj.

Bëjnë përjashtim trajtat e dëshirores së foljeve *kam* (kr. thjeshtë *pat-a*) dhe *vete* (kr. thjeshtë *vajt-a*, pjes. *vajt-ur*), ku t-ja e temës dhe sh-ja e mbaresës janë shkruar duke dhënë tingullin ç:

*paça, paç, paçim, paçi, paçin; vajça, vajç, vajçim, vajçi, vajçin*<sup>1)</sup>.

c) Foljet e klasës së dytë të zgjedhimit të dytë, që në të kryerën e thjeshtë ndërrojnë zanoret **a, e** ose grupin **je** të temës në **o**, e formojnë dëshiroren nga tema e pjesores:

*dal* (*dol-a, dal-ë*): *dalsha, dalsh, daltë, dalshim, dalshi, dalshin*;

*marr* (*mor-a, marr-ë*): *marrsha, marrsh, marrtë, marrshim, marrshi, marrshin*;

*heq* (*hoq-a, heq-ur*): *heqsha, heqsh, heqtë, heqshim, heqshi, heqshin*;

*vjel* (*vol-a, vjel-ë*): *vjelsha, vjelsh, vjeltë, vjelshim, vjelshi, vjelshin*;

*sjell* (*soll-a, sjell-ë*): *sjellsha, sjellsh, sjelltë, sjellshim, sjellshi, sjellshin* etj.

ç) Te trajtat e dëshirores që formohen nga tema më **-n, -nj** ose **-sh**, bashkëtingëllorja **sh** e mbaresave **-sha, -sh, -shim, -shi, -shin** ndërrohet në **ç, p.sh.**:

*lë* (pjes. *lë-në*): *lënça, lënç, lënçim, lënçi, lënçin*;

*ha* (pjes. *ngrë-në*): *ngrënça, ngrënç, ngrënçim, ngrënçi, ngrënçin*<sup>2)</sup>;

*them* (pjes. *thë-në*): *thënça, thënç, thënçim, thënçi, thënçin*;

*vë* (pjes. *vë-në*): *vënça, vënç, vënçim, vënçi, vënçin*;

*zë* (pjes. *zë-në*): *zënça, zënç, zënçim, zënçi, zënçin*<sup>3)</sup>

1) Shih për këto edhe «Drejtshkrimi i gjuhës shqipe» § 31.

2) Për këtë folje të kihet parasysh se trajtat *hëngërsha, hëngërsh, hëngërt hëngërshim, hëngërshi, hëngërshin*, të formuara nga tema e së kryerës së thjeshtë *hëngr-a*, janë dialektore dhe nuk duhen përdorur në gjuhën letrare.

3) Te pjesoret *lënë, ngrënë, thënë, vënë, zënë*, bashkëtingëllorja **n** i përket prapashtesës dhe jo temës së pjesores. Ashtu si në të tashmen e habitores (shih më lart § 107 shënim), këto folje e ruajnë bashkëtingëlloren **n** edhe në të tashmen e dëshirores.



rri (pjes. ndenj-ur): *ndenjça, ndenjç, ndenjçim, ndenjçi, ndenjçin*;  
 qesh (pjes. qesh-ur): *qeshça, qeshç, qeshçim, qeshçi, qeshçin*;  
 vesh (pjes. vesh-ur): *veshça, veshç, veshçim, veshçi, veshçin* etj.

Nën ndikimin e foljeve të mësipërme përdoren herë-herë gabimisht me mbaresat **-ça, -ç, -çim, -çi, -çin**, edhe trajtat e dëshirores së disa foljeve, tema e të cilave nuk del më **-n, -nj** ose **-sh**, po me një bashkëtingëllore tjetër, p.sh.: *dalça, dalç, dalçim, dalçi, dalçin; folça, folç...; sjellça, sjellç...; marrça, marrç...; kapça, kapç...; lidhça, lidhç...; ndezça, ndezç* etj. Në këto raste, siç u shpjegua më lart, duhen përdorur vetëm mbaresat **-sha, -sh, -shim, -shi, -shin**, pra, trajtat e drejta janë: *dalsha, dalsh, dalshim, dalshi, dalshin; folsha, folsh...; sjellsha, sjellsh...; marrsha, marrsh...;* etj.

## MËNYRA URDHËRORE

§ 109. Mënyra urdhërore ka vetëm vetë të dytë njëjës dhe shumës: (*ti*) *puno!*, (*ju*) *punoni!* Veta e dytë e shumësit të urdhërores është e barabartë me vetën e dytë të shumësit të dëftores: *bëni!*, *hapni!*, *digjni!*, *lani!*, *merrni!*, *ujitni!*, *veproni!*, *vilni!* etj., prandaj ato që u thanë për vetën e dytë të shumësit të dëftores në §§ 93-95, vlejnë edhe për urdhëroren<sup>1)</sup>.

Në vetën e dytë njëjës të urdhërores foljet me temë më **-a, -y, -ua -ye, -ie** marrin mbaresën **-j** (d.m.th. për këto folje veta e dytë e njëjës të urdhërores është e barabartë me vetën e parë të njëjësit të së tashmes së dëftores), p.sh.:

<i>laj duart!</i>	dhe jo	<i>la duart!</i>
<i>mos i çaj ato dru!</i>	» »	<i>mos i ça ato dru!</i>
<i>përçaj e sundo!</i>	» »	<i>përça e sundo!</i>

1) Po i ripërmendim këtu shkurt: foljet e zgjedhimit të dytë me temë më **-t** përdoren në dy trajta: *matni!*, *masni!*; *ujitni!*, *ujisni!*; *bërtitni!*, *bërtisni!*, *flitni!*, *flisni!* etj., nga të cilat trajtë normative kryesore është trajta me **t**; foljet që kanë grupin **-je** ose **-ie** në temë, në vetën e dytë e kthejnë këtë grup në **-i**: *nxirrni!*, *vilni!*, *sillni!*, *bini!* (por *zieni!*, *përzieni!*, *ndieni!*, *ndjeni!*); po kështu edhe: *blini!*, *dini!*, *flini!*, *ngrini!* (nre), *lini!*, *vini!*, *zini!*, *përzini!*, *nxini!*, por: *merrni!* (dhe, jo *mirrni!*).

<i>mos e thaj bukën!</i>	» »	<i>mos e tha bukën!</i>
<i>mos i fryj zjarrit!</i>	» »	<i>mos i fry zjarrit!</i>
<i>mos i ndyj duart!</i>	» »	<i>mos i ndy duart!</i>
<i>më shkruaj më shpesh!<sup>1)</sup></i>	» »	<i>më shkrua më shpesh!</i>
<i>mos e lyej!</i>	» »	<i>mos e lye!</i>
<i>mos e thyej!</i>	» »	<i>mos e thye!</i>
<i>më ziej një vezë!</i>	» »	<i>më zie një vezë etj.</i>

Me -j e kanë trajtën e urdhërores edhe foljet *bëj, gjej e brej<sup>1)</sup>*:

<i>më bëj një kafë!</i>	dhe jo	<i>më bë një kafë!</i>
<i>më gjej një çadër!</i>	» »	<i>më gje një çadër!</i>

Kur këto folje bashkohen me trajtën e shkurtër *më*, mbaresa -j, bie p.sh.:

*lamë një shami!, shkruamë më shpesh!, ziemë një vezë! etj.;*  
*bëmë një kafë!, gjejmë një çadër etj.*

Foljet e zgjedhimit të parë me temë *më -o-, -e-, -i-* në vetën e dytë njëjës të urdhërores nuk marrin mbaresë: *lexo!, mëso! shko!, defre!*  
*mos e këmbel!, mos e kthe!, mos e pëlqe:<sup>2)</sup> fshi! mos e lëpi!, mos e nxi! etj.*

Po kështu, pa mbaresë e kanë urdhëroren edhe foljet e zgjedhimit të tretë si edhe foljet e parregullta e supletive që në vetën e dytë të njëjësit të kësaj mënyre dalin me temë *më -a* ose *-i*: *ha!, fli! ngrit kokën! rri!, ji!, ki!* (dhe jo *haj!, flij! ose flej! pij!, kij!* etj.).

Të gjitha foljet e mësipërme që në urdhërore, duke mos pasur mbaresë, dalin më zanore, kur bashkohen me trajtat e shkurtra përemërore *i, u, ua*, marrin një j për të shmangur takimin e dy zanoreve, p.sh. *lexoje! kije kujdes!, ngrije! piqe!, haji!, këmbeji!, kërkoji!, kthejua!, tregojua etj.*

Këto folje në formën joveprore, për të shmangur takimin e zanores fundore të temës me pjesëzën *u* marrin një *h*: *mendohu!, vizitohu!, kthehu!, fshihu!* etj. (dhe jo *mendou ose mendoju, vizitou ose vizitoju, ktheu ose ktheju*).

1) Po kështu edhe foljet e parregullta *dua, them: duaj!, thuaj!*

2) Te folja *blej* në urdhërore zanorja e e temës ndërrohet në *i*: *blil!, blini!*

§ 110. Foljet me temë më bashkëtingëllore nuk marrin mbaresë në vetën e dytë të njëjësit të urdhërores:

<i>hip!</i>	dhe jo	<i>hipë!</i>
<i>ec!</i>	» »	<i>ecë!</i>
<i>ik!</i>	» »	<i>ikë!</i>
<i>fol!</i>	» »	<i>folë!</i>
<i>thirr!</i>	» »	<i>thirrë!</i>

po kështu: *dil!*, *hap!*, *hidh!*, *merr!*, *sill!*, *shëtit!*, *ujit!* etj. Siç shihet, asnjë folje nuk merr mbaresën -ë në vetën e dytë njëjës të urdhërores<sup>1)</sup>.

Foljet *gërgas*, *ngas*, *shkas*, *vras*, *pres* (*preva*, *prerë*) të klasës së dytë të zgjedhimit të dytë (shih § 85), të cilat e formojnë të kryerën e thjeshtë me mbaresën -va (*gërgava*, *ngava*, *shkava*, *vrava*, *preva*), njësoj si foljet e zgjedhimit të parë, përdoren në urdhërore me dy trajta:

*gërgit!*, *gërgitni!*, *ngit!*, *ngitni!*, *shkit!*, *shkitni!*, *vrit!*, *vritni!*, *prit!*, *pritni!*,

por edhe: *gërگا!*, *gërgani!*, *nga!*, *ngani!*, *vra!*, *vrani!*, *pre!*, *preni!*

§ 111. Foljet *hyj*, *vë*, *zë*, *lë*, *bie*, *shpie*, *shtie* në vetën e dytë të njëjësit të urdhërores e zgjerojnë temën me -r dhe nuk marrin mbaresë<sup>1)</sup>:

*hyr!*, *vër!*, *zër!*, *lër!*, *bjer!*, *shpjer!*, *shtjer!*

Vetën e dytë të shumësit këto folje, ashtu si gjithë të tjerat, e kanë të barabartë me vetën e dytë të shumësit të dëftores, por kur marrin në trup të tyre një trajtë të shkurtër përemërore, veta e dytë e shumësit formohet në bazë të trajtës së njëjësit, d.m.th.:

<i>vër!</i>	( <i>mos e</i> ) <i>vini!</i>	<i>vëreni!</i>
<i>zër!</i>	( <i>mos e</i> ) <i>zini!</i>	<i>zëreni!</i>
<i>lër!</i>	( <i>mos i</i> ) <i>lini!</i>	<i>lërimi!</i>
<i>bjer!</i>	<i>ma bini!</i>	<i>bjermani!</i>
<i>shpjer!</i>	( <i>ia</i> ) <i>shpini!</i>	<i>shpjerjani!</i>
<i>shtjer!</i>	( <i>mos u</i> ) <i>shtini!</i>	<i>shtjeruni!</i>

1) Shih për këtë edhe «Drejtshkrimi i gjuhës shqipe» § 9 gj.

## PJESORJA

§ 112. Trajta e pjesores formohet me anë të prapashtesave -r(ë), -ur, -ë dhe -në:

a) Me prapashtesën -r(ë)<sup>1)</sup> e formojnë pjesoren shumica dërrmuese e foljeve të zgjedhimit të parë, p.sh.:

*larë, tharë, blerë, fshirë, fryrë, hyrë, shtyrë* etj.;

*bluar, punuar, shkruar, thyer, pëlqyer, rrëfyer, shpërblyer* etj., si edhe disa folje të zgjedhimit të dytë e ndonjë folje supletive:

*vrarë, ngarë, shkarë, prerë, parë.*

b) Me prapashtesën -ur e formojnë pjesoren pjesa më e madhe e foljeve të zgjedhimit të dytë, p.sh.:

*hapur, hequr, djegur, mbyllur, nisur, çelur, pjekur, matur, ujitur* etj.,

si dhe foljet e zgjedhimit të parë që në të kryerën e thjeshtë e zgjerohen temën me -t- ose -jt- (shih § 100):

*gjetur, mbajtur, quajtur, vuajtur* etj.; po kështu edhe *ditur*.

c) Me prapashtesën -ë e formojnë pjesoren foljet e zgjedhimit të dytë me temë më -l, -ll a -rr, të cilat në të kryerën e thjeshtë pësojnë ndërrimet **a > o** ose **je > o**, p.sh.:

E tashmja	E kryera e thjeshtë	Pjesorja
<i>dal</i>	<i>dcla</i>	<b>dalë</b>
<i>marr</i>	<i>mora</i>	<b>marrë</b>
<i>mjel</i>	<i>mola</i>	<b>mjelë</b>
<i>vjel</i>	<i>vola</i>	<b>vjelë</b>
<i>mbjell</i>	<i>mbolla</i>	<b>mbjellë</b>
<i>sjell</i>	<i>solla</i>	<b>sjellë</b>
<i>vjell</i>	<i>volla</i>	<b>vjellë</b>
<i>nxjerr</i>	<i>nxara</i>	<b>nxjerrë</b>
<i>tjerr</i>	<i>tara</i>	<b>tjerrë</b> etj.
Po kështu e formon pjesoren edhe folja e parregullt		
<i>bie</i>	<b>prura</b>	<b>prurë</b>

1) Shkrimi ose jo i ë-së është shënuar në kllapa varet nga vendi i theksit në fjalë (shih edhe «Drejtshkrimi i gjuhës shqipe» § 8 k, § 9 e).

ç) Me prapashtesën -në e formojnë pjesoren disa folje të zgjedhimit të tretë e disa folje të parregullta, si:

*lënë, nxënë, vënë, zënë, përzënë, shpënë, shtënë;  
dhënë, rënë, ngrënë, qenë, lënë, thënë.*

§ 113. Vihet re se herë-herë përdoren pjesore të formuara jo sipas rregullave të mësipërme, d.m.th. në kundërshtim me normën letrare të sotme. Në përgjithësi takohen këto dy lloje gabimesh:

1. *Në vend të trajtave normative me -ë, përdoren gabimisht trajta me -ur.*

Siç u shpjegua në pikën c të paragrafit të mësipërm, foljet e zgjedhimit të dytë që mbarojnë me -I, -ll a -rr dhe që në të kryerën e thjeshtë pësojnë ndërrimet  $a > o$  ose  $je > o$ , e formojnë pjesoren me prapashtesën -ë, pra:

(kam)	<b>dalë</b>	dhe jo	<i>dalur</i>
»	<b>marrë</b>	» »	<i>marrur</i>
»	<b>mjelë</b>	» »	<i>mjelur</i>
»	<b>vjelë</b>	» »	<i>vjelur</i>
»	<b>mbjellë</b>	» »	<i>mbjellur</i>
»	<b>përcjellë</b>	» »	<i>përcjellur</i>
»	<b>sjellë</b>	» »	<i>sjellur</i>
»	<b>nxjerrë</b>	» »	<i>nxjerrur</i>
»	<b>tjerrë</b>	» »	<i>tjerrur etj.</i>

Edhe kur hyjnë në përbërjen e paskajores a të përcjellores ose kur përdoren si mbiemra, duke marrë një nyjë të përparme, këto trajta duhet të përdoren vetëm me prapashtesën -ë:

<i>për të dalë,</i>	<i>duke dalë,</i>	<i>i dalë;</i>
<i>për të mbjellë</i>	<i>duke mbjellë</i>	<i>i mbjellë</i>
<i>për të nxjerrë,</i>	<i>duke nxjerrë</i>	<i>i nxjerrë etj.</i>

2. *Në vend të trajtave normative me -ur, përdoren gabimisht trajta me -ë.*

Siç u shtjellua më lart, me prapashtesën -ë e formojnë pjesoren pak folje, të cilat plotësojnë njëkohësisht dy kushte:

1) e kanë temën më -l, -ll a -rr dhe 2) në të kryerën e thjeshtë pësojnë ndërrimet **a > o** ose **je > o**.

Foljet e tjera me temë më -l, -ll a -rr, por që nuk plotësojnë kushtin e dytë (nuk e ndërrojnë në **o** zanoren e temës në të kryerën e thjeshtë), e formojnë pjesoren me prapashtesën -ur. Pra:

E tashmja	E kryera e thjeshtë	Pjesorja		
<i>çel</i>	<i>çela</i>	<b>çelur</b>	dhe jo	<i>çelë</i>
<i>fal</i>	<i>fala</i>	<b>falur</b>	» »	<i>falë</i>
<i>flas</i>	<i>fola</i>	<b>folur</b>	» »	<i>folë</i>
<i>ngel</i>	<i>ngela</i>	<b>ngelur</b>	» »	<i>ngelë</i>
<i>shkul</i>	<i>shkula</i>	<b>shkulur</b>	» »	<i>shkulë</i>
<i>ul</i>	<i>ula</i>	<b>ulur</b>	» »	<i>ulë</i>
<i>vel</i>	<i>vela</i>	<b>velur</b>	» »	<i>velë</i>
<i>mbyll</i>	<i>mbylla</i>	<b>mbyllur</b>	» »	<i>mbyllë</i>
<i>korr</i>	<i>korra</i>	<b>korrur</b>	» »	<i>korrë</i>
<i>tkurr</i>	<i>tkurra</i>	<b>tkurrur</b>	» »	<i>tkurrë</i>
<i>thërres</i>	<i>thirra</i>	<b>thirur</b>	» »	<i>thirrë</i> etj.

Foljet e zgjedhimit të dytë, tema e të cilave mbaron me një bashkëtingëllore tjetër, të ndryshme nga **l**, **ll** ose **rr**, si edhe foljet që në të kryerën e thjeshtë e zgjerojnë temën me -t- ose -jt-, e formojnë pjesoren kurdoherë me prapashtesën -ur (shih edhe pikën *b* të paragrafit të mësipërm). Pra:

(kam)	<b>lidhur</b>	dhe jo	<i>lidhë</i>
»	<b>shmangur</b>	» »	<i>shmangë</i>
»	<b>fikur</b>	» »	<i>fikë</i>
»	<b>ndjekur</b>	» »	<i>ndjekë</i>
»	<b>hapur</b>	» »	<i>hapë</i>
»	<b>nisur</b>	» »	<i>nisë</i>
»	<b>shëtitur</b>	» »	<i>shëtitë</i>
»	<b>gdhendur</b>	» »	<i>gdhendë</i>

(kam)	<b>rritur</b>	dhe jo	<i>rritë</i>
»	<b>vendosur</b>	» »	<i>vendosë</i>
»	<b>gjetur</b>	» »	<i>gjetë</i>
»	<b>mbajtur</b>	» »	<i>mbajtë</i>
»	<b>matur</b>	» »	<i>matë</i> <sup>1)</sup> etj.

Edhe kur hyjnë në përbërjen e paskajores a të përcjellores ose kur përdoren si mbiemra, duke marrë një nyjë të përparme, pjesoret e foljeve të mësipërme duhet të përdoren vetëm në trajtën me **-ur**:

<i>për të çelur,</i>	<i>duke çelur,</i>	<i>i çelur</i>
<i>për të mbyllur,</i>	<i>duke mbyllur,</i>	<i>i mbyllur</i>
<i>për të korrur,</i>	<i>duke korrur,</i>	<i>i korrur</i>
<i>për të lidhur,</i>	<i>duke lidhur,</i>	<i>i lidhur</i>
<i>për të shëtitur,</i>	<i>duke shëtitur,</i>	<i>i shëtitur</i> etj.

## VËREJTJE RRETH DISA FOLJEVE TË PARREGULLTA

§ 114. Në § 89 u përmendën një numër foljesh të parregullta. Po tërheqim vëmendjen te disa trajta jonormative të tyre, që duhen mënjeluar nga gjuha letrare:

### 1. Folja **jap**.

Kjo folje shkruhet me **j-** nistore. Trajtat pa **j-**: (*unë*) *ap*, (*ti*, *ai*) *ep*, (*ne*) *apim*, (*ju*) *epni* (*ose ipni*), (*ata*) *apin* etj. janë dialektore dhe nuk duhen përdorur.

Në disa trajta vetore të kësaj foljeje zanorja **a** e temës **jap** në gjuhën letrare ndërrohet në **e**, po jo në **i**; prandaj trajta të drejta janë:

1) Për këtë arsye edhe mbiemri *i pamatë*, që përdoret nganjëherë në gjuhën e shkruar, është një formim jo i rregullt; duhet: *i pamatur* ose *i pamatshëm*.

(ju) jepni	dhe jo	jipni
(unë) jepja	» »	jipja
(ti) jepje	» »	jipje etj.
(unë) jepem	» »	jipem
(ti) jepesh	» »	jipesh
(ai) jepet	» »	jipet etj.

## 2. Folja ha.

Folja *ha* në të kryerën e thjeshtë bën

*hëngra* dhe jo *hangra*,

ndërsa trajta e pjesores është

(kam) *ngrënë* dhe jo (kam) *hangër*.

## 3. Folja ri.

Kjo folje nuk e zgjeron me -t temën e së kryerës së thjeshtë e të pjesores, pra:

*ndënja* dhe jo *ndenja*  
*ndenjur* » » *ndenjtur*,

## 4. Folja vij.

Trajtat e së kryerës së thjeshtë të kësaj foljeje fillojnë me zanoren e-:

*erdha*, *erdhe*, *erdhi*, *erdhëm*, *erdhët*, *erdhën*.

Trajtat që fillojnë me a, si *ardha*, *ardhe*, *ardhi* etj. janë dialektore dhe nuk duhet të përdoren në gjuhën letrare

Trajta e pjesores së kësaj foljeje fillon përkundrazi, me a-:  
 (kam) *ardhur* dhe jo *erdhur*<sup>1)</sup>.

1) Nga këto del se trajta e drejtë e përshëndetjes është:

*Mirë se erdhe!* dhe jo *ardhe*

*Mirë se erdhët!* » » *ardhët*, por: *mirëseardhje*, sepse kjo fjale

lë përmban emri *ardhje*, që del nga pjesorja *ardhur*.



5. Folja **them**.

Kjo folje në vetën e parë të njëjësit të së tashmes së dëftores ka trajtën

(*unë*) **them** dhe jo *thom*;

po kështu edhe në trajtat e formuara prej saj: *të them, do të them*.

Veta e parë dhe e dytë e njëjësit të së pakryerës janë:

(*unë*) **thosha** dhe jo *thoshja*

(*ti*) **thoshe** » » *thoshje*.

PJESA E DYTË

ÇËSHITJE TË SINTAKSËS



# I. PËRDORIMI I EMRIT NË TRAJTË TË SHQUAR DHE TË PASHQUAR

## TRAJTA E EMRIT TË SHOQËRUAR NGA NJË PËREMËR DËFTOR

§ 1. Në gjuhën letrare emri i shoqëruar nga përemrat dëftorë: *ky, kjo, ai, ajo*, përdoret, si rregull, i pashquar.

Emri i pashquar bashkë me përemrin dëftor që e prin, p.sh.: *ky vend, këto lajme, ajo vajzë, atë ditë, ato vendime*, janë të lidhur ngushtë si nga pikëpamja kuptimore, ashtu edhe nga pikëpamja gramatikore.

Togfjalësha të tillë shprehin një send të përcaktuar, që është afër ose larg folësit: emri i pashquar vetëm emërton klasën e sendeve, kurse përemri e individualizon sendin duke e treguar: *Ai vrapim i çmendur nën mjegull, ato konture të përthyerë si nga dhembjet nuk tregonin veçse armiqësi*. Në gjuhën letrare përemri dëftor përdoret kryesisht me këtë kuptim (tregues, diferencues).

Togfjalëshi *përemër dëftor + emër i pashquar* përdoret në fjali me vlerën e një emri të shquar, bile, në përmendjen e dytë të emrit ata mund të zëvendësojnë njëri-tjetrin:

— Na jetonin dikur në një fshat *ca bletëza* të vogla e punëtore. **Këto Bletëza** (ose **bletëzat**) fluturonin lule më lule e thithnin *polen*. **Këtë polen** (ose **polenin**) e hidhnin. . .

§ 2. Emri i shoqëruar nga përemri dëftor mund të jetë edhe i shquar, kur përemri nuk tregon, po përmend e përforcon atë që shpreh emri, i cili në çdo rast mund të përdoret edhe vetëm: *Ama shpejt i shkiste (ajo) pena e shkretët mbi letër; Ishte rrëgjuar fort (kjo) plaka e Ranxhës dhe mezi mbahej*.

Përemri dëftor përdoret përpara një emri të shquar që tregon:

a) një send për të cilin është folur përpara: *Unë erdha rrotull pranë shtyllave të tribunës, atje ku rrinte e priste ajo vajza.*

b) një send të cilin e kemi para sysh në çastin e ligjëritimit: *Eja ta hamë këtë pjeprin, se e kam ftohur në burim; Le të shkojë edhe Ba-toja me këta djemtë, që të kemi edhe ne një nga brezi ynë.*

c) një send që paraqitet si diçka e njohur prej të gjithëve (emri bën pjesë në një thënie me karakter përgjithësues): *Sa hynin ata, ne nisnim e blegërimin si ata kecat kërthinj, kur u teket për gjë.*

Ndërtime të tilla janë karakteristike për prozën tregimtare të gjuhës së folur. Në gjuhën e shkruar ato hasen në letërsinë artistike, sidomos tek ata shkrimtarë që qëndrojnë më afër gjuhës së folur popullore. Përdorimi i përemrit dëftor para një emri të shquar krahas përdorimit vetëm të emrit të shquar hyn në gjuhën e shkruar letrare si variant norme me vlerë stilistike.

§ 3. Kur togfjalëshat e tipit *përemër dëftor + emër i pashquar* (shih § 1) përcaktohen nga një përemër pronor, sidomos i vetës së parë e i vetës së dytë, ky i fundit emërzohet (merr mbaresat e një emri të shquar): *ky djalë imi, kjo vajzë juaja, këto detyra tonat, këtë artikull tëndin etj.*

*Po faj kishin edhe ata, faj të madh bile, që s'ma përmendën asnjëherë, as me letër, as me njeri, këtë gabim timin; Këto fakte e forcojnë edhe më tepër këtë mendim tonin.*

Përemri pronor i vetës së tretë përdoret zakonisht i emërzuar, po mund të përdoret edhe pa mbaresat e një emri të shquar, pra, si përemër: *Këtë tezë të tyren (ose të tyre) ata e argumentojnë me fakte të shumta; Në këtë veprim të sajin (ose të saj) unë nuk shihja asgjë të keqe.*

Përdorimi i pronorit të vetës së parë e të vetës së dytë si përemër (kjo vajzë juaj, këto detyra tona) përbën shkelje të normës, kurse përdorimet e pronorit të vetës së tretë si përemër (kjo fjalë e tyre) dhe si pronor i emërzuar (kjo fjalë e tyrja) hyjnë në gjuhën letrare si dy variante paralele të normës.

Shënim. Ndërtimi i tipit *ky djalë imi, kjo vajzë jona* nuk duhet të ngatërrohet me ndërtimin *ky djali im, kjo vajza jonë*, ku togfjalëshi *emër i shquar + përemër pronor* paraprihet nga përemri dëftor me kuptim përmendës e përforcues: *Plaku u tregoi me dorë këto viset tona dhe i përqafoi.* Këto dy ndërtime dallohen nga kuptimi dhe përdorimi i tyre stilistik (shih § 2).

## TRAJTA E EMRIT TË SHOQËRUAR NGA NYJA NJË

§ 4. Kur shoqërohet nga nyja *një*, emri përdoret në trajtën e pashquar: *Sapo kishte hapur një mënjollë e vogël karshi diellit; Pas ca ditësh një fshatar ngriti një këngë; Plumbi ciflosi një gur në murin e një shtëpie.*

Kur emri i prirë nga nyja *një* përcaktohet nga një pronor, mund të përdoret në trajtën e shquar dhe në të pashquarën.

1) Emri përdoret në trajtën e shquar, kur përcaktohet nga një përemër pronor: *një shoku im, një vëllai yt* etj., p.sh.:

*Pastaj erdhi një letër nga një miku im; Nga një njeriu ynë morëm vesh se kryekapedani na paska shtënë dashuri me një arnautkë; Atje ai takoi një mikun e tij.*

2) Emri përdoret në trajtën e pashquar, kur pronori përdoret i emëruar: *një mik imi, një mik yni, një vëlla yt, një njeri i saj, një vajzë e tija* etj., p.sh.:

*Një mitraloz yni i ndaloi nazistët të përparonin; Atje ishte një bateri jona; Kisha harruar nën jastëk të hotelit një gazetë shqipe që përmbante një vjershë timen; Partia jonë ka sot një mendim të saj, të qartë, të përcaktuar mirë, për të gjitha problemet e mëdha, të brendshme e të jashtme; Skënderbeu donte të shihte në mes të tyre një njeri të tijin; Tamam në këtë roman armiq të brendshëm nuk kanë një fizionomi të tyre.*

**Shënim 1.** Pronori emërohet, kur përcakton një emër në rasën emërore ose në kallëzore, siç duket qartë në shembujt e dhënë më lart.

**Shënim 2.** Pronori i vetës së tretë mund të përdoret si përcaktor i një emri të pashquar të prirë nga *një* edhe si përemër i paemëruar: *një djalë i tij, një vajzë e saj* etj., p.sh.:

*Këto lajme ai i mori vesh nga një mik i tij (ose nga një mik i tiji, ose nga një miku i tij); Iu kujtua historia e një shoqeje të saj (ose e një shoqes së saj).*

Ndërtimet *një + emër i shquar + përemër pronor dhe një + emër i pashquar + pronor i emëruar (ose pronor i paemëruar kur është në vetën e tretë)* janë variante të normës letrare.

## TRAJTAT E EMRIT TË SHOQËRUAR NGA NJË NUMËROR

§ 5. Në togfjalëshin *numëror + emër* emri përdoret i pashquar, kur togfjalëshi shpreh sasinë e sendeve. Emri i pashquar vetëm emërtot klasën e sendeve, kurse numërori tregon sasinë e tyre: *Në kabinë hyjnë me rrëmbim dy njerëz*

Emri përdoret i shquar, kur togfjalëshi *numëror + emër* shpreh sende në një numër të caktuar; për këto sende është folur më përpara ose ato janë të njohura, qoftë sepse dihen prej të gjithëve, qoftë sepse i kemi parasysh: *Gjenerali, prifti dhe tre shqiptarët u ulën në një tavolinë; U shuan edhe dy lëmshet e zbeta të dritës, që binin mbi truall; Kur turqit nuk do ta përshëndetnin më lindjen e diellit me dymbëdhjetë topat, do të ishte dita e tij.*

## TRAJTA E MBIEMRIT TË EMËRZUAR

§ 6. Mbiemri i emërzuar në kontekst (mbiemër i përdorur në vend të një togfjalëshi *emër + mbiemër*, kur emri është përmendur më përpara ose nënkuptohet) merr trajtën e emrit që zëvendëson: është i shquar, në qoftë se emri në togfjalëshin *emër + mbiemër* do të ishte i shquar; është i pashquar, në qoftë se emri në togfjalëshin *emër + mbiemër* do të ishte i pashquar: *Fletët e verdha era i hidhte herë në njëren anë, herë në tjetrën, kurse të kalburat* (krahaso: *fletët e kalbura*) *mezi lëviznin pak; Ty të rreh mendja ditë e natë të zogjtë e inkubatorit, kur fup të pëlçet sëmundja në të rriturit* (krahaso: *në zogjtë e rritur*); *Me mollë të mira e me të këqija* (krahaso: *me mollë të këqija*) *i hëngrën fëmijët, s'lanë asnjë spurdhjakët; Ka të mirë, po ka dhe më të mirë* (krahaso: *njerëz të mirë*).

Duhet mënjanuar si shmangie nga norma përdorimi i mbiemrit të emërzuar në trajtë të pashquar në raste të tilla, si: *Po tani hapin e parë dhe të dytë e kishte bërë, duhej të bënte edhe të tretin; Djalin e vogël e të madh; Në gjuhën e shkruar dhe të folur*. Në këta shembuj mbiemrat të *dytë, të madh, të folur* nuk janë të bashkërenditur me mbiemrat që kanë përpara, sepse i njëjti hap s'mund të jetë edhe i parë, edhe i dytë, ashtu si edhe i njëjti djalë s'mund të jetë edhe i madh, edhe i vogël. Mbiemrat të *dytë, të madh, të folur* janë përdorur

në vend të togfjalëshave *hapin e dytë, djalin e madh, gjuhën e folur, prandaj duhej të përdroreshin të shquar, pra: hapin e parë dhe të dytin, djalin e vogël dhe të madhin, në gjuhën e shkruar dhe në të folurën.*

§ 7. Është shkelje norme edhe përdorimi i përemrit dëftor para mbiemrit të dytë, kur ky i fundit është mbiemër i nyjshëm. Në shembujt e mëposhtëm: *Në këto raste lufta në mes mendimit të ri dhe atij të vjetër bëhet e ndërlikuar dhe e hollë; Në ndërtesën e vjetër dhe atë të re, s'janë në përputhje me natyrën e gjuhës shqipe, pra janë të gabuar. Përemri dëftor në këto raste është i tepërt, mjafton vetëm të emërohet mbiemri i dytë: në mes mendimit të ri dhe të vjetrit, në ndërtesën e vjetër dhe në të re.*

**Shënim.** Po për arsytet e mësipërme (sepse mbiemrat e panyjshëm nuk janë të bashkërenditur) dhe ndërtimet si: *populli vietnamez dhe kamboxhian, qeveria greke dhe italiane*, nuk janë në përputhje me normën. Po këtu edhe emërimi i mbiemrit të dytë nuk do të sillte qartësi të plotë logjike, sepse *kamboxhiani dhe italiani*, si emra, përdoren për të emërtuar banorin e këtyre vendeve. Kjo është arsyeja që ndërtimet: *populli vietnamez dhe kamboxhiani, qeveria greke dhe italia* nuk përdoren në gjuhën letrare.

Përdorimi i emrit në shumës: *popujt vietnamez dhe kamboxhian, qeveritë greke dhe italiane*, që ndeshet më të rrallë në gjuhën e publicistikës, si ndikim nga gjuhë të tjera, është gjithashtu i gabuar, jo vetëm se është në kundërshtim me rregullën gramatikore të përshtatjes së mbiemrit me emrin që përcakton, siç duket në shembullin e parë, po edhe se logjikisht ndërtime të tilla nuk janë të qarta: shembulli i dytë mund të interpretohet kështu: jo një, po shumë qeveri greke e shumë qeveri italiane.

Në këto raste, qartësia e plotë arrihet, po të përsëritet emri para mbiemrit të dytë: *populli vietnamez dhe populli kamboxhian, qeveria greke dhe qeveria italiane*, ose po të përdoret përemri dëftor para emrit të dytë: *populli vietnamez dhe ai kamboxhian, qeveria greke dhe ajo italiane*.



## II. PËRDO RIMI I FOLJES NË FUNKSIONIN E KALLËZUESIT

### PËRDORIMI I FOLJEVE GJYSMËNDIHMËSE MUND E DUHET PËRPARA NJË FOLJEJE NË LIDHORE

§ 8. Kur folja *mund* qëndron para një foljeje në mënyrën lidhore për të shprehur mundësinë e realizimit të veprimit, përdoret në formën e vetës së tretë njëjës të kohës së tashme të dëftores: *E kush mund ta dijë më mirë se unë se si mund të vihet në mulli pa lënë gjurmë gjëkund?*; *Pa një përkrahje të gjithanshme e të pakursyer të popullit, nuk mund të organizohet ushtria popullore revolucionare*; *Brenda një ore centralisti mund ta kishte pastruar rërën e grumbulluar në jaz nga Përroi i Vogël.*

Në ndërtime të tilla *mund + folje në lidhore* veta dhe koha jepen me foljen në lidhore, kurse folja *mund* përdoret e ngurosur, prandaj duhen quajtur si përdorime që s'janë në përputhje me normën, të gjitha ato raste ku folja *mund* ndryshon sipas vetës dhe kohës: *Në goftë se ne do të mundim të tregojmë me një numër lashtësinë e kafshëve të lartpërmendura, mundim të përpilojmë këtë pasqyrë* (duhet: *Në goftë se mund të tregojmë ... mund të përpilojmë...*); *Po nuk punuam shumë, nuk mundemi të fitojmë flamurin e kuq të shtabit* (duhet: *nuk mund të fitojmë*).

§ 9. Kur folja *duhet* qëndron para një foljeje në mënyrën lidhore për të shprehur domosdoshmërinë e realizimit të veprimit, përdoret në formën e vetës së tretë njëjës të kohës së tashme dhe të së pakryerës.

Përdoret në formën e vetës së tretë njëjës të së tashmes, kur folja në lidhore është në të tashmen dhe në të kryerën: *Puna dhe mendimi duhet t'i kushtohen lumturisë së atdheut dhe të popullit. Duhet të ketë qenë mbarimi i marsit ose fillimi i prillit.*

Përdoret në formën e vetës së tretë njëjës të së pakryerës, kur folja në lidhore është në të pakryerën ose në të kryerën e plotë: *Po në grykat e Labërisë, ku duhej të shkonte Evrenози për të hyrë në kryeqendrën e rebelëve, qëndronte Arianiti...; Kishin ëndrrat e tyre ata dhe duhej t'u ishin përgjigjur.*

Ka raste që në gjuhën e shkruar, ashtu si edhe në gjuhën e folur, përdoret forma e së tashmes *duhet*, kur folja në lidhore është në të pakryerën ose në të kryerën e plotë: *Unë duhet t'ia provoja asaj se sa e madhe ishte dashuria ime. Emrat e tyre duhet të ishin të gjithë të njëllojtë, ashtu si medaljoni që mbanin në qafë...; Këta duhet ta nxjerrin gjetiu fjalën, se këtë gjë duhet ta kishin biseduar më parë; Ajo duhet të mos e kishte bërë atë gabim.* Përdorimi i së tashmes *duhet* në vend të së pakryerës *duhej* në ndërtimet e mësipërme, që, me sa duket, është pasojë e dobësimit të kuptimit kohor të saj, bie në kundërshtim me përshtatjen e kohëve të foljeve në shqipen e sotme letrare.

§ 10. Foljet gjysmëndihmëse *mund* dhe *duhet* janë të lidhura ngushtë me foljen në lidhore si nga ana kuptimore, ashtu dhe nga ana gramatikore, prandaj ato vijnë fill në njëra pas tjetrës. Nuk janë në pajtim me normën ato raste, kur midis foljeve *mund* ose *duhet* dhe foljes në lidhore futet një gjymtyrë tjetër e fjalisë. Kështu, janë të gabuara përdorimet, si: *Është me vend të bëhet një pyetje: a mund garda kombëtare të bënte një grusht shteti pa dëshirën e Pentagonit?* (duhet: *a mund të bënte garda...*); *Në qoftë se mund me të vërtetë në një kohë kaq të shpejtë të ndizet zjarri i diellit në tokë me anë të rripit të ri prej drite, ky do të jetë sukses i madh teknik* (duhet: *Në qoftë se mund të ndizej me të vërtetë në një kohë kaq të shpejtë...*).

## PËRSHTATJA E FOLJEVE-KALLËZUES NË KOHË

§ 11. Problem me rëndësi për strukturën e gjuhës letrare është përshtatja kohore e foljes në mënyrën lidhore me foljen-kallëzues të pjesës kryesore në një fjali të përbërë qëllimore e fthilluese<sup>1)</sup> si edhe me pjesën e parë të kallëzuesit të përbërë që shpreh fillimin ose vazhdimin e veprimit.

1. Në qoftë se pjesa kryesore e ka foljen-kallëzues në të tashmen, në të ardhshmen dhe në të kryerën, folja-kallëzues në lidhore vihet në të tashmen: *Gjatë festave të nëntorit më pëlqen të shkoj në Muzeun e Luftës; Prapë do të fillojnë të përqafohen; PPSH ka kërkuar kurdoherë nga anëtarët e vet të mendojnë, të punojnë e të jetojnë si revolucionarë.*

2. Në qoftë se pjesa kryesore e ka foljen-kallëzues në të pakryerën, në të kryerën e plotë dhe në të kryerën e tejshkuar, folja-kallëzues në lidhore vihet në të pakryerën: *Këtë s'kishtë si ta harronte, sepse zemra e mamasë ishte arma e tij sekrete; Ata vetë ishin nisur nga shtëpia sa kishte filluar të zbardhëllonte, se era ishte larguar dhe Agimit ia kishte qejfi ta fillonte të mbjellët pa rënë dielli.*

3. Në qoftë se folja-kallëzues e pjesës kryesore është në të kryerën e thjeshtë, folja-kallëzues në lidhore mund të jetë:

a) në të pakryerën, kur tregon një veprim që është kryer para çastit të ligjërimit: *Partia forcoi punën edukuese me kooperativistët, me qëllim që ata t'i përqëndronin të gjitha përpjekjet në zhvillimin e ekonomisë së përbashkët; Që të mos u binte në sy, u tërhoq mënjanë.* (Foljet: të përqëndronin dhe të binte, tregojnë veprime që janë kryer para çastit të ligjërimit);

b) në të tashmen, kur tregon një veprim që kryhet në çastin e ligjërimit ose do të kryhet pas këtij çasti: *Aha! Prapë fillove të këndosh, Cucë? Të solla një libër që ta lexosh.* (Folja të këndosh tregon një veprim që kryhet në çastin e ligjërimit, kurse të lexosh një veprim që do të kryhet pas këtij çasti).

---

1) Fjalja e përbërë fthilluese është quajtur edhe periudhë me fjali të varur krye fjalore e kundërinore.

Këtë përshtatje të foljes në kohë po e paraqitim në një pasqyrë përmbledhëse.

Folja-kallëzues e pjesës kryesore	Folja-kallëzues e pjesës së nënrenditur
E tashme ( <i>kërkoj</i> ) E ardhshme ( <i>do të kërkoj</i> ) E kryer ( <i>kam kërkuar</i> )	E tashme e lidhore ( <i>të shkoj</i> )
E pakryer ( <i>kërkoja</i> ) E kryer e plotë ( <i>kisha kërkuar</i> ) E kryer e tejshkuar ( <i>pata kërkuar</i> )	E pakryer e lidhore ( <i>të shkoja</i> )
E kryer e thjeshtë ( <i>kërkova</i> )	E pakryer e lidhore ( <i>të shkoja</i> ) E tashme e lidhore ( <i>të shkoj</i> )

Herë-herë te disa autorë takohen edhe raste të përdorimit të së tashmes së lidhore në vend të së pakryerës, jo vetëm kur folja -kallëzues e pjesës kryesore është në të kryerën e thjeshtë, por edhe kur është në të pakryerën e në të kryerën e plotë: *Që nga ai çast ata filluan ta ndajnë* (duhet: **ta ndanin**) *gjahun që sillte shqiponja në tri pjesë të barabarta; Që atë ditë Vani shkonte shpesh të shikojë* (duhet: **të shikonte**) *kanalin e kthehej t'i rrëfejë* (duhet: **t'i rrëfente**) *të zot se gjer ku kishte arritur; Atij edhe pak qindra metra i kishin mbetur që të kalojë* (duhet: **të kalonte**) *pranë kullës së efendiut; Katundi tregonte se Cenin nuk e kishte parë njeri të shesë* (duhet: **të shiste**) *dhi.*

Siç shihet, e tashmja e lidhore është përdorur në këta shembuj për të shprehur një veprim që është kryer para çastit të ligjërit, që i përket kohës së shkuar. Ky zëvendësim i zvogëlon mundësitë shprehëse të gjuhës letrare, prandaj përdorimi i së tashmes së lidhore në vend të së pakryerës duhet mënjanuar si shkelje e normës.

§ 12. Në fjalitë e përbëra kushtore me lidhëzën *po* folja-kallëzues e pjesës së nënrenditur mund të jetë në të kryerën e thjeshtë të mënyrës dëftore dhe në të gjitha kohët e lidhore: *Po s'e mbajte në dorë pushkën, ta rrëmbejnë fitoren; Po të kesh vullnet, mund të bësh çdo gjë; Po të kenë qenë ndonjëherë në bregun e detit Jon, do ta kenë parë edhe fshatin tim.*

Nën ndikimin e ndërtimeve të ligjërimeve dialektore, hasen në gjuhën letrare fjali të përbëra kushtore me lidhëzën *po*, në të cilat folja-kallëzues e pjesës së nënrenditur është në kohën e tashme, në të pakryerën ose në të kryerën, në vend që të ishte në të kryerën e thjeshtë ose në një nga kohët e mënyrës lidhore: *Po ke (duhet: pate) gjë për të sqaruar, sqaroje kur të jemi të pranishëm edhe ne; Po s'i pëlqente (duhet: të mos i pëlqente) jeta atje, le të mbliidhte fshatin e t'u thoshte se si qëndronte puna; Po kam mbetur (duhet: të kem mbetur) ndonjëherë, ma thoni këtu në shesh.*

Përdorimi i foljes-kallëzues të pjesës së nënrenditur në të tashmen, në të pakryerën ose në çdo kohë të mënyrës dëftore, përveç së kryerës së thjeshtë, duhet mënjanuar nga gjuha letrare, si e shkruar dhe e folur, sepse është në kundërshtim me normën.

§ 13. Në një fjali të përbërë kohore me lidhëzën *kur*, folja-kallëzues e pjesës së nënrenditur duhet të jetë në të tashmen ose në të pakryerën e mënyrës lidhore, në qoftë se folja-kallëzues e pjesës kryesore është në të ardhshmen e dëftores ose në të tashmen e kushtores: *Kur të bjerë dielli, ne do të jemi në vendin e caktuar. Kur të dukeshim ne, ata do të lajmëronin me të shtëna pushkësh.*

Përdorimi i foljes-kallëzues të pjesës së nënrenditur në të ardhshmen e dëftores ose në të tashmen e kushtores në vend të së tashmes ose të së pakryerës së lidhore, si në shembujt e mëposhtëm: *Ne do të jemi duke bërë mësim, kur do të vijë (duhet: të vijë) profesor Jani; Shokët e togës s'dinin gjëra të tilla, që do t'i ndienin vetëm kur do të ktheheshin (duhet: të ktheheshin) nëpër fshatrat e tyre*, nuk është në përputhje me normën e prandaj duhet mënjanuar nga gjuha letrare.

## PËRSHTATJA E KALLËZUESIT ME KRYEFJALËN

§ 14. Në një fjali të përbërë përcaktore me përemrin lidhor që si kryefjalë, folja-kallëzues e pjesës së nënrenditur nuk mund të përshtatet me përemrin lidhor që, meqë ky është i palakueshëm, po me emrin a përemrin që zëvendëson përemri lidhor: **unë që kam, ti që ke, ai që ka, ju që keni** etj., p.sh.:

*Kombinati doli në horizontin e qytetit si ai vapori i madh e i jashtëzakonshëm që shfaqet në liman. Jam unë që për shekuj pranë teje kam ngjyer krodhën e thatë të bukës me gjak e lot. Ty që më gjete mua, të gjettë e mira! Ju jeni si ato erërat e veriut që trazojnë ujërat e pellgjeve në vjeshtë.*

**Shënim.** Në qoftë se përemri lidhor që zëvendëson dy emra të bashkërenditur, kallëzuesi vihet në shumës: *Larg, në shpat, dallohej një shkëmb dhe një shtëpi që rrinia të vetmuar në mes të atij pylli të gjelbër.*

Ka dy mundësi në përshtatjen e kallëzuesit të pjesës së nënrenditur, kur fjala që zëvendëson përemri lidhor, kryen funksionin e kallëzuesorit (përdoret së bashku me foljen *jam*). Ai mund të përshtatet me kallëzuesorin ose me kryefjalën e pjesës kryesore: *Ne jemi njerëzit që ngrejme* (ose *ngrejne*) *uzina, që sheshojme* (ose *sheshojnë*) *male; Ju jeni ata që bëtë* (ose *bënë*) *luftën; Ti je i vetmi që s'do t'ia dësh* (ose *s'do t'ia dījē*) *nga këto gjëra.* Përshtatet me kallëzuesorin, kur si subjekt i veprimit mendohet personi i shprehur nga kallëzuesori; përshtatet me kryefjalën e pjesës kryesore, kur si subjekt i veprimit mendohet personi a personat e shprehur prej kësaj kryefjale.

§ 15. Kur kryefjala është një emër përmbledhës, si rregull, kallëzuesi vihet në njëjës: *E morëm vesh përse keni ardhur, tha fshatari, sot gjithë graria e fshatit këtë punë kishte në gojë; Është ngritur tërë populli në luftë kundër zakoneve prapanike dhe besimeve fetare.*

Po, sidomos, kur kryefjala është një nga këta emra përmbledhës: *bota, njerëzia, djemuria, graria, bagëtia*, kallëzuesi mund të përshtatet edhe sipas formës gramatikore, edhe sipas kuptimit, pra, mund të vihet në shumës: **Bota thoshte** (ose **thoshin**) *se rronte, po shtëpia e qau për së gjalli; Po zbret* (ose **Po zbresin**) *bagëtia nga malet; Si do të më quajë* (ose **quajnë**) *njerëzia pastaj?*

Përdorime të tilla janë të mundshme si variante të normës kryesisht në stilin bisedor.

§ 16. Pas një vargu kryefjalësh të bashkërenditura që numërohen (të lidhura me lidhëzat *e, dhe, edhe* ose pa lidhëza), kallëzuesi vihet në shumës: **Mbrëmja dhe heshtja zbritën qetësisht si një çift lejlekësh; Gjithë pranverën gjenerali, prifti, specialisti shqiptar dhe grupi i punëtorëve të komunes u vërtitën poshtë e përpjetë nëpër kra-hina të ndryshme; Edhe mali, edhe fusha, edhe qielli tregonin se dimri po afrohej.**

Kallëzuesi vihet në njëjës, vetëm në rast se emrat që përdoren si kryefjalë të bashkërenditura, janë sinonime (qoftë edhe kontekstuale), pra, shprehin një objekt ose gjendje të vetme: **Kyçi dhe kryeporta e Shqipërisë ishte tani në duart e armikut (kyçi dhe kryeporta shprehin të njëjtën gjë, përdoren në vend të emrit Krujë); Gjithë jeta, gjithë qenia jonë varet nga përpjekjet tona, nga lufta që ne do të bëjmë për të mbrojtur lirinë, pavarësinë tonë.**

§ 17. Kur kallëzuesi ndodhet para vargut të kryefjalëve homogjene, ai mund të vihet edhe në njëjës, edhe në shumës, pra, mund të përshtatet me kryefjalën e parë që vjen pas tij; ose mund të përshtatet sipas kuptimit me të gjitha kryefjalët. Kështu, në këtë shembull: **Ç'janë ai tym i zi dhe ajo flakë që e bëjnë natën ditë dhe ditën natë?** kallëzuesi mund të përdorej drejt edhe në njëjës: **Ç'është ai tym i zi dhe ajo flakë...** Po kështu, në këta shembuj të tjerë: **Të kujtohet ajo natë janari dhe hija e palëvizshme në dritare?; Dhe haram na qoftë ky bar dhe këta lisa, kjo tokë e këta gurë, po s'ua shtypëm kokën!** kallëzuesi mund të përdorej drejt edhe në shumës: **Të kujtohen ajo natë janari dhe hija e palëvizshme në dritare?; Dhe haram na qofshin ky bar dhe këta lisa...**

§ 18. Në qoftë se vargu i kryefjalëve që nu mërohen, përmbillet nga një përemër në funksionin e një fjale përgjithësuese, kallëzuesi përshtatet me këtë të fundit e jo me vargun e kryefjalëve homogjene: **Toka, muret, xhamat, me një fjalë, gjithëcka dridhej nga bubullimat; Ushtarët, flamurët, kuajt e mbuluar me batanije leshi, qerret, pajimet, devetë e ngarkuara me bronx, mburojat, daullet, gjithëcka e kishte mbuluar pluhuri i dendur.**

§ 19. Ka dy mënyra në përshtatjen e kallëzuesit të një fjalie me kryefjalë homogjene të lidhura me lidhëzën *as . . . , as*. Kallëzuesi mund të vihet në shumës si në këta shembuj: **As unë, as im vëlla nuk e kuptuam përse e bëri këtë; Rri, nënë, se as ti, as babai nuk keni faj. Ylli ngriti kokën, po, sikur të mos ia mbushnin syrin as Shpresa, as i ati, as i vjehri, kërkonte diçka;** ose mund të përshtatet me kryefjalën më të afërt, pra, të vihet në njëjës, në qoftë se kryefjala më e afërt është në njëjës: **As puna, as çdo sakrificë nuk na ka trembur kurrë; Po as njëri, as tjetri nuk ishte nga ata që i tremben armikut.**

Të dyja mënyrat e përshtatjes së kallëzuesit me kryefjalë të tilla janë të mundshme si norma të barasvlershme.

§ 20. Pranë kryefjalësh homogjene të lidhura me lidhëzat: *jo . . . , po as; jo vetëm . . . , po edhe*, kallëzuesi përshtatet me kryefjalën më të afërt: **Jo ju, po askush s'e duron shtypjen; O Gurkë! — thirrri ai duke i treguar me dorë Drinin që tërhiqej zvarë në një vend ku s'e hante jo plumbi, po as dreqi; Jo vetëm, rruga, po edhe era ishte e padurueshme.**

§ 21. Pas kryefjalësh homogjene të lidhura me lidhëza veçuese: *ose, ose . . . , ose; o . . . , o etj.*, kallëzuesi vihet:

a) në vetën e parë shumës, në qoftë se në vargun e kryefjalëve homogjene ka përemër vetor të vetës së parë: **Nuk do të të lëmë vetëm: ose ai, ose unë do të të vizitojmë; S'ka si të bëhet ndryshe: o ti, o unë do të nisemi;**

b) në vetën e dytë shumës, në qoftë se në vargun e kryefjalëve homogjene ka përemër vetor të vetës së dytë (po të vetës së parë jo): **Ai ose ti — kjo s'ka rëndësi — këtë punë do ta kryeni. Dhe do ta kryeni mirë.**

Kallëzuesi përshtatet me kryefjalën më të afërt, në qoftë se në vargun e kryefjalëve homogjene ka vetëm përemra të vetës së tretë ose emra: **Ose ai, ose Agimi do të vijë.**

Kur ndodhet para kryefjalësh homogjene të lidhura me lidhëza veçuese, kallëzuesi përshtatet me kryefjalën më të afërt: **Të nesërmen nuk kishte mbetur në qytet asnjë ushtar turk, a kolonist, a renegat. S'ma merr mendja t'ju këtë zënë syri ose veshi patolog më të mirë se ai.**



## NDËRTIMI PËSOR

§ 22. Quhet kështu ai ndërtim që ka në bazë një folje pësore, p.sh.: *Tirana u çlirua më 17 nëntor 1944*, në të cilin tregohet që veprimin nuk e kryen kryefjala, siç duket qartë në shembullin e mësipërm. Karakteristikë e ndërtimeve të tilla është mosshprehja e vepruesit, ose sepse është një fakt i njohur dhe për këtë arsye s'është nevoja që të përmendet: *Gjurmët e mia të vjetra në kopsht ishin mbuluar* (i kishte mbuluar bora), *Oborri i shtëpisë s'njihej më* (askush s'e njihte); ose sepse folësi nuk e di a nuk do që ta tregojë: *Edhe llampa e qoshes kishte mbetur e thyer dhe atij i kujtohej që ajo ishte thyer po atë natë që kishte ikur Elsa* (s'e di se kush e ka thyer).

Kur duam të vëmë në dukje vepruesin (kush e kryen veprimin), përdorim ndërtimin vepror, që ka në bazë një folje veprore: *Tiranën e çliroi Ushtria Nacionalçlirimtare më 17 nëntor 1944*. Në ndërtimet veprore vepruesin e shpreh kryefjala dhe pësuesin (sendin që pëson veprimin) e shpreh kundrinori i drejtë.

Në gjuhën e sotme të shkruar, më shumë në publicistikë dhe në letërsinë shkencore e teknike, hasen edhe ndërtime pësore me veprues të shprehur me një emër ose përemër me parafjalën nga ose prej, p.sh.: *Po shkuan vitet dhe ky xhaxha s'u kujtua fare prej nënës; Aviatori që varrosur nga vetë fshatarët pranë aeroplanit; Ai u ndihmua nga reforma agrare; Gjatë dy vjetëve të kaluar janë bërë shumë manevra politike prej fuqive të mëdha*.

Këto fjali e të tjera si këto nuk janë në përputhje me strukturën sintaksore të shqipes, ato pasqyrojnë një ndikim të gjuhëve të huaja në gjuhën letrare shqipe, prandaj edhe duken artificiale. Shqipja vepruesin e jep me emër në rasën emërore, që kryen funksionin e kryefjalës, e jo me emër të shoqëruar me parafjalët nga ose prej. Norma letrare e shqipes kërkon që këto fjali të kenë në bazë jo ndërtimin pësor, por ndërtimin vepror: *Po shkuan vitet dhe këtë xhaxha nëna s'e kujtoi fare; Aviatorin e kishin varrosur fshatarët pranë aeroplanit; Atë e ndihmoi reforma agrare; Gjatë këtyre dy vjetëve të kaluar fuqitë e mëdha kanë bërë shumë manevra politike*.

Ndërtimet pësore me veprues të shprehur, meqë nuk janë rezultat i zhvillimit të brendshëm të gjuhës shqipe e meqë nuk shprehin kuptime a ngjytime kuptimore të reja, duhen mënjanuar nga gjuha letrare si ndërtime që s'janë në pajtim me normën. Në këto raste duhet pasur parasysh që vepruesi pranë një foljeje të shprehet me kryefjalën e një ndërtimi vepror.

**Shënim.** Nuk duhet ngatërruar përdorimi i një emri me parafjalën nga os<sup>o</sup> prej pranë një foljeje pësore, që shpreh *vepruesin*, për të cilin u fol më lart, me përdorimin e një emri me këto parafjalë pranë një foljeje pësore, por që shpreh *shkakun*, p.sh.: *Pushtoi me duar një lis të hollë që u hepua nga pesha e tij; Emira u zgjua nga një e trokitur e fortë në derën e dhomës së saj; — E, mor bir? — pyeti plaka, duke shtrënguar buzët që i dridheshin prej pleqërisë.* Ndërtime të tilla janë të zakonshme për të gjitha stilet e gjuhës letrare dhe janë në përputhje me normën.

### III. EMRI DHE PËREMRI NË FUNKSIONIN E KUNDRINORIT

#### PËRDORIMI I EMRIT NË FUNKSIONIN E KUNDRINORIT PRANË NJË EMRI FOLJOR

§ 23. Emri në rasën kallëzore ose dhanore në funksionin e një kundrinori të drejtë a të zhdrejtë varet zakonisht nga një folje: *Flokët e borës, të imtë e të shpeshtë, endnin mbi tokë shtresa të reja*. Është normë përdorimi i kundrinorit pranë një forme të pashtjelluar foljore, që ka në përbërjen e saj një emër foljor asnjandës: *Ne stërvitemi për t'i shërbyer atdheut tonë; Me të marrë letrën, nisuni për në Kurtez; Po, një të nxjerrë kokën, hop ti e kapje*; si edhe pranë ndërtimesh të tilla, si: *mbaroi (pushoi) së punuari tokën, mbaroi së lexuari librin, s'ngopen së pari djalin*.

Po në gjuhën e shtypit të sotëm hasen raste të përdorimit të kundrinorëve pranë emrash foljorë me prapashtesën *-je*: *Mundësitë e gjetjes punë janë të shumta; Ata e kishin organizuar mirë punën për dhënien punonjësve të pushimeve javore. Kryerja e shërbimeve kulturore ullinjve e pemëve frutore...*, *Ata kërkonin dhënien fund shtrenjtësimi të madh të jetesës*. Ndërtime të tilla dalin artificiale e të vështira, shpesh sjellin keqkuptime dhe për këto arsye nuk duhen përdorur. Siç u tha më lart, kundrinori përdoret pranë një foljeje, të shtjelluar ose të pashtjelluar, prandaj, që fjalitë e mësipërme të jenë në përputhje me normën, duhet të kenë në vend të emrit foljor një formë të foljes përkatëse, pra, të shprehen kështu: *Mundësitë për të gjetur punë...*;

*Ata e kishin organizuar mirë punën për t'u dhënë punonjësve pushimet . . . ; T'u kryejmë shërbimet kulturore ullinjve e pemëve frutore; Ata kërkonin t'i jepnin fund shtrenjtësimi të madh të jetës.*

## PËRDORIMI I TRAJTAVE TË SHKURTRA TË PËREMRAVE VETORË

§ 24. Pranë disa foljesh me kuptim kalimtar të zhdrejtë (që pranojnë si kundrinor një emër në rasën dhanore) përdoret krahas trajtës së shkurtër të përemrit vetor në dhanore edhe trajta e shkurtër në kallëzore: **ia arrij qëllimit, ia nis (filloj) punës, ia pëlças gazit, ia kris vrapit, ia dha vrapit (të qeshurit), ia mori këngës, s'ia thotë fare kësaj pune, ia kaloi shokut** etj. Përdorimi i trajtës së bashkuar *ia (i + e)* në këta togfjalësha përbën normë, kurse përdorimi vetëm i trajtës së shkurtër në dhanore: *i arrita qëllimit, i dha vrapit*, përbën shkelje norme.

§ 25. Trajta e shkurtër e përemrit vetor që zëvendëson kundrinorë homogjenë të bashkërenditur të shprehur me emra ose me përemra në njëjës dhe të lidhur me lidhëzat: *e, dhe, edhe, as* ose pa lidhëza, përdoret edhe në njëjës, edhe në shumës.

a) Kur kundrinorët homogjenë ndodhen para kallëzuesit, trajta e shkurtër përdoret zakonisht në shumës, pra, përshtatet sipas kuptimit me kundrinorët homogjenë. Trajta e shkurtër e përemrit vetor vihet në vetën e parë, në qoftë se midis kundrinorëve të bashkërenditur ka një kundrinor të shprehur me përemër vetor në vetën e parë: **Edhe mua, edhe ty, edhe Agimit do të na vlente shumë një këshillë e urtë**; vihet në vetën e dytë, në qoftë se midis kundrinorëve homogjenë ka kundrinor të shprehur me përemër vetor në vetën e dytë (po jo në vetën e parë): **As ty, as Hodos, as Mak Mokrës nuk ju punon truri**; vihet në vetën e tretë, në qoftë se s'ka kundrinorë të shprehur me përemër vetor në vetën e parë e të dytë: **Origjinalitetin, stilin, formen etj. njerëzit tanë të letërsisë dhe të arteve le t'i kërkojnë dhe do t'i gjejnë në radhë të parë në ambientin revolucionar krijues të popullit tonë të talentuar; Palin dhe Gjergjin i kishin përcjellë me urime.**

Por nuk mund të quhen shkelje norme rastet, ndonëse të rralla, kur trajta e shkurtër përshtatet edhe me kundrinorin më të afërt: **Zotësinë dhe shkathtësinë e saj e njohëm edhe ne.**

b) Kur kundrinorët homogjenë ndodhen pas kallëzuesit, trajta e shkurtër mund të përshtatet me kundrinorin më të afërt e të vihet në njëjës: **Puna i përgjigjet vrullit, entuziazmit dhe kërkesës së masave; Ajo e para i shpalli luftë konservatorizmit dhe liberalizmit;** ose mund të përshtatet sipas kuptimit e të vihet në shumës: **Pastaj erdhën mysafirët dhe të gjithë i harruan edhe nusen, edhe dhëndrrin.**

## IV. MBIEMRI DHE EMRI NË FUNKSIONIN E PËRCAKTORIT

### PËRSHTATJA E MBIEMRIT OSE E PËREMRLT QË PËRCAKTON NJË VARG GJYMTYRËSH HOMOQJENE

§ 26. Mbiemri a përemri që përcakton një varg gjymtyrësh homogjene, përshtatet me gjymtyrën homogjene më të afërt: *Aty-këtu nëpër grykat dhe pllajat e zhveshura dukeshin brigada djemsh e vajzash të reja, që po hapnin brezore; Mendja e tij e mpirë nga pagjumësia dhe duhani ishte fundosur në një pëshjtjellim dhe rrëmujë të madhe. Gjithë djemtë dhe vajzat e mia janë me shkollë; Ti duhet të pushosh: trupi dhe mendja jote janë lodhur.*

Po në disa raste, si në shembujt e mëposhtëm: *Mësuesit dhe mësueset që punojnë në kooperativat bujqësore, komunistë dhe pa parti, djem e vasha artdashës, duhet të ndihmojnë në zgjerimin e veprimtarisë artistike në fshat; Sot është dita e dëshmorëve, një ditë e madhe që eopulli ynë ua ka kushtuar bijve dhe bijave të tij më të mirë, më të dashur p më të shtrenjtë; Në sallë janë mbledhur studentët dhe studentet më të mirë; mbiemri është në gjininë mashkullore, si gjinia më përfaqësuese, megjithëse emri pranë tij është në gjinin femërore. Përdorime të tilla janë të pranueshme si variante të mundshme të normës letrare.*

§ 27. Mbiemri në funksionin e kallëzuesorit (mbiemri që lidhet me foljet *jam, kam, bëj* etj.) vihet në gjininë mashkullore, në numrin shumës, në qoftë se gjymtyrët homogjene (kryefjalë ose kundri-

norë të drejtë), të lidhura me lidhëzat shtuese ose pa lidhëza, janë gjinish të ndryshme: *Si Tomori, dhe Gjalica janë barabar të bukur; Ajo edhe syrin, edhe veshin, edhe hundën duhet ta ketë të mprehtë; Këta kooperativistë dhe kooperativiste janë të aftë të luajnë edhe pjesë teatrale.*

## RENDI I PËRCAKTORËVE TË NJË GJYMTYRE

Një emër i përdorur si gjymtyrë fjalie mund të marrë më shumë se një përcaktor. Këta përcaktorë mund të shprehen me mbiemra, me përemër e mbiemër ose me emër, me mbiemër e emër me parafjalë ose pa parafjalë, me emër e me pjesë të nënrenditur përcaktore<sup>1)</sup> etj. Renditja e përcaktorëve të një emri bëhet në bazë të disa rregullave të caktuara.

§ 28. Në qoftë se një gjymtyrë ndiqet nga dy përcaktorë-mbiemra, prej të cilëve njëri është i nyjshëm e tjetri i panyjshëm, vendin e parë e zë përcaktori i shprehur me mbiemër të nyjshëm, të dytin përcaktori i shprehur me mbiemër të panyjshëm: *Si blerimi mbi faqe malesh po mbinte epopeja e lavdishme partizane; Pika e ujit tani po kërciste me një tingull të qartë ritmik.*

Rendi i përkundërt i përcaktorëve të shprehur me mbiemra, si në shembullin e mëposhtëm *Nga larg, fare larg, dëgjohej një zhurmë ritmike e thellë.* është shkelje norme. Ky rend është në përputhje me normën, vetëm kur emri me mbiemrin e panyjshëm emërtojnë një send të vetëm, kanë vlerën e një termi, p.sh.: *kungull ujës i madh, kumbull gjatore e ëmbël, dardhë bishtje e pjekur.*

§ 29. Në qoftë se një gjymtyrë ndiqet nga dy përcaktorë të shprehur njëri me përemër, tjetri me mbiemër ose me emër, vendin e parë e zë përcaktori i shprehur me përemër, të dytin përcaktori i shprehur me mbiemër ose me emër: *Doktori kishte një arsye tjetër të fortë (jo arsye të fortë tjetër) për ta bërë operacionin; Shqipëria jonë socialiste (jo Shqipëria socialiste jonë) po hyn e elektrifikuar në pesëvjeçarin e pestë; Sidoqoftë, si e shpjegoni ju gjendjen time të vësh-*

1) Me termin *pjesë e nënrenditur* do të emërtohen ato ndërtime sintaksore që ndryshe janë quajtur edhe *fjali e varur*.

**tirë shpirtërore** (jo gjendjen e vështirë shpirtërore time); *Kjo është ana tjetër e medaljes* (po të ndryshohet rendi i përcaktorëve në këtë shembull, përemri do t'i kalonte emrit të dytë). *Flluskat e sapunit sajonin ylberë mbi duart tona me kallo.*

Përemri pronor mund të përdoret pas mbiemrit vetëm kur substantivohet: *Kjo është një e drejtë e ligjshme jona, që na e fali koha, jeta, revolucioni; Tani është fjala për një gabim të rëndë tëndin, për këtë folna, — ndërhyri sekretari i partisë.* Ky rend i përmbysur me përemër të substantivuar është brenda caqeve të normës si variant i mundshëm, që përlligjet vetëm kur synohet të theksohet ajo që shprehet nga përemri.

§ 30. Në qoftë se një gjymtyrë ndiqet nga dy përcaktorë të shprehur njëri me mbiemër, tjetri me emër (në rasën gjinore, rrjedhore ose të shoqëruar me parafjalë), vendin e parë e zë përcaktori i shprehur me mbiemër, të dytin përcaktori i shprehur me emër: *Në ajër ndihet kundërmimi i vakët i pranverës; Larg në fushë ishte po ajo bardhësi tronditëse e hënës; Në xhade po kalonte një kope e madhe dhensh; Më kanë thënë se ke bërë një kabinet të mirë fizike!; Kulprat kishin lëshuar lule si topa të bardhë me push.*

Rendi i përkundërt i përcaktorëve në togfjalësja të lirë është në kundërshtim me normën jo vetëm në rastet, si: *krevate prej dërrase dykatëshe, rrathë bakri të trashë*, ku forma e mbiemrit nuk na e bën të qartë se me cilin emër lidhet, po edhe në raste të tilla, si: *valë gëzimi e papritur, vëllimit të punës të nevojshëm*, ku forma e mbiemrit na e tregon qartë lidhjen e tij me emrin e parë.

Vetëm në disa raste e në kushte të caktuara rendi i përkundërt është në përputhje me normën.

a) Përcaktori i shprehur me mbiemër përdoret pas përcaktorit të shprehur me emër në rrjedhore pa parafjalë, kur ky i fundit së bashku me emrin e përcaktuar emërtojnë një send të vetëm, pra, kanë vlerën e një termi: *gjel deti i majmë, vaj peshku i freskët.*

b) Përcaktori i shprehur me mbiemër dhe i zgjeruar me fjalë të tjera përdoret gjithashtu pas përcaktorit të shprehur me emër: *Refleksi të kuqe dritash rrëshqitnin mbi zallin e lumit, të lagur nga shiu; Vështroi me bisht të syrit shenjat e sulmuesit, të mbërthyer në gozhup.* Përdorimi i përcaktorit të zgjeruar para përcaktorit të shpre-



hur me emër ose e bën të paqartë fjalinë; ... *mbi zallin e lagur nga shiu të lumit*, ose e ndryshon kuptimin e saj: ... *shenjat e mbërthyerat në gozhup të sulmuesit*.

c) Përcaktori i shprehur me mbiemër mund të qëndrojë edhe pas përcaktorit të shprehur me emër në rasën gjinore, po vetëm atëherë kur është i substantivuar dhe i veçuar, p.sh.: *Preva degën e pemës, të kalburën* (krahaso: *Preva degën e kalbur të pemës*); *E njuh vajzën e xha Batos, të voglën?* (krahaso: *E njuh vajzën e vogël të xha Batos?*). Një ndërtim i tillë është variant i mundshëm i normës, që përdoret kur duam të vëmë në dukje atë që shprehet nga mbiemri.

§ 31. Në qoftë se një gjymtyrë ndiqet nga dy përcaktorë të shprehur njëri me emër në rasën gjinore, tjetri me emër të prirë nga një parafjalë, ata renditen në këtë mënyrë:

a) Emri me parafjalë vihet i pari, emri në gjinore i dyti, kur gjymtyra prej së cilës varen, shprehet me emër jofoljor: *Shumë gjëra kanë parë muret prej guri të kësaj kulle; Plaku u ishte lutur shumë njerëzve t'i sillnin ca degë nga mollët me famë të Zvirinës; Pyjet me shkurre të bregdetit tonë po zëvendësohen me plantacione agrumesh*.

Shënim. Ka raste, kur për shkak të kuptimit leksikor të përcaktorëve dhe të formës së tyre gramatikore është i mundshëm rendi i përkundërt, si në shembullin e mëposhtëm: *Hëpërhë hante pilafin e mikut me mish pule*. Përmbysja e rendit të përcaktorëve në këtë shembull *pilafin me mish pule të mikut* do të sillte ndryshimin e kuptimit, sepse emri në gjinore do të lidhej me emrin *pule* e jo me emrin *pilafin*.

b) Emri në gjinore vihet i pari, emri me parafjalë i dyti, kur gjymtyra prej së cilës varen, shprehet me emër foljor: *Ata ndihmojnë për përgatitjen e pjesëve teatrale në një nivel të lartë* (jo... *për përgatitjen në një nivel të lartë të pjesëve teatrale*); *Në sytë e tyre dukej dëshira e zjarrtë për plotësimin e detyrave me sukses* (jo... *për plotësimin me sukses të detyrave*). *Vërshimi i lumenjve në fusha...* (jo *vërshimi në fusha i lumenjve...*); *Krasitja e pemëve me thikë...* (jo *Krasitja me thikë e pemëve...*) etj.

Përdorimi i dy përcaktorëve të tillë në shumë raste e bën të vështirë gjuhën, i humbet zhdërvjelltësinë dhe shpesh krijon mundësi për keqkuptime. Prandaj duhen bërë përpjekje që ndërtime të tilla të mënjanohen, kur është e mundshme, duke i zëvendësuar me ndërtime të tjera më të zbërthyer. Rruga më e drejtë që mund të ndiqej

në këto raste, do të ishte zëvendësimi i emrit foljor me një nga format e foljes prej së cilës vjen. Kështu, p.sh., ndërtimi: *Gjatë prerjes në kallëpe të sapunit të rrobave ... mund të jepej më mirë: Kur pritët në kallëpe sapuni i rrobave ...*; fjalia *Ata nuk ishin dakord me vendimin e Shijakut për kërkimin nga Stambolli të një princi turk*, mund të jepej më drejt: *... për të kërkuar nga Stambolli një princ turk*; ose ndërtimi *Sukseset në punën e kolektivit të ndërmarrjes sonë ...* mund të jepej më mirë kështu: *Sukseset që ka arritur në punë kolektivi i ndërmarrjes sonë ...*

§ 32. Në qoftë se një gjymtyrë ndiqet nga një përcaktor i shprehur me emër dhe nga një pjesë e nënrenditur përcaktore, kjo e fundit vjen pas përcaktorit të shprehur me emër: *Një rreze dielli, që futej nga dritarja, e ndante korridorin më dysh me një shirit të shkëlqyer; Edhe pak i duhej për të arritur te komanda e brigadës, që ishte vendosur te kazernat.*

Ndërtime të tilla, si: *U hodhi një vështrim çative, që vezullonin nga dielli, të shtëpive fshatare.*, ku pjesa e nënrenditur përcaktore del përpara përcaktorit të shprehur me emër, nuk janë në përputhje me normën e si të tilla duhen mënjanuar.

## V. PËRDORIMI I NYJAVE, I PARAFJALËVE DHE I PJESËZAVE PARA GJYMTYRËVE HOMOGJENE. FOLJET NDIHMËSE NË KALLË- ZUESIT HOMOGJENË

### PËRDORIMI I NYJAVE PËRPARA GJYMTYRËVE HOMOGJENE

§ 33. Në një varg prej dy gjymtyrësh homogjene, të shprehura me emra në rasën gjinore dhe të lidhura me lidhëzat shtuese *e, dhe, edhe* ose pa lidhëza, nyja përdoret përpara çdo gjymtyre homogjene: *Qysh në hapat e parë në drejtim të Maqedonisë e të Shqipërisë, vërsimet osmane hasën në qëndresën e shqiptarëve; Ne erdhëm që në ditët e para pas meremetimit të rrugës dhe të urës. Çështja e formës, e mjesh-tërisë së poetëve tanë është një temë më vete.*

Mospërdorimi i nyjës para gjymtyrës së dytë homogjene si te fjalia *Nga gryka e Drinos dhe Këlcyrës përparonin njëherësh hijet e natës*, është shkelje norme.

§ 34. Në një varg prej tri ose më shumë gjymtyrësh homogjene të shprehura me emra në rasën gjinore dhe të lidhura me intonacion numërimi (gjymtyra e fundit e vargut mund të jetë e lidhur edhe me lidhëzat *e, dhe*) nyja mund të mos përdoret në gjymtyrën e dytë dhe në të tjerat pas saj për arsye të caktuara kuptimore, stilistike dhe strukturore.

1) Nyja përdoret:

a) kur vihet në dukje ose theksohet gjymtyra e përcaktuar nga vargu i gjymtyrëve homogjene dhe jo ato vetë; përdorimi i nyjës para çdo gjymtyre homogjene jep idenë e lidhjes së ngushtë të se-

cilës prej tyre me gjymtyrën e përcaktuar: *Retë nxitonin nga të gjitha anët për të zbratur sa më shpëjt gjithë sasinë e bubullimave, të breshrit e të ujit që kishin me vete; Sytë e instruktorit, të kryetarit dhe të anëtarëve të tjerë të ekipit u përpoqën me sytë e atij; Në barakën tonë hynte edhe zhurma e shurdhër dhe e mbytur e turbinës, e kaldajës, e oficinës;*

b) kur gjymtyrët homogjene janë të zgjeruara me përcaktorë të shprehur me emra: *Për ata nuk ekziston koncepti i vlerës së kohës së punës, i rendimentit, i disiplinës, i punës së planifikuar.* Mospërdorimi i nyjës *i* para emrit *rendimentit* (... koncepti i vlerës së kohës së punës, rendimentit ...) do ta bënte të paqartë fjalinë, sepse nuk do të kuptohej se me cilin nga emrat që ka përpara, lidhet emri *rendimentit*.

2. Nyja nuk përdoret kur theksohet vargu i gjymtyrëve homogjene: *Mbi komodinën e krevatit është grumbulli i madh i letrave, telegrameve, gazetave dhe revistave të ardhura nga atdheu; Shembulli i mirë i rrethit të Skraparit, Pogradecit e Pukës duhet të përgjithësohet.*

*Shënim.* Në një varg të tillë gjymtyrësh homogjene, në qoftë se para gjymtyrës së dytë nyja ndryshohet (nga *e* ose *së në të*), atëherë ajo duhet të përdoret para gjymtyrës së dytë, po mund të mos përdoret në gjymtyrën e tretë e në të tjera pas saj: *Ishte një ditë e ethshme, ku ishin trazuar si në një vorbull lumi ujërat e shqetësimeve, të pritjeve, anktheve, dashurisë e frikës; Çështja e së drejtës së votës, të fjalës, mbledhjes dhe shtypit u zgjidh tek ne me fitoren e revolucionit popullor.*

## PËRDORIMI I PARAFJALËVE PARA GJYMTYRËVE HOMOGENE

§ 35. Në një varg prej dy ose më shumë gjymtyrësh homogjene, të lidhura me intonacion numërimi ose me lidhëzat *e, dhe*, parafjalët nga, te (tek), në, mbi, nëpër, me, prej, larg, afër etj., mund të përsëriten ose jo për arsye të caktuara kuptimore, stilistike dhe strukturore.

Parafjala përsëritet para çdo gjymtyre homogjene në këto raste:

a) kur çdo gjymtyrë homogjene duam ta vëmë në dukje si diçka më vete: *Vajzat shikonin nga dritaret njerëzit që vinin me makina*

nga Berati, nga Saranda, nga Shkodra, nga Tirana; *Atë ditë shiu rridhte mbi flokët e mi, mbi fytyrën time, mbi yështrimin tim dhe mbi mendimet e mia për atë; Rrugës këmbenin më të rrallë ndonjë fjalë për dëborën, për dimrin në përgjithësi dhe për kujdestarinë e ditës;*

b) kur gjymtyra homogjene para saj është e zgjeruar: *Nëpër pullazet e shtëpive të ulëta, nëpër shkallët e mbledhura e të ngatërruara njëra me tjetrën, nëpër udhët e ngushta bie po ajo ngjyrë gri që vjen nga Budaku.*

Parafjala mund të mos përsëritet para çdo gjymtyre homogjene, kur gjymtyrët homogjene nuk janë të zgjeruara dhe kur midis tyre ka një farë afrie kuptimore, që krijon përshtypjen e diçkaje tërësore. Në këto raste, mungesa e parafjalës, për shkak të afrisë kuptimore dhe të lidhjes së pandërmjetme, nuk sjell paqartësi dhe ngatërrësë: *Këtyre pishtarëve të mëdhenj ë luftës për liri dhe pavarësi kombëtare populli dhe PPSH u ngritën monumentin madhështor në Vlorë; Xhadeja, ura e lumit dhe rruga e zallit ishin mbushur me ushtarë, mushka, kamionë, që lëviznin ngadalë drejt veriut; Tek këndonin, të burgosurit s'donin t'ia dinin për hekura e mure, për gardianë e karabinierë; Ishin shkukur me djem e vajza, me gra e burra, me pleq e plaka, sikur t'u ishte përmbytur fshati nga shirat.*

## PËRDORIMI I PJESËZAVE PARA GJYMTYRËVË HOMOGENË

§ 36. Në një varg kallëzuesish homogjenë të shprehur me folje në mënyrën lidhore, në kohën e ardhshme të mënyrës dëftore dhe në mënyrën kushtore pjesëza të ose do të përsëritet para çdo gjymtyre të vargut: *Të mësojmë, të punojmë, të jetojmë si revolucionarë; Kështu do të vepronte: do të ngrihej, do të vraponte, do të ulej dhe përsëri do të ngrihej, derisa të arrinte te shkëmbi.*

Mospërsëritja e pjesëzës të ose do të në raste të tilla nuk është në përputhje me normën, prandaj shembuj të tillë: *Të nxitim dhe zgjerojmë iniciativat revolucionare; Do të zhvillojmë dhe thellojmë kritikën parimore;* janë të gabuar. Pra, në përputhje me normën e gjuhës letrare, para foljes zgjerojmë duhet të përsëritet pjesëza të (*Të nxi-*

*tim dhe të zgjerojmë . . .)* dhe para foljes *thellojmë* pjesëza *do të* (*Do të zhvillojmë dhe do të thellojmë . . .*).

§ 37. Po kështu, edhe në një varg gjymtyrësh homogjene të shprehura me forma foljore të pashtjelluara (paskajore, përcjellore dhe pjesore mohore) pjesëzat *për të*, *duke* dhe *pa* përsëriten para çdo gjymtyre të vargut: *Shumë net me radhë u mbloodhën ata për ta pleqëruar këtë punë dhe për të gjetur një zgjidhje; Mjegulla herë ngjitej e herë zbriste nëpër pllajat e pjerrëta duke mbuluar një copë vend e duke zbuluar një tjetër; Pa luftuar dhe pa dërdhur gjak nuk fitohet liria.*

Fjali të tilla, si: *Një turmë malësorësh doli prej andej dhe u hodh mbi ushtarët duke i dërmuar dhe rrokullisur poshtë; Ajo përdoret zakonisht në sëmundje që duan një kohë të gjatë për t'u kuruar dhe shëruar; Atë natë s'mbeti njeri pa e sharë ose mallëkuar Besimin;* ku pjesëzat: *duke*, *për të* e *pa*, nuk përsëriten para gjymtyrës së dytë homogjene, nuk janë në përputhje me normën.

## PËRDORIMI I FOLJEVE NDIHMËSE NË KALLËZUESIT HOMOGENË

§ 38. Në një varg kallëzuesish homogjenë, të shprehur me folje në kohë të përbëra (e kryer, e kryer e plotë, e kryer e tejshkuar ose e ardhshme e përparme) dhe të lidhur me lidhëzat: *e*, *dhe*, *ose*, folja ndihmëse, si rregull, përsëritet para çdo pjesoreje: *Përse i kishin sjellë dhe i kishin mbyllur këtu?; Kështu kishte qeshur e kishte luajtur fluturakja.*

Po, kur kallëzuesit homogjenë nuk janë të zgjeruar (nuk kanë gjymtyrë të tjera që t'i plotësojnë) dhe kur kanë kuptime të afërta, aq më tepër kur janë sinonime, folja ndihmëse mund të mos përsëritet për të vënë në dukje më shumë veprimin: *Shumë fshatra rreth e rrotull janë djegur dhe braktisur. Retë ishin rënduar e varur mbi briniat e maleve; I ishte mbushur mendja top, pasi e kishte rrahur e shoshitur nga të gjitha anët, se nuk kishte asnjë rrugëdalje tjetër.*

Mospërsëritja e foljes ndihmëse, si në shembullin e mëposhtëm: *Kishte ngrënë darkë dhe ndezur çibukun*, ku nuk kemi të bëjmë me kallëzues homogjenë, po me pjesë të bashkërenditura të një fjalie të përbërë, nuk është në përputhje me normën e prandaj duhet mënjeluar si shkelje e normës. Fjalja e mësipërme duhet të jetë: *Kishte ngrënë darkë dhe kishte ndezur çibukun.*

## VI. PËRDORIMI I DISA PARAFJALËVE, I DISA LIDHËZAVE DHE I DISA FJALËVE LIDHËSE

### Mbi

§ 39. Parafjala *mbi* përdoret pranë një emri për të treguar vendin mbi të cilin ndodh një veprim a gjendet një send:

Vihet re se në gjuhën letrare, sidomos në gjuhën e shtypit, parafjala *mbi* përdoret para një emri të shquar për të treguar objektin për të cilin flitet, diskutohet, shkruhet etj. në vend të parafjalës për: *Po, mendonte Tefta, s'është lehtë t'i thuash vetes komunist, kur nuk di gjë të madhe mbi komunizmin; Do të të pyesë mbi vendin tënd, mbi historinë dhe kulturën e tij; Biseduam gjer vonë mbi çështjet që shtronte para popullit e komunistëve Komiteti Qendror i Partisë; Sidoqoftë, pikëpamjet e tua mbi luftën e paqen, — tha doktor Besimi, — shpeshherë janë të thata.*

Në të gjitha fjalitë e mësipërme parafjala *mbi* është përdorur, pa ndonjë arsye, në vend të parafjalës për. Përdorimi i parafjalës *mbi* në raste të tilla pasqyron një ndikim të gjuhëve të huaja, prandaj është mirë të mënjanohet si një përdorim në kundërshtim me normën. Norma letrare e gjuhës shqipe kërkon që fjalitë e mësipërme të ndërtohen kështu: ... *nuk di gjë të madhe për komunizmin ose rreth komunizmit; Do të të pyesë për vendin tënd, për historinë...*; *Biseduam për të gjitha çështjet ...; Sidoqoftë, pikëpamjet e tua për luftën ...*

## Në drejtim (të)

§ 40. Në publicistikë dhe në letërsinë shkencore e teknike përdoret shpesh lokucioni parafjalor *në drejtim* para një emri në rasën gjinore me kuptim kufizimi. *Është detyrë e shtëpisë së kulturës që të bëjë një punë më të mirë në drejtim të artit dramatik; Ky mendim ka zier edhe për probleme të tjera që kanë shqetësuar repartet e ndryshme, sidomos në drejtim të prodhimit të pjesëve të ndërrimit për orë. Në brigadën tonë është bërë një punë e mirë në drejtim të organizimit të punës.*

Ndërtimet e mësipërme janë në kundërshtim me normën e sotme të gjuhës letrare e prandaj duhen mënjanuar. Në vend të tyre mund të përdoren ndërtime të tjera me parafjalë *për* ose, sipas rastit, me ndonjë tjetër, të cilat janë mjete të gjalla të gjuhës shqipe për të shprehur kuptimin e kufizimit a të lokalizimit. Fjalitë e mësipërme, që të jenë në përputhje me normën, duhet të ndërtohen kështu: ... *që të bëjë një punë më të mirë për artin dramatik; ... sidomos për prodhimin e pjesëve ...; është bërë një punë e mirë për organizimin ....*

**Shënim.** Nuk duhet ngatërruar përdorimi i mësipërm i *në drejtim (të)* me përdorimin e këtij ndërtimi, kur tregon drejtimin e lëvizjes, p.sh.: *Një valë uji shtruar-shtruar po ngjitej fushës përpjetë në drejtim të Semanit.* Ky përdorim nuk është i gabuar, sepse është i lidhur me kuptimin e mirëfilltë leksikor të emrit *drejtim*, po, megjithatë, në gjuhën e letërsisë artistike do të ishte më mirë të përdorej parafjala *drejt*: ... *po ngjitej fushës përpjetë drejt Semanit.*

## Prej

§ 41. Në përdorimet e saj kryesore, parafjala *prej* është sinonimike me parafjalën *nga*. Ato mund të zëvendësojnë njëra-tjetrën, kur përdoren për të treguar:

a) **vend:** *Në fshat erdhi mysafire prej pyllit (nga pylli) qetësia e thellë dhe e trishtuar;*

b) **shkak:** *Ata nuk u trembën as prej shiut (nga shiu), as prej borës (nga bora);*

c) **vepruesin:** *Jashtë shndriste dëbora e rrahur prej diellit (nga dielli);*



ç) kohë: *Atë ditë fryu një erë e tërbuar prej mëngjesi (nga mëngjesi deri në mbrëmje;*

**Shënim.** Në bashkëvajtje me emrat *kohë, ditë, javë, muaj, vit e shekull* (emrat që tregojnë fragment kohe), përdoret vetëm parafjala *prej*: *prej dtësh, që prej dy javësh, prej vitësh; Shiu kishte pushuar prej kohe.*

d) tërësinë prej së cilës veçohet një pjesë: *Shumë prej nesh (nga ne) gjatë kësaj kohe u thinjën.*

Në gjuhën e sotme letrare në të gjitha këto përdorime po zgjerohet përdorimi i parafjalës *nga*, ndërsa ai i parafjalës *prej* po ngushtohet. Prandaj, në të gjitha ndërtimet, ku parafjalët *nga e prej* zëvendësojnë njëra-tjetrën, duhet parapëlqyer përdorimi i parafjalës *nga*, pa e quajtur të gabuar edhe përdorimin e parafjalës *prej*, sidomos në përdorimet e saj si një variant stilistik i parafjalës *nga*: *Nga parcelat e mbjella nga nxënësit (ose prej nxënësve) u morën rendimente të larta.*

§ 42. Nuk është i përligjur përdorimi i parafjalës *prej* para një emri në rrjedhore për të treguar tipar a cilësi, sidomos kur emri i përcaktuar është i pashquar, p.sh.: *Më thoni, ju lutem, a është traditë dhe zakon prej shqiptarësh kjo gjë?; Nuk shkoj shumë dhe në dhomë u fut një burrë nja dyzet vjeç, me pamje prej kapadaiu.* Gjuha shqipe e jep këtë kuptim me emrin në rrjedhore: *traditë dhe zakon shqiptarësh, me pamje kapadaiu*; parafjala *prej* del këtu e tepërt dhe jo në përputhje me natyrën e gjuhës sonë, prandaj përdorimi i saj në ndërtime të tilla duhet mënjanuar si përdorim në kundërshtim me normën.

### Midis, në mes, përmes dhe ndërmjet

§ 43. Parafjala *midis* ngatërrohet shpesh me parafjalët *në mes, përmes* ose *ndërmjet* dhe përdoret kështu në vend të tyre.

Parafjala *midis* përdoret para një emri a përemri në rrjedhore për të treguar hapësirë në mes dy a më shumë sendesh: *Diçka lëvizi midis pemëve; Poshtë dukeshin dhentë dhe midis tyre fshatarët ...; Ajo kurrë nuk ka vënë shenjën e barazisë m'dis lirisë dhe anarkisë.*

Parafjala *midis* e jep këtë kuptim, kur përdoret para një emri

a përemri në shumës ose para dy emrave a përemrave të bashkërenditur në njëjës, siç duket edhe nga shembujt. Kur përdoret para një emri në njëjës, ajo ka kuptimin në mes, përmes; **Midis** (duhet përmes) *bulevardit të madh çau një taksì me ulërimë; Ne mbetëm vetëm midis* (duhet në mes të) *asaj bardhësie të pafund*. Përdorimi i parafjalës *midis* në vend të parafjalëve: *përmes e në mes (të)*, nuk është normë e prandaj duhet mënjanuar.

§ 44. Parafjala *midis* përdoret edhe në vend të parafjalës *ndërmjet*, që shpreh marrëdhënie, bashkëveprim ndërmjet sendesh. Në këta shembuj: *Lidhjet midis shkollës dhe familjes duhet të jenë sa më të ngushta; Midis nesh janë vendosur raporte të drejta*; parafjala *midis* nuk shpreh vend, po marrëdhënie ndërmjet sendesh. Ndonëse të afërta nga kuptimi; është mirë që në përdorimin e tyre këto parafjalë të dallohen. Në shembujt e mësipërm në vend të parafjalës *midis* duhet të përdoret parafjala *ndërmjet*: *Lidhjet ndërmjet shkollës dhe familjes; Ndërmjet nesh janë vendosur raporte të drejta*.

## PËRDORIMI I PËREMËRIT LIDHOR QË

§ 45. Përemri lidhor që vihet në krye të pjesës së nënrenditur përcaktore dhe e lidh këtë me një emër a përemër të pjesës kryesore: *Kombinati doli në horizontin e qytetit si ai vapori* (emri i përcaktuar) *i madh e i jashtëzakonshëm që shfaqet në liman*.

Përemri lidhor që zëvendëson në pjesën e nënrenditur emrin e përcaktuar, po funksioni i tij varet nga marrëdhëniet që ka ai me kallëzuesin e pjesës së nënrenditur. Le të shohim këtë shembull: *Asnjë dritë nuk dukej në shtëpizat që humbnin në mes pemëve*. Emri *shtëpizat* që është gjymtyrë e pjesës kryesore, kryen funksionin e rrethanorit të vendit, kurse përemri lidhor *që*, që e zëvendëson në pjesën e nënrenditur, kryen funksionin e kryefjalës (në vend të tij mund të vihet emri *shtëpizat*, po në rasën emërore: ... *që (shtëpizat) humbnin midis pemëve*).

Në gjuhën letrare përemri lidhor *që* përdoret vetëm në ato raste kur kryen funksionin e kryefjalës dhe të kundrinorit të drejtë, pra, përdoret në vend të një emri në rasën emërore ose në kallëzore pa

parafjalë: *Në çdo çetë kishte nga një celulë partie, që (celula — kryefjalë) përbënte zemrën e saj; Gjaku dhe jeta e djemve që (djemtë — kundrinor i drejtë) rritëm, i përket këtij vendi.*

Ndryshe nga gjuha e folur e popullit, në gjuhën letrare përemri lidhur *që* nuk përdoret në funksionin e një kundrinori të zhdrejtë, të një kundrinori me parafjalë ose të një rrethanori, pra, nuk mund të përdoret në vend të një emri në rasën dhanore ose të një emri me parafjalë. Në këto funksione gjuha letrare përdor përemrin lidhur *i cili* dhe ndajfoljet lidhore *ku* e *kur*: *Në ato male ishte liria, së cilës (dhe jo që) ai i kishte ndenjur gjithnjë besnik; Ata të gjithë ishin shokët e tij, nga të cilët (dhe jo që) as vdekja nuk mund ta ndante; Po aq e madhe është edhe fjetorja, ku (dhe jo që) kanë zënë vend vajzat e mallësisë; Fshati N nuk do të harrojë atë mëngjes të vrenjtur vjeshte, kur (dhe jo që) u mblodh i tëri te sheshi.*

Përdorimi i përemrit lidhur *që* në funksionin e një kundrinori të zhdrejtë, të një kundrinori me parafjalë ose të një rrethanori duhet të mënjanohet si përdorim në kundërshtim me normën. Kështu, shembuj të tillë si këta që do të jepen më poshtë, nuk janë në pajtim me normën, meqë përemri lidhur *që* është përdorur në vend të përemrit lidhur *i cili* e të ndajfoljeve *ku* e *kur* në funksionet që u vunë në dukje më lart: *Pranë shishes së rakisë mbi tavolinë qëndronte edhe një kandil, që (duhej të cilin) i vinte era vajguri; Atëherë si do ta marrë kjo brigadë rendimentin që (duhej për të cilin) është zotuar?; Në mbledhjen e patateve, që (duhej me të cilën) u morën kryesisht të rejtat, u arritën rezultate të mira; S'ka pus, që (duhej ku) të mos ketë qenë ai; Sot, në një vit, në kombinat prodhohet 1,5 herë më shumë se sa është prodhuar që nga viti 1923 që (duhej kur) zë fill industria e trikotazhit në qytetin tonë, deri...*

### Nga ku, prej ku, prej nga

§ 46. Disa herë, sidomos në gjuhën e shtypit, vihet re përdorimi i lokucioneve *nga ku, prej ku, prej nga* (e madje edhe *prej nga ku*), të cilat prijnë pjesë të nënrenditura përcaktore dhe tregojnë vendin nga nis veprimi, p.sh.: *U fut në një të çarë, nga ku ai nuk mundi*

*i të dilte prapë; Kishte zënë vend në krye të shkallëve, prej ku mund të kontrollonte punën; U bënë gardh në buzë të Zallit të Zaranikës, prej nga pritej të largoheshin komunistët; Kishte përforcuar shtigjet, prej nga ku mund të hynte armiku.*

Ndërtime të tilla nuk kanë asnjë mbështetje në gjuhën e folur. Ato nuk përputhen me normën e gjuhës letrare e, prandaj, duhet të mënjanohen. Në gjuhën letrare, në përputhje me gjuhën e gjallë të popullit, ky kuptim shprehet zakonisht me ndajfoljen lidhëse nga, po për një qartësi edhe më të madhe mund të përdoret sipas rastit edhe përemri *i cili* i shoqëruar me parafjalën nga ose prej: *U fut në një të çarë, nga (ose nga e cila) nuk mund të dilte më; Kishte zënë vend në krye të shkallëve, nga mund të kontrollonte punën; U bënë gardh në buzë të Zallit të Zaranikës, nga pritej të largoheshin komunistët; Kishte përforcuar shtigjet nga (ose nga të cilat) mund të hynte armiku.*

### Gjë që, gjë e cila

§ 47. Lokucioni lidhor *gjë që* është karakteristik për publicistikën dhe për letërsinë shkencore: *Ai e dinte shumë mirë këtë, gjë që e bëntë të ishte i qetë.* Nga kuptimi, ndërtimet me *gjë që* janë të afërta me ndërtimet me bashkërenditje që lidhen me lidhëzën dhe të ndjekur nga përemri *kjo* ose togfjalëshi *kjo gjë*: *Agimi ishte gjithnjë në ballë të punës, dhe kjo (= gjë që) ia rriti autoritetin.*

Lokucioni *gjë që* nuk përdoret në gjuhën e popullit dhe në gjuhën e letërsisë artistike. Ai mbetet brenda caqeve të normës vetëm në gjuhën e publicistikës dhe të veprave shkencore. Përdorimi i tij në gjuhën e letërsisë artistike është artificial dhe duhet quajtur shkelje norme.

Nganjëherë, gjithashtu në publicistikë dhe në letërsinë shkencore, vihet re përdorimi i lokucionit *gjë e cila* me vlerën e *gjë që*: *Ajo likuidoi pronën e madhe mbi tokën, gjë e cila shënoi revolucionin e parë në fushën e marrëdhënieve agrare në vendin tonë.* Ky përdorim, që e rëndon stilin, nuk është në pajtim me normën, prandaj nuk duhet përdorur në asnjë stil të gjuhës letrare.

## Apo


§ 48. Në gjuhën letrare lidhëza *apo* përdoret për të lidhur dy gjymtyrë ose dy pjesë homogjene në fjalitë me pyetje të drejtpërdrejtë ose të tërthortë: *Nga padija apo nga uria të ketë ndodhur ky mohim i pemëve frutore në të kaluarën?*; *Do të ikni apo do të rrini përgjithnjë?*; *Ai më pyeti në tallesha me ta apo e kisha me gjithë mend.*

Sidomos në gjuhën e publicistikës, vihet re që lidhëza *apo* përdoret edhe në llojet e tjera të fjalive, dëftore e nxitëse, në vend të lidhëzave *ose, a*: *Jo pa qëllim zgjodha një poemë dhe jo një roman apo (drejt ose, a) dramë; Vetëm në fshatin e madh Sungari nga zjarri i hapur prej policisë reaksionare u vranë apo (drejt ose, a) u plagosën 11 fshatarë; Në çdo skaj të vendit, ku çahen toka të reja apo (drejt ose, a) hapen brezare, jehojnë këngët patriotike.*

Përdorimi i lidhëzës *apo*, në kundërshtim me gjuhën e gjallë të popullit, në vend të lidhëzave *ose, a*, është artificial dhe e rëndon gjuhën. Prandaj duhet quajtur i gabuar përdorimi i lidhëzës *apo* në fjalitë dëftore dhe nxitëse (në fjali të tilla duhet të përdoren lidhëzat *ose, a*). Në çdo stil të gjuhës letrare lidhëza *apo* duhet të përdoret për të lidhur dy gjymtyrë ose dy pjesë homogjene në fjalitë me pyetje të drejtpërdrejtë ose të tërthortë.

PJESA E TRETË

ÇËSHITJE TË FORMIMIT TË FJALËVE



## HYRJE

§ 1. Për ta zotëruar mirë dhe në mënyrë të plotë normën letrare kombëtare është e nevojshme të njihen edhe mënyrat e tipat e formimit të fjalëve në gjuhën e sotme.


Formimi i fjalëve të reja sipas modeleve dhe rregullave të përpunuara nga gjuha përbën rrugën kryesore të pasurimit të fjalorit të shqipes së sotme letrare.

Formimi i fjalëve të reja është gjallëruar shumë sidomos pas Çlirimit, si pasojë e zhvillimit të gjithanshëm të ekonomisë, arsimit, kulturës etj. Janë pasuruar me fjalë të reja veçanërisht ato sfera të leksikut që lidhen me zhvillimin dhe organizimin e prodhimit industrial e bujqësor, me degët e reja të prodhimit, me proceset dhe mjetet e shumëllojshme të punës, me marrëdhëniet e reja në prodhim e në shoqëri, me mënyrën e re të qeverisjes e të jetesës, me ideologjinë socialiste e me botëkuptimin e ri. Shumica dërrmuese e këtyre formimeve të reja janë fjalë të formuara me prapashtesa ose fjalë të përbëra (kompozita). Janë shtuar shumë gjithashtu edhe fjalët e formuara me parashtesa e me mënyra të tjera.

Njohja e tipareve themelore të strukturës fjalëformuese të gjuhës ka rëndësi të dyfishtë: nga njëra anë, për të kuptuar ngarkesën kuptimore, lidhjet reale e të mundshme të fjalës në vargun e vet fjalëformues dhe, nga ana tjetër, për të njohur modelet fjalëformuese të gjalla që veprojnë në shqipen e sotme letrare, në mënyrë që fjalët e reja që formohen, të jenë në pajtim me strukturën fjalëformuese të shqipes dhe me prirjet e sotme të zhvillimit të saj. Njohja e tipave dhe e rregullave të formimit të fjalëve në shumë raste, siç do të vihet në dukje më poshtë, ndihmon edhe për shkrimin e shqiptimit e drejtë të tyre.



Për të kuptuar lidhjet e fjalës në vargun e vet fjalëformues po japim skemën e formimit të fjalëve të prejardhura nga mbiemri *i lirë* në të dyja kuptimet kryesore: 1. që gëzon liri, 2. që nuk kushton shumë.



Nga skema e mësipërme shihet se ngarkesa kuptimore e secilës prej fjalëve të prejardhura nga mbiemri *i lirë* lidhet me kuptimin e fjalës nga e cila ajo ka dalë drejtpërdrejt, megjithëse të gjitha ato kanë në themel kuptimin e mbiemrit *i lirë*. Kjo skemë tregon edhe se si vihen në jetë mundësitë fjalëformuese të gjuhës: në disa raste vargu fjalëformues është më i gjatë e me degëzime, në disa raste më i shkurtër ose vetëm me një gjymtyrë. Kuptimi i parë i mbiemrit *i lirë* jep mundësi për të krijuar një numër më të madh fjalësh të prejardhura në krahasim me kuptimin e dytë të tij. Ky ndryshim kuptimesh bën që për të formuar emrin abstrakt nga mbiemri, për kuptimin e parë përdoret parashtesa **-i**: *lir-i*, ndërsa për kuptimin e dytë parashtesa **-si**: *lirë-si*. Për të dyja këto formime në gjuhë ka modele të gjalla vepruese, p.sh.: *butë-si* (i butë), *egër-si* (i egër), *mirë-si* (i mirë) etj.; *bukur-i* (i bukur), *lumtur-i* (i lumtur), *dashur-i*

(i dashur) etj. Por modelet nuk shfrytëzohen të gjitha plotësisht. Ato plotësohen e pasurohen gjatë zhvillimit historik të gjuhës, së cilës shoqëria i shtron vazhdimisht kërkesa të reja.

Gjuhën e krijojnë dhe e zhvillojnë pikërisht ata që e flasin. Gjuha letrare kombëtare është varianti më i përpunuar i gjuhës së popullit tonë jo vetëm nga ana gramatikore, por edhe nga ana e leksikut dhe e formimit të fjalëve. Sa më mirë e zotërojnë atë masat punonjëse, aq më e gjallë dhe më e vetëdijshme bëhet veprimtaria e tyre krijuese gjuhësore. Më qartë se kudo, kjo veprimtari duket në krijimin e në përdorimin e fjalëve të reja.

## I. SI FORMOHEN FJALËT E REJA NË SHQIPEN E SOTME LETRARE

### NDËRTIMI I FJALËS. NDARJA E FJALËVE SIPAS FORMIMIT TË TYRE

§ 2. Te çdo fjalë dallojmë *temën morfologjike* të saj. *Temë morfologjike* quhet pjesa e fjalës që mbetet duke hequr mbaresën, p.sh.: *mal-i, mal-in, male-ve, male-sh, mik-u, mik-ut, mik-un, miq-ve, miq-sh, artiste-je, artiste-s, artiste-ve, vajzë-n, vajza-sh, përhap-im, përhap-te, lufto-j, lufto-va, ujit-ët, ujit-in* etj.<sup>1)</sup>

Tek ato trajta fjalësh që nuk kanë mbaresë, si edhe te të gjitha pjesët e pandryshueshme të ligjëratës <sup>2)</sup>, tema morfologjike përkon me vetë fjalën, p.sh.: *mal, shok, artist, artiste, përhap, ujit* etj.; *afër, larg, majtas, shpejt, në, për, te, as, dhe, por* etj.

Tema shpreh kuptimin leksikor të fjalës, ndërsa mbaresat shprehin kuptime gramatikore (kuptimin e rasës, të numrit, të trajtës, të vetës etj.).

---

1) Zakonisht tema morfologjike në tekstet shkollore quhet shkurt *temë*. Nga shembujt e mësipërm shihet se emrat që e formojnë trajtën e shumësit me mbaresa, si edhe ata që në këtë numër pësojnë ndërrime fonetike, kanë tema të veçanta për njëjësin dhe për shumësin.

2) Pjesë të pandryshueshme të ligjëratës janë ndajfoljet, parafjalët, lidhëzat, pjesëzat dhe pasthirrat. Ato quhen kështu sepse nuk e ndryshojnë formën e tyre (as lakohen, as zgjedhohen).

Nga pikëpamja e formimit të tyre të gjitha fjalët ndahen në dy grupe: a) *fjalë të parme* dhe b) *fjalë jo të parme*. Janë të parme të gjitha ato fjalë që nuk janë formuar prej temash të fjalëve të tjera, p.sh.: *det, krye, mal, motër, pyll, qytet, i bukur, i kaltër, i ri, e re, një, dy, tre, pesë, tetë, unë, ne, kush, cili, bëm, kap, mbyll, shkruaj, afër, drejt, larg, shpejt* etj. Janë jo të parme të gjitha ato fjalë që janë formuar prej temash të fjalëve të tjera, p.sh.: *detar (det), malësi (mal), dritare (dritë), sulmoj (sulm), sulmues (sulmoj), bukuri, zbukuroj (i bukur), kaltërsi (i kaltër), rini (i ri), njësi (një), pesëshe (pesë), përmbledh (mbledh), vlerësoj (vlerë), mbivlerësoj (vlerësoj), nënshkruaj (shkruaj), rregulloj (rregulloj), kryeqytet (krye + qytet), botëkuptim (botë + kuptim), gjellëbërës (gjellë + bërës), vetëshërbim (vetë + shërbim)* etj.

Tema e një fjale të parme nuk mund të zërthehet më tej në pjesë më të vogla të kuptimshme. Një temë e tillë quhet edhe *temë e thjeshtë* e fjalës (kjo temë në disa tekste quhet edhe *rrënjë* e fjalës).

Tema e fjalëve jo të parme është e zërthyeshme.

a) Në përbërjen e saj dallojmë temën prej së cilës është formuar drejtpërdrejt fjala e dhënë, dhe parashtesën a prapashtesën që ka shërbyer për formimin e kësaj fjale, p.sh. *detar* (det + ar), *malësi* (mal + ësi), *dritare* (dritë + are), *trimëri* (trim + ëri), *afërsi* (afër + si), *afërsisht* (afërsi + sht), *vlerësoj* (vlerë + soj), *mbivlerësoj* (mbi + vlerësoj) etj.

Tema prej së cilës është formuar një fjalë jo e parme quhet *temë fjalëformuese* e asaj fjale. Tema fjalëformuese mund të jetë e thjeshtë (d.m.th. e barabartë me rrënjën), si p.sh. temat fjalëformuese të fjalëve *detar* (det), *dritare* (dritë), *malësi* (mal), *i ndershëm* (nder), *punoj* (punë) etj., por mund të jetë edhe jo e thjeshtë — e ndërtuar prej një teme të thjeshtë dhe një parashtese a prapashtese, si p.sh. temat e fjalëve: *shpërdor* (përdor — nga për + dorë), *fshatarësi* (fshatar — nga fshat + ar), *besnikëri* (besnik — nga besë + nik), *çliroj* (liroj — nga lirë + o-j) etj. Temat fjalëformuese jo të thjeshta përbëjnë shumicën e temave, nga të cilat janë krijuar e krijohen fjalët e reja në gjuhën e sotme shqipe.

Siç shihet edhe nga shembujt e mësipërm, në temën e fjalëve jo të parme dallojmë këto pjesë të kuptimshme: *rrënjën, parashtesën* dhe *prapashtesën*.

*Rrënja* (ose tema e thjeshtë) është ajo pjesë e temës së fjalës që mbetet pasi të hiqen të gjitha parashtesat dhe prapashtesat që mund të ketë tema, p.sh.: *për-hap-je*, *hap-ësirë*; *stër-gjysh*, *stër-gjysh-or*; *mal-ësi*, *mal-or*; *uj-it*, *i uj-shëm*; *bark-as*, *nën-bark-je*; *sh-faq-je*, *shfaq-em*; *pa-rregull-si*, *i rregull-t*; *për-fund-oj*, *fund-or*, *pa-fund-ësi*; *ç-lir-im-tar*, *ç-lir-oj* etj.

*Parashtesa* është një element i kuptimshëm i temës së fjalës, që qëndron para temës fjalëformuese dhe shërben për të formuar fjalë të reja, p.sh.: *mos-besim*, *i pa-aftë*, *i zh-drejtë*, *ç-njerëzor*, *për-hap*, *ndër-pres*, *ri-punoj*, *sh-përdor* etj.

*Prapashtesa* është një element i kuptimshëm i temës së fjalës që qëndron pas temës fjalëformuese dhe shërben për të formuar fjalë të reja, p.sh.: *bes-nik*, *këngë-tar*, *hap-je*, *pun-ishte*, *udhë-to-j*, *djatht-as*, *vendim-tar*, *rrjedhim-isht*, *fshatar-ësi* etj.

Fjalët e formuara me parashtesa a prapashtesa quhen *fjalë të prejardhura*.

b) Një pjesë e fjalëve jo të parme e kanë temën e tyre të përbërë prej dy temash fjalëformuese të veçanta, p.sh.: *kryeqytet* (krye + qytet), *botë-kuptim* (botë + kuptim), *gjellëbërës* (gjellë + bërës), *vetëshërbim* (vetë + shërbim), *vajguri* (vaj + guri), *pesëdhjetë* (pesë + dhjetë), *ndonjëherë* (ndonjë + herë), *menjëherë* (me + një + herë) etj. Këto janë fjalë të përbëra ose të përngjitura (shih më poshtë §§ 30-39). Temat e fjalëve të përbëra ose të përngjitura mund të shërbejnë edhe si tema fjalëformuese. Prej tyre formohen disa herë fjalë të prejardhura me prapashtesa, p.sh.: *kryeqytetas* (kryeqytet + as), *botëkuptimor* (botëkuptim + or), *vajguror* (vajgur + or), *zemërgjerësi* (zemërgjerë + si), *i menjëherëshëm* (menjëherë + shëm) etj.

## ANALIZA E FJALËS SIPAS NDËRTIMIT DHE SIPAS FORMIMIT TË SAJ

§ 3. Fjalët jo të parme mund të analizohen nga pikëpamja e ndërtimit dhe nga pikëpamja e formimit të tyre. Këto dy analiza duhen dalluar mirë njëra nga tjetra.

Kur e analizojmë fjalën nga pikëpamja e ndërtimit, synojmë të gjejmë pjesët përbërëse të kuptimshme të temës së saj, rrënjën, parashtesat, prapashtesat, mbaresat, p.sh.: *anëtar*: *anë* + *tar*, *anëtarësi*: *anë* + *tar* + *ësi*, *bukuri*: *bukur* + *i*, *zbukuroj*: *z* + *bukur* + *o* + *j*, *nënshkruaj*: *nën* + *shkrua* + *j*, *përfundimtar*: *për* + *fund* + *im* + *tar*, *pakënaqësi*: *pa* + *kënaq* + *ësi*, *bregdet*: *breg* + *det*, *bregdetar*: *breg* + *det* + *ar*, *sypetrit*: *sy* + *petrit*, *fatkeqësi*: *fat* + *keq* + *ësi*, *kryeqytetas*: *krye* + *qytet* + *as* etj.

Kur e analizojmë fjalën nga pikëpamja e formimit (analizë fjalëformuese) gjejmë mënyrën dhe mjetet, me të cilat është formuar ajo si fjalë e re:

a) për fjalët e prejardhura synojmë të gjejmë temën nga e cila është formuar drejtpërdrejt fjala e dhënë dhe parashtesën a prapashtesën që është bashkuar me këtë temë, p.sh.: *anëtarësi*: *anëtar* + *ësi*; *bukuri*: *bukur* + *i*, *nënshkruaj*: *nën* + *shkruaj*, *pakënaqësi*: *pa* + *kënaqësi*, *bregdetar*: *bregdet* + *ar*, *fatkeqësi*: *fatkeq* + *ësi*, *kryeqytetas*: *kryeqytet* + *as* etj.

b) për fjalët e përbëra synojmë të gjejmë temat nga bashkimi i të cilave është formuar drejtpërdrejt fjala e dhënë, p.sh.: *armëpushim*: *armë* + *pushim*, *bakërpunues*: *bakër* + *punues*, *botëkuptim*: *botë* + *kuptim*, *kryeradhë*: *krye* + *radhë*, *vajguri*: *vaj* + *guri*, *vajgursjellës*: *vajgur* + *sjellës*, *zëvendës drejtor*: *zëvendës* + *drejtor* etj.

Nga shembujt e mësipërm shihet se fjala e analizuar nga pikëpamja e formimit të saj ndahet zakonisht në dy pjesë: *temë fjalëformuese* + *parashtesë a prapashtesë* ose *temë fjalëformuese* + *temë fjalëformuese*. Në analizën sipas ndërtimit fjala ndahet në të gjitha pjesët përbërëse të saj. Dallimi i analizës së fjalës sipas ndërtimit e sipas formimit mund të vihet re qartë nga krahasimi i shembujve të mëposhtëm.

#### Analiza sipas ndërtimit:

<i>anëtarësi</i> : <i>anë</i> + <i>tar</i> + <i>ësi</i> =	3 pjesë
<i>çlirimtar</i> : <i>ç</i> + <i>lir</i> + <i>im</i> + <i>tar</i> =	4 »
<i>nëntokësor</i> : <i>nën</i> + <i>tokë</i> + <i>sor</i> =	3 »
<i>vajgursjellës</i> : <i>vaj</i> + <i>gur</i> + <i>sjell</i> + <i>ës</i> =	4 »
<i>zëvendëskryetar</i> : <i>zë</i> + <i>vend</i> + <i>ës</i> + <i>krye</i> + <i>tar</i>	5 »

### Analiza sipas formimit:

<i>anëtar + ësi</i>	= 2 pjesë
<i>çlirim + tar</i>	= 2 »
<i>nëntokë + sor</i>	= 2 »
<i>vajgur + sjellës</i>	= 2 »
<i>zëvendës + kryetar</i>	= 2 »

**Shënim.** Ka disa fjalë që formohen nga bashkimi i njëhershëm i një teme fjalëformuese me një parashtesë e me një prapashtesë, p.sh.: *përfundoj*: *për* + *fund* + *o-j*, *zbukuroj*: *z* + *bukur* + *o-j*; ka gjithashtu edhe disa fjalë të përngjitura që formohen nga bashkimi i njëhershëm i tri a më shumë temave, p.sh.: *megjithatë*: *me* + *gjith* + *atë*, *meqenëse*: *me* + *qenë* + *se*, *drejtpërdrejt*: *drejt* + *për* + *drejt*, *tungjatjeta*: *t* + *u* + *ngjat* + *jeta*, (nga *t'u ngjattë jeta*) etj. Në këto raste analiza fjalëformuese e ndan fjalën në ato pjesë, nga bashkimi i njëhershëm dhe i drejtpërdrejtë i të cilave është formuar ajo.

## II. TIPAT FJALËFORMUES PRODUKTIVË DHE AKTIVË NË SHQIPEN E SOTME LETRARE

§ 4. Sistemi i përgjithshëm i fjalëformimit të një gjuhe përbëhet prej një numri nënsistemesh të veçanta. Çdo pjesë e ligjëratis ka mënyrat dhe mjetet e saj fjalëformuese të veçanta, të cilat formojnë një *nënsistem*. Nënsistemet e pjesëve të ligjëratis ndahen në *klasa*. Klasa fjalëformuese përbëhet prej fjalëve të formuara me një mënyrë fjalëformimi, p.sh. me parashtesim, me prapashtesim, me kompozim (bashkim temash) etj. Kështu, të gjithë emrat e formuar me prapashtesa përbëjnë klasën prapashtesore të formimit të emrave. Këto klasa ndahen në *nënklasa* sipas pjesës së ligjëratis së cilës i përket tema fjalëformuese, p.sh., nënklasa e emrave të formuar prej emrash, prej mbiemrash, prej foljesh. Por njësia bazë e sistemit të fjalëformimit është *tipi fjalëformues*.

Tipi fjalëformues përcaktohet: a) nga pjesa e ligjëratis ku hyn tema fjalëformuese, b) nga mënyra e fjalëformimit (parashtesim, prapashtesim, kompozim etj.) dhe nga mjete konkret fjalëformues; c) nga marrëdhëniet kuptimore midis pjesëve përbërëse të fjalës, si edhe midis vetë fjalës së prejardhur a të përbërë dhe temës a temave fjalëformuese të saj, d.m.th. nga kuptimi tipësor që shpreh fjala e re. Kështu, p.sh., emrat *bardhësi, gjatësi, gjerësi, lartësi, mirësi, qartësi* përbëjnë një tip fjalëformues, sepse janë formuar të gjithë nga tema të mbiemrave të nyjshëm (*i bardhë, i gjatë, i gjerë, i lartë, i mirë, i qartë*) me anë të së njëjtës prapashtesë *-si* dhe shprehin të njëjtin kuptim tipësor, tregojnë një tipar abstrakt; mbiemrat *belhollë, leshverdhë, syzi, shpatullgjerë, zemërmirë*, të formuar nga bashkimi i temave të emrave *bel, lesh, sy, shpatull, zemër* me temat e mbiemrave të nyjshëm *i hollë, i verdhë, i zi, i gjerë, i mirë*, përbëjnë gjith-



ashtu një tip, sepse edhe kuptimin tipësor e kanë të përbashkët, ata zbërthehen përkatësisht në: «që e ka belin të hollë», «që i ka leshrat të verdha», «që i ka sytë të zinj» etj. Por emra si *akullore* (akull + ore), *kripore* (kripë + ore), *orizore* (oriz + ore), *bregore* (breg + ore), megjithëse janë formuar nga një temë emërore me anë të po asaj prapashtese, nuk i përkasin një tipi fjalëformues, sepse marrëdhëniet kuptimore midis fjalës së prejardhur dhe temës fjalëformuese janë të ndryshme: *akullorja* është diçka e ftohtë, gati e ngrirë si akull, që hahet; *kriporja* është një vend ku nxirret kripa nga uji i detit ose një enëz ku mbahet kripa; *orizorja* është një tokë që mbillet me oriz; *bregorja* është një kodër e vogël. Nuk janë të një tipi as emrat e përbërë *besëlidhje*, *frymëmarrje*, *vëllavrasje* etj. dhe *datëlindje*, *fletëdalje*, *pikëpjekje* etj., sepse midis gjymtyrëve të tyre ka raporte kuptimore të ndryshme: te tre të parët gjymtyra e parë (*besë-*, *frymë-*, *vëlla-*) përcakton të dytën (*besëlidhje* «lidhje e besës», *frymëmarrje* «marrje frymë», *vëllavrasje* «vrasje e vëllait»), ndërsa te tre emrat e tjerë është gjymtyra e dytë (*-lindje*, *-dalje*, *-pjekje*) që përcakton të parën (*datëlindje* «datë e lindjes», *fletëdalje* «fleta e daljes», *pikëpjekje* «pika e pjekjes»).

Pra, për të grupuar fjalët e prejardhura e të përbëra në tipa fjalëformues duhet pasur parasysh si ana formale (përkatësia e temës në këtë ose atë pjesë të ligjëratës dhe mënyra e mjeti fjalëformues), ashtu edhe ana kuptimore.

Një tip fjalëformues quhet *produktiv* kur në gjuhë ka një numër pak a shumë të konsiderueshëm fjalësh që i përkasin atij tipi. Tipi fjalëformues mund të jetë *aktiv*, kur shërben si model i gjallë fjalëformues, d.m.th. kur sipas tij formohen rishtas fjalë të reja, ose *joaktiv*, kur formimet e reja janë shumë të rralla ose mungojnë krejt. Kështu, *produktiviteti* dhe *aktiviteti* i tipit fjalëformues nuk janë e njëjta gjë, prandaj tipat produktivë mund të jenë aktivë ose joaktivë, ndërsa tipat joproduktivë, si rregull, nuk janë aktivë. Aktiviteti dhe produktiviteti i tipave të fjalëformimit ndryshojnë gjatë zhvillimit të gjuhës. Në shqipen e sotme letrare duhet të përkrahen formimet sipas tipave produktivë e aktivë, sepse ata shprehin prirjet e gjalla të zhvillimit e të pasurimit të saj. Formimet e këtyre tipave zakonisht janë normative.

## A. FJALËT E PREJARDHURA

### 1. FJALË TË FORMUARA ME PARASHTESA

Me anë parashtesash në shqipen e sotme letrare formohen emra, mbiemra e folje.

#### FORMIME ME PARASHTËSËN PA-

§ 5. Kjo parashtesë u jep fjalëve kuptim mohor. Me anë të saj formohen emra e mbiemra.

Emrat me parashtesën **pa-** formohen prej emrash abstraktë që tregojnë cilësi dhe që janë formuar kryesisht me prapashtesat **-i, -(ë)ri, -(ë)si**, p.sh.: *pa*barazi (barazi), *pa*pjekuri (pjekuri), *pa*siguri (siguri); *pa*ndershmëri (ndershmëri), *pa*ndryshueshmëri (ndryshueshmëri), *pa*pajtueshmëri (pajtueshmëri), *pa*përshtatshmëri (përshtatshmëri), *pa*rrezikshmëri (rrezikshmëri); *pa*aftësi (aftësi), *pa*drejtësi (drejtësi), *pa*kënaqësi (kënaqësi), *pa*mundësi (mundësi), *pa*qartësi (qartësi), *pa*saktësi (saktësi), *pa*zotësi (zotësi); *pa*dijeni (dijeni), *pa*dije (dije) etj.

Ky tip është produktiv dhe aktiv.

Mbiemrat me parashtesën **pa-** formohen kryesisht prej mbiemrash të nyjshëm me prejardhje foljore, të formuar me prapashtesën **-shëm** ose nga pjesorja, p.sh.: *pa*afrueshëm (i afrueshëm), *pa*banueshëm (i banueshëm), *pa*besueshëm (i besueshëm), *pa*durueshëm (i durueshëm), *pa*pijshëm (i pijshëm), *pa*përshtatshëm (i përshtatshëm), *pa*shoqërueshëm (i shoqërueshëm), *pa*tretshëm (i tretshëm),

*i pavdekshëm* (i vdekshëm) etj.; *i paarmatosur* (i armatosur), *i pabërë* (i bërë), *i padalë* (i dalë), *i padëmtuar* (i dëmtuar), *i paditur* (i ditur), *i pambrojtur* (i mbrojtur), *i pamësuar* (i mësuar), *i paprerë* (i prerë), *i pavjelë* (i vjelë), *i pazënë* (i zënë) etj.

Të dy këta tipa janë produktivë dhe aktivë në gjuhën e sotme letrare, sidomos në fushën e publicistikës e të terminologjisë shkencore-teknike.

Në raste më të pakta parashtesa **pa-** bashkohet edhe me mbiemra më **-shëm**, të formuar nga një temë jofoljore, p.sh.: *i paanshëm* (i anshëm), *i paarsyeshëm* (i arsyeshëm), *i padëmshëm* (i dëmshëm), *i pamëshirshëm* (i mëshirshëm), *i pangeshëm* (i ngeshëm), *i panjerëzishëm* (i njerëzishëm), *i pavlefshëm* (i vlefshëm) etj.

Edhe ky tip është produktiv dhe aktiv në gjuhën e sotme letrare.

Parashtesa **pa-** bashkohet edhe me një numër mbiemrash të tjerë, si *i paaftë* (i aftë), *i padenjë* (i denjë), *i padrejtë* (i drejtë), *i padyshimtë* (i dyshimtë), *i papastër* (i pastër), *i paqartë* (i qartë), *i parregullt* (i rregullt), *i pasaktë* (i saktë) etj.

Ky tip nuk është aktiv në gjuhën e sotme letrare.

Me parashtesën **pa-** formohen edhe mbiemra të nyjshëm drejtpërdrejt prej emrash, p.sh.: *i paanë* (anë), *i pabesë* (besë), *i pacipë* (cipë), *i pafat* (fat), *i pafund* (fund), *i pafytyrë* (fytyrë), *i pagojë* (gojë), *i pamasë* (masë), *i papunë* (punë), *i pastrehë* (strehë), *i pashkollë* (shkollë), *i pashpresë* (shpresë), *i pashpirt* (shpirt) etj. Ky tip është produktiv dhe aktiv, por aktiviteti i tij kushtëzohet nga disa faktorë, në radhë të parë nga faktorë stilistikë. Në rastet kur krahas mbiemrave të këtij tipi përdoren me të njëjtin kuptim edhe mbiemra me parashtesën **pa-** e me prapashtesën **-shëm**, p.sh.: *i padëm*, *i pafaj*, *i pakujdes* *i pander*—*i padëmshëm*, *i pafajshëm*, *i pakujdesshëm*, *i pandershëm* etj., këta të fundit përdoren pa ndonjë ngarkesë stilistike të veçantë, ndërsa të parët kanë zakonisht një ngarkesë shprehëse- emocionale, një theks keqësues, miratues etj.

**Shënim.** Mbiemrat *i paanë* («që s'ka anë e fund, shumë i madh») dhe *i paanshëm* («që s'mban anën as të njëjës as të tjetrës palë») kanë kuptime të ndryshme, prandaj nuk mund të përdoren në vend të njëri-tjetrit.

## FORMIME ME PARASHTESËN MOS-

§ 6. Ashtu si parashtesa **pa-** edhe parashtesa **mos-** u jep fjalëve kuptim mohor. Me anë të saj formohen vetëm emra. Parashtesa **mos-** bashkohet me emra që tregojnë veprim dhe që janë formuar prej temash foljore me anë të prapashtesave **-im** ose **-je**, p.sh.: *mosbesim, mosplotësim, mospajtim, mospranim, mossulmim, mosveprim* etj.; *mosardhje, mosbindje, mosmarrëveshje, mosmirënjohje, mosqenie* etj.

Të dy këta tipa janë produktivë dhe aktivë në gjuhën e sotme letrare.

Shënim. Siç shihet nga shembujt e mësipërm, parashtesa **mos-** bashkohet me emra foljorë të formuar me prapashtesat **-im** ose **-je**, prandaj janë në kundërshtim me normën e sotme letrare emrat e formuar me anë të kësaj parashtese prej emrash të prejardhur me prapashtesat **-(ë)si, -(ë)ri, -i**. Në këto raste duhet përdorur vetëm parashtesa **pa-**, pra:

paaftësi	dhe jo	<i>mosaftësi</i>
padrejtësi	» »	<i>mosdrejtësi</i>
paqartësi	» »	<i>mosqartësi</i>
pasaktësi	» »	<i>mossaktësi</i>
pazotësi	» »	<i>moszotësi</i>
pandryshueshmëri	» »	<i>mosndryshueshmëri</i>
papajtueshmëri	» »	<i>mospajtueshmëri</i>
papërshtatshmëri	» »	<i>mospërshtatshmëri</i>
parrezikshmëri	» »	<i>mosrrezikshmëri</i>
pabarazi	» »	<i>mosbarazi</i>
pakujdesi	» »	<i>moskujdesi</i>
pamundësi	» »	<i>mosmundësi</i>
pasiguri	» »	<i>mossiguri</i> etj.

## FORMIME ME PARASHTESËN JO-

§ 7. Parashtesa **jo-** shërben për të formuar mbiemra me kuptim mohor prej mbiemrash të *panyjshëm*, p.sh.: *jokalimtar, jokapitalist, jonormal, jopërparimtar, jopjellor, joprodhues, joshkencor, jozyrtar* etj.

Formimet me parashtesën **jo-** janë produktive dhe aktive sidomos në stilin shkencor e publicistik.

## FORMIME ME PARASHTESËN PËR-

§ 8. Me parashtesën për- në shqipen e sotme formohen kryesisht folje.

Foljet e formuara me këtë parashtesë mund të vijnë prej foljesh ose prej emrash.

Parashtesa për- u jep foljeve të formuara prej foljesh zakonisht një kuptim përforcues, intensiv, p.sh.: *përcaktoj*, *përdredh*, *përforcoj*, *përgjysmoj*, *përjetoj*, *përkujtoj*, *përmbaj*, *përmbyt*, *përngjaj*, *përpunoj*, *përqesh*, *përshejtoj* etj.

Në një varg foljesh parashtesa për-, krahas intensitetit të veprimit, shpreh edhe ngjyrimet e reja kuptimore, p.sh.: *përbluaj* (khs. bluaj), *përfshij* (khs. fshij), *përhap* (khs. hap), *përkthej* (khs. kthej), *përlaj* (khs. laj), *përlyej* (khs. lyej), *përmbledh* (khs. mbledh), *përndjek* (khs. ndjek), *përplak* (khs. plak), *përputh* (khs. puth), *përsos* (khs. sos), *përrul* (khs. ul) etj.

Formimet e mësipërme janë produktive dhe aktive në gjuhën e sotme letrare.

Me parashtesën për- formohen edhe një numër foljesh, kryesisht prej emrash që emërtojnë pjesë të trupit të njeriut ose lëndë, p.sh.: *përball* (ballë), *përbuz* (buzë), *përfytem* (fyt), *përdor* (dorë), *përkrak* (krah), *përgjunj* (gjunjë) etj., *përbalt* (baltë), *përgjak* (gjak), *përmiell* (miell), *përgjarg* (jargë) etj.

Të dy këta tipa janë produktivë, por jo aktivë në shqipen e sotme letrare.

## FORMIME ME PARASHTESËN Ç-/SH-/ZH-

§ 9. Kjo parashtesë, që paraqitet në tri variante fonetike<sup>1)</sup>, shërben kryesisht për të formuar folje prej foljesh. Ajo i jep fjalës një kuptim të kundërt, p.sh.: *çarmatos* (armatos), *çënjtem* (ënjtem), *çorganizoj* (organizoj), *çorientoj* (orientoj), *shpalos* (palos), *shqep*

1) Për përdorimin e tyre shih «Drejtshkrimi i gjuhës shqipe» § 23.

(qep), *shthur* (thur), *zhredh* (dredh), *zhduk*, *zhdukem* (dukem), *zhvendos* (vendos), *zhvulos* (vulos) etj.

Ky tip është produktiv dhe aktiv në gjuhën e sotme letrare.

Te një numër foljesh kjo parashtesë shpreh intensitetin e veprimit të shoqëruar edhe me ngjyrimë të reja kuptimore, p.sh.: *çliroj* (khs. liroj), *shkëmbej* (khs. këmbej), *shkëput* (khs. këput), *shndërroj* (khs. ndërroj), *shpërndaj* (khs. përndaj) etj. Me këtë kuptim parashtesa *ç-/sh-/zh-* përdoret rrallë në gjuhën e sotme letrare për formime të reja.

Foljet e formuara me anë të parashtesës *ç-/sh-* prej emrash janë të rralla, p.sh.: *shfaq* (faqe), *shkoq* (koqe), *çmallem* (mall), *çmend* (mend).

Ky tip nuk është as produktiv, as aktiv.

**Shënim.** Ka dallime ndërmjet mbiemrave prejpjesorë të formuar prej foljesh që kanë parashtesën *ç-/sh-/zh-* dhe mbiemrave prejpjesorë të formuar me parashtesën *pa-*: *i çarmatosur*, *i çorientuar*, *i shqepur*, *i zhvidhosur* etj. dhe *i paarmatosur*, *i paorientuar*, *i paqepur*, *i pavidhosur* etj. Të parët tregojnë një tipar që është pasojë e veprimit të shprehur nga folja përkatëse (*i çarmatosur* = «që është çarmatosur»), ndërsa të dytët tregojnë një tipar që është pasojë e mungesës së veprimit që shpreh kjo folje (*i paarmatosur* = «që nuk është armatosur»).

Të njëjtin dallim kanë edhe emrat *çarmatosje* (= të çarmatosurit), *çorientim*, *shqepje*, *zhvidhosje* etj. dhe *mosarmatosje* (mungesa e të armatosurit), *mosorientim*, *mosqepje* etj. Pra, një mbiemër ose një emër foljor mund të ketë dy antonime<sup>1)</sup>, midis të cilave ka dallime kuptimore të qarta:

*i paarmatosur* ← *i armatosur* → *i çarmatosur*

*mosarmatosje* ← *armatosje* → *çarmatosje*

Këto dallime kuptimore duhen mbajtur parasysh në mënyrë që emrat dhe mbiemrat antonimikë të përdoren drejt, në përputhje me kuptimet e tyre.

## FORMIME ME PARASHTESAT MBI- E NËN-

§ 10. Me parashtesat **mbi-** e **nën-** formohen kryesisht emra e folje. Këto prapashtesa janë antonimike, d.m.th. kanë kuptime të kundërta.

1) Antonime quhen fjalët që kanë kuptime të kundërta, p.sh.: *i madh* — *i vogël*, *qep* — *shqep* etj.

Tek emrat parashtesa **mbi-** shpreh kuptimin e të qenit sipër diçkaje (qoftë drejtpërdrejt, qoftë si diçka e shtuar) ose kuptimin e të qenit në një shkallë më të lartë se e zakonshmja, në një shkallë që e kalon masën e caktuar, p.sh.: *mbikalim, mbilëkurë, mbis!krim, mbishtresë, mbivlerë* etj.; *mbilodhje, mbingacmim, mbingarkesë, mbinormativë, mbinxehje, mbinjeri, mbipërcjellës, mbiprodhim, mbipunë, mbitension* etj.

Te foljet parashtesa **mbi-** shpreh përgjithësisht kuptimin e tepri-së ose të një veprimi që kryhet në një shkallë më të lartë se e zakonshmja, p.sh.: *mbiçmoj* («çmoj më tepër se ç'vlen»), *mbijetoj* («vazhdoj të jetoj duke kapërcyer vështirësi dhe rreziqe, jetoj më shumë se dikush tjetër»), *mbivlerësoj* («vlerësoj më tepër se ç'vlen në të vërtetë»), *mbizotëroj* («qëndroj a dal mbi gjithë të tjerët nga rëndësia, nga sasia etj.»).

Tipat e mësipërm të formimeve me parashtesën **mbi-** janë produktivë dhe aktivë në gjuhën e sotme letrare.

Parashtesa **nën-**, te emrat e formuar me anë të saj, shpreh kuptimin e të qenit poshtë diçkaje, p.sh.: *nën!ëkurë, nënshtresë, nëntokë* etj., ose kuptimin e varësisë a të nënndarjes, p.sh.: *nëndrejtor, nënkolonel, nënoficer*, etj.; *nëngrup, nënklasë, nënprodukt, nënsistem, nënstacion* etj.

Këta tipa janë produktivë dhe aktivë në shqipen e sotme letrare.

Foljet e formuara me parashtesën **nën-** kanë kuptim të kundërt me foljet përkatëse të formuara me parashtesën **mbi-**, dhe tregojnë një veprim që kryhet në një shkallë jo të plotë a më të ulët sesa duhet, p.sh.: *nënçmoj, nënvlerësoj* («çmoj, vlerësoj më pak se ç'vlen në të vërtetë»).

**Shënim.** Foljet *nënkuptoj, nënqesh, nënshkruaj, nënshtraj* kanë fituar një kuptim të ri, më pak a më shumë të ndryshëm nga kuptimi i fjalës prej së cilës janë formuar (krahaso p.sh. *qesh* e *nënqesh*).

## SHQIPËRIMI I DISA PARASHTESAVE TË HUAJA

§ 11. Bashkë me fjalët e reja me prejardhje të huaj kanë hyrë në gjuhën shqipe edhe një numër parashtesash të huaja, si: **a-**, **anti-**, **de-** **dis-** (**dez-**), **inter-**, **ko-**, **multi-**, **pan-**, **poli-** **super-** etj. Fjalët që

përmbajnë këto parashtesa, i përkasin sidomos terminologjisë tekniko-shkencore ose shoqërore-politike, p.sh.: *anormal, apolitik, antidemokratik, antifashist, antiklerikal, decentralizoj, deformat, dekompoz, dezinfektoj, disproporcion, internacional, kooperim, kooperoj, panevropian, policentrizëm, polivalent, superstrukturë* etj. Disa prej parashtesave të mësipërme kanë dhënë formime të reja edhe brenda shqipes, si: *afetar, antiajror, antifetar, antipopullor, panshqiptar, superprodhim* etj.

Një pjesë e mirë e parashtesave të huaja mund të zëvendësohen në një varg fjalësh me mjete të gjuhës shqipe ose e gjithë fjala e huaj mund të shqipërohet, p.sh.:

1. **anti-** mund të zëvendësohet me **kundër-**:

*kundëracid* (antiacid), *kundërajror* (antiajror), *kundërdridhës* (antivibrant), *kundërgaz* (antigaz), *kundërhelm* (antihelm), *kundërqeveritar* (antiqeveritar), *kundërrepublikan* (antirepublikan), *kundërsimetrik* (antisimetrik), *kundërtank* (antitank), *kundërtrup* (antikorp) etj.

2. **de-, dis- (dez-)** mund të zëvendësohen zakonisht me **ç-, sh-, zh-** ose me **shpër-**:

*çamidoj* (dezamidoj), *çaneksim* (dezaneksim), *çemulsionoj* (dezemulsionoj), *çmilitarizoj* (demilitarizoj), *çjonizim* (dejonizim), *çoksidim* (dezoksidim), *çnatyrim* (denatyrim); *shformim* (deformim), *shpërqëndrim* (decentralizim), *shpërbërje* (dekompozim), *shpolarizim* (depolarizim), *zhgëlqerëzim* (decalcifikim), *zhgënjim* (deziluzion); *shpërbashkim* (disociacion), *shpërpjesëtim* (disproporcion) etj.

3. **inter-** mund të zëvendësohet me **ndër-**:

*ndërballkanik* (interballkanik), *ndëraleat* (interaleat), *ndërkombëtar* (internacional), *ndërkombëtare* — *ndërkombëtarja* (internacionale), *ndërhyrje* (intervenim), *ndërkontinental* (interkontinental), *ndërkapje* (interceptim), *ndërmolekular* (intermolekular), *ndërprerës* (interruptor), *ndërshtënie* (interpolim), *ndërshtie* (interpoloj), *ndërzazor,-e* (intervokalik, -e) etj.



4. **ko-** mund të zëvendësohet me **bashkë-**:

*bashkekzistencë* (koekzistencë), *bashkëboshtor* (koaksial), *bashkëkohor* (kontenporan), *bashkëpunim* (kooperim), *bashkëqendror* (koncentrik), *bashkëreferat* (koreferat), *bashkërendim* (koordinim), *bashkëvariant* (kovariant) etj.

5. **poli-** **multi-** e **pluri-** mund të zëvendësohen me **shumë-**:  
*shumëbërthamor* (polinuklear), *shumëfaqësh* (poliedër), *shumëfishësi* (multiplicitet), *shumëfishim* (multiplikacion), *shumëkëndësh* (poligon), *shumëkombësh* (multinacional, plurinacional), *shumëngjyrësh* (multikolor), *shumëpalësh* (multilateral), *shumëqelizor* (multicelular, pluricelular) etj.

6. **pan-** mund të zëvendësohet me **gjithë-**:

*gjithafrikan* (panafrikan), *gjith evropian* (panevropian), *gjithënjëzëzor* (panhuman), *gjithëshqiptar* (panshqiptar) etj.

7. **super-** mund të zëvendësohet me **mbi-**:

*mbikombëtar* (supernacional), *mbindërtim* (superstrukturë), *mbinjerëzor* (supernjerëzor), *mbishqisor* (supershqisor), *mbishtetëror* (superetatik), *mbishtresë* (superstrat) etj.

Në periudhën e pasçlirimit janë bërë përpjekje të suksesshme për shqipërimin e parashtesave të huaja dhe për gjallërimin e formimeve të reja me parashtesa shqipe. Por duhet pasur parasysh se disa nga parashtesat e huaja të përmendura më lart nuk mund të zëvendësohen në të gjitha rastet. Zëvendësimi i tyre është më i vështirë kur fjala është ngulitur pak a shumë në gjuhë me atë parashtesë, p.sh. *antibiotik*, *antiparti*, *antizogist*, *internacional*, *internacionalist*, *internacionalizëm*, *superfuqi*, etj. Në disa raste të tjera shqipërimi i parashtesës ose i gjithë fjalës së huaj është i pamundur për arsye kuptimore, p.sh. mbiemri *apolitik*, -e nuk është i barabartë me *jopolitik*, -e.

## 2. FJALË TË FORMUARA ME PRAPASHTESA

Formimi i fjalëve të reja me anë prapashtesash është një nga rrugët kryesore për pasurimin e leksikut të shqipes së sotme letrare. Me prapashtesa formohen emra, mbiemra, folje e ndajfolje.

Prapashtesat kryesore produktive të shqipes së sotme letrare janë:

### PRAPASHTESA -(Ë)S

§ 12. Me anë të kësaj prapashtese formohen emra e mbiemra. Si temë fjalëformuese për emrat e mbiemrat e formuar me këtë prapashtesë shërben kryesisht tema e pjesores: *blerës* (blerë), *djegës* (djeg-ur), *nxënës* (nxënë), *prerës* (prerë), *shitës* (shit-ur), *vjelës* (vjelë) etj. Për foljet me temë më -o ose më -ua (si *dëgjo-j*, *shkrua-j*) prapashtesa -s i ngjitet temës së pjesores më -ue, e cila ka hyrë me këtë funksion në sistemin fjalëformues të gjuhës letrare nga ish-varianti letrar verior: *dëgjues* (dëgjue), *kërkues* (kërkue), *sulmues* (sulmue), *shkrues* (shkrue) etj.

Ka edhe disa emra e mbiemra që janë formuar me prapashtesën -(ë)s nga tema e së tashmes së disa foljeve, si p.sh.: *kamës* (kam), *ngasës* (ngas), *vrasës* (vras) etj.

Ky tip nuk është as produktiv, as aktiv.

Një varg emrash e mbiemrash me prapashtesën -(ë)s janë formuar prej temash emërore, p.sh.: *grykës* (grykë), *gjykatës* (gjykatë), *lajmës* (lajm), *mesës* (mes), *(bimë) mjaltëse* (mjaltë), *mullis* (mulli), *ndihmës* (ndihmë), *petës* (petë), *(pjepër) ujës* (ujë), *(ullinj) vajës* (vaj) etj.

Këto formime nuk janë shumë produktive në gjuhën e sotme letrare.

Emrat me prapashtesën -(ë)s të formuar prej një teme foljore emërtojnë zakonisht një person sipas veprimit që kryen, sipas profesionit ose punës me të cilën merret, p.sh.: *blerës*, *dëgjues*, *endëse*, *folës*, *hetues*, *lypës*, *mësues*, *mundës*, *ndërtues*, *nxënës*, *qitës*, *shitës*, *shkrirës*, *shkrues*, *votues*, *zgjedhës* etj. Të gjithë këta emra nga pikëpamja kuptimore mund të zbërthehen në togun: *ai që + folja përka-*

*rëse në të tashmen e dëftores*, p.sh.: *blerës* «ai që blen», *dëgjues* «ai që dëgjon» etj.

Mbiemrat me prapashtesën *-(ë)s* tregojnë një tipar, një cilësi, sipas veprimit të emërtuar nga tema fjalëformuese: *bindës* (fakt bindës), *dallues* (tipar dallues), *ëndërrues* (sy ëndërrues), *helmues* (gaz helmues), *kullues* (kanale kulluese), *lehtësues* (rrethana lehtësuese), *mbjellës* (makinë mbjellëse), *përvëlues* (rreze përvëluese), *prodhues* (forca prodhuese), *shprehës* (vështrim shprehës), *tërheqës* (pamje tërheqëse), *tretës* (lëngje tretëse) etj.

**Shënim.** Trajtat e ish-variantit letrar jugor: *dëgjonjës*, *ëndërronjës*, *helmonjës*, *prodhonjës*, *veçonjës*, *votonjës* etj., nuk janë në pajtim me normën e sotme letrare dhe nuk duhen përdorur. Bën përjashtim vetëm *punonjës* (si emër e si mbiemër), që është ngulitur në gjuhën letrare në këtë trajtë, p.sh.: *punonjësit e bujqësisë*, *masat punonjëse* etj.

## PRAPASHTESAT *-AR, -TAR*

§ 13. Me anë të këtyre prapashtesave formohen emra e mbiemra, kryesisht prej temash emërore.

Emrat me prapashtesat *-ar, -tar-* emërtojnë: a) një person sipas mjeshtërisë së tij, p.sh.: *argjendar*, *bletar*, *detar*, *fshesar*, *gazetar*, *këngëtar*, *këpucar*,<sup>1)</sup> *kopshtar* etj.; *arsimtar*, *farkëtar*, *peshkatar*, *zdrukthëtar* etj.; b) një person sipas veprimit që kryen, p.sh.: *gënjeshhtar*, *kundërshtar*, *notar*, *tradhtar* etj. (këta tre të fundit janë formuar përkatësisht nga temat e foljeve *kundërshtoj*, *notoj*, *tradhtoj* dhe nga kuptimi janë *emra vepruesi*); *çlirimtar*, *dëshmitar*, *lajmëtar*, *luftëtar*<sup>2)</sup>, *udhëtar* etj.<sup>3)</sup>; po kështu edhe *atdhetar* («ai që do atdheun dhe përpiqet për të mirën e tij»).

1) Fjala *këpucëtar* nuk është normative.

2) Fjala *luftar* nuk është normative.

3) Në disa formime prapashtesa *-tar* del në trajtën *-atar*, p.sh. *gjakatar*, *peshkatar*, *pushkatar* etj. Kjo trajtë e zgjeruar e prapashtesës *-tar* është formuar për analogji me rastet kur ajo është bashkuar me një temë shumësi më *-a*: *lajka + tar*: *lajkatar*, *ledha + tar*: *ledhatar* e prej këtej edhe *gjakatar*, *peshkatar* etj. Formimet me *-atar* kanë mbetur mjaft të kufizuara në gjuhën letrare.

Me prapashtesën **-ar** formohen edhe disa emra banorësh, si *kolonjar, korçar, lushnjar, myzeqar, pogradecar* etj.

Mbiemrat e formuar me prapashtesat **-ar, -tar** shprehin përgjithësisht marrëdhënie përkatësose, p.sh.: *bregdetar* «që i takon bregdetit, që ndodhet në bregdet» (p.sh.: *qytet bregdetar*) ose «që është karakteristik për bregdetin» (p.sh.: *klimë bregdetare*), po kështu edhe *djaloshar, familjar, legjendar, mesjetar, polar, postar, zyrtar* etj. Mbiemrat e formuar me prapashtesën **-tar** prej një emri foljor më **-im**, si *kalimtar, përfundimtar, përparimtar, shkatërrimtar, vendimtar* etj., shprehin një tipar në bazë të rezultatit të veprimit që është kryer, p.sh.: *periudhë kalimtare* (periudhë që shërben si kalim për në një periudhë tjetër), *njeri përparimtar* (njeri që do përparimin) etj.

**Shënim.** Në disa raste krahas emrave e mbiemrave të formuar me prapashtesën **-(ë)s** prej temash foljore, si *çlirues, fitues, krijues, ngadhënyes* etj., përdoren në gjuhë edhe emra e mbiemra të formuar me prapashtesën **-tar** nga emra të veprimit më **-im**, p.sh.: *çlirimtar, fitimtar, krijimtar, ngadhënyimtar* etj. Këta tipa fjalësh kanë kuptime të afërta, pasi emërtojnë personin që kryen veprimin e shprehur nga tema fjalëformuese: *çlirues, çlirimtar* («ai që çliron»), por ata kanë edhe dallime ndërmjet tyre e prandaj nuk mund të përdoren lirisht në vend të njëri-tjetrit. Te emrat e mbiemrat me prapashtesën **-(ë)s** kuptimi i vepruesit (i personit që kryen një veprim konkret në një çast të dhënë) është më i qartë, më i drejtpërdrejtë, sepse ata formohen drejtpërdrejt nga folja përkatëse, ndërsa te emrat më **-tar** kuptimi i vepruesit del jo drejtpërdrejt nga folja, por nga një emër foljor (*çliroj > çlirim > çlirimtar*); veç kësaj te emrat më **-tar** ky kuptim është i shoqëruar edhe me një nuancëtipari, paraqitet si veti e personit përkatës. Për këtë arsye thuhet: *Populli i Elbasanit priti me dashuri çliruesit e tij, partizanët e Brigadës XV Sulmuese; fituesit e kupës; fituesit e konkursit* etj.; por: *Proletariati është çlirimtari i njerëzimit nga shtypja dhe shfrytëzimi; «Çlirimtarët»* (titull romani); *fitimtarët nuk janë të pakritikueshëm* etj.

Të kihet parasysh se tipi i emrave të vepruesit me prapashtesën **-s** është më produktiv se tipi sinonimik me prapashtesën **-tar**, kështu që në shumë raste ka vetëm formime me **-s**, p.sh.: *botues, dëgjues, lexues, mësues, vrapues* etj. (dhe jo njëkohësisht edhe *botimtar, dëgjimtar, leximtar* etj.), por në disa raste të veçanta ka vetëm formime me **-tar**, p.sh.: *kërcimtar, mendimtar, mërgimtar* etj. (dhe jo njëkohësisht edhe *kërcyes, mendues, mërgues* etj.). Në këto raste përdorimi i emrave të tipit më **-s** ose të tipit më **-tar** është ngulitur nga tradita.

## PRAPASHTESAT -OR, -TOR

§ 14. Në gjuhën e sotme letrare me anë të këtyre prapashtesave formohen kryesisht mbiemra që në shumicën e rasteve shprehin: a) marrëdhënie përkatësose, p.sh.: *arsimor,-e* «që i përket arsimit, që ka të bëjë me arsimin», *bujqësor,-e* «që ka të bëjë me bujqësinë, që i përket bujqësisë», po kështu edhe: *bashkëshortor,-e*, *bimor,-e*, *botëror,-e*, *burimor,-e*, *dialektor,-e*, *ditor,-e*, *gramatikor,-e*, *hekurdhor,-e*, *ideor,-e*, *javor,-e*, *kërkimor,-e*, *mendimor,-e*, *mjekësor,-e*, *njerëzor,-e*, *qymyrguror,-e*, *sasior,-e*, *shkollor,-e*, *trupor,-e*, *vjetor,-e* etj.; b) një tipar cilësor (shumë herë në bazë të një krahasimi), p.sh.: *burrëror,-e* «që i ka hije burrit, që është i fortë ashtu si burri, që ka tipare të burrit» (*qëndrim burrëror*, *sjellje burrërore*, *këngë burrërore*, *zë burrëror*, *tipare burrërore* etj.), po kështu edhe *femëror,-e*, *fëmëror,-e*, *foshnjor,-e*, *njerëzor,-e*, *paqësor,-e*, *rrënjësor,-e*, *thelbësor,-e*, *vajzëror,-e* etj.

Prapashtesa -or në disa formime paraqitet në trajtat e zgjeruara -(ë)sor, p.sh.: *gjyqësor* (gjyq), *jetësor* (jetë), *paqësor* (paqe), *rrënjësor* (rrënjë) etj., ose -(ë)ror, p.sh.: *botëror* (botë), *shpirtëror* (shpirt), *shtetëror* (shtet) etj.

Tipi i mbiemrave të formuar me prapashtesën -or është shumë produktiv sidomos në terminologjinë shkencore-teknike, p.sh.: *bërthamor,-e*, *boshtor,-e*, *botor,-e*, *buxhetor,-e*, *dëftor,-e*, *doganor,-e*, *dytësor,-e*, *dyvizor,-e*, (numër) *dhjetor*, *gojor,-e*, *grykor,-e*, (dru) *gjethor*, *gjyqësor,-e*, (dru) *halor,-e*, *hundor,-e*, *kanunor,-e*, *këndor,-e*, *kohor,-e*, *lëndor,-e*, *lëvizor,-e*, (mënyra) *lidhore*, *ligjor,-e*, *madhor,-e*, *martesor,-e*, *parësor,-e*, *rrokjesor,-e*, *shëndetësor,-e*, *vepror,-e*, *zakonor,-e* etj.

Siç shihet nga këta shembuj, prapashtesa -or bashkohet zakonisht me tema emërore e në raste të veçanta edhe me tema mbiemërore, si *dytësor* (i dytë), *madhor* (i madh), *parësor* (i parë), ose foljore, si (përemër) *dëftor* (dëftoj), (mënyra) *lidhore* (lidh), (*diateza*) *veprore* (veproj) etj.

Prapashtesa -tor ka të njëjtin kuptim me -or, por sot nuk është aq aktive. Me të janë formuar vetëm disa mbiemra, si *baritor*, *leshtor*, *pastërtor* etj.

**Shënim 1.** Në shqipën e sotme prapashtesat *-ar* e *-tar* shërbejnë për të formuar kryesisht emra, ndërsa prapashtesa *-or* për të formuar mbiemra. Kjo shihet sidomos në rastet kur ato bashkohen me të njëjtën temë, p.sh.: *arsimtar,-i* — *arsimor*, *ditar,-i* — *ditor*, *gojëtar,-i* — *gojor*, *mendimtar,-i* — *mendimor*, *kërkimtar,-i* — *kërkimor*, *pronar,-i* — *pronor*, *shkaktar,-i* — *shkakor*, *shkencëtar,-i* — *shkencor*, *shkolltar,-i* — *shkollor*, *vjetar,-i* — *vjetor* etj.

Prapashtesa *-tor* nuk është aktive në gjuhën e sotme, prandaj për rastet kur ka formime paralele me *-tor* dhe *-tar*, janë normative vetëm këto të fundit: *gjahtar*, *këngëtar*, *tradhtar*, *vjershëtar* etj. (dhe jo *gjahtor*, *këngëtor*, *tradhtor*, *vjershëtor*).

**Shënim 2.** Për t'i përdorur drejt mbiemrat e formuar me prapashtesën *-or*, të kihen parasysh udhëzimet e mëposhtme:

a) Të dallohet kuptimi i emrit në rasën gjinore, rrjedhore ose në një rasë tjetër nga kuptimi i mbiemrit përkatës më *-or*:

- kopshti i shkollës*  
ose dhe jo *kopshti shkollor*
- kopsht shkollë*  
por: *viti shkollor*;
- lufta e klasave*  
ose dhe jo *lufta klasore*,
- luftë klasash*  
por: *qëndrim klasor*;
- orari i mësimeve* dhe jo *orari mësimor*,  
por: *plani mësimor*;
- rruga e shkencës* dhe jo *rruga shkencore*,  
por: *vepër shkencore*;
- gishti i unazës* dhe jo *gishti unazor*,  
por: *lidhje, prerje unazore*;
- letërsia për fëmijë* dhe jo *letërsia fëminore*,  
por: *buzëqeshje fëminore* etj.

Siç shihet nga shembujt e mësipërm, emri në gjinore, rrjedhore a kallëzore me parafjalë shpreh përkatësi, ndonjëherë destinacion (*letërsia për fëmijë*), ndërsa mbiemrat përkatës më *-or(e)* shprehin një tipar cilësor e jo marrëdhënie përkatësore (prandaj ata nuk mund të përdoren në vend të emrave).

b) Të mos formohen pa nevojë dhe në kundërshtim me natyrën e shqipes mbiemra me prapashtesën *-or(e)*, kur në vend të tyre mund të përdoret një emër me ose pa parafjalë, p.sh.: *rrugicë me kalldrëm* (dhe jo *kalldrëmore*), *det me tallaze* (dhe jo *tallazor*), *kordoni i kërthizës* (dhe jo *kërthizor*), *veçoritë e karakterit* (dhe jo *karakterore*), *vepra në prozë* (dhe jo *prozore*) etj.; po kështu të mos formohen pa nevojë mbiemra më *-or(e)*, kur përdoren në gjuhë mbiemra të tjerë me të njëjtën temë, p.sh.: *veçori fonetike* (dhe jo *fonetikore*), *mjete stilistike* (dhe jo *stilistikore*), *male vigane* (dhe jo *viganore*) etj.

## PRAPASHTESA -IST

§ 15. Kjo prapashtesë me prejardhje të huaj është bërë mjaft produktive për formimin e emrave që emërtojnë një person sipas mjeshtërisë ose punës që kryen, p.sh.: *buldozerist, centralist, çiklist, ekskavatorist, elektrikist, futbollist, karikaturist, kooperativist, kitarist, motorist, sportist, shahist, tankist, traktorist, vagonist, violinist, volejbollist* etj.

Me anë të kësaj prapashtese formohen edhe emërtime të partizanëve a të pasuesve të një dukurie, rryme ose organizate, p.sh.: *anarkist* (anarkizëm), *fashist* (fashizëm), *idealist* (idealizëm), *imperialist* (imperializëm), *leninist* (leninizëm), *marksist* (marksizëm), *materialist* (materializëm), *socialist* (socializëm) etj. Sipas këtij modeli janë formuar edhe: *ballist* (Balli Kombëtar), *fanolist* (Fan Noli), *majtist* (i majtë), *zjarrist* (Grupi i «Zjarrit»), *zogist* (Zogu) etj.

Tipi është produktiv dhe aktiv në gjuhën e sotme.

## PRAPASHTESA -IM

§ 16. Me anë të kësaj prapashtese formohen prej foljesh më -oj, -ej emra veprimi (emra që tregojnë veprim), p.sh. *acarim* (acaroj), *admirim* (admirtoj), *afrim* (afroj), *betonim* (betonoj), *copëtim* (copëtoj), *dëmërim* (dëmëroj), *gërmim* (gërmoj), *kuvendim* (kuvendoj), *përgjithësim* (përgjithësoj), *plehërim* (plehëroj), *rrezatim* (rrezatoj), *sundim* (sundoj), *udhëtim* (udhëtoj), etj., *dëfrim* (dëfrej), *këmbim* (këmbej), *kërcim* (kërcej), *pëlqim* (pëlqe), *rrëfim* (rrëfej), *shpërblim* (shpërblej) etj.

Disa nga emrat e formuar me prapashtesën -im përveç kuptimit të veprimit kanë edhe kuptimin e rezultatit të veprimit, p.sh.: *botim* (1. të botuarit, p.sh.: *Botimi i «Historisë së PPSH» qe një ngjarje e shënuar për masat punonjëse dhe për Partinë; 2. vepra e botuar ose tërësia e kopjeve të një vepre, të botuara njëherësh, p.sh.: botimet e reja, botimi i dytë* etj.) po kështu edhe: *emërtim, kompozim, propozim, vërtetim* etj. Disa emra të tjerë më -im kanë vetëm kuptimin e rezultatit të veprimit, p.sh.: *agim, blerim, vendim*.

Tipi i emrave të formuar me prapashtesën -im është shumë produktiv dhe aktiv në gjuhën e sotme letrare.

## PRAPASHTESA -IMË

§ 17. Me anë të kësaj prapashtese formohen prej foljesh më -ij, -ej, -oj emra abstraktë femërorë që emërtojnë kryesisht një farë zhurme ose fenomene atmosferike, p.sh.: *blegërimë* (blegërin), *fërshëllimë* (fërshëllij, fërshëllej), *fishkëllimë* (fishkëllij, fishkëllej, fishkëlloj), *gogësimë* (gogësi), *gumëzhimë* (gumëzhij), *hingëllimë* (hingëllin), *kërcëllimë* (kërcëllin), *oshëtimë* (oshëtin), *pshehtëtimë* (pshehtëtij), *rrapëllimë* (rrapëlloj), *sokëllimë* (sokëllij), *shushurimë* (shushurin), *tringëllimë* (tringëllij, tringëlloj), *trokëllimë* (trokëllij), *ulërimë* (ulërij), *uturimë* (uturin) etj.; *bubullimë* (bubullin), *shkreptimë* (shkreptin), *vetëtimë* (vetëtin) etj.

Me këtë prapashtesë janë formuar edhe një numër emrash të tjerë që kanë kuptime të ndryshme, si *cingërimë*, *çikërrimë*, *rrukullimë*, *shkarëzimë*, *vogëlimë* etj.

Tipat e mësipërm të emrave të formuar me prapashtesën -imë janë produktivë e deri diku aktivë, sidomos tipi i emrave që tregojnë një zhurmë.

Për disa nga emrat më -imë që tregojnë një zhurmë, përdoret herë-herë edhe një variant mashkullor më -im, p.sh.: *fërshëllimë* e *fërshëllim,-i*, *fishkëllimë* e *fishkëllim,-i*, *kërcëllimë* e *kërcëllim,-i*, *tringëllimë* e *tringëllim,-i* etj. Në përgjithësi, këto variante fjalëformuese të gjinisë mashkullore kanë dalë nga norma e sotme letrare dhe duhen mënjanuar nga përdorimi.

## PRAPASHTESA -ESË

§ 18. Me prapashtesën -esë janë formuar e formohen nga tema e kohës së tashme të foljeve më -oj, -ej, -uaj emra konkretë e abstraktë që emërtojnë rezultatit e një veprimi ose një send sipas punës për të cilin shërben, p.sh.: *ankesë*, *fejesë*, *fërgesë*, *harresë*, *jetesë*, *krijesë*, *kujtesë*, *kthesë*, *martesë*, *mungesë*, *ndalesë*, *ndërtesë*, *ngarkesë*, *ngatërrësë*, *qëndresë*, *shtesë*, *urdhëresë*, *vonesë* etj.; *banesë*, *fshesë*, *kulesë*, *mbulesë*, *ndërresa,-t*, *shtresë* etj.

Tipat e emrave të formuar me prapashtesën -esë janë produktivë, por shumë pak aktivë në gjuhën e sotme letrare.



**Shënim.** Në mjaft raste nga e njëjta folje është formuar një emër me prapashtesën **-im** e një emër me **-esë**. Këta dy tipa emrash kanë dallime kuptimore dhe nuk duhen ngatërruar në përdorim. Në përgjithësi, emrat me prapashtesën **-im** janë abstraktë dhe tregojnë një *veprim*, ndërsa emrat me prapashtesën **-esë** tregojnë *rezultatit* (konkret ose abstrakt) të atij veprimi, p.sh. *ndërtim* (veprimi i të ndërtuarit) dhe *ndërtesë* (rezultati i ndërtimit), *krijim* (p.sh.: *krijimi i kushteve të reja për ...*) dhe *krijesë* (p.sh.: *njeriu është krijesë e natyrës*); po kështu: *dërgim* — *dërgesë*, *kërkim* — *kërkesë*, *kthim* — *kthesë*, *largim* — *largesë*, *mbarim* — *mbaresë* (përdoret vetëm si term në gramatikë), *mbulim* — *mbulesë*, *ndalim* — *ndalesë*, *ngarkim* — *ngarkesë*, *ngatërrim* — *ngatërresë*, *pagim* — *pagesë*, *parashtrim* — *parashtrtesë*, *qëndrim* — *qëndresë*, *shartim* — *shartesë*, *shkrim* — *shkresë*, *shtim* — *shtesë*, *trajtim* — *trajtesë* etj. Prandaj duhet thënë: *kërkimi i llogarisë* (dhe jo *kërkesa e llogarisë*), por: *ka kërkesa për libra teknikë e shkencorë*; *ritmi i shtimit të popullsisë*, por: *shtesa e popullsisë për vitin 1974* (dhe jo *shtimi*); *u krye shartimi i dardhëve*, por: *të gjitha shartesat kanë zënë* (dhe jo *shartimet*) etj.

Në rastet kur edhe emri më **-im** tregon rezultatit e një veprimi, ashtu si emri më **-esë**, ata kanë fituar kuptime të ndryshme, p.sh.: *krijim* (me kuptimin «vepër artistike», p.sh.: *krijime të letrarëve të rinj*) dhe *krijesë* («diçka e krijuar» — zakonisht frymor, p.sh. *njeriu është krijesa më e lartë e natyrës*), *shkrim* (një krijim i shkruar, p.sh.: *shkrime të botuara*, *shkrime me përmbajtje të shëndoshë*) dhe *shkresë* (diçka e shkruar me karakter zyrtar); *ndërtime* (vetëm në shumës: «vepra që janë në ndërtim e sipër», p.sh.: *po bëhen shumë ndërtime*) dhe *ndërtesa*.

## PRAPASHTESA -JE

§ 19. Me anë të kësaj prapashtese formohen emra veprimi të gjinisë femërore. Prapashtesa **-je** bashkohet: a) *me temën e pjesores së foljeve që në të tashmen e dëftores dalin me temë më bashkëtingëllore*, si edhe të atyre foljeve që e zgjerojnë temën e së kryerës së thjeshtë e të pjesores me **-(j)t<sup>-1</sup>**, p.sh.: *hapje* (hap, hap-ur), *marrje* (marr, marrë), *prekje* (prek, prek-ur), *shëtitje* (shëtit, shëtit-ur), *veshje* (vesh, vesh-ur) etj.; *gjetje* (gjej — gjeta, gjet-ur), *gjuajtje* (gjuaj — gjuajtja, gjuajt-ur), *mbajtje* (mbaj — mbajta, mbajt-ur), *ruajtje* (ruaj — ruajta, ruajt-ur), *vërejtje* (vërej — vërejta, vërejt-ur), *fjetje* (fle — fjeta, fjet-ur) etj.; b) *me pjesoren e foljeve të klasës së parë të zgje-*

1) Shih §§ 100, 112 në pjesën «Çështje të morfologjisë».

dhimit të parë që dalin më **-aj, -ej<sup>1)</sup>, -ij, -yj, -iej, -uaj<sup>2)</sup>, -yej**, si edhe të shumicës së foljeve të zgjedhimit të tretë e të foljeve të parregullta e supletive, që dalin në pjesore më **-në**, p.sh.: *larje* (laj, larë),<sup>3)</sup> *sharje* (shaj, sharë), *blerje* (blej, blerë), *fshirje* (fshij, fshirë), *hyrje* (hyj, hyrë), *shtyrje* (shtyj, shtyrë), *zierje* (ziej, zier), *bluarje* (bluaj, bluar), *shuarje* (shuaj, shuar), *kryerje* (kryej, kryer), *lyerje* (lyej, lyer) etj.; *nxënie<sup>4)</sup>* (nxë, nxënë), *vënie* (vë, vënë), *shtënie* (shtie, shtënë), *lënie* (lë, lënë), *thënie* (them, thënë), *ngrënie* (ha, ngrënë), *qenie* (jam, qenë) etj. Në raste të veçanta kjo prapashtesë bashkohet edhe me temën e së tashmes, p.sh.: *kamje* (kam), *ngasje* (ngas), *vrasje* (vras). Pra, siç shihet edhe nga shembujt e mësipërm, prapashtesa **-je** bashkohet me të gjitha ato tema foljesh, me të cilat nuk bashkohet prapashtesa **-im**.

Emrat e formuar me prapashtesën **-je** (njësoj si ata me **-im**) janë emra abstraktë veprimi, por disa prej tyre emërtojnë edhe rezultatin e veprimit përkatës ose një send konkret, p.sh.: *dalje* («dera nga dalim»), *hyrje* («dera nga hyjmë»), *mbledhje* (p.sh.: *mbledhje e kolektivit*), *ndarje* («një pjesë e ndarë e një hapësire»), *përzierje* (p.sh.: *përzierje kimike*), *thirrje* (p.sh.: *Thirrje e Frontit Demokratik*) etj.

**Shënim.** Siç u përmend në § 16, prej foljeve më **-oj** emrat foljorë të veprimit formohen me prapashtesën **-im** e jo me **-je**, prandaj përdorimi i emrave, si *helmuarje* (helmoj), *hutuarje* (hutoj), *shpuarje* (shpoj), *shtruarje* (shtroj), *zgjuarje* (zgjoj), në vend të *helmim*, *hutim*, *shpim*, *shtrim*, *zgjim* nuk është në pajtim me normën letrare (por mund të përdoren emrat *çuarje* e *shkuarje*, të formuar nga pjesoret *çuar* e *shkuar*, për analogji me *bluarje*, *kruarje* etj., meqenëse nga foljet *çoj* e *shkoj* nuk janë formuar emra me prapashtesën **-im**).

Formimi i emrave me prapashtesën **-je** është produktiv dhe aktiv në gjuhën e sotme letrare.

- 1) Me përjashtim të foljeve që në pjesore e zbërthejnë zanoren e të temës në **-ye-**, si *kërcej* — *kërçyer*, *rrëfej* — *rrëfyer* etj.
- 2) Me përjashtim të foljeve *gatuaj*, *paguaj*, *shkruaj*, *përshkruaj*, prej të cilave formohen emra me prapashtesën **-im**: *gatim*, *pagim*, *shkrim*, *përshkrim*.
- 3) Zanorja ë fundore e pjesores bie kurdoherë para prapashtesës **-je**.
- 4) Pas bashkëtingëllores **n** prapashtesa **-je** shkruhet **-ie**; shih për këtë «Drejtshkrimi i gjuhës shqipe» § 32.

## PRAPASHTESA -ISHTE/-ISHTË

§ 20. Me anë të kësaj prapashtese, që paraqitet me dy variante, formohen kryesisht emra që tregojnë një vend ku gjenden me shumicë sende të emërtuara nga tema fjalëformuese (tema fjalëformuese në të shumtën e rasteve është një emër bime), p.sh.: *agrumishte, ahishte* ose *ahishtë, farishte, fidanishte, fierishtë* ose *fierishte, jonxhishtë, kallamishte* ose *kallamishhtë*<sup>1)</sup>, *lajthishte* ose *lajthishtë*, *lulishte, pemishte, plepishte* ose *plepishhtë*, *qarrishhtë, ranishte, rrapishhtë* ose *rrapishte, shelgjishhtë* ose *shelgjishte, trëndafilishte* ose *trëndafilishtë, thekërishte, ullishtë* ose *ullishte, zallishtë* etj. Siç shihet nga shembujt e mësipërm, disa emra janë ngulitur në gjuhën letrare në trajtën me **-ishte**, disa me **-ishtë**, ndërsa disa të tjerë përdoren herë me njëjërën e herë me tjetrën trajtë<sup>2)</sup>. Në këto raste duhen parapëlqyer në përgjithësi trajtat me **-ishtë**.

Me prapashtesën **-ishte** është formuar nga tema e foljes *punoj* edhe emri *punishte*.

Tipi i emrave të formuar me prapashtesën **-ishte/-ishtë** është produktiv dhe aktiv në gjuhën e sotme letrare.

## PRAPASHTESAT -I, -(Ë)SI, -(Ë)RI

§ 21. Me anë të këtyre prapashtesave formohen emra abstraktë të gjinisë femërore, që tregojnë një cilësi a një veçori.

Prapashtesat **-i, -(ë)si, -(ë)ri** janë të afërta nga kuptimi themelor që shprehin, por dallohen njëra nga tjetra sipas llojit të temës me të cilën bashkohen.

- 1) Ky emër, veç kuptimit «një vend ku ka shumë kallama», ka edhe kuptimin «kallam, kallam i misrit».
- 2) Sipas tingullit fundor të prapashtesës ndryshon edhe mënyra e formimit të trajtës së shquar dhe të shumës: emrat më **-ishte** e formojnë trajtën e shquar me **-ja** (duke rënë **e**-ja fundore e patheksuar) dhe shumësin e kanë njësoj si njëjës, p.sh.: *ullishte* — *ullishtja*, shumësi: *ullishte-t*, ndërsa emrat më **-ishtë** e formojnë trajtën e shquar me **-a** (duke rënë **ë**-ja fundore e patheksuar) dhe në shumës kanë mbaresën **-a**, p.sh.: *ullishtë* — *ullishta*, shumësi: *ullishta,-t*. Prandaj duhet pasur kujdes që, në rast se në një tekst përdoret varianti *ullishtë*, trajta e shquar duhet të jetë *ullishta* dhe shumësi *ullishta,-t* (dhe jo *ullishtja, ullishte,-t*), ndërsa kur përdoret varianti *ullishte*, trajta e shquar duhet të jetë *ullishtja* dhe shumësi *ullishte,-t* (dhe jo *ullishta, ullishta,-t*).

## 1. Prapashtesa -i

Kjo prapashtesë bashkohet kryesisht me tema emrash që në shumicën e rasteve janë emërtime të njerëzve sipas veprimtarisë së tyre prodhuese, shoqërore, shkencore etj. dhe me tema mbiemrash. Në disa raste ajo bashkohet edhe me tema foljesh e ndajfoljesh. Nga pikëpamja fonetike shumica e këtyre temave dalin më -r ose më -s, p.sh.: *beqari* (beqar), *blegtori* (blegtor), *bujari* (bujar), *detari* (detar), *drejtori* (drejtor), *dhelperi* (dhelpër), *dhëndëri* (dhëndër), *gazetari* (gazetar), *hetuesi* (hetues), *kopraci* (koprac), *krushqi* (krushq), *kopshtari* (kopshtar), *kujdestari* (kujdestar), *mësuesi* (mësues), *mjeshtëri* (mjeshtër), *muratori* (murator), *ndërmjetësi* (ndërmjetës), *nëpunësi* (nëpunës), *peshkatori* (peshkatar), *përgjegjësi* (përgjegjës), *sekretari* (sekretar), *zejtari* (zejtar) etj.; *amulli* (amull), *bukuri* (i bukur), *dashuri* (i dashur), *denduri* (i dendur), *dituri* (i ditur), *krenari* (krenar), *lagështi* (i lagësht), *larmi* (i larmë), *liri* (i lirë), *lumturi* (i lumtur), *mençuri* (i mençur), *mituri* (i mitur), *mizori* (mizor), *pabesi* (i pabesë), *pasuri* (i pasur), *përsosuri* (i përsosur), *pjekuri* (i pjekur), *plogështi* (i plogësht), *pjellori* (pjellor), *prodhimtari* (prodhimtar), *varfëri* (i varfër) etj.; *dredhi* (dredh), *lakmi* (lakmoj), *tradhti* (tradhtoj) etj., *befasi* (befas), *brendi* (brenda), *tepri* (tepër) etj.

Siç shihet nga shembujt e mësipërm, disa emra të formuar me këtë prapashtesë prej një teme emërore mund të tregojnë një degë të ekonomisë, një profesion, një zyrë a një vend pune, p.sh. *blegtori*, *detari*, *gazetari*, *rrobaqepësi*, *drejtori*, *sekretari* etj.

Tipat e emrave të formuar me prapashtesën -i prej temash emërore e mbiemërore janë produktivë dhe aktivë në gjuhën e sotme letrare; ndërsa formimet prej temash foljore e ndajfoljore janë mjaft të rralla.

## 2. Prapashtesa -(ë)si

Kjo prapashtesë formon zakonisht emra abstraktë të cilësisë, duke u bashkuar në radhë të parë me tema mbiemrash cilësorë, kryesisht jofoljorë, p.sh.: *aftësi* (i aftë), *ashpërsi* (i ashpër), *athtësi* (i athët), *butësi* (i butë), *cektësi* (i cekët), *drejtësi* (i drejtë), *egërsi* (i egër), *ëm-*

*bëlsi* (i ëmbël), *fshehtësi* (i fshehtë), *gjatësi* (i gjatë), *hollësi* (i hollë), *imtësi* (i imtë), *kotësi* (i kotë), *lartësi* (i lartë), *lehtësi* (i lehtë), *ligësi* (i lig), *lirësi* (i lirë), *madhësi* (i madh), *mbarësi* (i mbarë), *mefshhtësi* (i mefshtë), *mirësi* (i mirë), *mprehtësi* (i mprehtë), *ndyrësi* (i ndyrë), *poshtërsi* (i poshtër), *qartësi* (i qartë), *qetësi* (i qetë), *rëndësi* (i rëndë), *rreptësi* (i rreptë), *shpejtësi* (i shpejtë), *thjeshtësi* (i thjeshtë), *urtësi* (i urtë), *vogëlsi* (i vogël), *zgjuarsi* (i zgjuar) etj.

Siç shihet nga shembujt e mësipërm, kjo prapashtesë bashkohet kryesisht me tema mbiemrash më -të, -ët, -ër, -ël, prandaj kur nga këto tema krahas formimeve me -(ë)si ka edhe formime me -i, këto të fundit sot nuk janë normative, d.m.th. duhet përdorur: *ashpërsi*, *poshtërsi*, *shpejtësi*, *urtësi*, *vjetërsi* dhe jo *ashpëri*, *poshtëri*, *shpejti*, *urti*, *vjetëri* etj. Po kështu në çiftin *parësi* e *pari* si variant fjalëformues themelor duhet konsideruar i pari. Emrat *vogëlsi* e *vogëli*, të dy të formuar nga tema e mbiemrit *i vogël*, kanë kuptime të ndryshme: *vogëlsi* ka kuptimin «të qenët i vogël, sende të vogla të parëndësishme», ndërsa *vogëli* ka kuptimin «mosha e të voglit».1)

Një veçori tjetër e prapashtesës -(ë)si është se ajo bashkohet në një shkallë shumë më të gjerë se prapashtesat -i e -(ë)ri me tema mbiemrash të përbërë, p.sh.: *fatbardhësi* (fatbardhë), *fatkeqësi* (fatkeq), *gjakftohtësi* (gjakftohtë), *gjaknxehhtësi* (gjaknxehhtë), *kryelartësi* (kryelartë), *mendjemadhësi* (mendjemadh) etj.

Prapashtesa -(ë)si bashkohet në një masë më të vogël edhe me tema emrash (mashkullorë ose femërorë), p.sh.: *anësi* (anë), *atësi* (atë), *bimësi* (bimë), *bujqësi* (bujq), *fajësi* (faj), *fqinjësi* (fqinjë), *fshatarësi* (fshatar), *grykësi* (grykë), *gjuhësi* (gjuhë), *kombësi* (komb), *letërsi* (letër), *malësi* (mal), *mendësi* (mend), *miqësi* (miq), *mjekësi* (mjek), *pleqësi* (pleq), *popullsi* (popull), *pronësi* (pronë), *rregullsi* (rregull), *shëndetësi* (shëndet) etj.

Tipat e emrave të formuar me prapashtesën -(ë)si janë mjaft produktivë dhe aktivë në gjuhën e sotme letrare.

1) Me këtë kuptim përdoret edhe emri *vegjëli*, p.sh.: *që në vogëli* ose *që në vegjëli*.

### 3. Prapashtesa -(ë)ri

Kjo prapashtesë ka një sferë veprimi më të ngushtë në krahasim me prapashtesat -i e -(ë)si. Me këtë prapashtesë janë formuar një numër emrash me kuptim abstrakt ose përmbledhës nga tema emrash e mbiemrash, p.sh.: *besnikëri* (besnik), *burrëri* (burrë), *dinakëri* (dinak), *djalëri* (djalë), *fisnikëri* (fisnik), *foshnjëri* (foshnjë), *gjallëri* (i gjallë), *hasmëri* (hasmë), *pleqëri* (pleq), *robëri* (rob), *skllavëri* (skllav), *shoqëri* (shoq), *trimëri* (trim) etj.

Në pak raste nga e njëjta temë janë formuar një emër me -(ë)ri e një tjetër me -(ë)si, duke marrë kuptime të ndryshme, p.sh.: *madhëri* e *madhësi*, *pleqëri* e *pleqësi*.

Prapashtesa -(ë)ri është bërë sot mjaft produktive e aktive për formimin e emrave abstraktë prej temave të mbiemrave të nyjshëm me prapashtesën -shëm (shumica e tyre të formuar prej pjesores së ish-variantit letrar verior), p.sh.: *bymyeshmëri* (i bymyeshëm), *djegshmëri* (i djegshëm), *domosdoshmëri* (i domosdoshëm), *hershëmëri* (i hershëm), *lëvizshmëri* (i lëvizshëm), *ligjshmëri* (i ligjshëm), *natyrshmëri* (i natyrshëm), *ndershëmëri* (i ndershëm), *ndjeshëmëri* (i ndjeshëm), *ndryshueshmëri* (i ndryshueshëm), *ngjashëmëri* (i ngjashëm), *njëtrajtshmëri* (i njëtrajtshëm), *papajtueshëmëri* (i papajtueshëm), *paprekshmëri* (i paprekshëm), *pashmangshmëri* (i pashmangshëm), *partishëmëri* (i partishëm), *pathyeshëmëri* (i pathyeshëm), *përshkueshmëri* (i përshkueshëm), *qëndrueshëmëri* (i qëndrueshëm), *rrezikshmëri* (i rrezikshëm), *rrjedhshmëri* (i rrjedhshëm), *shumëllojshmëri* (i shumëllojshëm), *trashëgueshmëri* (i trashëgueshëm), *tretshmëri* (i tretshëm), *ushqyeshëmëri* (i ushqyeshëm), *vazhdueshëmëri* (i vazhdueshëm), *vijueshmëri* (i vijueshëm) etj. Emri *kalueshmëri* është formuar nga ndajfolja *kalueshëm*.

Për shkak të produktivitetit dhe aktivitetit shumë të madh të prapashtesës -(ë)ri në disa raste vihen re formime analogjike, drejtpërdrejt nga tema e një emri ose e një foljeje, p.sh.: *ideshmëri* (nuk ka ndonjë mbiemër *i ideshëm*), *kripshmëri* «përqindja e kripës në ujë» (ky emër nuk lidhet kuptimisht me mbiemrin *i kripshëm*, i cili është i mundshëm në gjuhë vetëm në kuptimin «që mund të kripet», por me emrin *kripë*), *përcjellshmëri* «shkalla e aftësisë së lëndëve të ndryshme për të përcjellë elektricitetin, nxehtësinë etj.» (ky emër nuk lidhet

kuptimisht me mbiemrin *i përcjellshëm* «që mund të përcillet», por me foljen *përcjell*), *pjellshmëri* «aftësia për të pjellë» (ky emër lidhet kuptimisht me foljen *pjell* e jo me ndonjë mbiemër *i pjellshëm*, i cili nuk përdoret), *vdekshmëri* «sasia e vdekjeve në një periudhë të caktuar» (ky emër nuk lidhet kuptimisht me mbiemrin *i vdekshëm*, por me emrin *vdekje*) etj.

## PRAPASHTESA -SHËM

§ 22. Me anë të kësaj prapashtese formohen mbiemra të nyjshëm prej temash foljore, emërore ose ndajfoljore.

Shumë produktiv dhe aktiv është tipi i mbiemrave të formuar nga tema e pjesores, si *i afrueshëm* (afrue)<sup>1)</sup>, *i ardhshëm* (ardh-ur), *i besueshëm* (besue), *i botueshëm* (botue), *i çmueshëm* (çmue), *i dallueshëm* (dallue), *i djegshëm* (djeg-ur), *i kapshëm* (kap-ur), *i lejueshëm* (lejue), *i lëkundshëm* (lëkund-ur), *i mundshëm* (mund-ur), *i pëlqyeshëm* (pëlqye-r), *i përdorshëm* (përdor-ur), *i thyeshëm* (thye-r), *i ushqyeshëm* (ushqye-r), *i vazhdueshëm* (vazhdue) etj.

Mbiemrat e këtij tipi tregojnë mundësi, aftësi e disa herë domosdoshmëri për t'iu nënshtruar një veprimi a për të kryer një veprim, p.sh.:

*i besueshëm* «që mund të besohet», *i djegshëm* «që mund të digjet», *i përdorshëm* «që mund të përdoret», *i pijshëm* «që mund të pihet», *i tretshëm* «që mund të tretet» etj.;

*i kënaqshëm* «që të kënaq», *i lodhshëm* «që të lodh», *i mërzitshëm* «që të mërzit», *i ushqyeshëm* «që të ushqen» etj.;

*i lëvizshëm* «që lëviz», *i rrjedhshëm* «që rrjedh», *i vazhdueshëm* «që vazhdon» etj.;

*i admirueshëm* «që meriton, që duhet të admirohet», *i lavdërueshëm* «që meriton, që duhet të lavdërohet», *i dënueshëm* «që meriton, që duhet të dënohet», *i kritikueshëm* «që mund ose që meriton, që duhet të kritikohet» etj.

1) Për foljet më -oj e -uaj si temë fjalëformuese shërben tema e pjesores më -ue të ish-variantit letrar verior.

Nga këta mbiemra mund të formohen rregullisht mbiemra me kuptim të kundërt (ose mbiemra antonimikë) me parashtesën pa- (shih e dhe më lart § 5), p.sh.:

- i besueshëm* — *i pabesueshëm*  
*i kënaqshëm* — *i pakënaqshëm*  
*i kritikueshëm* — *i pakritikueshëm*  
*i lejueshëm* — *i palejueshëm*  
*i lodhshëm* — *i palodhshëm*  
*i mundshëm* — *i pamundshëm*  
*i thyeshëm* — *i pathyeshëm* etj.

Mbiemrat me parashtesën pa- i ruajnë gjithashtu kuptimet karakteristike të tyre (në këtë rast ata tregojnë pamundësi, paaftësi për t'iu nënshtruar një veprimi a për të kryer një veprim).

Duhet dalluar në përdorim mbiemrat e formuar me prapashtesën -shëm nga mbiemrat e nyjshëm të formuar pa prapashtesë, drejt-përdrejt nga pjesorja, të cilët tregojnë një tipar cilësor të arritur pas një veprimi, p.sh.: *i dënuar* «që është dënuar», *i djegur* «që ëhtë djegur», *i përdorur* «që është përdorur», *i thyer* «që është thyer» etj. Prandaj për të zbatuar normën e sotme letrare, duhet thënë: *fëmijë i afrueshëm* (dhe jo *i afruar*), *ndihmë e çmueshme* (dhe jo *e çmuar*), *kjo më duket e pabesueshme* (dhe jo *e pabesuar*), *vullnet i pamposhtshëm* (dhe jo *i pamposhtur*), *sjellje e palejueshme* dhe jo *e palejuar*, *sulm i papërmbajtshëm* (dhe jo *i papërmbajtur*), *kjo është e pamundshme* (dhe jo *e pamundur*), *ngjarje e paharrueshme* (dhe jo *e paharruar*), *miqësi e pathyeshme* (dhe jo *e pathyer*) etj. Nga pikëpamja e normës së sotme, përdorimi i mbiemrave pa prapashtesë në vend të mbiemrave më -shëm në këto raste shihet si dialektor.

Mjaft produktiv dhe aktiv është edhe tipi i mbiemrave të formuar me prapashtesën -shëm nga tema e një emri (konkret ose abstrakt), p.sh.: *i arsyeshëm* (arsye), *i bujshëm* (bujë)<sup>1)</sup>, *i dëmshëm* (dëm), *i dobishëm* (dobi), *i famshëm* (famë), *i frikshëm* (frikë), *i frytshëm* (fryt), *i fuqishëm* (fuqi), *i hollësisshëm* (hollësi), *i lavdishëm* (lavdi), *i ligjshëm*

1) Zanorja ë fundore e patheksuar e temës fjalëformuese bie kurdoherë para parashtesës -shëm, shih edhe «Drejtshtkrimi i gjuhës shqipe» § 7 c.



(ligj), *i logjikshëm* (logjikë), *i natyrshëm* (natyrë), *i ndershëm* (nder), *i ngeshëm* (nge), *i partishëm* (parti), *i rrezikshëm* (rrezik), *i shijshëm* (shijë), *i ujshëm* (ujë), *i vëllimshëm* (vëllim), *i vrullshëm* (vrull), *i zellshëm* (zell) etj.

Nga pikëpamja e kuptimit këta mbiemra në përgjithësi zbërthehen në «që ka, që është + emrin që shërben si temë fjalëformuese», p.sh.: *i arsyeshëm* «që ka, që është me arsye», *i famshëm* «që ka, që është me famë», *i ujshëm* «që ka mjaft ujë, lëng; që është si ujë», *i vëllimshëm* «që ka vëllim të madh»; ose në «që sjell (që të shtie) + emrin që shërben si temë fjalëformuese», p.sh.: *i dëmshëm* «që sjell dëm», *i dobishëm* «që sjell dobi», *i tmerrshëm* «që të shtie tmerrin» etj. Disa mbiemra, si *i frikshëm*, *i turpshëm* mund të kenë, sipas kontekstit, herë njërin, herë tjetrin nga kuptimet e mësipërme.

Edhe nga këta mbiemra mund të formohen antonime me parashtesën **pa-**, por ato nuk janë të mundshme në të gjitha rastet. Sot përdoren çifte antonimike si:

<i>i arsyeshëm</i>	—	<i>i paarsyeshëm</i>
<i>i dëmshëm</i>	—	<i>i padëmshëm</i>
<i>i dobishëm</i>	—	<i>i padobishëm</i>
<i>i frikshëm</i>	—	<i>i pafrikshëm</i>
<i>i fuqishëm</i>	—	<i>i pafuqishëm</i>
<i>i ligjshëm</i>	—	<i>i paligjshëm</i>
<i>i ndershëm</i>	—	<i>i pandersshëm</i>
<i>i zellshëm</i>	—	<i>i pazellshëm</i> etj.,

por nuk përdoren antonime, si *i pabujshëm*, *i pafamshëm*, *i pahollësishëm*, *i paujshëm* etj. Në këto raste mohimi i tiparit bëhet me anë të pjesëzës mohuese **jo**: *jo i bujshëm*, *jo i hollësishëm* etj.

Tipi i mbiemrave të formuar me prapashtesën **-shëm** nga tema ndajfoljore është shumë më pak produktiv se dy të tjerët. Mbiemra të tillë janë: *i andejshëm*, *i atëhershëm*, *i brendshëm*, *i dikurshëm*, *i djeshëm*, *i këtejshëm*, *i këtushëm*, *i menjëhershëm*, *i ngadalshëm*, *i pardjeshëm*, *i përherëshëm*, *i qëkurshëm*, *i sivjetshëm*, *i sotshëm*, *i vjetshëm* etj. Këta mbiemra tregojnë një tipar sipas kuptimit të temës fjalëformuese. Nga këta mbiemra nuk formohen antonime me parashtesën **pa-**.

## PRAPASHTESAT -O- -RO-, -TO-, -SO-, -ZO-

§ 23. Këto prapashtesa shërbejnë për të formuar folje dhe në shumicën e rasteve bashkohen me tema emërore, mbiemërore e ndaj-foljore. Prapashtesat **-ro-**, **-to-**, **-so-**, **-zo-** janë zgjerime të prapashtesës **-o-**. Të gjitha foljet e formuara me këto prapashtesa janë të klasës së parë të zgjedhimit të parë (shih § 85 në pjesën «Çështje të morfologjisë»), d.m.th. në vetën e parë njëjës të kohës së tashme marrin mbaresën **-j**, në vetën e parë njëjës të së kryerës së thjeshtë marrin mbaresën **-va**, ndërsa në pjesore dalin më **-uar** (*punë — punoj, punova, punuar*).

### 1. Prapashtesa -o-

Kjo është prapashtesa më produktive dhe më aktive për formimin e foljeve në gjuhën e sotme letrare. Me anë të kësaj prapashtese formohen folje kryesisht prej temash emërore, mbiemërore e ndajfoljore, p.sh.:

*ajroj* (ajër)<sup>1)</sup>, *anoj* (anë), *besoj* (besë), *dimëroj* (dimër), *eksportoj* (eksport), *filmoj* (film), *fluturoj* (flutur), *gërshetoj* (gërshet), *luftoj* (luftë), *mendoj* (mend), *nderoj* (nder), *punoj* (punë), *rrafshoj* (rrafsh), *qarkoj* (qark), *sharroj* (sharrë), *sheshoj* (shesh), *tmerroj* (tmerr), *thumboj* (thumb), *urdhëroj* (urdhër), *vrapoj* (vrap), *zemëroj* (zemër), *zhavorroj* (zhavorr) etj.;

*çaloj* (i çalë), *holloj* (i hollë), *pastroj* (i pastër), *pasuroj* (i pasur), *rralloj* (i rrallë), *shkurtoj* (i shkurtër), *shtrembëroj* (i shtrembër), *shtrenjtoj* (i shtrenjtë), *thelloj* (i thellë), *varfëroj* (i varfër) **vjetroj** (i vjetër) etj.;

*afroj* (afër), *bashkoj* (bashkë), *largoj* (larg), *mjaftoj* (mjaft), **përparoj** (përpara), *shpejtoj* (shpejt), *teproj* (tepër), *veçoj* (veç) etj.

---

1) Për rëniën ose jo të ë-së paratheksore te foljet e formuara prej temash më **-ër**, **-ël** shih: «Drejtskrimi i gjuhës shqipe» § 5 ç.

## 2. Prapashtesa -ro-

Kjo prapashtesë është pak produktive. Me anë të saj janë formuar një numër i kufizuar foljesh, kryesisht nga tema emërore, e në raste të rralla nga ndonjë temë mbiemërore, foljore a ndajfoljore, p.sh.: *flakëroj* (flakë), *lajmëroj* (lajm)<sup>1)</sup>, *lavdëroj* (lavd), *ligjëroj* (ligj), *mishëroj* (mish), *plehëroj* (pleh), etj.; *gjallëroj* (i gjallë), *shkrifëroj* (shkrif), *shqipëroj* (shqip) etj.

**Shënim.** Në disa raste nga e njëjta temë janë formuar folje edhe me prapashtesën -o- edhe me -ro-, p.sh.: *flakoj*, *lajmoj*, *lëvdaj* dhe *flakëroj*, *lajmëroj*, *lavdëroj*. Në gjuhën e sotme letrare janë normative këto të fundit.

## 3. Prapashtesa -to-

Me këtë prapashtesë, që është më produktive se prapashtesa -ro-, janë formuar një numër foljesh kryesisht prej temash emërore, p.sh.: *arkëtoj* (arkë), *arsyetoj* (arsye), *copëtoj* (copë), *dëmtoj* (dëm), *farkëtoj* (farkë), *pjesëtoj* (pjesë), *shkaktoj* (shkak), *shtegtoj* (shteg), *tregtoj* (treg), *udhëtoj* (udhë), *vizatoj* (viza), *shqiptoj* (shqip) etj. Me këtë prapashtesë janë formuar edhe foljet *pushkatoj* (pushkë), *rrezatoj* (rreze), *miratoj* (mirë), duke marrë një -a- mbështetëse midis temës e prapashtesës për analogji me formime të tilla si *lajkatoj*, *ledhatoj*, *vizatoj*, te të cilat si temë fjalëformuese ka shërbyer trajta e shumësit më -a: *lajka*, *ledha*, *viza*.

**Shënim.** Folja *farkoj*, e formuar nga emri *farkë* me anë të prapashtesës -o-, në gjuhën e sotme letrare, sidomos në stilin tekniko-shkencor e publicistik, është zëvendësuar nga *farkëtoj*.

---

1) Kur tema fjalëformuese del më bashkëtingëllore, midis saj dhe prapashtesës shtohet një ë mbështetëse (shih edhe «Drejtskrimi i gjuhës shqipe» § 5 c).

#### 4. Prapashtesat -so-, -zc-

Me anë të prapashtesës -so- janë formuar folje, kryesisht i rrej temash emërore, mbiemërore e ndajfoljore, p.sh.: *frikësoj* (frikë), *vlerësoj* (vlerë) etj.; *ëmbëlsoj* (i ëmbël), *keqësoj* (i keq)<sup>1)</sup>, *lartësoj* (i lartë), *lehtësoj* (i lehtë) etj., *ngadalësoj* (ngadalë), *pakësoj* (pak), *plotësoj* (plot) etj.

Prapashtesa -so- është shumë pak aktive në gjuhën e sotme letrare.

**Shënim.** Në disa raste nga e njëjta temë janë formuar folje edhe me prapashtesën -o- edhe me -so-, p.sh.: *ashpëroj*, *frikoj*, *lartoj*, *pakoj* dhe *ashpërsoj*, *frikësoj*, *lartësoj*, *pakësoj*. Në gjuhën e sotme letrare janë normative këto të fundit.

Prapashtesa -zo-, e cila është shumë produktive e aktive në gjuhën e sotme letrare, sidomos në publicistikë e në terminologjinë tekniko-shkencore, bashkohet kryesisht me tema emrash, p.sh.: *copëzoj* (copë), *dorëzoj* (dorë), *frymëzoj* (frymë), *gjunjëzoj* (gjunjë), *kolonizoj* (koloni), *kryqëzoj* (kryq)<sup>2)</sup>, *kufizoj* (kufi), *lulëzoj* (lule), *miellzoj* (miell), *petëzoj* (petë), *popullzoj* (popull), *pyllëzoj* (pyll), *shoqërizoj* (shoqëri), *shtetëzoj* (shtet), *trupëzoj* (trup), *udhëzoj* (udhë), *vallëzoj* (valle)<sup>3)</sup> etj. ; *belbëzoj* (i belbët), *dyzoj* (dy), *shumëzoj* (shumë).

Krahas këtyre formimeve, në shqipen e sotme letrare përdoren edhe folje me prapashtesën -izo-; zakonisht, këto janë fjalë të huazuara, që i janë nënshtruar sistemit morfologjik të shqipes, si p.sh.: *aktivizoj*, *ekranizoj*, *individualizoj*, *industrializoj*, *kolektivizoj*, *konkretizoj*, *militarizoj*, *mobilizoj*, *rajonizoj*, *revolucionarizoj*, *stabilizoj* etj. Nën ndikimin e këtyre fjalëve në shqipen e sotme letrare kanë filluar të formohen edhe fjalë me prapashtesën -izo- nga tema të vetë shqipes, si p.sh.: *kombëtarizoj*, *shqiptarizoj* etj. Këto formime nuk janë shumë aktive.

- 1) Kur tema fjalëformuese del më bashkëtingëllore, midis saj dhe prapashtesës në disa raste shtohet një -ë- mbështetëse (shih edhe «Drejtshkrimi i gjuhës shqipe» § 5 c).
- 2) Kur tema fjalëformuese del më bashkëtingëllore, midis saj dhe prapashtesës në disa raste shtohet një -ë- mbështetëse (shih edhe «Drejtshkrimi i gjuhës shqipe» § 5 c).
- 3) Te foljet *lulëzoj* e *vallëzoj* e-ja fundore e temave *lule*, *valle* është shndërruar në ë.

**Shënim.** Nga foljet *njës* e *njës*, të dyja të formuara nga numërori *një*, e para ka marrë një përhapje më të madhe dhe është bërë si variant normativ kryesor, prandaj edhe fjalët e prejardhura prej saj: *njës*, *njësuar*, duhen parapëlqyer ndaj *njës*, *njësuar*.

Foljet *shum* e *shumës* nuk janë variante fjalëformuese, por kanë kuptime të ndryshme dhe nuk mund të përdoren në vend të njëra-tjetrës.

## PRAPASHTESA -OS

§ 24. Me këtë prapashtesë, që është produktive, por sot jo-aktive në gjuhën letrare, formohen folje prej temash emërore, p.sh. *balsamos* (balsam), *baltos* (baltë), *barros* (barrë), *bregos* (bregë), *brumos* (brumë), *burgos* (burg), *damkos* (damkë), *faqos* (faqë), *fundos* (fund), *gjakos* (gjak), *hekuros* (hekur), *inatos* (inat), *katranos* (katran), *leckos* (leckë), *llafos* (llafë), *merakos* (merak), *njolllos* (njollë), *përrallos* (përrallë), *plagos* (plagë), *plevitos* (plevit), *syrgjynos* (syrgjyn), *tymos* (tym), *vendos* (vend), *vulos* (vulë) etj.

**Shënim.** Në disa raste, nga e njëjta temë, përveç formimeve me prapashtesën -os, ka edhe formime me prapashtesën -o-, p.sh.: *barroj*, *brumoj*, *faqoj*, *faroj*, *gjakoj*, *njolloj*, *përralloj*, *plagoj*, *vuloj* etj.

Në këto raste formimet me prapashtesën -o-, në përgjithësi, nuk janë normative në gjuhën e sotme letrare, por ndër foljet *ajroj* dhe *ajros* e para duhet të merret si varianti normativ kryesor, pasi me temat më -ër (ajër) bashkohet prapashtesa -o- e jo -os-; rrjedhimisht, edhe *ajrim* e *ajruar* (që dalin nga *ajroj*) duhen parapëlqyer ndaj *ajros*, *ajrosur* (që dalin nga *ajros*).

Foljet *tymoj* e *tymos* (tym), *vendoj* e *vendos* (vend) janë dalluar deri diku kuptimisht e mund të përdoren secila me ngjyrimin kuptimor që kanë fituar. Folja *tymoj* përdoret me kuptim jokalimtar, (p.sh.: *tymojnë oxhakët e fabrikave*), ndërsa folja *tymos* përdoret më shumë me kuptim kalimtar (p.sh. *tymos bletët, peshkun*, prandaj thuhet edhe *peshk i tymosur* e jo *i tymuar*).

Folja *vendos* përdoret me dy kuptime: 1. «i jap udhë, zgjidhje një çështjeje»; 2. «i gjej vendin diçkaje a dikujt, vë diçka në një vend», ndërsa folja *vendoj* sot përdoret vetëm me kuptimin e dytë. Emri *vendim* lidhet kuptimisht me foljen *vendos*, megjithëse nga ana formale paraqitet si i formuar nga folja *vendoj*.

## PRAPASHTESA -AS/-AZI

§ 25. Me anë të kësaj prapashtese, që del në dy variante, formohen vetëm ndajfolje. Prapashtesa **-as/-azi** mund të bashkohet me tema emërore, mbiemërore, foljore e ndajfoljore, p.sh.: *barkas, barkazi* (bark); *brinjas, brinjazi* (brinjë); *fytas, fytazi* (fyt); *gjunjas, gjunjazi* (gjunjë); *radhas, radhazi* (radhë) etj.; *djathtas, djathtazi* (i djathtë); *fshehtas, fshehtazi* (i fshehtë); *majtas, majtazi* (i majtë) etj.; *falas* (falur), *ndaras* (ndarë), *rrëshqitas* (rrëshqit-ur), *shkaras, shkarazi* (shkarë), *vjedhuras, vjedhurazi* (vjedhur) etj.; *keqas* (keq), *largas* (larg) etj.

Siç shihet nga shembujt e mësipërm, shumica e ndajfoljeve të formuara me këtë prapashtesë përdoren në dy trajta, me **-as** e me **-azi**, por disa prej tyre janë ngulitur në gjuhën letrare vetëm në trajtën me **-as** (si *djathtas, majtas* etj.). Ndajfoljet e formuara me prapashtesën **-as/-azi** janë ndajfolje mënyre.

Kjo prapashtesë është produktive dhe aktive sidomos në gjuhën e folur popullore, ndërsa në stilin libror është më pak aktive.

## PRAPASHTESA -(I)SHT

§ 26. Është prapashtesa më produktive dhe më aktive, me anën e së cilës formohen ndajfolje në gjuhën e sotme letrare, sidomos në stilin libror të saj. Ajo bashkohet kryesisht me tema emrash të prejardhur, të formuar me prapashtesat **-(ë)si, -(ë)ri, -i, -im**, dhe me tema mbiemrash <sup>1)</sup>, p.sh.:

*afërsisht* (afërsi), *egërsisht* (egërsi), *fatmirësisht*, *fatkeqësisht*, *gjerësisht*, *hollësisht*, *miqësisht*, *munlësisht*, *nxehtësisht*, *pavarësisht*, *përgjithësisht*, *përzemërsisht*, *qetësisht*, *rastësisht*, *tërësisht*, *thellësisht* etj.;

*besnikërisht* (besnikëri), *burrërisht* (burrëri), *dinakërisht*, *fisnikërisht*, *pleqërisht*, *shoqërisht*, *trimërisht*, *vëllazërisht* etj.;

1) Te ndajfoljet e formuara prej temash më **-im** ose prej mbiemrash përdoret trajta e zgjeruar **-isht** (me përjashtim të *ligisht* < *i lig*).

*befasisht* (befasi), *bujarisht* (bujari), *dhelpe̋risht*, *lirisht*, *miturisht*, *mjeshterisht*, *njerëzisht* etj.;

*detyrimisht* (detyrim), *gabimisht* (gabim), *parimisht*, *qëllimisht*, *vazhdimisht* etj.;

*aktivisht* (aktiv), *artistikisht* (artistik), *brutalisht* (brutal), *ekonomikisht*, *energjikisht*, *familjarisht*, *financiarisht*, *heroikisht*, *historikisht*, *kolektivisht*, *konkretisht*, *ligisht*, *numerikisht*, *paralelisht*, *personalisht*, *politikisht*, *sistematikisht*, *shqiptarisht*, *teorikisht*, *ushtarakisht*, *vullnetarisht*, *zyrtarisht*<sup>1)</sup> etj.

Me anë të prapashtesës **-isht** formohen edhe ndajfoljet që shënojnë gjuhën e një populli a një dialekt, p.sh.: *anglisht*, *bullgarisht*, *greqisht*, *gjermanisht*, *koreanisht*, *persisht*, *spanjisht*, *turqisht*, *vietnamisht* etj.; *çamërisht*, *gegërisht*, *labërisht*, *shkodranisht*, *toskërisht* etj.

Për analogji me ndajfoljet e formuara nga emrat e prejardhur me prapashtesat **-(ë)si**, **-(ë)ri**, **-i**, **-im**, janë formuar një numër i kufizuar ndajfoljesh, te të cilat prapashtesa **-sht** paraqitet në trajtë të zgjeruar:

**-(ë)sisht**, p.sh.: *denjësisht* (i denjë), *krejtësisht* (krejt), *plotësisht* (plot), *rrënjësisht* (rrënjë) etj.;

**-(ë)risht**, p.sh.: *botërisht* (botë), *çuditërisht* (çudi), *pjesërisht* (pjesë), *shkencërisht* (shkencë), *shpirtërisht* (shpirt) etj.;

**-(i)misht**, p.sh.: *fuqimisht* (fuqi), *shprehimisht* (shpreh)<sup>2)</sup>.

**Shënim.** Përdorimi i ndajfoljeve me prapashtesën **-isht**, sidomos i atyre që janë formuar prej temash mbiemërore, është karakteristik sidomos për stilin e letërsisë tekniko-shkencore, të veprimtarisë shtetërore-administrative e në një farë shkalle edhe për publicistikën. Në letërsinë artistike e në ligjërimin e përditshëm nga ndajfoljet më **-isht** mund të përdoren ato që janë bërë të përgjithshme në gjuhë e që nuk kanë ndonjë ngjyrim stilistik të veçantë, si *bujraisht*, *burrërisht*, *gabimisht*, *grarisht*, *lirisht*, *miqësisht*, *mundësisht*, *pleqërisht*, *rastësisht*, *shoqërisht*, *vazhdimisht* etj. Ndajfoljet e tjera mund të përdoren për qëllime të caktuara stilistike-shprehëse.

1) Siç shihet nga shembujt e mësipërm, prapashtesa **-isht** në shumicën e rasteve bashkohet me tema mbiemërore më **-al**, **-ar**, **-ik**, **-iv**.

2) Në vargun fjalëformues të formimeve të tilla mungon një hallkë e pikërisht ajo që duhej të ishte tema fjalëformuese e rregullt: krahaso p.sh. *i qetë* > *qetësi* > *qetësisht* me *i denjë* > *denjësisht* (hallka *denjësi* mungon), prandaj formime të tilla janë përjashtime nga tipat e rregullt dhe duhen kufizuar.

Në rastet kur ka një ndajfolje më **-isht** e një ndajfolje pa prapashtesë, që kanë po atë rrënjë, në gjuhën e letërsisë artistike e në ligjërimin e përditshëm duhen përdorur këto të fundit, p.sh.: *afër* (ose *afro*) *30 veta* (dhe jo *afërsisht*); (*i foli ashpër, egër, shkurt, vrazhdë* (dhe jo *ashpërsisht, egërsisht, shkurtimisht, vrazhdësisht*) etj.

Në përgjithësi duhet pasur parasysh që të mos teprohet përdorimi i ndajfoljeve më **-isht**. Gjuha shqipe ka edhe mënyra të tjera të thëni me vlerë ndajfoljore e shumë herë edhe me fuqi shprehëse më të madhe se ndajfoljet më **-isht**, p.sh.: *afërsisht — me afërsi; artistikisht — nga ana, nga pikëpamja artistike; barbarisht — si barbar, në mënyrë barbare; besnikërisht — me besnikëri; bujarisht — me bujari; burrisht — me burri, si burrat; demokratikisht — në mënyrë demokratike; dhelpërisht — me dhelpëri; egërsisht — me egërsi; ekonomikisht — nga ana, nga pikëpamja ekonomike, nga ekonomia; marrëzisht — si i marrë; telegrafisht — me telegram; trimërisht — si trim(at), me trimëri etj., etj.* Duke përdorur sipas kontekstit e rrethanave të ligjërimin herë këto mënyra të thëni me vlerë ndajfoljore, herë ndajfoljet me prapashtesën **-isht** e bëjmë gjuhën më shprehëse e më të larmishme.

Duhet pasur kujdes gjithashtu që të mos përdoren ndajfolje më **-isht** të formuara pa nevojë e shumë herë edhe në mënyrë të parregullt, si *bindësisht, dramaturgjikisht, dredhërisht, heshtësisht, mjaftësisht, modestisht, pakrahasimisht* etj. Kuptimet e këtyre ndajfoljeve mund të jepen me këto shprehje ose fjalë: *në mënyrën bindëse, nga pikëpamja dramaturgjike, me dredhi, heshtazi ose në mënyrë të heshtur, aq sa duhet ose në mënyrë të mjaftueshme, me modesti ose në mënyrë modest, pa krahasim etj.*

## SHQIPËRIMI I DISA PRAPASHTESAVE TË HUAJA

§ 27. Bashkë me fjalët me prejardhje të huaj kanë hyrë në gjuhën shqipe edhe disa prapashtesa të huaja, si **-al, -azh, -esk, -itet, -ist, -izëm, -llëk, -xhi, -çi** (dy të fundit janë me burim nga turqishtja). Këto kanë mbetur të kufizuara kryesisht te ato fjalë me prejardhje të huaj bashkë me të cilat kanë hyrë, por disa prej tyre janë bërë produktive duke dhënë formime të reja brenda shqipes (duke u bashkuar me tema fjalësh shqipe ose me tema fjalësh të huaja), si prapashtesa **-ist** (shih më lart § 15) ose **-izëm**, p.sh.: *djathtizëm, letrarizëm, majtizëm, shkollarizëm, zyrtarizëm* etj.

Ashtu si prapashtesat me prejardhje të huaj, edhe prapashtesat mund të zëvendësohen në mjaft raste me mjete të shqipes.



1. Prapashtesa **-al** mund të zëvendësohet te disa fjalë me prapashtesën **-or**, p.sh.: *kadastral — kadastror, kultural — kulturor, leksikal — leksikor, muzikal — muzikor* etj. Në një varg rastesh të tjera fjala e huaj me prapashtesën **-al** mund të zëvendësohet me një fjalë shqipe me prapashtesën **-or**, p.sh.: *aksial — boshtor, central — qendror, esencial — thelbësor, konsitucional — kushtetor, lateral — anësor, margjinal — skajor, nazal — hundor, ora! — gojor, sezonal — stinor, social — shoqëror* etj. Mbiemrat *racor* dhe *racial* dallohen kuptimisht, p.sh.: *tipare racor*, por *dallim racial*.

2. Prapashtesa **-esk** ka kuptim keqësues, tregon tipar negativ, p.sh.: *politikë aventureske, interpretim diletantesk, elemente estradeske, qarqet gazetareske, ngjyra karikatureske, studim libresk, fraza pllakateske, roman policesk* etj.

Përdorimi i mbiemrave të formuar me këtë prapashtesë nuk është i domosdoshëm, ai e rëndon gjuhën dhe e largon nga ligjërimi i gjallë i popullit. Prandaj mbiemrat më **-esk** mund të mënjanoohen fare nga shqipja letrare. Në vend të disa mbiemrave më **-esk** mund të përdoret emri përkatës në rasën rrjedhore të shumësit të pashquar ose në gjinore të shquar, p.sh.: *politikë aventurash* (dhe jo *aventureske*), *letërsi bulevardesh* (dhe jo *bulevardeske*), *qarqet e gazetarëve* (dhe jo *gazetareske*), *fraza pllakatesh* (dhe jo *pllakateske*), *lojërat e studentëve* (dhe jo *studenteske*) etj.; në raste të tjera mund të përdoret një mbiemër me prapashtesën **-or**, p.sh. *roman policor* dhe jo *policesk*), *lojërat* (ose *rinia*) *studentore* (dhe jo *studenteske*) etj.

3. Emrat e veprimit me prapashtesat **-ion**, **-acion**, të huazuar nga gjuhët neolatine, mund të zëvendësohen me emra veprimi të formuar me prapashtesën shqipe **-im** nga folja përkatëse më **-oj** (në rast se përdoret një folje e tillë në gjuhën shqipe), p.sh.: *diskriminim* (diskriminacion), *diskutim* (diskusion), *dislokim* (dislokacion), *emigrim* (emigracion), *ilustrim* (ilustracion), *imigrim* (imigracion), *kapitullim* (kapitulacion), *kooperim* (kooperacion), *likuidim* (likuidacion) etj. Por kur këta emra më **-ion**, **-acion** nuk kanë kuptimin e një emri veprimi (qoftë në përgjithësi, qoftë në rastin konkret), ata zakonisht nuk mund të zëvendësohen nga një emër më **-im**, prandaj duhen da-

lu ar: *emigracion, infeksion, informacion, kompozicion, okupacion, operacion* etj. nga *emigrim, infektim, informim, kompozim, okupim, operim* etj. Këta dy tipa emrash përdoren në gjuhën letrare secili me kuptimin e tij të veçantë.

4. Me prapashtesën **-xhi/-çi**, me burim nga turqishtja, janë formuar emra që emërtojnë një person sipas profesionit ose sipas punës që kryen.

Një pjesë e mirë e emrave me prapashtesën **-xhi/-çi** janë zëvendësuar në gjuhën letrare me emra të formuar me prapashtesat **-tar, -ar** ose me kompozita (fjalë të përbëra) që kanë zakonisht si pjesë të dytë emrin *punues*, p.sh.: *bakërpunues* ose *remtar* (bakërxi), *bejtar* (bejtexhi), *falltar* (fallxhi), *furrtar* (furrxi), *jorganpunues* (jorganxhi), *këpucar* (kundraxhi), *lëkurëtar* (lëkuraxhi), *orëndreqës* (sahatçi), *pemëshitës* (pemaxhi), *qeleshpunues* (qeleshxhi), *samarpunues* (samarxhi), *teneqepunues* (teneqexhi) etj.

Por një numër fjalësh me prapashtesën **-xhi**, sidomos ato që emërtojnë nocione të së kaluarës, janë ngulitur në gjuhë në këtë trajtë, p.sh.: *bojaxhi, bosianxhi, duhanxhi, dyqanxhi, fajdexhi, hallvaxhi, hanxhi, kafexhi, kallajxhi, kazanxhi, qiraxhi, qymyrixhi, sazexhi, sobaxhi, sharrëxhi, sheqerxhi* etj. Disa fjalë të tjera me prapashtesën **-xhi** përdoren me ngjyrimë të caktuara stilistike-shprehëse, si *belaxhi, breshkaxhi, dallaveraxhi, duaxhi, hallexhi, kalemxhi, kumarxhi, poterexhi, qelepîrxhi, sehîrxhi, shakaxhi, shamataxhi, sherxhi, xhabaxhi* etj. Prandaj si të parat (tipi *bojaxhi*), ashtu edhe të dytat (tipi *qelepîrxhi*) përdoren në gjuhën letrare në mënyrë të kufizuar.

### 3. FJALË TË FORMUARA NJËKOHËSISHT ME PARASHTESË E ME PRAPASHTESË

§ 28. Në gjuhën shqipe ka mjaft raste kur me temën fjalëformuese bashkohen njëkohësisht një parashtesë dhe një prapashtesë. Në këtë mënyrë janë formuar një numër foljesh, si *përballoj, përfundoj, përgënjeshtroj* (me temat *ballë, fund, gënjeshtër* bashkohen njëkohësisht parashtesa **për-** dhe prapashtesa **-o-**), *përbetoj* e *përbe-*

*tohem* (me temën *be* bashkohen njëkohësisht parashtesa **për-** dhe prapashtesa **-to-**), *përfaqësoj*, *përjetësoj*, *përmirësoj*, *përvetësoj* (me temat *faqe*, *jetë*, *mirë*, *vetë* bashkohen njëkohësisht parashtesa **për-** dhe prapashtesa **-so-**), *ngurosoj* (me temën *gur* bashkohen **n-** dhe **-os**), *shfrytëzoj* (me temën *fryt* bashkohen **sh-** dhe **zo-**), *zbukuroj*, *zgjeroj* (me temat *bukur*, *gjerë* bashkohen **z-** dhe **-o-**), *zhburroj* (me temën *burr(ë)* bashkohen **zh-** dhe **-no-**) etj. Në këtë mënyrë janë formuar edhe një varg mbiemrash e emrash, si *i përbindshëm*, *i përbotshëm*, *i përgjumshëm*, *i përjavshëm*, *i përshpirtshëm*, *i përzishëm* (me temat *bind-em*<sup>1)</sup>, *botë*, *gjumë*, *javë*, *shpirt*, *zi* bashkohen njëkohësisht parashtesa **për-** dhe prapashtesa **-shëm**); *pagjumësi* (me temën *gjumë* bashkohen **pa-** e **-si**), *përjetësi* (me temën *jetë* bashkohen **për-** e **-si**) etj.

Siç shihet nga shembujt e mësipërm, në fjalët e formuara njëkohësisht me parashtesë e me prapashtesë, parashtesa më produktive është **për-**, ndërsa prapashtesat më produktive janë **-o-** për foljet e **-shëm** për mbiemrat; si tema fjalëformuese në shumicën e rasteve shërbejnë temat emërore e mbiemërore.

Tipat e fjalëve të formuara njëkohësisht me parashtesë e me prapashtesë janë më pak produktivë sesa formimet vetëm me parashtesë ose vetëm me prapashtesë, por këta tipa janë mjaft aktivë në shqipen e sotme letrare, siç omos në sti in libror.

#### 4. FJALË TË FORMUARA PA PARASHTESA A PRAPASHTESA

§ 29. Një vend të rëndësishëm në sistemin e fjalëformimit të gjuhës së sotme letrare zënë edhe tipat e fjalëve të formuara pa ndonjë parashtesë a prapashtesë, por duke kaluar nga një pjesë ligjërata në një tjetër. Ky kalim ndodh për shkak të ndryshimit të kushteve sintaksore të përdorimit të tyre. Fjalët *i ri*, *e re* janë mbiemra dhe përdoren për të përcaktuar një emër, p.sh.: *djalë i ri*, *vajzë e re*,

1) Në këtë rast folja *bindem* ka kuptimin «çuditem, mbetem me gojë hapur».

*gjëra të reja* etj. Por kur këto fjalë përdoren pa emrin që përcaktojnë, ato bëhen vetë emra, p.sh.: *një i ri nga fabrika jonë, e reja N.N; të rinjtë dhe të rejat; të reja nga shkenca dhe teknika; lufta e së resë me të vjetrën* etj.

## 1. EMËRZIMI

Emërzim a substantivim quhet shndërrimi në emër i një pjese të ligjëratës që nuk është emër. Në përgjithësi emërzohen mbiemrat dhe pjesorja. Duke u emërzuar, mbiemri bëhet emri i sendit që ka tiparin cilësor të shprehur prej tij ose emri i vetë cilësisë, p.sh.: *i ditur,-i* «njeriu i ditur», *e bukur,-a* «gjithçka që është e bukur» (p.sh.: *e bukura në letërsi dhe në art*) etj.

Me anë të emërzimit të mbiemrave formohen:

a) Emra personash të gjinisë mashkullore e femërore, të karakterizuar sipas një tipari të tyre, p.sh. *i çmendur,-i* — *e çmendur,-a, i dashur,-i* — *e dashur,-a, i njohur,-i* — *e njohur,-a, i mbytur,-i* — *e mbytur,-a, i pasur,-i* — *e pasur,-a, i sëmur|ë,-i* — *e sëmur|ë,-a, i shtypur,-i* — *e shtypur,-a, i vdekur,-i* — *e vdekur,-a, i ve* — *e ve,-ja* etj.; *besnik,-u* — *besnik|e,-ja, gënjeshtar,-i* — *gënjeshtar|e,-ja, mëngjërash,-i* — *mëngjërash|e,-ja, shtatanik,-u* — *shtatanik|e,-ja* etj.

b) Emra abstraktë të gjinisë femërore, p.sh.: *e bukur,-a, e drejtë,-a, e keq|e,-ja, e lig|ë,-a, e mir|ë,-a, e sotshm|e,-ja, e shkuar,-a, e vërtet|ë,-a* etj.

Në disa raste nga e njëjta temë është formuar edhe një emër abstrakt me prapashtesën *-i* ose *-(ë)si*, por me një ngjyrim kuptimor pak a shumë të ndryshëm, p.sh.: *e bukur,-a* dhe *bukuri,-a, e drejt|ë,-a* dhe *drejtësi,-a, e mir|ë,-a* dhe *mirësi,-a, e vërtet|ë* dhe *vërtetësi,-a* etj.

c) Emra të gjinisë asnjënjë, kryesisht abstraktë, p.sh. *të bardhë,-t, të fikët,-it, të ftohtë,-t, të keq,-të, të kuq,-të, të mbarë,-t, të mirë,-t, të mugët,-it, të nxehtë,-t, të ri,-të, të thatë,-t, të verdhë,-t* (emër sëmundjeje), *të zi,-të* (e ullirit) etj.

Përdorimi dhe formimi i emrave që radhitëm në pikën c, ka ardhur duke u pakësuar. Në gjuhën e sotme letrare vihet re prirja për

të përdorur për këto nocione emra abstraktë të gjinisë femërore, të formuar me prapashtesa, si *mbarësi, mirësi, mugëtirë, rini, thatësirë, verdhëz* etj. Në disa raste përdoren me të njëjtin kuptim dhe si të barasvlershme nga pikëpamja e normës letrare edhe trajta asnjane, edhe trajta femërore, p.sh.: *të ftohtët — e ftohta, të nxehtët — e nxehta*, ndërsa në disa raste të tjera emri asnjane ose femëror pa prapashtesë dhe emri femëror me prapashtesë përdoren me kuptime pak a shumë të ndryshme, p.sh.: *e bardha* (e vezës, e syrit) dhe *bardhësia* (e borës), *të ftohtët* ose *e ftohta* (e janarit dhe *ftohtësi,-a* (zakonisht me kuptim figurativ «ftohtësi në marrëdhëniet me dikë, por edhe «të qenët i ftohtë, shkalla e të ftohtit», p.sh.: *ftohtësia e akullit* etj.), *të nxehtët, e nxehta* (me kuptimin «temperatura e lartë e atmosferës ose e trupit të të sëmurit») dhe *nxehtësi,-a* (e furrës, e motorit etj., d.m.th. «të qenët i nxehtë, shkalla e të nxehtit»).

**Shënim.** Emrat asnjane të formuar prej mbiemrash përdoren dendur në një numër shprehjes h frazeologjike, si: *me të butë, me të egër, me të keq, vjen si më të kuq, mbahet më të madh, më të rrallë, me të urtë, të zitë e ullirit* etj. Në këto shprehje përdorimi i emra ve asnjane është normativ.

ç) Emra femërore që përdoren vetëm në shumës, p.sh.: *të ardhura,-t, të holla,-t, të korra,-t, të lashta,-t, të mbjella,-t, të mbushura,-t, të palara,-t, të vjela,-t* etj.

Nga emërzimi i pjesores janë formuar emra asnjane që shënojnë veprime abstrakte, si p.sh.: *të afruar,-it, të dalë,-t, të dëgjuar,-it, të folur,-it, të hyrë,-t, të marrë,-t, të mbajtur,-it, të menduar,-it, të ndenjur,-it, të ngrënë,-t, të nuhatur,-it, të nxjerrë,-t, të parë,-t, të punuar,-it, të qarë,-t, të qeshur,-it, të vështruar,-it, të zënë,-t* etj.

Shumica e emrave prejfoljorë asnjane kanë kuptime të njëjta me emrat e formuar me prapashtesat **-im** ose **-je** nga tema e po asaj foljeje, p.sh.: *të afruar,-it, -afrim,-i, të bashkuar,-it — bashkim,-i, të ndaluar,-it — ndalim,-i, të ndriçuar,-it, — ndriçim,-i, të pastruar,-it — pastrim,-i, të rënuar,-it — rënkim,-i, të zbuluar,-it — zbulim,-i, të zhvilluar,-it — zhvillim,-i* etj.; *të dehur,-it — dehje,-a, të çarë,-t — çarje,-a, të larë,-t — larje,-a, të lyer,-it, — lyerje,-a, të prashitur,-it — prashitje,-a, të qenë,-t — qeni,-a<sup>1)</sup>, të sjellë,-t — sjellje,-a, të*

1) Vetëm kur përdoret me kuptim abstrakt.

*ujitur,-it — ujitj|e,-a, të vjel,-t — vjelj|e,-a, të zënë,-t — zëni|e,-a* etj. Në këto raste në gjuhën e sotme janë normativë vetëm emrat e formuar me prapashtesat **-im** ose **-je**, pra duhet thënë: *afrimi i pranverës, ndalimi i qarkullimit, prashitja e misrit* etj., dhe jo *të afruarit, të ndaluarit, të prashiturit* etj.

Një pjesë e emrave prejfoljorë asnjnës përdoren me kuptime deri diku të ndryshme nga ato të emrave përkatës të formuar me prapashtesat **-im** ose **-je**, p.sh.: *të çmuar,-it — çmim,-i, të kënduar,-it — këndim,-i, të menduar,-it — mendim,-i, të mësuar,-it — mësim,-i, të punuar,-it — punim,-i, të shkruar,-it — shkrim,-i* etj.; *të lutur,-it — lutj|e,-a, të ngjarë,-t — ngjarj|e,-a, të pyetur,-it — pyetj|e,-a, të sharë,-t — sharj|e,-a* etj. Pjesorja e emëruar në këto raste e jep më **të** theksuar kuptimin e *procesit* të veprimit, ndërsa formimet me prapashtesa e emërtojnë veprimin si nocion abstrakt dhe në mjaft raste emërtojnë edhe vetë rezultatin e veprimit. Pikërisht për këtë arsye në gjuhën e sotme letrare këta emra mund të përdoren me vlerat e tyre kuptimore të veçanta, p.sh.: *arti i të kënduarit, por: shkrim e këndim; të mësuarit përmendsh, por: mësimi i këngës; procesi i të menduarit, por: forca e mendimit, gjuha dhe mendimi; mënyra e të shprehurit, por: shprehja e fytyrës, shprehje e bukur* etj.

Në disa raste krahas emrave prejfoljorë asnjnës përdoren me të njëjtin kuptim edhe emra prejfoljorë të gjinisë femërore: *të goditur,-it — e goditur,-a, të qeshur,-it — e qeshur,-a, të shtënë,-t — e shtënë|ë,-a, të shtyrë,-t — e shtyr|ë,-a* etj., p.sh.: *u dëgjua të qeshurit* (ose *e qeshura*) *e tij*. Në raste të tilla në gjuhën e sotme letrare emrat femërorë janë varianti normativ themelor.

**Shënim.** Emrat prejfoljorë asnjnës kanë një përdorim të gjerë e të qëndrueshëm në gjuhën e sotme letrare në një varg shprehjesh e mënyrash të thëni me karakter frazeologjik, si: *me të qeshur e me të ngjeshur; me të lutur; më të ngrysur; më të gdhirë; më të perënduar të diellit; në të hyrë të fshatit, në të pirë e sipër; ka marrë të krisur; ia plasi të qarit; s'ka të pushuar* etj. Përdorimi i emrave të tipit të mësipërm në shprehje të tilla është plotësisht normativ.

## 2. MBIEMËRZIMI

Mbiemërzim ose adjektivim quhet shndërrimi në mbiemër i një pjese të ligjëratës që nuk është mbiemër. Me këtë rrugë formohen mbiemra të panyjshëm e mbiemra të nyjshëm.

### a) MBIEMRAT E PANYJSHËM

Shndërrohen në mbiemra të panyjshëm kryesisht një numër emrash të formuar me prapashtesa, të cilët emërtojnë zakonisht një person, p.sh.: *fshatar,-i* (emër) — *popullsia fshatare* (mbiemër), *këngëtar,-i* (emër) — *zogjtë këngëtarë* (mbiemër), po kështu edhe: *komunist,-i* — *parti komuniste*, *lab,-i* — *kënga labe*, *luftëtar,-i* — *popull luftëtar*, *punëtor,-i* — *ky djalë është shumë punëtor*, *qytetar,-i* — *popullsia qytetare*, *shkodran,-i* — *kënga shkodrane* etj.

Emrat e parmë që mund të shndërrohen në mbiemra, janë më të rrallë, p.sh.: *frëng,-u* — *letërsia frënge*; *plak,-u*, *plak/ë,-a* — *burrë plak*, *grua plakë*, *trim,-i* — *djalë trim*, *vajzë trime* etj.

Mbiemërzimi i emrave për të formuar mbiemra të panyjshëm është një mënyrë aktive në shqipen e sotme letrare. Formimi e përdorimi i mbiemrave të tillë është normativ në të gjitha stilet.

### b) MBIEMRAT E NYJSHËM

Shumica dërrmuese e pjesoreve të foljeve mund të shndërrohen në mbiemra të nyjshëm. Mbiemrat e formuar prej pjesoreve të foljeve kalimtare në gjuhën e sotme letrare kanë përgjithësisht kuptim pësor, p.sh.: *i bashkuar* «që është bashkuar», *i çliruar* «që është çliruar», *i dëmtuar* «që është dëmtuar», po kështu *i hapur*, *i lagur*, *i mbyllur*, *i shkruar*, *i shkukur*, *i thyer*, *i zhveshur* etj.

Krahas mbiemrit prejpjesor në një varg rastesh përdoret edhe një mbiemër tjetër i formuar me prapashtesën **-ët** ose **-të** nga tema e po asaj foljeje, p.sh.: *(i,e) çelur* — *(i,e) çelët*, *(i,e) ftohur* — *(i,e) ftohtë*, *(i,e) hapur* — *(i,e) hapët*, *(i,e) mbyllur* — *(i,e) mbyllët*, *(i,e) mprehur*

— (i,e) mprehtë, (i,e) ngrohur — (i,e) ngrohtë, (i,e) nxehur — (i,e) nxehtë, (i,e) tharë — (i,e) thatë, (i,e) vyshkur — (i,e) vyshkët, (i,e) zbrazur — (i,e) zbrazët etj. Mbiemrat prejpjesorë shënojnë një tipar cilësor duke e paraqitur si diçka që është arritur si pasojë e kryerjes së një veprimi të caktuar (p.sh. *i hapur* ka kuptimin: «që është hapur pas kryerjes së veprimit të shënuar nga folja *hap*», *i ngrohur* ka kuptimin «që është ngrohur pas kryerjes së veprimit të shënuar nga folja *ngroh*» etj.), kurse të dytët shënojnë një tipar cilësor pavarësisht nga kryerja ose moskryerja e veprimit të foljes përkatëse (krahaso, p.sh.: *i hapur* e *i hapët*, *i mbyllur* e *i mbyllët*, *i ngrohur* e *i ngrohtë*, *i tharë* e *i thatë*, *i vyshkur* dhe *i vyshkët*, *i zbrazur* e *i zbrazët* etj.). Një dallim i tillë në kuptimin e në përdorimin e këtyre mbiemrave është normativ për shqipen e sotme letrare.

Mbiemrat e formuar prej pjesoreve të foljeve jokalimtare kanë në përgjithësi kuptim vepror, p.sh.: *i ardhur* «që ka ardhur», *i dalë* «që ka dalë», *i qeshur* «që i qesh fytyra», *i vuajtur* «që ka vuajtur» etj.

Mbiemërzimi i trajtës së pjesores është një mënyrë shumë produktive e aktive për formimin e mbiemrave në gjuhën e sotme letrare.

### 3. NDAJFOLJEZIMI

Ndajfoljezim ose adverbializim quhet shndërrimi në ndajfolje i një pjese të ligjëratës që nuk është ndajfolje. Në shumicën e rasteve pjesët e ligjëratës që ndajfoljezohen, janë emra, mbiemra ose folje (pjesorja). Kur shndërrohen në ndajfolje, këto pjesë të ligjëratës shërbejnë për të emërtuar rrethanat e kryerjes së një veprimi ose një tipar të tij.

Ndajfolje të formuara prej emrash janë: *anës* (anë), *ditën* (ditë), *fare* (farë), *krejt* (krye), *mot* (mot,-i), *rrafsh* (rrafsh,-i), *rresht* (rresht,-i), *sheshit* (shesh,-i) *vjet* (vjet,-i) etj. Ky tip formimi nuk është aktiv në gjuhën e sotme letrare.

Një tip të veçantë përbëjnë ndajfoljet e formuara nga forma e ngurosur e rrjedhores së mbiemrave të emëruar asnjëherë, si *së afërmi*, *së andejmi*, *së brendshmi*, *së jashtmi*, *së koti*, *së largu*, *së*



*larti, sē mbari, sē tepërmi* etj. Ky tip, megjithëse më produktiv se i pari, nuk është aktiv në gjuhën e sotme letrare.

Një numër mbiemrash të formuar me prapashtesën *-shëm* prej temash emërore ose foljore shndërrohen në ndajfolje duke u zhveshur nga nyja, p.sh.: *fuqishëm* (i fuqishëm), *furishëm* (i furishëm), *gëzueshëm* (i gëzueshëm), *hareshëm* (i hareshëm), *mendueshëm* (i mendueshëm), *natyrshëm* (i natyrshëm), *ngeshëm* (i ngeshëm), *përmallshëm* (i përmallshëm), *rrjedhshëm* (i rrjedhshëm), *vrullshëm* (i vrullshëm) etj. Ky tip është produktiv dhe aktiv në gjuhën e sotme letrare dhe kjo lidhet drejtpërdrejt me karakterin produktiv e aktiv të mbiemrave më *-shëm*.<sup>1)</sup>

Ndajfolje të formuara nga trajta e pjesores janë: *dendur, hapur, rrëmbyer, prerë, shkoqur, shtruar* etj. Ky tip, megjithëse deri diku produktiv, nuk është aktiv në gjuhën e sotme letrare.

**Shënim.** Ka disa çifte mbiemër i nyjshëm — ndajfolje me të njëjtën rrënjë, ku si mbiemri, ashtu edhe ndajfolja duhet të shkruhen me ë fundore, p.sh.: *(i,e) butë — butë, (i,e) ftohtë — ftohtë, (i,e) gjallë — gjallë, (i,e) gjatë — gjatë, (i,e) lehtë — lehtë, (i,e) mirë — mirë, (i,e) ngrohtë — ngrohtë, (i,e) shkretë — shkretë, (i,e) vonë — vonë* etj.

Në çiftet e mëposhtme mbiemri shkruhet me ë fundore, ndërsa ndajfolja shkruhet pa -ë: *(i,e) drejtë — drejt, (i,e) fortë — fort, (i,e) kotë — kot, (i,e) lartë — lart, (i,e) mbrapshtë — mbrapsht, (i,e) plotë — plot, (i,e) shpejtë — shpejt, (i,e) thjeshtë — thjesht, (i,e) vërtetë — vërtetë*<sup>2)</sup>.

#### 4. PARAFJALËZIMI

Parafjalëzim quhet shndërrimi në parafjalë i disa fjalëve që u përkasin pjesëve të tjera të ligjëratës. Fjalët që shndërrohen në parafjalë, janë kryesisht ndajfolje dhe emra.

Parafjalë të formuara prej ndajfoljesh janë: *afër, anëmbanë, anës, brenda, drejt, gjatë, jashtë, këtej, krahas, larg, lart, matanë, përmes, përpara, poshtë, prapa, sipër* etj. Këto fjalë, kur përdoren si parafjalë, qëndrojnë zakonisht para një emri a përemri, p.sh.: *afër shko-*

1) Ndonjëherë formohen ndajfolje me prapashtesën *-shëm* drejtpërdrejt nga tema e pjesores, p.sh.: *shterueshëm* (nuk përdoret ndonjë mbiemër i *shterueshëm*).

2) Shih për këtë edhe «Drejtshtkrimi i gjuhës shqipe» § 8 c.

*llës, anembanë Shqipërisë, anës lumit, drejt meje, përmes fushës, përpara nesh, prapa shtëpisë etj.*

Parafjalë të formuara prej emrash janë: *buzë, majë, mes, midis, rrëzë etj.*, p.sh.: *buzë lumit, majë malit, mes fushash, midis pyllit, rrëzë malit etj.*

## B. FJALËT E PËRBËRA (KOMPOZITAT)

§ 30. Fjalë të përbëra ose kompozita quhen fjalët e formuara nga bashkimi i dy ose i më shumë temave në një fjalë të vetme, p.sh.: *botëkuptim* (botë + kuptim), *bregdet* (breg + det), *gurgdhendës* (gur + gdhendës), *juglindje* (jug + lindje), *orëndreqës* (orë + ndreqës), *vetëshërbim* (vetë + shërbim), *dyluftim* (dy + luftim), *tremujor* (tre + mujor), *vinç-urë* (vinç + urë), *ditë-punë* (ditë + punë), *gojëmjaltë* (gojë + mjaltë), *kokëshkretë* (kokë + shkretë), *syshqiponjë* (sy + shqiponjë), *shpatullgjerë* (shpatull + gjerë), *zemërbardhë* (zemër + bardhë), *bujqësor-industrial* (bujqësor + industrial), *ekonomiko-shoqëror* (ekonomik + shoqëror), *ballëlart* (ballë + lart), *duarplot* (duar + plot), *krahëhapur* (krahë + hapur), *mirëmbaj* (mirë + mbaj), *bashkëveproj* (bashkë + veproj) etj.

Siç shihet nga shembujt e mësipërm, në formimin e kompozitave marrin pjesë zakonisht tema emrash, mbiemrash, foljesh e ndajfoljesh e në raste më të rralla edhe tema numërorësh e përemrash.

**Shënim.** Kompozitat, edhe kur kanë në përbërjen e tyre tri a më shumë tema, janë formuar zakonisht prej dy gjymtyrësh, p.sh.: *zëvendës drejtor* (zëvendës + drejtor), *zëvendëskryeredaktor* (zëvendës + kryeredaktor), *vajgursjellës* (vajgur + sjellës), *atdheadashuri* (atdhe + dashuri) etj.

Sipas marrëdhënieve që kanë ndërmjet tyre gjymtyrët përbërëse, kompozitat ndahen në dy grupe kryesore: a) kompozita këpujore dhe b) kompozita përcaktore.

§ 31. *Kompozitat këpujore* janë fjalë të përbëra zakonisht prej dy gjymtyrësh, që kanë lidhje bashkërenditëse<sup>1)</sup> ndërmjet tyre.

Gjymtyrët e një kompozite kanë lidhje bashkërenditëse ndërmjet tyre atëherë kur plotësojnë reciprokisht njëra-tjetrën. Kompozitat

1) Shih edhe: «Drejtshkrimi i gjuhës shqipe» § 67 Ac.

me lidhje bashkërenditëse mund të zbërthehen në shumicën e rasteve në një togfjalësh me gjymtyrë të lidhura me lidhëzat këpujore *e, dhe*, p.sh.: *dritëhije*: dritë dhe hije, *hekurbeton* (hekur dhe beton), *shitblerje* (shitje dhe blerje), *ekonomiko-shoqëror* (ekonomik dhe shoqëror), *bujqësor-industrial* (bujqësor dhe industrial) etj.

Kompozitat këpujore mund të jenë emra ose mbiemra:

**emra:** *dritëhije, gushtovjeshhtë, hekurbeton, juglindje, marrëdhënie, shitblerje, shurdhmemec, verilindje, veriperëndim, veshmbathje* etj.; *bar-bufe, bar-lulishte, hekur-nikel, hotel-restorant, hyrje-dalje, ngarkim-shkarkim, postë-telegraf-telefon, pritje-përcjellje, vajtje-ardhje* etj.;

**mbiemra:** *bujqësor-industrial, ekonomiko-shoqëror, historiko-gjeografik, klasor-revolucionar, (puna) mësimore-edukative, politiko-kulturor, tekniko-material, tekniko-shkencor, ushtarako-politik* etj.; *afrikano-aziatik, austro-hungarez, greko-romak, kino-shqiptar* etj.

Nga tipat e mësipërm të kompozitave këpujore, më produktiv e më aktiv në gjuhën e sotme është tipi i mbiemrave si *bujqësor-industrial, ekonomiko-shoqëror* etj. Me formime të tilla është e pasur veçanërisht gjuha e botimeve politiko-shoqërore e tekniko-shkencore. Te pjesa më e madhe e këtyre mbiemrave tema e parë del më zanoren **o** (shih shembujt më lart), e cila shërben si zanore lidhëse për gjymtyrët e kompozitës). Kur tema e parë është e prejardhur dhe del më **-or**, kompozita nuk ka zanore lidhëse: *klasor-revolucionar* (dhe jo *klasoro-revolucionar*). Këto kompozita, kur vihen në trajtën e gjinisë femërore, marrin prapashtesën **-e** jo vetëm te gjymtyra e dytë, por edhe te e para, p.sh.: (fryma) *klasore-revolucionare*.

Shumica e kompozitave këpujore, emra e mbiemra, shkruhen me vizë lidhëse në mes, sepse gjymtyrët e tyre janë të barasvlershme nga pikëpamja kuptimore dhe kanë ndërmjet tyre marrëdhënie plotësuese ose të ndërsjellta. Vetëm disa kompozita emra, gjymtyrët e të cilave janë njësuar plotësisht si nga ana leksikore, ashtu edhe nga ana gramatikore, shkruhen njësh (shih shembujt më lart<sup>1)</sup>.

1) Për shkrimin njësh ose me vizë të kompozitave këpujore shih edhe «Drejtshkrimi i gjuhës shqipe» § 67 Ac, § 68 c,d.

§ 32. *Kompozitat përcaktore* janë fjalë të përbëra prej dy gjymtyrësh, nga të cilat njëra përcakton tjetrën: e para të dytën, p.sh.: *kryeqytet, hekurkthyes, mirëmbaj* etj., ose e dyta të parën, p.sh.: *armëpushim, bregdet, fatbardhë, sypetrit, vinç-urë* etj.

Pjesa më e madhe e kompozitave përcaktore janë emra e mbiemra. Kompozitat folje janë më të pakta.

## TIPAT KRYESORË TË KOMPOZITAVE EMRA

§ 33. Sipas temave prej të cilave formohen dhe sipas marrëdhënieve kuptimore ndërmjet këtyre temave, në gjuhën e sotme letrare dallohen këta tipa kryesorë të kompozitave përcaktore emra:

### 1. TIPI EMËR + EMËR

Ky tip ndahet në katër nëntipa:

a) Gjymtyra e dytë është një emër foljor i vepruesit me prapashtesën -(ë)s. Formimet e këtij tipi emërtojnë persona sipas profesionit a punës që bëjnë, ose vegla e mjete teknike, p.sh. *gurgdhendës* (gur + gdhendës), *hekurkthyes* (hekur + kthyes), *këpucëbërës* (këpucë + bërës), *leshpunuese* (lesh + punuese), *letërshpërndarës* (letër + shpërndarës), *libralidhës* (libra + lidhës), *luftënxitës* (luftë + nxitës), *orëndreqës* (orë + ndreqës), *rrobaqepës* (rroba + qepës) etj.; *brumëgatuese* (brumë + gatuese), *flakëhedhëse* (flakë + hedhëse), *lartësimatës* (lartësi + matës), *rrufepritës* (rrufe + pritës), *ujësjellës* (ujë + sjellës) etj. Te këto kompozita gjymtyra e parë përcakton të dytën dhe tregon objektin e veprimit të saj, p.sh.: *libralidhës* «lidhës i librave, ai që lidh libra», *flakëhedhëse* «një armë që hedh flakë» etj.

Ky tip është shumë produktiv e aktiv në gjuhën e sotme letrare. Me kompozita të këtij tipi janë zëvendësuar sidomos shumë fjalë me prapashtesën turke **-xhi/-çi** (shih më lart § 27,4).

b) Gjymtyra e dytë është një emër foljor i veprimit me prapashtesat **-je** ose **-im**. Kompozitat e formuara në këtë mënyrë kanë zakonisht kuptim abstrakt, p.sh. *besëlidhje* (besë + lidhje), *frymëmarrje*

(frymë + marrje), *krahëmarrje* (krahë + marrje), *vëllavrasje* (vëlla + vrasje) etj.; *armëpushim* (armë + pushim), *botëkuptim* (botë + kuptim), *dëmshpërblim* (dëm + shpërblim), *jetëshkrim* (jetë + shkrim), *letërkëmbim* (letër + këmbim) etj. Te këto kompozita gjithashtu gjyntyra e parë përcakton të dytën dhe tregon objektin e veprimit të saj, p.sh.: *fryëmarrje* (marr frymë), *letërkëmbim* (këmbej letra) etj.

Ky tip është gjithashtu shumë produktiv dhe aktiv në gjuhën e sotme letrare.

c) Gjyntyra e dytë është një emër çfarëdo, i parmë a i prejar-dhur (duke përfshirë edhe emra me prapashtesat **-im** ose **-je**). Te kompozitat e këtij tipi gjyntyre përcaktuese është zakonisht e dyta, p.sh.: *bregdet* (bregu i detit), *datëlindje* (data e lindjes), *fletëdalje* (fleta e daljes), *fletëhyrje* (fleta e hyrjes), *letërnjoftim* (letër njoftimi), *mesnatë* (mesi i natës), *pikëpamje* (pikë pamjeje), *pikëpjekje* (pikë pjekjeje), *vargmal* (varg malesh), *vendbanim* (vend banimi), *vendkalim* (vend kalimi) etj.; por ka edhe kompozita të këtij tipi, te të cilat gjyntyra e parë përcakton të dytën, p.sh.: *anëshkrim* (shkrim anës, në anë), *gjysmëkoloni* (koloni jo e tipit klasik, shtet që ka pavarësi formale, por që në të vërtetë është i varur nga një shtet tjetër), *hekurudhë* (udhë hekuri), *kryeqytet* (qyteti kryesor i një shteti, ku ka selinë qeveria) etj.

Kompozitat e tipit *b*, që kanë si gjyntyre të dytë një emër veprimi me prapashtesat **-je** ose **-im**, dallohen nga kompozitat e tipit *c*, sepse te të parat emri i veprimit është gjyntyre e përcaktuar (p.sh., te *fryëmarrje*, *krahëmarrje* gjyntyret *frymë*, *krahë* përcaktojnë gjyntyren *marrje*), ndërsa te të dytat emri i veprimit është gjyntyre përcaktuese (p.sh., te *fletëdalje*, *fletëhyrje* gjyntyret *dalje*, *hyrje* përcaktojnë gjyntyren *fletë* dhe tregojnë llojin e saj). Kompozitat e tipit *c* me gjyntyre të dytë një emër më **-im** a më **-je** dallohen gjithashtu nga kompozitat e tipit *b*, sepse kanë si burim togfjalëshat emër + emër në rrjedhore ose në gjinore: *fletëdalje* = *fletë daljeje*, *fleta e daljes*, *vendbanim* = *vend banimi*, *vendi i banimit* etj.

ç) Kompozita me marrëdhënie përcaktore-ndajshimore ndër-mjet gjyntyre të tyre, p.sh.: *dhomë-muze*, *qytet-muze*, *shtëpi-muze*, *qytet-hero*, *dyqan-shtëpi*, *hotel-pension*, *vagon-cisternë*, *vagon-resto-*

*rant, vinç-kullë, vinç-urë, organizatë-bazë (punimet e) shpim-kërkimit, (brigada e) shpim-shfrytëzimit, plan-detyrë, qen-ujk* etj. Në këto kompozita gjymtyra e dytë përcakton të parën: *qytet-muze* «një qytet që është muze», *vagon-cisternë* «një vagon që është cisternë», *shpim-shfrytëzim* «shpim që bëhet për shfrytëzim» etj.

Gjatë lakimit të kompozitave të mësipërme ndryshon vetëm gjymtyra e parë:

*qytet-muze, qyteti-muze, qytetit-muze, qytetin-muze; vinç-urë, vinçi-urë, vinçit-urë, vinçin-urë* etj. (dhe jo *vinç-ura, vinç-urës, vinç-urën*).

Kompozitat e mësipërme shkruhen me vizë lidhëse në mes<sup>1)</sup>. Ky tip është produktiv e aktiv në gjuhën e sotme letrare, veçanërisht në fushën e terminologjisë tekniko-shkencore.

**Shënim.** Duhet dalluar kompozitat përcaktore-ndajshimore të mësipërme, të cilat shërbejnë si emërtime, nga togfjalëshat e lirë me lidhje ndajshimore (gjymtyrët e të cilëve shkruhen ndaras), si *vend mik, vend vëlla, ushtar hero, nënë heroinë, roman epope, popull ushtar* etj. të cilët nuk shërbejnë si emërtime.

Kompozitat dhe togfjalëshat me lidhje ndajshimore dallohen edhe nga pikëpamja e formës: në numrin shumës të kompozitat ndryshon vetëm gjymtyra e parë: *vinçat-urë, organizatat-bazë, qytetet-muze* etj., ndërsa te togfjalëshat ndryshojnë të dyja gjymtyrët: *vende,-t miq, vende,-t vëllezës, nëna,-t heroïna* etj.

## 2. TIPI NDAJFOLJE + EMËR

Zakonisht gjymtyra e dytë është një emër veprimi ose vepruesi me prapashtesat **-im, -je, -(ë)s, -tor, -tar**, p.sh. *drejtqëndrim, drejtshkrim, keqtrajtim, mürëkuptim, parakalim* etj.; *keqdashje, larghedhje, mbarëvajtje* etj.; *bashkënxënës, bashkëbisedues, mirëbërës, paraardhës, pasardhës* etj.; *bashkautor, bashkëpunëtor* etj.; *bashkëfshatar, bashkëqytetar* etj.; *bashkëshort, baraspeshë* etj.

Ky tip (megjithëse si gjymtyrë e parë në këto formime shërben një numër i kufizuar ndajfoljesh) është produktiv dhe aktiv në gjuhën e sotme letrare.

1) Shih edhe «Drejtshkrimi i gjuhës shqipe» § 68 c.

### 3. TIPI NUMËROR (OSE SHUMË) + EMËR NË RRJEDHORE TË PASHQUAR SHUMËS

Sipas këtij tipi strukturor janë formuar një varg emrash, si *dhjetëvjetësh,-i* (dhjetë + vjetësh), *pesëmbëdhjetëditësh,-i* (pesëmbëdhjetë + ditësh), *dyjavësh,-i* (dy + javësh), *shumëkëmbësh,-i* (shumë + këmbësh), *trikëmbësh,-i* (tri + këmbësh) etj. Meqenëse te fjalët e përbëra të mësipërme mbaresa **-sh** e rrjedhore së pashquar të shumësit nuk shpreh asnjë kuptim gramatikor, ajo bashkë me **-ë-në** që ndodhet para saj, u ndien si një prapashtesë dhe në këtë mënyrë lindën formime të reja analogjike, si *trekëndësh* (tre + kënde) + (ësh), *katërkëndësh* (katër + kënde) + (ësh), *shumëkëndësh* (shumë + kënde) + (ësh).

Sipas këtij tipi janë formuar edhe mjaft mbiemra, si *njërrrokësh,-e* (një + rrokje) + (ësh), *tetërrrokësh,-e* (tetë + rrokje) + (ësh), *shumërrrokësh,-e* (shumë + rrokje) + (ësh), *dykatësh,-e* (dy + kate) + (ësh), *gjashtëkatësh,-e* (gjashtë + kate) + (ësh), *dypolësh,-e* (dy + pole) + (ësh), *shumëpalësh,-e* (shumë + palë) + (ësh), *tringjyrësh,-e* (tri + ngjyra) + (ësh), *dyvendësh,-e* (dy + vende) + (ësh), *disaditësh,-e* (disa + ditë), *disajavësh,-e* (disa + javësh), (*monedhë*) *dhjetëlekësh,-e* (dhjetë + lekësh, njëqind + lekësh) + prap. **-e** të gjinisë femërore.

Disa prej këtyre mbiemrave mund të përdoren edhe si emra (emërzohen), p.sh. *tetërrrokësh,-i* «vargu tetërrrokësh», *dhjetëlekësh/e,-ja* «monedhë dhjetëlekësh» etj.

Nga kuptimi mbiemrat e tipit të mësipërm janë të ngjashëm me mbiemrat e tipit numëror (ose përemër) + mbiemër, si *njëvjeçar*, *dyditor* etj.

### 4. TIPI PËREMËR + EMËR

Te kompozitat e këtij tipi gjymtyra e parë përcakton të dytën, që është zakonisht një emër veprimi me prapashtesat **-im** ose **-je**, p.sh.: *vetëbesim*, *vetëmbrojtje*, *vetëmohim*, *vetëshërbim*, *vetëvendosje*, *vetëvrasje* etj. Siç shihet nga shembujt, si gjymtyrë e parë shërben vetëm

tema përemërore *vetë*. Ky tip është bërë produktiv sidomos për shqipërimin e kompozitave të gjuhëve të huaja që kanë si gjymtyrë të parë elementin *auto-1)*, p.sh.: *vetëjonizim* (autojonizim), *vetinduksion* (autoinduksion), *vetedukim*, *vetëhelmim*, *vetëkatalizë*, *vetëlavdërim*, *vetëmbrojtje*, *vetëngjizje*, *vetëpërtretje*, *vetëruajtje*, *vetëshkarkim*, *vetëvendosje*, *vetoksidim*, *vetoksidues*, *vetushqyes* etj.

## 5. TIPI FOLJE + EMËR

Kompozita të këtij tipi janë emrat *dashamir* («ai që të do të mirën»), *dredhalesh* «zejtari që dridhte lesh»), *djegagur-i*, *rrahaderë*, *krehabisht* (lajkatar), *thirravajë*, *thithlopë* etj. Ky tip nuk është as produktiv, as aktiv në gjuhën e sotme letrare.

## TIPAT KRYESORË TË KOMPOZITAVE MBIEMRA

§ 34. Sipas temave prej të cilave formohen dhe sipas marrëdhënieve kuptimore ndërmjet këtyre temave, dallohen këta tipa kompozitash përcaktore *mbiemra*:

### 1. TIPI EMËR + EMËR

Ky tip ndahet në dy nëntipa sipas vendit që zë gjymtyra e përcaktuar:

a) *Gjymtyra e dytë përcakton të parën*, p.sh.: *gojëmjaltë*, *hundëshkabë*, *kokëshkëmb*, *sypetrit*, *zemërgur*, *zemërhekur* etj.

Këta mbiemra shprehin një tipar nëpërmjet një krahasimi, p.sh.: *hundëshkabë* «që e ka hundën të kthyer si sqepi i shkabës, ashtu siç e ka

---

1) Po kështu edhe për shqipërimin e një numri fjalësh prej anglishtes, gjermanishtes e rusishtes, të cilat në këto gjuhë nisin përkatësisht me elementet *self-*, *selbst-* e *samo-*, që kanë të njëjtin kuptim me *auto-*.



s hkaba, që e ka hundën si të shkabës» etj.

Ky tip është produktiv dhe aktiv si në gjuhën e folur të popullit, ashtu edhe në gjuhën e letërsisë artistike.

b) *Gjymtyra e parë përcakton të dytën*, e cila është një emër veprimi me prapashtesën *-(ë)s*, p.sh.: *dobiprurës, dritëdhënës, jetëdhënës, lirishtës, lotsjellës, punëdashës* etj.

Ky tip është produktiv dhe aktiv në gjuhën e sotme letrare, siç domos në fushën e terminologjisë tekniko-shkencore e në publicistikë.

## 2. TIPI EMËR + MBIEMËR

Te kompozitat e këtij tipi gjymtyra e parë përcaktohet nga e dyta, p.sh.: *belhollë, dorëmbarrë, dorëshpuar, dritëshkurtër, fije-hollë, flokëverdhe, syshkruar, vetullzi, zhurmëmadh* etj. Nga pikëpamja kuptimore mbiemrat e mësipërm zërthehen në këtë mënyrë: *belhollë* «që e ka belin të hollë», *dorëmbarrë* «që e ka dorën të mbarë» etj.; kështu kuptimi i tyre i përgjithshëm është i ngjashëm me atë të tipit *gojëmjaltë*.

Ky tip është produktiv dhe aktiv në gjuhën e sotme letrare.

**Shënim.** Ka disa kompozita mbiemërore të tipave *emër + emër* ose *emër + mbiemër*, njëra gjymtyrë e të cilave është e formuar prej pjesësh të bashkërenditura me lidhëzën *e*. Në kompozita të tilla midis lidhëzës *e* dhe pjesëve të bashkërenditura shënohet një vizë lidhëse<sup>1)</sup>, p.sh. *gjuhëhelm-e-thikë* (gjuhë) + (helm-e-thikë), *gushë-e-llërë-e-gjibardhoshe* (gushë-e-llërë-e-gji) + (bardhoshe), *shpirt-e-zemërmadh* (shpirt-e-zemër) + (madh) etj.

## 3. TIPI NUMËROR (OSE PËREMËR) + MBIEMËR

Si gjymtyrë e parë në këtë tip mund të shërbejë çdo numëror, ndërsa nga përemrat marrin pjesë ata që tregojnë sasi të papërcaktuar (zakonisht *shumë* e ndonjëherë *disa*), p.sh.: *njëvjeçar, njëditor, një-mujor, dyvjeçar, dhjetëvjeçar, i njëanshëm, i dyanshëm, i shumanshëm, shumëvjeçar, disavjeçar* etj.

Tipi është produktiv dhe aktiv në gjuhën e sotme letrare.

1) Shih edhe «Drejtshtkrimi i gjuhës shqipe» § 67 Ab, shënim.

**Shënim 1.** Mbiemrat e tipit *numëror + mujor, vjeçar*, që tregojnë njësi kohore, kthehen lehtë në emra, p.sh.: *tremujor,-i, gjashtëmujor,-i, nëntëmujor,-i* etj., *dyvjeçar,-i* (plan i dyvjeçar; një nga ish-institutet pedagogjike dyvjeçare; një fëmijë dyvjeçar), *trevjeçar,-i* (një nga institutet pedagogjike trevjeçare; një fëmijë trevjeçar), *pesëvjeçar,-i* (një periudhë prej pesë vjetësh; një plan pesëvjeçar), *gjashtëvjeçarë,-t* (fëmijët gjashtëvjeçarë), *pesëmbëdhjetëvjeçar,-i* (një i ri pesëmbëdhjetëvjeçar; një plan pesëmbëdhjetëvjeçar etj.), *njëzetvjeçarët* (të rinjtë njëzetvjeçarë) etj.; por duhet pasur parasysh se për të emërtuar periudha kohore prej dhjetë vjetësh e lart (zakonisht shumëfishe të dhjetës) përdoren formime të tipit *numëror + emrin vjetësh*, p.sh.: *dhjetëvjetëshi* (njëzetvjetëshi, tridhjetëvjetëshi) i parë i këtij shekulli etj. dhe jo *dhjetëvjeçari, njëzetvjeçari* etj. Mbiemrat e emëruar të këtij tipi, që kanë si gjymtyrë të dytë mbiemrin *ditor*, nuk janë normativë; në vend të tyre sot përdoren emrat e përbërë të tipit *numëror + emër në rrjedhore shumës të pashquar*, si *dhjetëditëshi, pesëmbëdhjetëditëshi, njëzetditëshi* etj. (dhe jo *dhjetëditori, pesëmbëdhjetëditori, njëzetditori* etj.). Mbiemri *dyjavor* (i vetmi mbiemër i tipit *numëror + javor* që përdoret sot) mund të emërzohet, p.sh.: *dyjavori i parë i shtatorit*, por krahas këtij, si variant fjalëformues normativ, përdoret edhe emri i përbërë *dyjavësh,-i*, i cili ka një përhapje më të gjerë.

**Shënim 2.** Në gjuhën e shtypit përdoren herë-herë disa mbiemra të përbërë, të formuar nga dy tema mbiemërore (nganjëherë tema e parë mund të jetë emër), njëra prej të cilave lidhet me një emër vendi (p.sh.: *korean, vietnamez, gjerman, amerikan*), ndërsa tjetra me emrin e një ane të horizontit (*verior, jugor, lindor, perëndimor*). Mbiemra të tillë janë: *koreanojugor* (ose *jugkorean*), *koreanoverior* (ose *verikorean*), *vietnamezoverior* (ose *verivietnamez*), *vietnamezojugor* (ose *jugvietnamez*), *amerikanoverior, amerikanojugor, gjermanoperëndimor* etj. Siç shihet, këta mbiemra lidhen me një emërtim gjeografiko-politik, si *Koreja e Jugut, Vietnami i Veriut, Gjermania Lindore* etj.

Kompozitat mbiemërore të mësipërme, që janë përkthime të drejtpërdrejta prej gjuhësh të huaja, nuk janë në pajtim me sistemin e formimit të fjalëve në gjuhën shqipe, prandaj kanë mbetur një numër i kufizuar dhe nuk kanë shërbyer si model për të formuar mbiemra të tjerë të ngjashëm<sup>1)</sup>. Struktura fjalëformuese e gjuhës shqipe kërkon që në vend të këtyre kompozitave mbiemërore të përdoret emërtimi gjeografik përkatës në rasën gjinore, p.sh.: *qeveria* kukull e **Koresë së Jugut** (dhe jo *koreanojugore*), *populli i Vietnamit të Veriut* (dhe jo *vietnamezoverior* ose *verivietnamez*), *skuadra përfaqësuese e Gjermanisë Perëndimore* (dhe jo *gjermanoperëndimore*), *industria kimike e Gjermanisë Lindore* (dhe jo *gjermano-lindore*), *imperializmi i Amerikës së Veriut* ose i *Amerikës Veriore* (dhe jo *amerikano-verior*), *patriotët e Irlandës së Veriut* ose e *Irlandës Veriore* (dhe jo *veriirlandezë*) etj.

1) Kështu nga emërtimet *Shqipëria e Veriut, Shqipëria e Jugut, Evropa Perëndimore* etj. nuk janë formuar mbiemra *shqiptaroverior* ose *verishqiptar, shqiptarojugor, evropianoperëndimor* etj.

## TIPAT KRYESORË TË KOMPOZITAVE FOLJE

§ 35. Foljet kompozita janë shumë më të pakta në krahasim me emrat e me mbiemrat. Sipas temave prej të cilave formohen, këto kompozita ndahen në dy tipa:

### 1. TIPI NDAJFOLJE + FOLJE

Në shumicën e rasteve si gjymtyrë e parë përdoren ndajfoljet *bashkë*, *brenda*, *jashtë*, *para*, *mirë*, *keq*, *tej*, p.sh.: *bashkëbisedoj* (*bashkë* + *bisedoj*), *bashkëfjalosem* (*bashkë* + *fjalosem*), *bashkëjetoj* (*bashkë* + *jetoj*), *bashkëpunoj* (*bashkë* + *punoj*), *bashkërendit* (*bashkë* + *rendit*), *bashkëveproj* (*bashkë* + *veproj*) etj.; *brendashkruaj* (*brenda* + *shkruaj*); *jashtëqes* (*jashtë* + *qes*), *jashtëshkruaj* (*jashtë* + *shkruaj*); *paracaktot* (*para* + *caktot*), *paralajmëroj*, (*para* + *lajmëroj*); *parandalot* (*para* + *ndalot*); *parandiej* (*para* + *ndiej*), *parapaguaj* (*para* + *paguaj*) etj.; *mirëpres* (*mirë* + *pres*), *mirëmbaj* (*mirë* + *mbaj*), etj., *keqkuptot* (*keq* + *kuptot*), *keqpërdor* (*keq* + *përdor*), *keqtrajtot* (*keq* + *trajtot*) etj.; *tejçot* (*tej* + *çot*), *tejkaloj* (*tej* + *kaloj*) etj.

Ky tip është produktiv dhe aktiv në gjuhën e sctme letrare.

### 2. TIPI EMËR + FOLJE

Ka fare pak folje të këtij tipi: *buzëqesh* (*buzë* + *qesh*), *duartrokas* (*duar* + *trokas*), *udhëheq* (*udhë* + *heq*).

Ky tip nuk është as produktiv, as aktiv.

**Shënim.** Kompozitat luajnë një rol të rëndësishëm për pasurimin e fjalorit, pasi ato shërbejnë shpeshherë edhe si tema për formimin e fjalëve të reja, d.m.th. për zgjerimin e vargut fjalëformues, p.sh.: *bregdet* — *bregdetar*, *bregdetas*; *fatkeq* — *fatkeqësi*, *fatkeqësisht*; *gjaknxehtë* — *gjaknxehtësi*; *kryeqytet* — *kryeqytetas*; *hekurjudhë* — *hekurudhor*; *rrobaqepës* — *rrobaqepësi*; *udhëheq* — *udhëheqës*, *udhëheqje*; *uglindje* — *juglindor* etj. Këto fjalë të prejardhura nga tema e një kompozite duhen dalluar nga kompozitat e vërteta të formuara nga bashkimi i dy temave: *bregdet*, *kryeqytet*, *fatkeq* etj. janë kompozita, ndërsa *bregdetar*, *kryeqytetas*, *fatkeqësi* etj. janë fjalë të prejardhura.

## KOMPOZITAT PA TAKIM

§ 36. Në gjuhën tonë letrare ndeshet edhe një tip kompozitash që quhen kompozita pa takim. Në këto raste kemi të bëjmë me dy a më shumë kompozita që e kanë gjymtyrën e dytë të përbashkët dhe që janë të bashkërenditura ndërmjet tyre. Për ta bërë më të shkurtër shprehjen, gjymtyra e përbashkët e tyre përmendet e shkruhet vetëm një herë te kompozita e dytë (ose te e fundit), ndërsa te kompozita e parë në vend të saj shënohet një vizë, p.sh.: në vend të: (shkollat) *tetëvjeçare dhe dymbëdhjetëvjeçare* shkruhet *tetë- dhe dymbëdhjetëvjeçare*; po kështu edhe: (vargje) *gjashtë- dhe tetërrrokëshe, (botime) dy- e mëshumëvëllimëshe, (ndërtesa) pesë- dhe gjashtëkatëshe, kamiona tre-, pesë- dhe shtatëtonësh* etj.<sup>1)</sup>

## SHKURTESAT

§ 37. Shkurtesat janë një tip i veçantë i kompozitave përcaktor re. Ato formohen nga bashkimi i dy a më shumë temave të shkuaruara. Shkurtesat janë vetëm emra. Ka dy tipa shkurtesash:

1. *Tipi rrokjesor*, kur bashkohen rrokjet e para të temave, p.sh.: *mapo* (magazinë popullore). Ky tip nuk është produktiv.

2. *Tipi me nistore*, kur bashkohen tingujt nistorë të fjalëve të një emërtimi të përbërë, p.sh.: *PTT, SMT, TEC*. Këto shkurtesa shqiptohen e lakohen si emra të gjinisë femërore a mashkullore: *sëmëtë,-ja, sëmëtësë, sëmëtënë, sëmëtëtë*; *tec,-i, tecit, tecin, tecet* etj.

Edhe ky tip nuk është produktiv e aktiv në formimin e emrave të përgjithshëm. Shkurtesat e këtij tipi që kanë kaluar në emra të përgjithshëm janë të pakta: *pëtëtë, sëmëtë, tec* etj. Por ky tip është aktiv në formimin e emërtimeve të shkurtuara të ndërmarrjeve, institucioneve e organizatave të ndryshme etj., si *PPSH, ATSH, BGSH, NTUS, NB, OKB* etj.

1) Shih për këtë edhe «Drejtshkrimi i gjuhës shqipe» § 67 Ab, shënim.

## C. FJALË TË FORMUARA NJËKOHËSISHT ME KOMPOZIM E ME PRAPASHTESIM

§ 38. Në gjuhën shqipe ka disa emra të formuar nga kompozimi i dy gjymtyrëve të një togfjalëshi frazeologjik, të cilave u shtohet një prapashtesë, p.sh.: *pjesëmarrës* (marr pjesë), *kryengritës* (ngrit-ur krye)<sup>1)</sup>, *marrëveshje* (marrë vesh) etj.

Emrat e formuar sipas mënyrës së mësipërme duhen dalluar mirë nga fjalët e përbëra që kanë si gjymtyrë të dytë një emër të prejardhur me prapashtesë, si edhe nga fjalët e prejardhura të formuara nga tema e një fjale të përbërë, p.sh.:

*gurgdhendës* formuar nga *gur* + *gdhendës*  
*kryeqytetas* » » *kryeqytet* + *as*, por:  
*kryengritës* » » (*ngrit-ur krye*) + (*-ës*)

Formimet e mësipërme të përfutuara nga kompozimi i gjymtyrëve të një togfjalëshi, duke u bashkuar me to një prapashtesë, nuk janë as produktive, as aktive në gjuhën e sotme letrare. Disa formime të përfutuara nga prapashtesimi i gjymtyrëve të një emri vetjak, si *asimzenelas,-it* (anëtar i kooperativës bujqësore «Asim Zeneli» ose nxënës i gjimnazit «Asim Zeneli»), *bajramcurras,-it* (banor i qytetit Bajram Curri) kanë mbetur gjithashtu të veçuara dhe nuk janë shndërruar në një model produktiv e aktiv.

## Ç. FJALËT E PËRNGJITURA

§ 39. Fjalët e përngjitura formohen nga bashkimi në një fjalë të vetme i dy a më shumë fjalëve të veçanta, zakonisht për arsye të përdorimit të gjatë të tyre njëra pranë tjetrës. Fjalë të përngjitura janë, p.sh., emrat *ecejake,-t* (ec e jakë), *farefis* (farë e fis), *gjëegjëzë* (gjë e gjëzë), *thashetheme* (thashë e them) etj.; numërorët *njëmbëdhjetë*

1) Siç shihet, në fjalën e re të formuar sipas mënyrës së mësipërme rendi i gjymtyrëve të togfjalëshit mund të përmbysset në mënyrë që prapashtesa -ës e emrave të veprimt të bashkohet me temën foljore.

(një mbë dhjetë), *dymbëdhjetë* ... *nëntëmbëdhjetë*, *njëqind* (një qind), *dyqind* etj.; përemrat e pakufishëm *asgjë* (as gjë), *askush* (as kush), *asnjeri*, *cilido*, *gjithçka*, *gjithfarë*, *ndonjë*, *ndonjëri*, *shumëkush*, *tjetërkush* etj.; ndajfoljet *anëmbanë* (anë e mbë anë), *asnjëherë* (as një herë), *atëherë* (atë herë), *menjëherë* (me një herë), *ndonjëherë* (ndonjë herë), *gjithnjë* (gjithë një), *padashur* (pa dashur), *përdhe* (për dhe), *qëkur* (që kur), *qëmoti* (që moti), *shkeleshko* (shkel e shko), *tejpërtej* (tej për tej) etj.; parafjalët *nëpër* (në për), *përmbi* (për mbi), *përveç*, *simbas* ose *sipas*, *ndërmjet* etj.; lidhëzat *derisa* (deri sa), *megjithatë* (me gjithë atë), *megjithëqë*, *meqë*, *mirëpo*, *qëkurse*, *sesa*, *siç* etj.; pas-thirrmat *faleminderit* (falemi nderit), *mirëmëngjes*, *mirëdita*, *tungjatjeta* etj.

Siç shihet nga këta shembuj, fjalët e përngjitura u takojnë më shumë pjesëve të pandryshueshme të ligjëratës (ndajfolje, parafjalë, lidhëza, pasthirrma), si edhe përemrave të pakufishëm.

Në disa raste elementet përbërëse të një fjale të përngjitur mund të përdoren pranë njëri-tjetrit si fjalë më vete, me një kuptim të ndryshëm nga ai i fjalës së përngjitur. Në këto raste ato nuk shkruhen njësh, por ndaras. Krahaso, p.sh.: *ka qenë dimër atëherë* dhe *nuk e kam takuar as atë herë*, *as këtë herë*; *kështu rronin njëherë* (dikur) dhe *ai vjen një herë në javë*; *gjimnastika duhet bërë përditë* dhe *qyteti ishte zbukuruar si për ditë feste*; *kjo ka ndodhur qëkur* (ose *qyshkur*) dhe *që kur ra dëborë u ftoh moti*; *përse nuk erdhi dhe për se është fjala*; po kështu edhe *nëse* (lidhëz) e *në se*; *ngase* (lidhëz) e *nga se*; *sesa* (lidhëz) e *se sa*; *seç* (pjesëz) e *se ç'* etj.<sup>1)</sup>

1) Shih për këtë edhe «Drejtskrimi i gjuhës shqipe» § 67 Aç, shënim.



PJESA E KATËRT

DISA NGA RREGULLAT KRYESORE TE  
DREITSHQIPTIMIT TE GIJHES LETRARE  
SHQIPE





## I. NJOHURI TË PËRGJITHSHME

### OBJEKTI I DREJTSHQIPTIMIT. DREJTSHQIPTIMI DHE DREJTSHKRIMI

§ 1. Në fazën e sotme sfera e përdorimit të gjuhës letrare të folur është zgjeruar shumë, prandaj krahas nevojës për vendosjen e normave drejtshkrimore shtrohet edhe nevoja për vendosjen e normave të njëjta drejtshqiptimore.

Drejtshqiptimi është një sistem rregullash që siguron shqiptimin e drejtë dhe të njëjlojtë të fjalëve. Ai mbështetet tek shqiptimi më i përgjithshëm letrar dhe jo tek shqiptimet e veçanta dialektore. Midis drejtshqiptimit dhe drejtshkrimit të gjuhës shqipe ekziston një lidhje e ngushtë; ata ndikojnë te njëri-tjetri. Parimi themelor i drejtshkrimit të shqipes është parimi fonetik: në përgjithësi fjalët dhe pjesët e tyre të kuptimshme shkruhen ashtu siç shqiptohen në ligjërimin letrar (sidomos në stilin e plotë të shqiptimit). Por, krahas parimit fonetik, drejtshkrimi i njësuar i shqipes mbështetet gjerësisht edhe në parimin morfologjik, i cili kërkon që fjalët dhe pjesët e tyre përbërëse të sistemit trajtëformues e fjalëformues të shkruhen njëjloj, pavarësisht nga ndryshimet tingullore të shkaktuara prej ligjeve fonetike që veprojnë sot në gjuhën tonë. Veprimi i parimit morfologjik në drejtshkrimin e gjuhës shqipe ndikon vazhdimisht edhe mbi drejtshqiptimin, pra jo vetëm shkruajmë ashtu siç shqiptojmë, por edhe shqiptojmë ashtu siç shkruajmë. Kur në shqiptimin letrar ka ende luhatje, drejtshqiptimi i nënshtrohet drejtshkrimit, sepse procesin e kristalizimit të normës gjuhësore letrare e udhëheq gjuha e shkruar.

Vendosja e normave të njësuar kombëtare bëhet në të gjitha hallkat e sistemit të gjuhës letrare, por, ndërsa për gjuhën e shkruar shqipe pas shumë përpjekjesh dhe pas një pune të vijueshme u arrit që të vendosen e të zbatohen nga të gjithë rregulla të njësuar, që pasqyrohen në «Drejtshkrimin e gjuhës shqipe», në gjuhën e folur normat e shqiptimit letrar po vendosen e po përgjithësohen më ngadalë. Në krahasim me njësimin e shkrimit, njësimi i shqiptimit arrihet më vonë. Ai është një proces i gjatë dhe i ndërlikuar. Burimi kryesor i shmanגיעve nga shqiptimi letrar është ndikimi i dialekteve. Duke i parë nga vlera shoqërore, normat e drejtshqiptimit kanë për trajtën e folur të gjuhës letrare po atë rëndësi që kanë normat e drejtshkrimit për trajtën e shkruar të saj. Gjuhësia shqiptare ka bërë përpjekje, sidomos në kohët e fundit, për të studjuar e për të përcaktuar edhe tiparet themelore të shqiptimit letrar kombëtar. Nga studimi i sistemit fonetik të gjuhës shqipe, i veçorive e i prirjeve të drejtshqiptimit dhe i lidhjeve të tij me drejtshkrimin është arritur në përfundime që lejojnë përcaktimin e rregullave kryesore të shqiptimit të sotëm letrar.

## STILET E SHQIPTIMIT

§ 2. Në gjuhën letrare dallohen dy stile shqiptimi: *stili i plotë* dhe *stili jo i plotë*.

*Stili i plotë* është karakteristik për ligjërimin letrar libror. Përdoret në rastet kur përpigemi të flasim rreptësisht sipas normave të gjuhës letrare (p.sh., në radio, në kongrese, në konferenca, në shkollë etj.). Ky stil shqiptimi i cili lidhet drejtpërdrejt me gjuhën e shkruar, karakterizohet nga artikullimi i shkoqur i tingujve, nga shqiptimi i tyre i plotë, pa i rrëgjuar, pa i shkurtuar dhe pa i shkrirë ata.

*Stili jo i plotë* është karakteristik për ligjërimin bisedor, d.m.th. për të folurit e zakonshëm, kur shqiptimit i kushtohet më pak vëmendje, tingujt shpeshherë rrëgjohen, shkurtohen a shkrihen.

Për qëllime të caktuara stilistike (për individualizimin e personazheve), përdoret në raste të veçanta shqiptimi dialektor, që përmban elemente që shkelin normën letrare ose s'përputhen me të.

## TINGUJT E GJUHËS LETRARE SHQIPE

§ 3. Për të kuptuar më lehtë rregullat e shqiptimit letrar, po japim disa njohuri për tingujt-fonema të gjuhës letrare shqipe.

Gjuha shqipe ka 7 zanore dhe 29 bashkëtingëllore. Kur shqiptojmë zanoret, ajri nuk ndesh pengesë gjatë rrugës së kalimit të tij, ndërsa, kur shqiptojmë bashkëtingëlloret, ndesh pengesë.

Zanoret, sipas shkallës së ngritjes së gjuhës, ndahen në:

*zanore të ngritjes së ulët: a;*

*zanore të ngritjes së mesme: e, o, ë;*

*zanore të ngritjes së lartë: i, y, u.*

Bashkëtingëlloret, sipas pjesëmarrjes së gjuhës ose të buzëve në formimin e tyre, ndahen në:

*bashkëtingëllore gjuhore: c, ç, d, dh, g, gj, h, j, k, l, ll, n, nj, q, r, rr, s, sh, t, th, x, xh, z, zh;*

*bashkëtingëllore buzore: b, f, m, p, v.*

Sipas tipit të pengesave, bashkëtingëlloret e gjuhës shqipe ndahen në:

*bashkëtingëllore pëlçitëse: b, c, ç, d, gj, k, p, q, t, x, xh;*

*bashkëtingëllore hundore: m, n, nj;*

*bashkëtingëllore fërkimore: dh, f, h, j, l, ll, s, sh, th, v, z, zh;*

*bashkëtingëllore dridhëse: r, rr.*

Sipas pjesëmarrjes ose mospjesëmarrjes së zërit, bashkëtingëlloret e gjuhës shqipe ndahen në:

*bashkëtingëllore të zëshme: j, l, ll, m, n, nj, r, rr, b, d, dh, g, gj, v, x, xh, z, zh;*

*bashkëtingëllore të shurdhëta: p, t, th, k, q, f, c, ç, s, sh, h.*

Brenda fjalës dy zanore mund të vijnë njëra pas tjetrës. Bashkimi i tyre në një rrokje të vetme quhet *diftong*. Në diftong njëra nga zanoret e humbet aftësinë rrokjeformuese dhe kthehet në gjysmëzanore. Të tilla janë zanoret *i, u* dhe *y*. Çdo diftong duhet të ketë,

pra, detyrimisht një nga këto gjysmëzanore. Brenda diftongut theksi mund të bjerë në zanoren e parë (p.sh. *ái, éi, ói*) ose në zanoren e dytë (p.sh.: *uá, ié, yé*). Në rastin e parë diftongu quhet zbritës, ndërsa në rastin e dytë, ngjitet. Kur dy zanore që janë pranë njëra-tjetrës, shqiptohen secila në rrokje më vete, ato përbëjnë një grup zanor (p.sh.: *ie* te *diell, miell* etj.; *ye* te *fyell, lyej* etj.; *ua* te *grua, luaj* etj.). Për stilin e plotë të shqiptimit është karakteristike që takimet e zanoreve *i, u* ose *y* të patheksuara me një zanore tjetër përgjithësisht shqiptohen si grup zanor e jo si diftong, p.sh.: *babai, vëllai, ftoi, kroi, kau, lau, dheu, preu, fshiu, miu, ftuan, gruan, shkuan*<sup>1)</sup> etj. (dhe jo *babaj vëllaj, ftoj* etj.<sup>2)</sup>), por takimet e trajtës së shkurtër *i* me një zanore tjetër (*ia dha, ia thashë, iu afrua* etj.) shqiptohen si diftong: *ja dha, ja thashë, ju afrua*.

Për gjuhën shqipe është karakteristike mungesa e bashkëtingëlloreve të dyfishta. Bën përjashtim vetëm bashkëtingëllorja *rr*, e cila është *r* dyfishe dhe përbën një fonemë më vete. Dallimi i tyre në disa raste shërben edhe për dallimin e kuptimeve të fjalëve, p.sh.: *arë* (tokë buke), dhe *arrë* (pëmë), *ruaj* (*shtëpinë*) dhe *rruaj* (mjekrën) etj.

Një tjetër veçori e gjuhës shqipe është se shqiptimi ka karakter rrokjesor, d.m.th. nuk shqiptohet çdo tingull veças (p.sh., *d-o-r-a, p-u-n-ë, n-x-ë-n-ë-s* etj.), por tingujt e fjalëve në fjali shqiptohen të lidhur në rrokje (*do-ra, pu-në, nxë-nës* etj.).

## II. DREJTSHQIPTIMI I ZANOREVE

### ZANORJA E E THEKSUAR

§ 4. Fjalët me e të theksuar, të ndjekur nga një bashkëtingëllore hundore (*m, n, nj*), në pajtim me shkrimin dhe shqiptimin më të përhapur të tyre, duhet të shqiptohen të gjitha me e dhe jo disa

- 1) Grupi *ua* shqiptohet si diftong te disa fjalë të huaja, si *kuádro, kuárc, kuótë* etj.
- 2) Shenja *í* e vendosur nën zanore tregon se ajo shqiptohet si gjysmëzanore dhe formon një diftong me zanoren fqinjë.

me e e disa me ë. Me e duhet të shqiptohen gjithashtu fjalët e prejardhura ose të përbëra të formuara prej tyre, pavarësisht nga lëvizja e theksit. Po radhitim më poshtë një numër fjalësh të tilla, të cilat shpeshherë dëgjohen të shqiptuara edhe me -ë:

(më) *dhemb, dhembje, emër, emërore, femër, femërore, gjemb, gjembaç, e premtë, shemb, shembull, shembullor, i pashembullt, i shtrembër, shtrembërim, shtrembëroj, tremb, trembje, i patrembshëm, thembër, zemër, zemëroj, zemërim, i përzemërt* etj. (dhe jo më *dhëmb, dhëmbje, ëmër* etj.).

*argjend, argjendar, argjendari, argjendpunues, (i,e) argjendtë, brenda, brendësi, brendi, i brendshëm, çmend, çmendinë, (i,e) çmendur, çmenduri, dend, (i,e) dendur, denduri, deng, dhen, end, gjendje, kuvend, kuvendim, kuvendoj, mend, mendim, mendje, mendor, përmend, përmendore, parmendë, qendër, qendror, (kam) qenë, qenësi, qenësore, qenie, qengj, shpend, tendë, tendos, i tendosur, vend, vendës, vendos, zëvendës, zëvendësim, zëvendësoj* (dhe jo *argjënd, brënda, çmënd* etj.);  
*e enjte, gështenjë, gështenjëpjekës, i gështenjtë, ndenja, (i,e) ndenjnjur, shenjë, (i,e) shenjtë, (i,e) shtrenjtë, shtrenjtësi, shtrenjtoj* etj. (dhe jo *e ënjte, gështënjë* etj.).

## ZANORJA Ë

§ 5. Zanorja ë mund të jetë e theksuar dhe e patheksuar. Në shqiptimin e tyre ka dallim. Kur është e theksuar, zanorja ë shqiptohet më e fortë, ndërsa kur është e patheksuar, shqiptohet më e dobët.

Një nga problemet më të ndërlikuara të drejtshqiptimi të gjuhës sonë përbën zanorja ë e patheksuar. Sipas studimeve që kanë bërë gjuhëtarët tanë në fushën e fonetikës së sotme të shqipes, ë-ja e patheksuar është një tingull i shkurtër, i reduktuar, i ngritjes së mesme; hyn në grupin e zanoreve që quhen të lëvizshme, të paqëndrueshme. Kur kjo zanore është e patheksuar, në përgjithësi ruhet më mirë në ligjërimin libror dhe në të folurit e ngadalshëm, ndërsa në ligjërimin bisedor dhe në të folurit e shpejtë rrudhet (reduktohet) në shkallë të ndryshme.

Ë-ja e patheksuar dobësohet në shkallë të ndryshme sipas pozicionit në të cilin ndodhet. Ky dobësim ka çuar në disa raste (kur

ë-ja fundore ka qenë dy rrokje larg theksit, si tek *flútur(ë)*, *dáshur(ë)*, *bóitën(ë)* që ajo të mos shqiptohet fare dhe kjo gjë të pasqyrohet edhe në normën e sotme drejtshkrimore.

## ZANORJA Ë E THEKSUAR

§ 6. Fjalët tek të cilat ë-ja e theksuar i përgjigjet historikisht një a-je të ndjekur nga një bashkëtingëllore hundore, shqiptohen me ë dhe jo me a<sup>1</sup>). Po kështu shqiptohen me ë edhe të gjitha fjalët e prejardhura ose të përbëra prej tyre, pavarësisht nga lëvizja e theksit, p.sh.: *běj, çështje, dëm, dëmtim, dëmtoj, (i,e) dëmtuar, dhëmb, dhëmballë, dhëndër, dhënë, dhënie, (i,e) ëmbël, ëmbëlsirë, ëmbëlsoj, ëmbëltore, këngë, këngëtar, lëndë, lëng, (i) lëngshëm, mbrëmje, mëngë, nëntë, nxënë, rrënjë, rrënjësor, parathënie* etj.

Duhet pasur kujdes për fjalët: (unë) *lë, një, njëjës, i njëjtë, njëri, njëra, njësi*, (unë) *vë, (unë) zë*, të cilat shpeshherë shqiptohen gabimisht me e ose i në vend të ë-së (*le, nji, njejës, i njejtë, njeri, njera, ve, ze*).

Të gjitha këto fjalë duhet të shqiptohen me ë<sup>2</sup>).

Prapashtesa **-llëk** duhet të shqiptohet kurdoherë me ë, ashtu sikurse shkruhet, dhe jo me i:

<i>batakçillëk, batakçillëqe</i>	dhe jo	<i>batakçillik, batakçilliqe</i>
<i>bollëk</i>	» »	<i>bollik</i>
<i>boshllëk, boshllëqe</i>	» »	<i>boshllik, boshlliqe</i>
<i>budallallëk, budallallëqe</i>	» »	<i>budallallik, budallalliqe</i>
<i>fodullëk</i>	» »	<i>fodullik</i>
<i>hamallëk</i>	» »	<i>hamallik</i>
<i>matrapazllëk, matrapazllëqe</i>	» »	<i>matrapazllik, matrapazlliqe</i>
<i>pazarllëk, pazarllëqe</i>	» »	<i>pazarllik, pazarlliqe</i>
<i>pishmanllëk</i>	» »	<i>pishmanllik</i>
<i>tersllëk, tersllëqe</i>	» »	<i>tersllik, terslliqe</i>

1) Fjalët si *dhanore, (i,e) mangët, ranishte, ranor-e, i pashmangshëm, zanë, zanore* etj., që kanë hyrë në gjuhën letrare me a, shqiptohen e shkruhen me a (shih edhe «Drejtshkrimi i gjuhës shqipe» § 2 shënim).

2) Shqiptohen me e, ashtu sikurse shkruhen, fjalët: *i gjerë, gjerësi, gjerësisht, zgjeroj, zgjerim, krehër*.

## ZANORJA Ë E PATHEKSUAR

§ 7. Zanorja ë e patheksuar mund të ndodhet para rrokjes së theksuar, p.sh.: *anëtar, dëbórë, ftohtësi* ose pas rrokjes së theksuar në trup a në fund të fjalës, p.sh.: *marksizëm, (i, e) pástër, vëgël, dásme, partizánë, púnë* etj.

## ZANORJA Ë PARATHEKSORE

§ 8. Zanorja ë paratheksore mund të ndodhet në rrokje të hapur, p.sh.: *a-në-tar, kë-mbë-sor* ose në rrokje të mbyllur, p.sh.: *e-gër-si, ndër-tim*. Zanorja ë paratheksore takohet te këta tipa fjalësh:

a) *Ë-ja* paratheksore te fjalët e parme dhe te fjalët ku ajo ndodhet në rrokjen e parë.

Ë-ja paratheksore e kësaj kategorie fjalësh në rrokje të mbyllur shkruhet dhe shqiptohet, p.sh.: *dërgoj, fërkim, gëlqere, gëlltit, gërmadhë, kërbaç, kërcej, përçues, përfshij, përparoj, ndërkombëtar, ndërmjet, ndërtoj, vërtet, vërtetoj* etj.

Ë-ja paratheksore në rrokje të hapur, kur ndodhet në rrokjen e parë, shqiptohet qartë, p.sh.: *dëshirë, fëmijë, kënetë, këpucar, mënyrë, mësim, shëtit* etj. Megjithatë, në disa fjalë ku pas ë-së vjen bashkëtingëllorja **rr**, si p.sh.: *bërryl, gërryej, kërrabë, kërrusem, ndërroj, ndërresë, përrallë* etj., ë-ja shqiptohet mjaft e rrudhur. Sipas drejtshkrimit, fjalët e mësipërme shkruhen me ë, por në gjuhën letrare kjo ë shqiptohet mjaft e rrudhur.

b) *Ë-ja* paratheksore te fjalët e prejardhura me prapashtesa

Shkalla e shqiptimit të ë-së paratheksore e cila shkruhet rregullisht te fjalët e prejardhura të formuara nga një temë më ë me anë prapashtesash që nisin më bashkëtingëllore (p.sh., *copëtoj — copë + toj*) dhe te fjalët e tjera të prejardhura ku ajo shkruhet si zanore mbështetëse (*bujqësi — bujq + ë + si*), varet në një farë mase nga natyra e bashkëtingëlloreve që ndodhen para dhe pas ë-së. Kur këto bashkëtingëllore formojnë një grup që shqiptohet me lehtësi, pa ndër-



mjetësinë e zanores ë, atëherë kjo zanore shqiptohet në mënyrë shumë të rrudhur.

Në rastet e tjera, e sidomos kur tema fjalëformuese del me dy bashkëtingëllore, shqiptohet një ë më pak ose më shumë e rrudhur, por, sidoqoftë, më e qartë; shkalla e rrudhjes së ë-së në këto raste varet edhe nga stili i shqiptimit. Në stilin e plotë të shqiptimit ajo ndihet më e qartë, ndërsa në stilin jo të plotë, më e dobët. E rrëgjuar shqiptohet ë-ja, për shembull, te fjalët e mëposhtme: *gjatësi, gjerësi, gjuhësi, gjuhëtar, gjunjëzoi, hollësi, këmbësor, këmbësori, kombësi, kombëtar, kordhëtar, lartësi, madhësi, malësor, mbarësi, mirësi, mjekësi, mjekësore, përmirësoj, pemëtore, pikëllim, plotësoj, qetësi, rreptësi, rrogëtar, shkallëzim, shpejtësi, shterpësi, trashësi, thatësi, vesh-tirësi, vjershëtar, zdrukthëtar, zotëroj* etj.<sup>1)</sup>, por në rastet kur tema fjalëformuese del më dy bashkëtingëllore (si te *kombësi, kordhëtar, rreptësi, shterpësi, zdrukthëtar* etj.) shqiptimi i ë-së është më i qartë.

Te fjalët e prejardhura të formuara prej temash më -ër, -ërr, -ël, -ës, -ëz me anë prapashtesash që fillojnë me zanore, si p.sh.: *arbëror, breshëri, dimëror, gjelbërim, mjeshtëri, numëror, urdhëresë; ëndërrim; vegjëli, zvogëloj, zvogëlim; nëpunësi, përgjegjësi; bulëzon, njerëzi, njerëzor* etj., drejtshqiptimi përputhet me drejtshkrimin, d.m.th., ë-ja paratheksore shqiptohet e qartë.

Në përgjithësi, në ligjërimin libror, ku shqiptimi përputhet me drejtshkrimin ose i afrohet sa më shumë atij, ë-ja paratheksore ruhet më mirë, ndërsa në ligjërimin bisedor kjo ë rrudhet.

c) *Ë-ja* paratheksore në kufi të temave te fjalët e përbëra dhe të përngjitura.

*Ë-ja* e patheksuar mund të ndodhet në pozicionin paratheksor edhe në kufi të temave te fjalët e përbëra dhe të përngjitura (p.sh.: *armëpushim, datëlindje, i gjithëfuqishëm, atëherë, vërejtje* etj.).

Kur fjalët e përbëra dhe të përngjitura kanë si pjesë të parë një temë më ë të patheksuar, të ndjekur nga një temë më bashkëtingëllore,

1) Në të dy stilet shqiptohen pa ë (në përputhje me drejtshkrimin) fjalët: *amtar, besnik, fillestar, furratar, kishtar, lojtar, meshtar, nevojtar, nevojtare, ngatërrestar, pishtar, rojtar, zyrtar.*

p.sh.: *botëkuptim* (botë + kuptim) *dorëshkrim* (dorë + shkrim), *gjashtëdhjetë* (gjashhtë + dhjetë), *naftësjellës* (naftë + sjellës), *pesëvjeçar* (pesë + vjeçar) etj., kjo ë shqiptohet afërsisht si edhe ë-ja e patheksuar në fund të fjalës, kur pas saj vjen një fjalë tjetër që fillon me bashkëtingëllore (shih më poshtë § 10).

Kur fjalët e përbëra dhe të përngjitura kanë si pjesë të parë një temë më ë të theksuar të ndjekur nga një temë që nis qoftë me bashkëtingëllore, qoftë me zanore, kjo ë shqiptohet e plotë, p.sh.: *njëanësi* (një + anësi), *njëditor* (një + ditor), *njëherë* (një + herë), *njëkatëshe* (një + katëshe), *vëmendje* (vë + mendje), *vërej*, *vërejtje* (vë + re), *zëëmbël* (zë + ëmbël).

Kur fjalët e përbëra dhe të përngjitura kanë si pjesë të parë një temë më -ë të patheksuar, të ndjekur nga një temë që fillon me zanore, ë-ja fundore e temës së parë nuk shqiptohet dhe nuk shkruhet, pra: *gojëmbël* (gojë + ëmbël), *kokulur* (kokë + ulur), *i shumanshëm* (shumë + anshëm) (dhe jo *gojëëmbël*, *kokëulur*, *i shumëanshëm*).

Te përemrat e pakufishëm, te ndajfoljet e te lidhëzat e përngjitura që kanë si pjesë të parë fjalët *gjithë* ose *kurrë*, ë-ja paratheksore as shqiptohet, as shkruhet, p.sh.: *gjithçka*, *gjithfarë*, *gjithherë*, *kurrjë*, *kurrkund*, *kurrkush*, *kurrsesi* etj. (dhe jo *gjithëfarë*, *gjithëherë*, *gjithëkund*, *gjithëmonë*, *gjithënjë*, *kurrësesi* etj.)<sup>1)</sup>.

## ZANORJA Ë PASTHEKSORE

### A. Ë-ja pastheksore jofundore

§ 9. Zanorja ë pastheksore jofundore shqiptohet e plotë në të gjitha rastet kur ndodhet në rrokje të mbyllur, p.sh.: *bukël*, *i ëmbël*, *gupël*, *vegël*, *i vogël* etj.; *ajër*, *dimër*, *dhelpër*, *i gjelbër*, *i kaltër*, *zemër* ptj.; *dokërr*, *kokërr*, *vjehërr* etj.; *blerës*, *çelës*, *djegës*, *grykës*, *nxënës*, *tronditës*, *ujitës*, *vendës* etj.; *pesëkatësh*, *shumëngjyrësh*, *tetërrokësh*, *trekëndësh* etj.; *të dalësh*, *të flasësh*, *të hapësh*, *të marrësh* etj.; *drejtëz*, *gjuhëz*, *këmbëz* etj.; *ateizëm*, *çiklizëm*, *marksizëm*, *reumatizëm* etj.;

1) *Gjithë* dhe *kurrë*, kur kanë përdorim të mëvetësishëm, shqiptohen dhe shkruhen me ë.

*i cekët, i dobët, të dobëtve, i errët, i shkathët, të shkathëtve, të shkathëtish etj.; i jashtëm, i jashtëmve, i sotëm, të sotëmve, i vetëm, të vetëmve etj.; i ardhshëm, të ardhshëmve, i atjeshëm, të atjeshëmve, i ndershëm, të ndershëmve etj.*

Kur gjatë ndryshimit të fjalës ë-ja e rrokjes së mbyllur del në rrokje të hapur, në disa tipa fjalësh ajo nuk shqiptohet fare, kurse në disa tipa të tjerë shqiptohet e rrëgjuar.

1) Ë-ja pastheksore nuk shqiptohet dhe nuk shkruhet në këto raste:

a) tek emrat dhe mbiemrat më -ël, -ër, -ërr gjatë lakimit të tyre: *vegël*, por: *vegle, vegla, veglës, veglën, veglat, veglash* (dhe jo *vegële, vegëla, vegëlës, vegëlën, vegëlat, vegëlash*);

*dhelpër*, por: *dhelpre, dhelpra, dhelprës, dhelprën, dhelprat, dhelprash* (dhe jo *dhelpëre, dhelpëra, dhelpërës, dhelpërën, dhelpërat, dhelpërash*);

*i ashpër*, por: *i ashpri, të ashprit, të ashprin, të ashprit* (dhe jo *i ashpëri, të ashpërit, të ashpërin, të ashpërit*);

*kokërr*, por: *kokrre, kokrra, kokrrës, kokrrën, kokrrat, kokrrash* (dhe jo *kokërre, kokërra, kokërrës, kokërrën, kokërrat, kokërrash*);

b) tek mbiemrat me prapashtesën -ëm ose -shëm gjatë lakimit, kur pas këtyre prapashtesave vjen një zanore ose bashkëtingëllorja **j**: *i jashtëm*, por: *i jashtmi, të jashtmit, të jashtmin, e jashtme, e jashtmja, të jashtmen, të jashtmet* (dhe jo *i jashtëmi, të jashtëmit, të jashtëmin, e jashtëme, e jashtëmja, të jashtëmen, të jashtëmet*);

*i vetëm*, por: *i vetmi, të vetmit, të vetmin, e vetme, e vetmja, të vetmen, të vetmet* (dhe jo *i vetëmi, të vetëmit, të vetëmin, e vetëme, e vetëmja, të vetëmen, të vetëmet*);

*i besueshëm*, por: *i besueshmi, të besueshmit, të besueshmin, e besueshme, e besueshmja, të besueshmen, të besueshmet* (dhe jo *i besueshëmi, të besueshëmit, të besueshëmin, e besueshëme, e besueshëmja, të besueshëmen, të besueshëmet*);

*i shkëlqyeshëm*, por: *i shkëlqyeshmi, të shkëlqyeshmit, të shkëlqyeshmin, e shkëlqyeshme, e shkëlqyeshmja, të shkëlqyeshmen, të shkëlqyeshmet* (dhe jo *i shkëlqyeshëmi, të shkëlqyeshëmit, të shkëlqyeshëmin, e shkëlqyeshëme, e shkëlqyeshëmja, të shkëlqyeshëmen, të shkëlqyeshëmet*).

Shënim. Për të njëjtën arsye nuk shqiptohen dhe nuk shkruhen me ë edhe mbiemrat e formuar me prapashtesën *-shëm* nga një temë me ë (sepse ë-ja fundore e këtyre temave del në rrokje të hapur): *i natyrshëm* (natyrë), *i përkohshëm* (kohë), *i pjesshëm* (pjesë), *i përbotshëm* (botë) (dhe jo *i natyrëshëm*, *i përkohëshëm*, *i pjesëshëm*, *i përbotëshëm* etj.).

2) Ë-ja pastheksore shqiptohet e rrëgjuar dhe shkruhet në këto raste:

a) tek emrat femërorë më *-ëz*, tek emrat e mbiemrat mashkullore më *-ës*, *-ësh* dhe te femërorët përkatës:

*drejtëz, drejtëze, drejtëza, drejtëzës, drejtëzën, drejtëzash;*

*lidhëz, lidhëze, lidhëza, lidhëzës, lidhëzën, lidhëzash;*

*çelës, çelësi, çelësa, çelësash;*

*shpikëse, shpikëseje, shpikëset, shpikëseve;*

b) tek mbiemrat më *-ët* gjatë lakimit të tyre:

*i cekët, i cekëti, të cekëtin, të cekëtit;*

*i dobët, i dobëti, të dobëtin, të dobëtit;*

*i ulët, i ulëti, të ulëtin, të ulëtit.*

## B. Ë-ja pastheksore fundore

§ 10. Zanorja ë pastheksore mund të ndodhet edhe në pozicion fundor, p.sh.: *(i,e) artë, barkë, basmë, darkë, deriçkë, djemtë, festë, leckë, (të) lidhë, (i,e) mbjellë, ngushtë, pesë, (të) punojmë, (i,e) sheshtë, trajtë* etj.

Në stilin e plotë të shqiptimit ë-ja fundore, megjithëse rrudhet, ndihet mjaft qartë.

Kur ë-ja fundore ndodhet pas dy bashkëtingëlloresh, shqiptohet më qartë sesa kur ndodhet pas një bashkëtingëlloreje:

a) pas një bashkëtingëlloreje: *bukë, (i,e) butë, çfarë, dhjetë, (i,e) gjallë, (i,e) lirë, (i,e) mirë, njëherë, pesë, (i,e) qetë, rrallë (i,e) thatë, thellë* etj.;

b) pas dy bashkëtingëlloresh: *(i,e) barabartë, (i,e) bardhë, bashkë, (i,e) brishtë, (i,e) çelikutë, dackë, darkë, (i,e) drejtë, (i,e) fortë, (i,e) gaztë, gjashtë, lehtë, (i,e) rreptë, (i,e) thartë, urtë, (i,e) zjarhtë* etj.

Në stilin jo të plotë ë-ja fundore shqiptohet më dobët, si një tingullth i shkurtër, mjaft i rrudhur.

Ë-ja e patheksuar fundore në gjuhën shqipe kryen disa funksione. Ajo mund të shërbejë si tregues gramatikor i gjinisë (*ditë, klasë, punë*), si tregues i shumësit (*një artist — shumë artistë, një shok — shumë shokë, një patriot — shumë patriotë*), si prapashtesë (*plak — plakë, zog — zogë*), për të mënjeluar homoniminë, p.sh., *pres* (një dru), *presë* (e sëpatës), *lajm* (emër), *lajmë* (folje), *ar* (metal), *arë* (tokë) etj.

Në shqiptimin e plotë letrar këto funksione të ë-së fundore të patheksuar shprehen me ruajtjen e saj gjatë shqiptimit.

Shkalla e rrudhjes së zanores ë fundore varet edhe nga natyra e tingullit të parë të fjalës ndjekëse:

Kur fjala ndjekëse nis me bashkëtingëllore të shurdhët, ë-ja fundore ndihet më qartë, p.sh.: *bukë thekre, buzë kufirit, dhjetë copë, krijimtarisë sonë, luftë çlirimtare, palë kundërshtare, pesë shekuj, rrugë shpëtimi* etj. (te këta shembuj ë-ja fundore ndiqet nga bashkëtingëlloret e shurdhëta **th, k, c, s, ç, sh**, prandaj dëgjohet më qartë).

Përpara një bashkëtingëlloreje të zëshme ndihet e rrudhur, e dobët, p.sh., *ditë vere, pranë dritares, shumë grurë* etj.

Përpara një zanoreje të fjalës ndjekëse ë-ja fundore e patheksuar (p.sh.: *arti ynë i ri, burrë i gjatë, dritë elektrike, forcë e brendshme, fushë e gjerë, pjesë e pandarë* etj.) shqiptohet e qartë në stilin e plotë, sidomos në shkollë e në raste të tjera që kërkojnë qartësi e saktësi sa më të madhe gjuhësore në kumtimin e mendimit, ndërsa në ligjërimin bisedor mund të rrudhet në shkallë të ndryshme.

Ë-ja fundore mungon krejt në të dy stilet e shqiptimit tek nyjat e përparme të, së me kuptim pronor në rasat e zhdrejta të emrave *i ati, e ëma: (i,e) t'et, (i,e) s'ëmës* etj.

Për arsye të ndryshme, kryesisht nën ndikimin e ligjërimeve dialektore e të disa varianteve drejtshkrimore të mëparshme, në disa raste (shih më poshtë) shqiptohet dhe shkruhet gabimisht një ë e tepërt, e panevojshme. Kjo ë fundore as duhet shqiptuar dhe as duhet shkruar. Shkrimi e shqiptimi i gabuar i një ë-je të tillë vihet re sidomos:

a) te emrat që në shumësin e pashquar dalin më bashkëtingëlloret

**-gj -q** të prira nga një zanore: disa herë shkruhet e shqiptohet gabimisht *zogjë,-t, zogjësh, fiqë,-t, fiqësh, pleqë,-t, pleqëve, pleqësh*, kurse duhet shkruar e shqiptuar *zogj,-të, zogjsh, fiq,-të, fiqsh, pleq,-të, pleqve, pleqsh* etj.;

b) te emrat që në shumësin e pashquar dalin më *-j, -nj*: disa herë shkruhet e shqiptohet gabimisht *bijë,-t, bijëve, bijësh, ftonjë,-t, ftonjëve, ftonjësh, heronjë,-t, heronjëve, heronjësh, thonjë,-t, thonjëve, thonjësh*, kurse duhet shkruar e shqiptuar: *bij,-të, bijve, bijsh, ftonj,-të, ftonjve, ftonjsh, heronj,-të, heronjve, heronjsh, thonj,-të, thonjve, thonjsh* etj.;

c) te rrjedhorja e pashquar e shumësit të emrave që mbarojnë me zanore të theksuar: disa herë shkruhet e shqiptohet gabimisht *grashë, shtëpishë, drushë, syshë*, kurse duhet shkruar e shqiptuar *drush, grash, sysh, shtëpish*;

ç) te një numër emrash e mbiemrash me theks në rrokjen e para-fundit: disa herë shkruhet e shqiptohet *fluturë, kodërë, dhelpërë, rregullë, vetullë, dhëmbëzë, lidhëzë, i hekurtë, i tepërtë, i afërmë, i sipërmë*; kurse duhet shkruar e shqiptuar *flutur, kodër, dhelpër, rregull, vetull, dhëmbëz, lidhëz, i hekurt, i tepërt, i afërm, i sipërm* etj.; po kështu edhe te disa trajta të lakimit të emrave: disa herë shkruhet e shqiptohet *botësë, botënë, këngësë, këngënë*<sup>1)</sup>, kurse duhet shquar e shqiptuar *botës, botën, këngës, këngën*.

**Shënim 1.** Shqiptohen dhe shkruhen me *-të* dhe jo me *ët* në trajtën e shquar emrat:

<i>cjep</i> — <i>cjepë</i>	dhe jo	<i>cjepët</i>
<i>desh</i> — <i>deshtë</i>	»	» <i>deshët</i>
<i>djem</i> — <i>djemtë</i>	»	» <i>djemët</i>
<i>dhen</i> — <i>dhentë</i>	»	» <i>dhenët</i>
<i>qen</i> — <i>qentë</i>	»	» <i>qenët</i> .

Rasat e zhdrejta të shumësit të emrave të mësipërm shkruhen dhe shqiptohen pa *ë* fundore, prandaj edhe para mbaresave *-ve* dhe *-sh* te këta emra nuk shkruhet e nuk shqiptohet ndonjë *ë*:

<i>cjep</i> — <i>cjepve, cjepsh</i> (dhe jo <i>cjepëve; cjepësh</i> );
<i>desh</i> — <i>deshve</i> (dhe jo <i>deshëve, por deshësh</i> <sup>2)</sup> );
<i>dhen</i> — <i>dhenve, dhensh</i> (dhe jo <i>dhenëve, dhenësh</i> );
<i>qen</i> — <i>qenve, qensh</i> (dhe jo <i>qenëve, qenësh</i> ).

1) Shih për këtë § 5.

2) Këtu *ë*-ja shkruhet dhe shqiptohet për të shmangur takimin e dy *sh*-ve.

Shënim 2. a) Shqiptohen dhe shkruhen me -më dhe jo -ëm në trajtën e njëjësit të pashquar emrat femërorë:

<i>bashtë</i>	dhe jo	<i>basëm</i>
<i>çezhtë</i>	» »	<i>çezëm</i>
<i>dashtë</i>	» »	<i>dasëm</i>
<i>ferhtë</i>	» »	<i>ferëm</i>
<i>gjyshtë</i>	» »	<i>gjysëm</i>
<i>kazhtë</i>	» »	<i>kazëm</i>
<i>krishtë</i>	» »	<i>krisëm</i>

b) Emrat që dalin me grupin -lm, si: *film, ngulm, sulm*, shqiptohen ashtu siç s shkruhen. Shqiptimi me -ë- (*filëm, kulëm, ngulëm, sulëm*), është i gabuar.

## ZANORET U DHE Y

§ 11. Për shqiptimin e zanoreve u dhe y duhet të kemi parasysh që:

1) Tek emrat dhe mbiemrat më -ull, -ur zanorja u shqiptohet në të gjitha rasat, ashtu siç shkruhet:

a) <i>akulli, akullin</i>	dhe jo	<i>aklli, akllin</i>
<i>kukulla, kukullash</i>	» »	<i>kuklla, kukllash</i>
<i>kumbulla, kumbullave</i>	» »	<i>kumblla, kumbllave</i>
<i>nofulla, nofullën</i>	» »	<i>noflla nofillën</i>
<i>petulla, petullat</i>	» »	<i>petlla, petllat</i>
<i>sqetulla, sqetullave</i>	» »	<i>sqetilla, sqetillave</i>
<i>uthull-a, uthullën</i>	» »	<i>uthlla, ufla, uthllën, ufillën</i>
<i>vetulla, vetullës</i>	» »	<i>vetlla, veillës etj.</i>
b) <i>flutura, fluturën</i>	» »	<i>flutra, flutrën</i>
<i>hekuri, hekurave</i>	» »	<i>hekri, hekrave</i>
<i>lepuri, lepurin</i>	» »	<i>lepri, leprin</i>
<i>i bukuri të bukurat</i>	» »	<i>i bukri të bukrat.</i>

2) Shqiptohen e shkruhen me u dhe jo me y fjalët:

*bufe, bulmet, bulmetore, duke (mësuar), duzinë, fruta,-t, frutore, grunjëra, (i,e) grunjtë, gjurmë, gjurmashkë, gjurmoj, sfungjer, temperaturë, tuberkuloz, tunel, turk, turqisht, turli etj.*

3) Shqiptohen e shkruhen me *y* dhe jo me *u* fjalët: *byrazer, dyqan, fryt*<sup>1)</sup>, *i frytshëm, frytdhënës, gjynah, mysafir, mysliman, myshteri, trysni, yndyrë, virtyt* etj.

## ZANORJA I

§ 12. I-ja është zanore e radhës së përparme, e ngritjes së lartë. Në rastet e mëposhtme kjo zanore në ligjërimin letrar shqiptohet i dhe jo y:

a) Te fjalët ku kjo zanore është e theksuar dhe ndodhet para një bashkëtingëlloreje buzore, p.sh.: *hip, krimb, kripë, kripore, qilim, rrip, shqip* etj. (por: *lyp, lypës*);

b) Te fjalët ndërkombëtare, si *hidrocentral, hidrogjen, hidrolizë, hipotekë, hipotension, idil, mister, mitologji* etj.

Shqiptimi i fjalëve të grupeve *a* e *b* me *y* (*hyp, krymb, krypë, kryp, krypore, qylym, rryp, shqyp; hydrocentral, hidrogjen, hidrolizë, hypotekë, hypotension, idyl, myster, mytologji*) është në kundërshtim me normën e sotme letrare.

## GRUPI I ZANOREVE IE

§ 13. Emrat tek të cilët grupi zanor *ie* ndiqet nga një bashkëtingëllore e lëngët (*I, ll, r*) si *e diel, diell, miell, qiell, fier* si edhe fjalët e formuara prej tyre, si *diellor, qiellor, fierishtë* etj., shqiptohen me *ie* (me theksin në elementin e parë: *diell, qiell* dhe jo me *je* (me theksin në elementin e dytë: *djëll, qjëll*).

Ky grup ruhet si i tillë në shqiptim edhe te foljet, tek të cilat ndiqet nga mbaresa *-j*: *ziej, zien, ziejnë; përzien, përziejmë; ndiej, ndiejmë, ndiejnë*<sup>2)</sup>. Këto folje do të shqiptohen me *je* vetëm në trajtat e njëjësit të së kryerës së thjeshtë të dëftores (*zjeva, zjeve, zjeu; përzjeva, përzjeve, përzjeu; ndjeva, ndjeve, ndjeu*) dhe në trajtat e dëshirores (*zjefsha, zjefsh, zjefstë, zjefshim, zjefshi, zjefshin; përzjefsha, përzjefsh, përzjefstë; ndjefsha, ndjefstë, ndjefshim, ndjefshi, ndjefshin*).

1) Duhet dalluar në shqiptim, ashtu si edhe në shkrim, emri *frutë, fruta* (me kuptimin «pemë») nga *fryt,-i* (me kuptim abstrakt «fryti i punës»).

2) Edhe në shqiptim duhet bërë dallimi kuptimor midis *ndiej* (provoj një ndjenjë) dhe *ndjej* (ia fal fajin dikujt).



## GRUPET E ZANOREVE UE, YE

§ 14. Gjuha letrare përmban një varg fjalësh të parme (si: *arsye, fyell, krye, lyej, pyes, thyej*) e të prejardhura (sidomos emra të vepruesit dhe mbiemra më *-shëm*) që përmbajnë grupin zanor *ue* (*dëgjues, mësues, i palexueshëm, i papajtueshëm, i vazhdueshëm*) ose grupin zanor *ye* (*i arsyeshëm, i pathyeshëm*). Në shqiptimin e grupeve të zanoreve në fjalët e këtij tipi vihen re luhatje të ndryshme, nën ndikimin e shqiptimeve dialektore e të traditës shqiptimore të varianteve letrare të mëparshme: disa i shqiptojnë të plota (*arsye, fyell, krye, lyej, pyes, thyej; dëgjues, mësues, i palexueshëm, i papajtueshëm, i vazhdueshëm; i arsyeshëm, i pathyeshëm* etj.), të tjerë i rrudhin përkatësisht në *y* dhe *u* (*arsy, fyll, kry, lyj, pys, thyj; dëgjus, mësus, i palexushëm, i papajtushëm, i vazhdushëm; i arsyshëm, i pathyshëm*). Në mjaft raste emrat më *-ues, -yes* dhe mbiemrat më *-ueshëm, -yeshëm*) shqiptohen edhe me *uë, yë* (*dëgjuës, mësues; i palexuëshëm, i pathyëshëm*).

Për shqiptimin e këtyre fjalëve në ligjërimin letrar do të udhëhiqemi nga drejtshkrimi, duke i shqiptuar ato me *ue* dhe *ye* të plotë. Pra, do të shqiptojmë ashtu siç shkruajmë: *arsye, fyell, krye, lyej, pyes, thyej, dëgjues, mësues, i palexueshëm, i papajtueshëm, i vazhdueshëm; i arsyeshëm, i pathyeshëm* (dhe jo *arsy, dëgjus, i palexushëm, i arsyshëm*, as *dëgjuës, mësues, i palexuëshëm*).

## III. DREJTSHQIPTIMI I BASHKËTINGËLLOREVE

### BASHKËTINGËLLORET E ZËSHME NË FUND E NË TRUP TË FJALËS

§ 15. Sipas pjesëmarrjes ose mospjesëmarrjes së zërit, bashkëtingëlloret, siç është përmendur në § 5, ndahen në të zëshme dhe në të shurdhëta.

Bashkëtingëlloret e zëshme *b, d, dh, g, gj, v, x, xh, z, zh*, kur gjenden në fund të fjalës ose në trup të saj përpara një bashkëtingë-

lloreje të shurdhët ose përpara bashkëtingëllores **n**, në ligjërimin letrar shqiptohen si të zëshme, ashtu siç shkruhen, p.sh.: *elb, fund, i madh, breg, qengj, hov, borxh, gaz, garazh; humbte, mundte, vendstrehim, hidhte, digjte, i hovshëm, hovte, i gazi, gaztor; humbni, mundni, mbliidhni, digjni* etj.)

Po me bashkëtingëllore të zëshme shqiptohen edhe mbiemrat e prejardhur me prapashtesën **-shëm** prej emrash femërorë tema e të cilëve gjatë fjalëformimit del më bashkëtingëllore të zëshme, p.sh.: *javë — i përjavshëm, buzë — i përbuzshëm, ndërgjegje — i ndërgjegjshëm*.

Shqiptimi i fjalëve të mësipërme me bashkëtingëllore të shurdhët (*elp, funt, i math, brek, qenq, hof, borç, gas, garash; humpte, muntte, ventstrehim, hithte, diqte, i hofshëm, hoftë, i gastë, gastor; humpni, muntni, mblithni, diqni; i përjafshëm, i përbusshëm, i ndërgjegjshëm*) përbën shkelje të normës letrare të sotme.

## BASHKËTINGËLLORET SH-/ZH-/Ç- NISTORE

§ 16. Për fjalët me **sh-/zh-/ç-** nistore (shpesh në funksion parashtese), siç dihet, drejtshkrimi ka dhënë këtë zgjidhje: Shkruhen me **sh-** fjalët ku kjo ndiqet nga një bashkëtingëllore e shurdhët (**f, k, p, q, t, th**), p.sh.: *shfryj, shkëput, shpyllëzim, shqetësoj, shtjelloj, shthur*; me **zh-**, kur kjo ndiqet nga një bashkëtingëllore e zëshme (**b, d, g, gj, v**), p.sh.: *zhbllokoj, zhdedh, zhgjakos*; me **ç-**, kur kjo ndiqet nga një zanore ose nga një bashkëtingëllore e tingullt (**l, ll, r, rr, m, n, nj, j**), p.sh.: *çarmatos, çlirimtar, çnjerëzor* etj. Siç shihet, për shkrimin e këtyre fjalëve drejtshkrimi mbështetet në parimin fonetik dhe merr parasysh natyrën e tingujve pasues. Shqiptimi letrar i sotëm, në stilin e tij të plotë, në të gjitha këto raste udhëhiqet nga drejtshkrimi, d.m.th., këto fjalë shqiptohen ashtu siç shkruhen.

## SHQIPTIMI I J-së

§ 17. Bashkëtingëllorja j ruhet në shqiptim:

a) Tek emrat dhe te fjalët e formuara prej tyre, ku kjo bashkëtingëllore ndërzanore i përket temës:

<i>anije</i>	dhe jo	<i>anie</i>
<i>bijë</i>	» »	<i>bi</i>
<i>e bija</i>	» »	<i>e bia</i>
<i>çaji</i>	» »	<i>çai</i>
<i>fëmijë</i>	» »	<i>fëmi</i>
<i>hije</i>	» »	<i>hie</i>
<i>hijerëndë</i>	» »	<i>hierëndë</i>
<i>hijeshi</i>	» »	<i>hieshi</i>
<i>hijshëm (i)</i>	» »	<i>hishëm (i)</i>
<i>kallaji</i>	» »	<i>kallai</i>
<i>korije, a -et</i>	» »	<i>korie</i>
<i>lloji</i>	» »	<i>lloi</i>
<i>maji</i>	» »	<i>mai</i>
<i>pajis</i>	» »	<i>pais</i>
<i>i pajisur</i>	» »	<i>paisur</i>
<i>shkëndijë</i>	» »	<i>shkëndi</i>
<i>vaji</i>	» »	<i>vai</i>

b) Tek emrat femërorë më -e të theksuar, gjatë trajtave të lakimit, kur zanorja e theksuar ndiqet nga një zanore tjetër:

<i>bé — béja</i>	dhe jo	<i>bea</i>
<i>dyshemé — dyshemeja</i>	» »	<i>dyshemea</i>
<i>haré — haréja</i>	» »	<i>harea</i>
<i>idé — idéja</i>	» »	<i>idea</i>
<i>kafé — kaféja</i>	» »	<i>kafea</i>
<i>ré — réja</i>	» »	<i>rea</i>
<i>rrufé — rruféja</i>	» »	<i>rrufea</i>
<i>e vé — e véja</i>	» »	<i>e vea</i>
<i>Koré — Koréja</i>	» »	<i>Korea</i>

c) Tek trajta e shquar e emrave femërorë, të cilët në njëjës in e pashquar para zanores e kanë bashkëtingëlloret mesgjuhore **gj,q**;

<i>lagje — lagjja</i>	dhe jo	<i>lagja</i>
<i>ndërgjegje — ndërgjegjja</i>	» »	<i>ndërgjegja</i>
<i>përgjigje — përgjigjja</i>	» »	<i>përgjigja</i>
<i>paqe — paqja</i>	» »	<i>paqa</i>

ç) Tek emrat e përgjithshëm dhe të përveçëm që dalin në **o** ë patheksuar (*depo, kosto, pako, Kongo, Niko* etj.) në trajtat e gjinore, dhanores e të rrjedhores së njëjësit të pashquar, si edhe të emërores së njëjësit të shquar *një depoje, kostoje, pakoje* etj.; *depoja, kostoja, pakoja, Kongoja, Nikoja* etj.;

Në emëroren e shquar këta emra, nën ndikimin e traditës dhe të dialekteve, herë-herë shqiptohen edhe duke zbërthyer zanoren **o** në **ua** (*depua, kostua, pakua, Kongua, Nikua* etj.). Në pajtim me drejtshkrimin, që ka marrë parasysh shqiptimin më të përgjithshëm dhe prirjen e sotme, këta emra duhet të shqiptohen me **-ja** dhe jo me **-ua**, pra:

<i>depoja</i>	dhe jo	<i>depua</i>
<i>kostoja</i>	» »	<i>kostua</i>
<i>Nikoj</i>	» »	<i>Nikua</i>

d) Tek foljet më **-aj, -ej, -ëj, -ij, -oj, -uj, -yj, -yej, -uaj, -yej**, në mënyrën urdhërore, kur u prapangjiten trajtat e shkurtra e dhe **i**: *arrij — arrije (shokun), arriji (shokët)* (dhe jo *arrie, arrii*); *kërkoj — kërkoheni (shokun), kërkoheni (shokët)* (dhe jo *kërkoeni, kërkoheni*); *laj — laje (fytyrën), laji (rrobat)* (dhe jo *lae, lai*); *punoj — punoj (tokën), punojeni (tokën)* (dhe jo *puno, punoeni*).

## NJ-ja NË TRUP E NË FUND TË FJALËS

§ 18. Shqiptohen me **nj** e jo me **j**:

a) emrat femërorë që kanë **nj** në trup të fjalës, p.sh.:

<i>banjë</i>	dhe jo	<i>bajë</i>
<i>beronjë</i>	» »	<i>berojë</i>
<i>brinjë</i>	» »	<i>brijë</i>
<i>finjë</i>	» »	<i>fijë</i>
<i>gështenjë</i>	» »	<i>gëshujë</i>
<i>mushkonjë</i>	» »	<i>mushkojë</i>
<i>shenjë</i>	» »	<i>shejë</i>
<i>shkronjë</i>	» »	<i>shkrojë</i>
<i>shushunjë</i>	» »	<i>shushujë</i>
<i>thinja-t</i>	» »	<i>thij-at</i>
<i>ujkonjë</i>	» »	<i>ujkojë</i>
<i>zonjë</i>	» »	<i>zojë</i>
<i>zonjushe</i>	» »	<i>zojushe etj.</i>

b) Trajtat e shumësit të emrave mashkullorë më zanore të theksuar:

<i>arí</i> — <i>arínj</i>	dhe jo	<i>arij</i>
<i>barí</i> — <i>barínj</i>	» »	<i>barij</i>
<i>budallá</i> — <i>budallénj</i>	» »	<i>budallej</i>
<i>kërcí</i> — <i>kërcínj</i>	» »	<i>kërcij</i>
<i>i rí</i> — <i>të rínj</i>	» »	<i>të rij</i>
<i>ullí</i> — <i>ullínj</i>	» »	<i>ullij</i>
<i>i zí</i> — <i>të zínj</i>	» »	<i>të zij</i> <sup>1)</sup>

c) Trajtat e shumësit të emrave mashkullorë më **-ua**:

<i>dragua</i> — <i>dragonj</i>	dhe jo	<i>dragoj</i>
<i>ftua</i> — <i>ftonj</i>	» »	<i>ftoj</i>
<i>përrua</i> — <i>përrenj</i>	» »	<i>përrej</i>
<i>thua</i> — <i>thonj</i>	» »	<i>thoj</i>

1) Shqiptohen me **j** dhe jo me **nj** emrat femërorë *mburojë, shtrojë*, si edhe shumësat e fjalëve: *kufi* — *kufij*, *i keq*, *e keqe* — *të këqij, të këqija, krua* — *kroje*.

ç) Trajatat e shumësit të emrave mashkullorë si:

<i>drapër</i>	—	<i>drapinj</i>	dhe jo	<i>drapij</i>
<i>gjarpër</i>	—	<i>gjarpërinj</i>	» »	<i>gjarpij</i>
	ose	<i>gjarpinj</i>	» »	<i>gjarpërij</i>
<i>lumë</i>	—	<i>lumenj</i>	» »	<i>lumej</i>
<i>shkëmb</i>	—	<i>shkëmbinj</i>	» »	<i>shkëmbij</i>

## BASHKËTINGËLLORJA H

§ 19. H-ja është një tingull i shkurtër. Rryma e ajrit që nxjerrim duke shqiptuar atë është mjaft e dobët, prandaj në mjaft raste ajo ndihet pak ose mezi ndihet. Tingulli h mund të ndodhet në fillim të fjalës, p.sh.: *ha, habitem, hardhi, harroj, hedh, hero, hesht, hënë, e hënë, hi, hije, hinkë, hithra, hollë, hosten, hov, hu, i huaj, hudhër, hyj* etj., në mes, p.sh.: *lahem, kthehem, bëhem, fshihem, tregohu, mësohu, shtyhu*, ose në fund, p.sh.: *ah, gjah, krah, pah, pleh, deh, ftoh, leh, nxeh, njoh* etj.

Bashkëtingëllorja h ndihet më mirë kur ndodhet në fillim të fjalës, sesa kur ndodhet në mes a në fund të saj. Në pajtim me drejtshkrimin h-ja në ligjërimin libror duhet të shqiptohet në të tria pozicionet<sup>1)</sup>. Shqiptimi pa h i fjalëve që e përmbajnë këtë tingull, është në kundërshtim me normën letrare kombëtare të sotme.

Në kundërshtim me normën është edhe rasti i kundërt, kur, nën ndikimin dialektor, shtohet në fillim të disa fjalëve një h, p.sh.: *hana, harritur, hec, hik, hindian, hoborr*, etj.

Këto fjalë duhen shqiptuar dhe shkruar pa h: *ana, arritur, ec, ik, indian, oborr*.

H-ja ruhet në shkrim dhe në shqiptim edhe në fjalët me prejardhje të huaj që e kanë. Shqiptohen me h, ashtu siç shkruhen, fjalë si: *hajdut, hajmali, haliç, hallkë, hambar, han, haraç, harar, harmoni, hartë, harxh, hasm, hashash, hashure, hava, havan, havjar, hebraik, hejbe, hezkakorant, helen, helikë, hemoglobinë, hepatit, hibrid, hidrocentral, hidrogjen, higjienë, hipizëm, hipnozë, hipodrom, hipokrit, histeri, histologji, histori, homonim, hordhi, hotel, hyzmet, koherent, kohezion* etj. (dhe jo *ajdut, ajmali, aliç, allkë, ambar, an, araç, arar*,

1) Për fjalët që kanë h shih «Drejtshkrimi i gjuhës shqipe» § 27.

armoni, artë, arxh, asmë, ashash, ashure, ava, avan, avjar, ebraik, ejbë, ekzaklorant, elen, elikë, emoglobinë, epatit, ibrid, idrocentral, idrogjen, igjienë, ipizëm, ipnozë, ipodrom, ipokrit, isteri, istologji, istori, omonim, ordhi, otel, yzmet, koerent, koezion etj.). Po ashtu, shqiptohen me **h**, siç shkruhen, edhe emrat e përveçëm të njerëzve dhe të vendeve si: *Hajne, Hesiodi, Hipokrati, Homeri, Hagë, Hanoi, Havanë, Hungari* (po kështu hungarez).

Herë-herë, nën ndikimin e shqiptimit dialektor, disa fjalë me **h** në pozicion fundor, si p.sh.: *ftoh, mpreh, njoh, shoh* etj., shqiptohen me **f**, p.sh.: *ftof, mpref, njof, shof*. Shqiptimi me **f** i këtyre fjalëve është një shkelje e normës së sotme drejtshqiptimore. Fjalët e mësipërme duhet të shqiptohen kurdoherë me **h** dhe jo me **f**<sup>1)</sup>.

## BASHKËTINGËLLORJA RR

§ 20. Bashkëtingëllorja **rr** është një tingull-fonemë (shih § 3). Ajo mund të ndodhet në fillim, në mes dhe në fund të fjalës; shqiptohet e qartë dhe në mënyrë të dallueshme nga **r**-ja në të tria këto pozicione.

Shqiptohen me **rr** fjalë si:

a) *rrafsh, rrah, (i,e) rrallë, rrap, rras, rrebesh, (i,e) rremë, rrenë, (i,e) rreptë, rresht, rreshtor, rreth, rreth e rrotull, rrethim, rreze, rrezik, rrëfej, rrëfim, rrëmbej, rrëmih, rrëmujë, rrënoj, rrënjë, rrënjësor, rrëpirë, rrëqethem, rrëshqas, rrëzë, rrëzoi, rri, rrip, rrit, rrjedh, rrjep, rrjetë, rrobë, rrodhe, rroftë, rrogë, rroj, rrok, rrokje, rrokullis, rropatëm, rrotë, rruaj (mjekrën, por ruaj shtëpinë), rruaza, rrudhë, rrudh, rrudhje, rrufe, fletërrufe, rrugë, rrugor, rrush, rruzull, rrymë etj.*

b) *arrë* (pemë, por: *arë* me *grurë*), *arrogancë, barrë, bërryl, birrë* (pije, por: *birë* «vrimë»), *burracak, burrë, burrëcr, ferrë, furrë, karrige, kërrabë, kërraç, korrik, korrje, kurrë, kurriz, mëshqerrë, murriz, përrallë, përrua, (i,e) pjerrët, qerre* («mjet transporti»), por: *qere* «sëmundje lëkure»), *qurra, skëterrë, sorrë, sterrë, sharrë, shkurre, terror, terrorist, urra!, zorrë etj.*

1) Bëjnë përjashtim fjalët *njoftoj, njoftim* (nga *njoh*), të cilat janë ngulitur prej kohësh në gjuhën letrare, në shkrim e në shqiptim, me trajtën më **f**.

c) *berr, çjerr, derr, ëndërr, horr, kokërr, korr, marr, morr, nxjerr, oborr, qorr, tjerr, tmerr, varr, (i, e) vocërr, vjehërr, zjarr, zhavorr.*

**Shënim 1.** Nga foljet që shqiptohen dhe shkruhen me rr në kohën e tashme të dëftores, ato që në të kryerën e thjeshtë pësojnë ndërrimin je : o, ose a : o, në këtë kohë shqiptohen dhe shkruhen me r: *çjerr* (por: *çora, çore, çori, çorëm, çorët, çorën*), *marr* (por: *mora, more, mori, morëm, morët, morën*), *nxjerr* (por: *nxora, nxore, nxori, nxorëm, nxorët, nxorën*), *tjerr* (por: *tora, tore, tori, torëm, torët, torën*), por: *korr, korra, korre, korri, korrëm, korrët, korrën, tkurr, tkurra, tkurre, tkurri, tkurrëm, tkurrët, tkurrën.*

**Shënim 2.** Shqiptohen dhe shkruhen me r dhe jo me rr fjalët: *karotë, (i,e) ngurtë, racë, radhë, rebel, remtar, resht* (pushoj), *reshje, regjistër, rënkoj, rol, ryshfet, shter, i pashtershëm* (dhe jo *karrotë, (i, e) ngurrhtë, rracë, rradhë, rrebel, rremtar, rresht*, (pushoj) *rreshje, rregjistër, rrënkoj, rrol, rryshfet, shterr, i pashterrshëm*).

## TAKIME BASHKËTINGËLLORESH

### § 21. TAKIMI I G-së OSE I N-së ME J-në

Ka fjalë dhe trajta fjalësh me theks në rrokjen e parafundit tek të cilat g-ja ose n-ja e temës takohet me j-në e prapashtesës a të mbaresës (*djeg + je, marrëdhën + je, partizan + ja, pedagog + ja* etj.). Për drejtshqiptimin takimi i g-së ose i n-së me j-në s'përbën problem: secili tingull ruan mëvetësinë, shqiptohet si tingull më vete. Duhet pasur parasysh se drejtshkrimi, për të mënjeluar shqiptimin e këtyre dy shkronjave si një tingull të vetëm (gj, nj), kërkon që fjalët e këtij tipi të shkruhen me i dhe jo me j (*djegje, marrëdhënie, partizania, pedagogia*). Këto fjalë, pavarësisht nga shkrimi, duhet t'i shqiptojmë me j dhe jo me i (*djeg + je, marrëdhën + je, partizan + ja, pedagog + ja*), pra njëlloj si edhe fjalët e tjera të formuara në mënyrë analoge, po ku nuk takohet g-ja ose n-ja me j-në, si p.sh.: *ndar + je përhap + je, pjek + je, prit + je; përgjegjës + ja, student + ja*, etj.



## IV. DREJTSHQIPTIMI I FJALËVE ME PREJARDHJE TË HUAJ

§ 22. Në leksikon e gjuhës sonë, në kohë dhe në rrugë të ndryshme kanë hyrë një numër fjalësh nga gjuhë të tjera ose nga terminologjia ndërkombëtare. Këto fjalë, që i takojnë sidomos terminologjisë tekniko-shkencore, kanë depërtuar në gjuhën shqipe kryesisht nëpërmjet gjuhës së shkruar.

Zgjidhjet që janë dhënë në «Drejtshkrimin e gjuhës shqipe» (kreu i tretë) për shkrimin e fjalëve dhe të emrave të përveçëm me prejardhje të huaj, duhet të shërbejnë si bazë edhe për drejtshqiptimin e këtyre fjalëve.

Këtu po ndalemi tek një varg veçorish të shqiptimit të disa grupeve të fjalëve me prejardhje të huaj.

§ 23. Te fjalët që në shkrim kanë *-ia-*, *-ie-*, *-io-*, *-iu-* me *i* të patheksuar në trup të tyre (qoftë kur *kjo i* bën pjesë në rrokje të theksuar, qoftë kur ajo bën pjesë në rrokje të patheksuar), *i*-ja shqiptohet si një tingull që qëndron midis *i*-së dhe *-j*-së, p.sh.: *aviator, brazilian, diagnozë, diafragmë, diagonale, diagramë, dialekt, dialektik, dialektor, dialog, diapazon, diatezë, materializëm, specialist; bankier, kantier, pionier; portier, poliomielit, mision, seksion, sesion, televizion, violinë; barium, silicium, stadium.*

**Shënim.** Te një numër fjalësh të tjera që kanë në trup grupet e mësipërme, *i*-ja ruhet më mirë si e tillë në shqiptim. Këto janë fjalë që fillojnë me elementet *bio-*, *mio-*, *trio-*, p.sh.: *biokimi, biologji, biogjen, biosferë, biomekanikë, biofizikë, biotik,-e, bioenergjetikë; miokard, miokardit, miocen, miop; triodë, trioleinë, triolet* etj.

Afërsisht si *j* shqiptohet *-i*-ja edhe te fjalët që përmbajnë grupin *-ie*, në rrokje pastheksore, p.sh.: *arie, malarie, materie, mumie.*

Por te fjalë të tjera të këtij tipi, si: *austriak, elegjiak, industrial, higjienë* etj., ku shqiptimi *i* *i*-së afërsisht si *j* do të krijonte një grup bashkëtingëlloresh që shqiptohet me vështirësi (*strj, gj*), zanorja *i* edhe gjatë shqiptimit ruan cilësinë e saj, pra shqiptohet *i*.

§ 24. Fjalët me prejardhje të huaj që shkruhen me *-oo-* (*alkool, kooperativë, kooptoj, koordinatë, zoogjeografi, zoolog, zoomorfizëm, zoopatologji, zooteknik* etj.), në stilin e plotë libror shqiptohen me

-oo- dhe jo me -o-, pra: *alkool, kooperativë, zoologji* etj. (dhe jo *alkol, koperativë, zologji*).

§ 25. Fjalët me prejardhje të huaj që shkruhen me c të ndjekur nga zanorja i ose e, shqiptohen gjithashtu me c dhe jo me ç: *acid, brakicefal, celebrim, celulë, central, cikël, ciklamin, ciklon, ciklostil, cirilik, cisternë, citrik, deficit, elektrikist, incizoj, koncert, koncesion, konciz, proces, recension, recetë, suficit* etj.

Bëjnë përjashtim fjalët *biçikletë, çiklist, çiklizëm, çimento*, shqiptimi dhe shkrimi me ç i të cilave është ngulitur prej kohësh.

§ 26. Shqiptohen, ashtu siç shkruhen, d.m.th. me d, t, dhe jo me dh, th, fjalët ndërkombëtare me burim nga greqishtja e vjetër, si p.sh.: *olimpiadë, antologji, antropolog, entuziazëm, maratonë, patetik, patolog, simpati, teatër, temë, tezë* etj.

§ 27. Shqiptohen me l, ashtu si shkruhen dhe jo me ll fjalët me prejardhje të huaj, si: *atlas, diplomat, diplomë, falsifikim, filozof, ideologji, komplot, logjikë, lustër, psikologji, spekuloj* etj.

§ 28. Ndër fjalët me prejardhje të huaj ka të tilla që ende shqiptohen në mënyra të ndryshme. Për shqiptimin e drejtë të tyre duhet të mbështetemi tek drejtshkrimi. Në pajtim me të, do të shqiptohen drejt fjalët si:

<i>adjutant</i>	dhe jo	<i>axhutant</i>
<i>agjenci</i>	» »	<i>agjensi, axhensi</i>
<i>arkipelag</i>	» »	<i>arqipelag</i>
<i>autobus</i>	» »	<i>autobuz</i>
<i>bibliotekë</i>	» »	<i>biblotekë</i>
<i>dezinfektim</i>	» »	<i>dizinfektim</i>
<i>dispensë</i>	» »	<i>dispencë</i>
<i>dizenteri</i>	» »	<i>dizanteri</i>
<i>egjiptian</i>	» »	<i>egjyptian</i>
<i>ekskavator</i>	» »	<i>eskavator</i>
<i>ekskursion</i>	» »	<i>eskursion</i>
<i>higjienë</i>	» »	<i>higjenë, hygjenë</i>
<i>injeksion</i>	» »	<i>inzheksion, inxheksion</i>
<i>inventar</i>	» »	<i>iventar</i>
<i>juri</i>	» »	<i>zhuri</i>

<i>kazermë</i>	dhe	jo	<i>gazermë</i>
<i>kolegjum</i>	»	»	<i>kolegjum</i>
<i>kompetencë</i>	»	»	<i>kopetencë</i>
<i>kuotizacion</i>	»	»	<i>kotizacion</i>
<i>lajtmotiv</i>	»	»	<i>leitmotiv</i>
<i>legjion</i>	»	»	<i>legjon</i>
<i>makinë</i>	»	»	<i>maqinë</i>
<i>manjolie</i>	»	»	<i>magnolie</i>
<i>mensë</i>	»	»	<i>mencë</i>
<i>neurolog</i>	»	»	<i>nevrolog</i>
<i>neurologji</i>	»	»	<i>nevrologji</i>
<i>oligarki</i>	»	»	<i>oligarqi</i>
<i>plenum</i>	»	»	<i>plenium</i>
<i>projektor</i>	»	»	<i>prozhektor</i>
<i>psikiatri</i>	»	»	<i>psihiatri</i>
<i>qeramikë</i>	»	»	<i>keramikë</i>
<i>regjisor</i>	»	»	<i>regjizor</i>
<i>reumatizëm</i>	»	»	<i>rematizëm</i>
<i>simfoni</i>	»	»	<i>sinfoni</i>
<i>simptomë</i>	»	»	<i>simtomë</i>
<i>transistor</i>	»	»	<i>tranzistor</i>
<i>volejball</i>	»	»	<i>voliboll</i>
<i>zero</i>	»	»	<i>xero</i>
<i>zhongler</i>	»	»	<i>xhongler</i>

si edhe fjalë të tjera të formuara prej tyre ose të një tipi me to.

## V. THEKSI

§ 29. Në gjuhën shqipe theksi mund të bjerë në çdo rrokje të fjalës (*liri, paralajmërim, dritë, i kujdësshëm, pópulli, i kátërti*), por në pjesën më të madhe të fjalëve bie në rrokjen e parafundit (*mírë, dérë, ngjýrë, rrúgë, gurgdhëndës* etj.). Si rregull, emrat gjatë lakimit dhe foljet gjatë zgjedhimit e ruajnë theksin mbi të njëjtën rrokje (p.sh., *libër, librave; lexója, lexóje, lexónte, lexóva, lexóve, lexóji*).

Për fjalët e huaja (qoftë emra të përveçëm ose të përgjithshëm) që hyjnë në gjuhën tonë, theksi zakonisht rregullohet sipas natyrës së shqipes: në shumicën e rasteve bie në rrokjen e parafundit, por në disa raste bie edhe në rrokjen e fundit:

a) Theksi bie në rrokjen e parafundit në fjalë (kryesisht terma ndërkombëtare), si:

*bionikë-a* dhe jo *biònika*  
*elektronikë-a* » » *elektrònika*  
*kibernetikë-a* » » *kibernétika etj.*

b) Theksi bie në rrokjen e fundit në fjalë si:

*bariúm* dhe jo *bárium*  
*forúm* » » *fórum*  
*kaliúm* » » *kálim*  
*magneziúm* » » *magnéziúm*  
*natriúm* » » *nátrium*  
*plenúm* » » *plénum*

c) Tek një varg huazimesh nga turqishtja, si: *bakër, hatër, hasude, perde, qoshe, qese, teneqe, tenxhere, xhezve, shishe* etj., në gjuhën e folur, nën ndikimin e dialekteve, vihen re luhatje në shqiptim. Këto fjalë në pjesën më të madhe të të folmeve jugore shqiptohen me theks në rrokjen e fundit (*bakër, hatër, ... tenxheré* etj.), ndërsa në të folmet veriore, me theks në rrokjen e parafundit (*bákër, hátër, tenxhère* etj.). Sot, në përgjithësi, është normë letrare shqiptimi i këtyre fjalëve me theks në rrokjen e parafundit (*bákër, hátër, hasúde, pérde, qóshe, qése, tenéqe, tenxhère, xhézve, shíshe* etj.).

# LITERATURË PLOTËSUESE\*

## I

### Studime të përgjithshme

- Aleksandër Xhuvani «*Parashtesat e gjuhës shqipe*, në «Çështje të —Eqrem Çabej, gramatikës së shqipes së sotme» II, Tiranë, 1975, f. 5-55.
- Aleksandër Xhuvani «*Prapashtesat e gjuhës shqipe*», Tiranë, 1962 —Eqrem Çabej,
- Anastas Dodi, *Drejtshtkrimi dhe shqiptimi letrar*, në «Kongresi i Drejtshtkrimit të Gjuhës Shqipe» I, Tiranë, 1973, f. 289-298.
- Androkli Kostallari, «*Gjuha e sotme letrare shqipe dhe disa probleme themelore të drejtshtkrimit të saj*», Tiranë, 1973 dhe në «Kongresi i Drejtshtkrimit të Gjuhës Shqipe» I, f. 51-135.
- Androkli Kostallari, *Mbi disa veçori strukturore e funksionale të gjuhës letrare shqipe të kohës sonë*, në «Studime filologjike», 2, 1970, f. 3-51 dhe në «Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe» I, Tiranë, 1972, f. 7-50.
- Androkli Kostallari, *Mbi tiparet kryesore të shqipes së sotme letrare*, në «Shkencat shoqërore në shkollë», 1967, f. 61-74.
- Androkli Kostallari, *Parimet themelore për hartimin e «Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe»*, në «Studime filologjike» 2, 1968, f. 43-134 dhe në «Studime

---

\*) Kjo literaturë plotësuese përfshin një numër studimesh të rëndësishme për gjuhën e sotme letrare, të cilat mund t'u shërbejnë të gjithë atyre që dëshirojnë të zgjerojnë e të thellojnë njohuritë në këtë fushë. Duke qenë se një pjesë e këtyre studimeve janë shkruar disa kohë më parë, në to nganjëherë ka zgjidhje e përfundime që nuk janë tërësisht në pajtim me normën e sotme letrare. Në të gjitha këto raste duhen pranuar si normative zgjidhjet e rekomandimet që jepen në tekstin «*Gjuha letrare shqipe për të gjithë*» dhe në botimet e fundit të gramatikave shkollore.

mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe» II, Tiranë, 1972, f. 3-78.

*Formimi i gjuhës letrare kombëtare shqipe dhe veçoritë themelore të normës së sotme gjuhësore* (dispensë, botim i Fakultetit të Shkencave Politiko-Juridike) Tiranë, 1975, I 136 f., II 326 f.

Jorgji Gjinari,

*Gjuha letrare, drejtshkrimi dhe dialektet e shqipes*, në «Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe» I, Tiranë, 1973, f. 299-307.

## II

### Studime të veçanta

Ali Dhrimo,

*Formimi i mbiemrave në gjuhën e sotme shqipe*, në «Studime filologjike» 3, 1972, f. 43-80 dhe në «Çështje të gramatikës së shqipes së sotme» II, Tiranë, 1975, f. 141-188.

Ali Dhrimo,

*Vëzhgime rreth ngulitjes së normës gjuhësore në publicistikën e pasçlirimit*, në «Studime filologjike» 3, 1969, f. 125-152.

Androkli Kostallari,

*Kompozitat dëshirore dhe urdhërore të shqipes*, në «Studime filologjike» 4, 1968, f. 23-70 dhe në «Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe» I, Tiranë, 1972, f. 153-190.

Androkli Kostallari,

*Kompozitat ekzocentrike të shqipes si tema fjalëformuese*, në «Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës», seria shkencat shoqërore, 3, 1962, f. 3-48 dhe në «Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe» I, Tiranë, 1972, f. 95-135.

- Androkli Kostallari, *Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe*, në «Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës», seria shkencat shoqërore, 3, 1961, f. 3-24 dhe «Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe» I, 1972, f. 75-90.
- Enver Hysa, *Formimi i ndajfoljeve me prapashtesa në shqipen e sotme letrare*, në «Studime filologjike», 1, 1970, f. 111-120.
- Fatmir Agalliu, *Emrat që përdoren vetëm në shumës në gjuhën shqipe*, në «Çështje të fonetikës dhe të gramatikës së shqipes së sotme» I, Tiranë, 1972, f. 87-105.
- Ferdinand Leka — Sofika Morcka, *Zhvillimi dhe pasurimi i terminologjisë pas Çlirimit*, në «Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe» II, Tiranë, 1972, f. 185-194.
- Jani Thomaj, *Mbi rendin e fjalëve në strukturën e frazeologjizmave të shqipes*, në «Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe» I, Tiranë, 1972, f. 385-394.
- Mehmet Çeliku, *Çështje të normës morfologjike në letërsinë artistike pas Çlirimit*, në «Studime filologjike» 3, 1969, f. 109-124.
- Menella Totoni, *Konstrukte me folje aspektive të fillimit të veprimit në gjuhën shqipe*, në «Studime filologjike» 1, 1968, f. 85-96.
- Menella Totoni, *Trajtat e pjesores së foljeve me temë në likuide në toskërishten*, në «Studime filologjike» 4, 1965, f. 133-140.
- Miço Samara, *Mbi leksikun politiko-shoqëror të shqipes dhe mbi zhvillimin e tij pas Çlirimit*, në «Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe» I, Tiranë, 1972, f. 275-282.

- Miço Samara, *Vëzhgime mbi antonimet me parashtesa në gjuhën shqipe*, në «Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe» I, Tiranë, 1972, f. 237-243.
- Pavli Haxhillazi, *Vëzhgime mbi mbiemrat foljorë me prapashtesën -shëm në gjuhën shqipe*, në «Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe» I, Tiranë, 1972, f. 257-272.
- Shaban Demiraj, «*Çështje të sistemit emëror të gjuhës shqipe*», Tiranë, 1972.
- Xhevat Lloshi, *Mbi studimin e veçorive stilistike të shqipes*, në «Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe» I, Tiranë, 1972, f. 477-487.



## PASQYRA E LËNDËS

	Faqe
PJESA I: ÇËSHTJE TË MORFOLOGJISË . . . . .	10
I. E M R I . . . . .	11
Gjinia . . . . .	11
Shumësi i emrave . . . . .	13
Shumësi i emrave mashkullorë . . . . .	14
Shumësi i emrave femërorë . . . . .	32
Emra që përdoren vetëm në shumës . . . . .	36
Lakimi i emrave . . . . .	37
Lakimi i parë . . . . .	38
Lakimi i dytë . . . . .	40
Lakimi i tretë . . . . .	42
Lakimi i katërt . . . . .	43
Lakimi i emrave në numrin shumës . . . . .	44
Disa vërejtje për përdorimin e trajtës . . . . .	48
Ndërrimi i gjinisë së disa emrave mashkullorë në numrin shumës . . . . .	49
II. N U M Ë R O R I . . . . .	52
III. P Ë R E M R I . . . . .	53
1. Përemri vetor . . . . .	53
Lakimi i përemrave vetorë . . . . .	53
Vërejtje rreth disa përdorimeve të gabuara të përemrave vetorë . . . . .	55
Trajtat e shkurtra të përemrave vetorë . . . . .	57
Vërejtje rreth disa përdorimeve të gabuara të trajtave të shkurtra të përemrave vetorë . . . . .	59

2. Përemri pronor . . . . .	63
Lakimi i përemrave pronorë . . . . .	66
Përdorime të gabuara të disa trajtave të përemrave pronorë: . . . . .	73
A. Mospërshtatje në rasë . . . . .	74
B. Mospërshtatje në gjini . . . . .	79
Përemri pronor <i>i(e,të,)vet</i> . . . . .	81
3. Përemri pyetës . . . . .	85
IV. NYJAT TEK EMRI, MBIEMRI, NUMËRORI DHE PËREMRI . . . . .	88
Funksionet dhe karakteristikat gramatikore të nyjave . . . . .	88
Lakimi i nyjave . . . . .	90
Disa raste kur duhet përdorur nyja të dhe jo së . . . . .	94
Disa raste kur duhet përdorur nyja së dhe jo të . . . . .	96
Disa çështje të tjera të përdorimit të nyjave . . . . .	87
V. FOLJA . . . . .	100
Folje kalimtare e jokalimtare . . . . .	100
Diatezat e foljes . . . . .	101
Mënyrat e foljes . . . . .	102
Koha, veta dhe numri i foljes . . . . .	103
Foljet <i>kam</i> e <i>jam</i> . . . . .	104
Ndarja e foljeve në zgjedhime . . . . .	108
Zgjedhimi i parë . . . . .	109
Zgjedhimi i dytë . . . . .	115
Zgjedhimi i tretë . . . . .	121
Foljet e parregullta . . . . .	127
Vërejtje rreth përdorimit të disa trajtave foljore . . . . .	128
Mënyra dëftore . . . . .	128
E tashmja dhe e pakryera . . . . .	128
E kryera e thjeshtë . . . . .	135
Mënyra lidhore . . . . .	139
Mënyra habitore . . . . .	142
Mënyra dëshirore . . . . .	142
Mënyra urdhërore . . . . .	146
Pjesorja . . . . .	149
Vërejtje rreth disa foljeve të parregullta . . . . .	152

	Faqe
<b>PJESA II: ÇËSHTJE TË SINTAKSËS</b>	155
<b>I. PËRDORIMI I EMRIT NË TRAJTË TË SHQUAR DHE TË PA-SHQUAR</b>	157
Trajta e emrit të shoqëruar nga një përemër dëftor	157
Trajta e emrit të shoqëruar nga nyja <i>një</i>	159
Trajta e emrit të shoqëruar nga një numëror	160
Trajta e mbiemrit të emëruar	160
<b>II. PËRDORIMI I FOLJES NË FUNKSIONIN E KALLËZUESIT</b>	162
Përdorimi i foljeve gjysmëndihmëse <i>mund e duhet</i> përpara një foljeje në lidhore	162
Përshtatja e foljeve-kallëzues në kohë	164
Përshtatja e kallëzuesit me kryefjalën	167
Ndërtimi pësor	170
<b>III. EMRI DHE PËREMRI NË FUNKSIONIN E KUNDRINORIT</b>	172
Përdorimi i emrit në funksionin e kundrinorit pranë një emri foljor	172
Përdorimi i trajtave të shkurtra të përemrave vetorë	173
<b>IV. MBIEMRI DHE EMRI NË FUNKSIONIN E PËRCAKTORIT</b>	175
Përshtatja e mbiemrit ose e përemrit që përcakton një varg gjymtyrësh homogjene	175
Rendi i përcaktorëve të një gjymtyre.	176
<b>V. PËRDORIMI I NYJAVE, I PARAFJALËVE DHE I PJESËZAVE PARA GJYMTYRËVE HOMOGENE. FOLJET NDIHMËSE NË KALLËZUESIT HOMOGENË</b>	180
Përdorimi i nyjave para gjymtyrëve homogjene	180
Përdorimi i parafjalëve para gjymtyrëve homogjene	181
Përdorimi i pjesëzave para gjymtyrëve homogjene	182
Përdorimi i foljeve ndihmëse në kallëzuesit homogjenë	183

VI. PËRDORIMI I DISA PARAFJALËVE, I DISA LIDHËZAVE DHE I DISA FJALËVE LIDHËSE . . . . .	184
<i>Mbi</i> . . . . .	184
<i>Në drejtim (të)</i> . . . . .	185
<i>Prej</i> . . . . .	185
<i>Midis, në mes, përmes dhe ndërmjet</i> . . . . .	186
Përdorimi i përemrit lidhor <i>që</i> . . . . .	187
<i>Nga ku, prej ku, prej nga</i> . . . . .	188
<i>Gjë që, gjë e cila</i> . . . . .	189
<i>Apo</i> . . . . .	190
PJESA III: ÇËSHTJE TË FORMIMIT TË FJALËVE . . . . .	191
H Y R J E . . . . .	193
I. SI FORMOHEN FJALËT E REJA NË SHQIPEN E SOTME LETRARE . . . . .	196
Ndërtimi i fjalës. Ndarja e fjalëve sipas formimit të tyre . . . . .	196
Analiza e fjalës sipas ndërtimit dhe sipas formimit të saj . . . . .	198
II. TIPAT FJALËFORMUES PRODUKTIVË DHE AKTIVË NË SHQIPEN E SOTME LETRARE . . . . .	201
A. FJALËT E PREJARDHURA . . . . .	203
1. FJALË TË FORMUARA ME PARASHTESA . . . . .	203
Formime me parashtesën <i>pa-</i> . . . . .	203
Formime me parashtesën <i>mos-</i> . . . . .	205
Formime me parashtesën <i>jo-</i> . . . . .	205
Formime me parashtesën <i>për-</i> . . . . .	206
Formime me parashtesën <i>ç-/sh-/zh-</i> . . . . .	206
Formime me parashtesat <i>mbi- e nën-</i> . . . . .	207

SHQIPËRIMI I DISA PARASHTESAVE TË HUAJA . . . . .	208
<b>2 FJALË TË FORMUARA ME PRAPASHTESA</b>	<b>211</b>
Prapashtesa <b>-(ë)s</b> . . . . .	211
Prapashtesat <b>-ar, -tar</b> . . . . .	212
Prapashtesat <b>-or, -tor</b> . . . . .	214
Prapashtesa <b>-ist</b> . . . . .	216
Prapashtesa <b>-im</b> . . . . .	216
Prapashtesa <b>-imë</b> . . . . .	217
Prapashtesa <b>-esë</b> . . . . .	217
Prapashtesa <b>-je</b> . . . . .	218
Prapashtesa <b>-ishte/-ishtë</b> . . . . .	220
Prapashtesat <b>-i, -(ë)si, -(ë)ri</b> . . . . .	220
Prapashtesa <b>-shëm</b> . . . . .	224
Prapashtesat <b>-o-, -ro-, -fo-, -so-, -zo-</b> . . . . .	227
Prapashtesa <b>-os</b> . . . . .	230
Prapashtesa <b>-as/-azi</b> . . . . .	231
Prapashtesat <b>-(i)sht</b> . . . . .	231
 SHQIPËRIMI I DISA PRAPASHTESAVE TË HUAJA . . . . .	 233
<b>3. FJALË TË FORMUARA NJËKOHËSISHT ME PARASHTESË E ME PRAPASHTESË</b> . . . . .	<b>235</b>
<b>4. FJALË TË FORMUARA PA PARASHTESA A PRAPASHTESA</b>	<b>236</b>
1. Emërzimi . . . . .	237
2. Mbiemërzimi . . . . .	240
a) Mbiemrat e panyjshëm . . . . .	240
b) Mbiemrat e nyjshëm . . . . .	240
3. Ndajfoljezimi . . . . .	241
4. Parafjalëzimi . . . . .	242
 <b>B. FJALËT E PËRBËRA (KOMPOZITAT)</b>	 243
Tipat kryesorë të kompozitave emra . . . . .	245
1. Tipi <i>emër + emër</i> . . . . .	245
2. Tipi <i>ndajfolje + emër</i> . . . . .	247

3. Tipi <i>numëror</i> (ose <i>shumë</i> ) + <i>emër</i> në <i>rrejdhorë të pashquar shumë</i> s . . .	248
4. Tipi <i>përemër</i> + <i>emër</i> . . . . .	248
5. Tipi <i>folje</i> + <i>emër</i> . . . . .	249

Tipat kryesorë të kompozitave mbiemra . . . . .	249
---	-----

1. Tipi <i>emër</i> + <i>emër</i> . . . . .	249
2. Tipi <i>emër</i> + <i>mbiemër</i> . . . . .	250
3. Tipi <i>numëror</i> (ose <i>përemër</i> ) + <i>mbiemër</i> . . . . .	250
Tipat kryesorë të kompozitave folje . . . . .	252
1. Tipi <i>ndajfolje</i> + <i>folje</i> . . . . .	252
2. Tipi <i>emër</i> + <i>folje</i> . . . . .	253
Kompozitat pa takim . . . . .	253
Shkurtesat . . . . .	253

C. FJALË TË FORMUARA NJËKOHËSISHT ME KOMPOZIM E ME PRAPASHTESIM. . . . .	254
Ç. FJALËT E PËRNGJITURA. . . . .	254

#### PJESA IV: DISA NGA RREGULLAT KRYESORE TË DREJTSHQIPTI-MIT TË GJUHËS LETRARE SHQIPE . . . . .

257

##### I. NJOHURI TË PËRNGJITHSHME . . . . .

259

Objekti i drejtshqiptimit. Drejtshqiptimi dhe drejtshkrimi . . . . .	259
Stilet e shqiptimit . . . . .	260
Tingujt e gjuhës letrare shqipe . . . . .	261

##### II. DREJTSHQIPTIMI I ZANOREVE . . . . .

262

Zanorja e e theksuar . . . . .	262
Zanorja ë . . . . .	263
Zanorja ë e theksuar. . . . .	264
Zanorja ë e patheksuar . . . . .	265
Zanorja ë paratheksore . . . . .	265
a) Ë-ja paratheksore të fjalët e pame dhe të fjalët ku ajo ndodhet në rrokjen e parë . . . . .	265
b) Ë-ja paratheksore të fjalët e prejardhura me prapashtesa . . . . .	265

c) Ë-ja paratheksore në kufi të temave të fjalët e përbëra dhe të përngjitur	266
Zanorja ë pastheksore	267
A. Ë-ja pastheksore jofundore	267
B. Ë-ja pastheksore fundore	269
Zanoret u dhe y	272
Zanorja i	273
Grupi i zanoreve ie	273
Grupet e zanoreve ue, ye	274
III. DREJTSHQIPTIMI I BASHKËTINGËLLOREVE	
Bashkëtingëlloret e zëshme në fund e në trup të fjalës	274
Bashkëtingëlloret sh-/zh-/ç- nistore	275
Shqiptimi i j-së	276
Nj-ja në trup e në fund të fjalës	278
Bashkëtingëllorja h	279
Bashkëtingëllorja rr	280
Takime bashkëtingëlloresh	281
Takimi i g-së ose i n-së me j-në	281
IV. DREJTSHQIPTIMI I FJALËVE ME PREJARDHJE TË HUAJ	282
V. THEKSI	284
LITERATURE PLOTËSUESE	286

Tirazhi: 30 000 kopje

Formati: 60 x 88/16

Stash. 2204-72

Shtypur në Kombinatin Poligrafik  
Shtypshkronja «MIHAL DURI» — Tiranë